

PROCESSING COPY

CENTRAL INTELLIGENCE AGENCY

INFORMATION REPORT

S-E-C-R-E-T

This Document contains information affecting the National Defense of the United States, within the meaning of Title 18, Sections 793 and 794, of the U.S. Code, as amended. Its transmission or revelation of its contents to or receipt by an unauthorized person is prohibited by law. The reproduction of this form is prohibited.

25X1

~~SECRET~~

COUNTRY	Albania	REPORT	
SUBJECT	Albanian Workers (Communist) Party	DATE DISTR.	31 January 1957
DATE OF INFO.		NO. OF PAGES	1
PLACE ACQUIRED		REQUIREMENT NO.	RD <i>Reel #90</i>
DATE ACQUIRED		REFERENCES	

25X1

THE SOURCE EVALUATIONS IN THIS REPORT ARE DEFINITIVE.
THE APPRAISAL OF CONTENT IS TENTATIVE.

25X1

~~SECRET~~

[Redacted] 181-page untranslated (Albanian) report on the Albanian Workers (Communist) Party.

Attachment: 181-page document

[Redacted]

25X1

S-E-C-R-E-T

STATE	ARMY	NAVY	AIR	FBI	AEC					
-------	------	------	-----	-----	-----	--	--	--	--	--

(Note: Washington Distribution Indicated By "X"; Field Distribution By "#"). Form No. 51-61, January 1953

25X1

SECRET

ATTACHMENT

Sergjio pretias se L-re:
Kur u themelua Partia komuniste e Shqiperise, nga kush dhe ne cilin qytet
(Si fillori).

Partia komuniste shqiptare (sof Parti e Runes se Shqiperise) u formua me 8 nender 1941. Per ajo u njeh si e tille nga Kominterni (Internacionalia e III-te) vetem nga fillimi i vitit 1943. (Dihet se Kominterni u shpernda pak me von, ne pranveren e po atij viti, per arsye nderkombetare).

Me perpara se data 8 nendot¹⁹⁴¹ nuk kish ne Shqipori jo vetem parti komuniste, por as levizje komuniste te organizuar. Kish vetem disa grupe-lilipute, sektare, te udhehequra jo nga forume per nga "shefa misterioze", pa asnje strukture organizative te percaktuar, pa asnje platforme politike te perpunuar. Aktiviteti i ketyre grupeve ish zero. Ata, domethene grupet "komuniste", ishin atrofuar nga nje konspiracion i kalbur, dhe nga goditjet e organeve zogiste, nga anarqia dhe lufta e nenedheshme fraksioniste qe zhvillenin midis tyre. Mbi keta grupe do te flas me peshte.

Dihet se okupacioni italian, duke prekur ndjenjen patriotike te masave me te sqaruara politikisht, krijoi konditen objektive per lulezimin e ketyre grupeve. Diktatura e Zogut kish frenuar e dermuar jo vetem levizjen komuniste ne Shqiperi, per frenuar dhe penguar krijimin e cdo organizate politike. Ne kohën e okupacionit Shqiperia nuk kish asnje parti politike, asnje organizate masash. Jashte individëve antizogiste dhe antifashiste (qofshin keta intelektuale si Mid'hat Frasherri, qofshin feodale si Muharrem Bajraktari), e vetmia forçe kelektive disi e organizuar antizogiste dhe antifashiste ishin keta grupe "komuniste".

Ne kete sijuatë, cdo forçe me nje fare peshe qe do te ngrinte flamurin e atdheashurise e para, qe do te fillonte nje fare aktiviteti te organizuar, kish te gjitha mundesite te viheshe ne krye te situates, te fitonte prestigj, autoritet dhe te beheshe flamurtarja e luftes per clirim, duke fituar, kesh-tu, kapitalin e nevojeshem politik e moral.

Kush mund ta ngrinte kete flamur

SECRET

SECRET

- Individet antizogiste dhe antifashiste te inteligencias, si Mid'hat Frasheri etj. qe ndodheshin ne kohën e okupacionit ne Shqiperi. Keta nuk e bene dot sepse nuk kishin forca-rezerve te organizuara. Okupacioni i gjeti, pikerisht si komunistet, ne befasi dhe te "izoluar" nga geditjet e Zogut.

- Individet zogiste per antifashiste dhe anti-italiane, qe ndodheshin ne Shqiperi. Keta nuk mund ta benin ~~sepse~~ (sikurse nuk e bene) sepse nuk qene persona politike. Te gjith njerezit e kesaj kategorie i perkisnin kastit te prapambetur feudal, si Abaz Kupa - elemente, pra, jo te afte per aktivitet ilegal, organizativ, politik.

- Individe antizogiste, si Ali Kelcyra, Skender Çami, ^{Beqir} ~~Valter~~ Valteri etj. qe kishin jetuar ne emigracion deri ateherë dhe qe u kthyen ne Shqiperi pas 9 prillit 1939. As keta nuk e bene, pjeserisht sepse antizogizmi i tyre i col ne bashkepunim me italianet, pjeserisht sepse ndenjen ne pozita atandiste: "prit gomar te mbije bar".

- Grupet lillipute "komuniste" ne Shqiperi. Pikerisht keta e ngriten flamarin e atdhedashurisë. Faktorët determinante qe i ndihmuan: sado qe te organizuar, ne anarkine e atehershme politike, ishin me te...organizuarit. Sado qe pa nje program politik dhe organizate unike, munden te bashkohen e grumbullohen organizativisht me pare se te tjeret, te caktojne nje vije politike te tyre dhe te vihen, keshtu, ne krye te situates.

Ndersa te tjerit, individet antizogiste te illejit Mid'hat Frasheri e Ali Kelcyra - diskutonin akademkisht, ose grindeshin ^{ne te reze} per kryesine, grupet komuniste u hodhen ne aktivitet. Duke cfrytuar antagonizmat, ~~duke~~ hezitimet dhe poziten atandiste te ketyre "shefave patriote te vjeter", grupet komuniste bene te parat hapin e, pare, fituan precedencen. Gjysma e fatit te luftes qe do te zhvilloheshe me von midis "shefave patriote te vjeter" dhe "shefave komuniste te rinj", u percaktua qe ne ate faze.

Mirepo duke hyre ne aktivitet te organizuar, grupet komuniste nuk u hodhen ne lufte si grupe-lillipute, per si nje organizate unike politike, si parti komuniste. Gilet jane faktorët qe determinuan kete bashkim te komunisteve.

..

SECRET

SECRET

- 3 -

Keta faktore kane qene kryesisht te jashtem.

Se pari, komunistet shqiptare ne emigracion. Pas 7 prillit 1939, shume shqiptare qe ishin antare te Partise komuniste franceze (si Ymer Dishnica, Goge Nushi, etj.), ese antare te Partise komuniste italiane (si Nake Spirua), u kthyen ne Shqiperi per te vene ne rruge te drejte levizjen komuniste. Ata suallen nga partit e tyre, ku benin pjese me pare, direktiven qe te bashkohen grupet komuniste ne Shqiperi. Filluan keshtu, nga viti 1940 mbledhjet e "shefave" te grupeve komuniste per krijimin e nje partie te vetme komuniste. Ne fillim, ato nuk dhane asnje rezultat. Secili "shef" kerkonte kryesin e partise, poste me influence per kuadret e grupit te tij dhe si orientim politik orientimin politik dhe parimet e grupit te vet.

Ne kete situatë kerkoheshë pa tjetër qenia e nje personi me influence, jashte frymes e tarafeve te grupeve. Pikerisht per kete, me rruge dhe mjete qe me jane te panjehura, (me duket se u dergua ^{posill shanketa} ~~me~~ ne Beograd) u kerkua nga komiteti qendror i Partise komuniste jugesllave dergimi i nje delegati i cili, ne bashkepunim me shefat e grupeve, ^{me bashkepunim me shefat} te caktonte platformen politike te partise komuniste, strukturen organizative te saj dhe njerezit qe do ta udheheqnin kete parti te vetme. Komiteti qendror i Partise komuniste jugesllave, me qene se kuadret e saj te larta i kish vete te pakta nga humbjet qe kish pesuar ne te kaluaren prej goditjeve te organeve te Krajlit, u propozoi kete zgjidhje shqiptare.

Te lironin nga kampi i perqendrimit te Duresit Miladin Popovicin dhe Dushan Migeshin, qe te dy antare te Komitetit ~~qendror~~ ^{te Partise} krahiner, per Kes-Metin, i pari edhe kandidat i Komitetit qendror te Partise komuniste jugesllave dhe, qe te dy, kapur muaj me pare nga italianet ~~me~~ ne Jugesllavi dhe internuar ne Shqiperi. ^{Burgjardit pranoi qe} te dy keta, sipas propozimit shqiptar, te qendronin ne Shqiperi je vetem derisa te fermoheshë Partia e vetme komuniste ^{ne Shqiperi} ~~ne Shqiperi~~, por edhe me von ne menyre qe, me eksperiencen e tyre te vjeter dhe fermimin e shendeshe komunist, te ndihmonin udheheqjen e re shqiptare qe do te viheshe ne krye te Partise se re komuniste shqiptare.

Me mjete qe me jane te panjehura, Komunistet shqiptare munden te organizonin arratisjen e Miladin Popovicit dhe te Dushan Migeshit nga kampi i perqendrimit italian te Duresit. Qe atehere i pari mori pseudonimin "ALIU" dhe i dyti pseudonimin "SALA".

SECRET

SECRET

- 4 -

Ne nga kjo faze, tere merita per krijimin e Partise komuniste shqiptare, dhe, me ven, thuhet cdo problem politik e ceshtje organizative inherente me udheheqjen e Partise komuniste shqiptare, u takon ketyre dy delegateve jugesllave, ^{e Republiksht Miladinoviq} Dhe, si esht e natyreshme, nepermjet tyre, udheheqjes se Partise komuniste jugesllave, Tites e shekeve te tij.

Cilet qene, nga pala shqiptare, eksponentet me ne ~~xy~~ zë, qe kontribuan ne kete bashkimë

Si eshte e natyreshme "shifat" e grupeve te vjetra komuniste. Konkretisht: Anastas Lulua (per grupin e Rinise), me pseudonimin "ORRI"; Zef Mala, i njohur me pseudonimin "MALI" (per grupin komunist te Shkodres); Koca Tashkua, me pseudonimin "RUSI", (per grupin komunist te Korces).

Per te qene i sakte duhet te percaktohet se roli i ketyre personave te lart-permendur mbarehet me krijimin e Partise komuniste shqiptare. Delegates jugesllave (demethene Aliu dhe Sala) i lane ata, qe ne fillim, ne perithere te tre, demethene Anastas Lulua, Zef Mala dhe Koca Tashkua, para se te zinin postet ne udheheqje, duhet te kalonin nje periude-prove. Kush do ta kapte me sukses kete periude, kush do te jepte shembuj konkrete se ish sherruar nga fryma e "tarafave te vjetra", e "grupeve", e "sektarizmit", etj. vetem ay do te hynte ne udheqje. ^{perioda qe pasoi} ~~shkollim~~/tregoi se asnje nga keta nuk u vu me ne udheqje. Ata qene shume te infektuar me frymen e vjeter, me metodat e vjetra te punes se grupeve, keshtu qe gradualisht dhe duke bere vazhdimisht prapa-ktheu u cduken nga horizonti.

I pari, Anastas Lulua, u vra misteriozisht ne mal, ku u dergua qellimisht nga Komiteti qendror si "denim". Koha e ekzekutimit: pranvere e 1942-se. Aresyeja: ne kundërshtim me direktiven kryesore te Partise qe ishte: "Asnje fraksion ne shpine te partise", "asnje percapje per thyerjen e unitetit te partise", Anastas Lulua krijoi lidhje te fshehta me njerez te grupit te tij per rrezimin e Komitetit qendror te zgjedhur nga delegates jugesllave. Ky fraksion "Lulist" brenda-per-brenda Partise u zbulua. Disa nga personat e keti fraksioni, si Nasi Mariani, Ajet Rusi, etj. u perjashtuan perkohesisht nga partia, me kenditen se do te ripranoheshin po te jepnin "shenja pendimi te sinqerte per fajin e tyre". Ne fakt, brenda nje viti, thuhet se tere u ripranuan. Anastas Lulua u konsiderua shume i rrezikeshme. Dhe personalisht

SECRET

SECRET
- 5 -

mendoj se ^{veç} ~~veç~~ e tij u vendos nga keto arsye:

Komiteti qendror druante me shume se cdo gje tjeter jo perseritjen e nje orvatjeje identike nga ana e mules, per faktin semes ky, nga marrazi, kalonte nga radhet e komunizmit ne radhet e policise. Demi qe do te shkaketonte ne kete rast, per ^{faktin} ~~faktin~~ se Partia e persafermuar i kish kullqet akoma te debta, do te ish i pandreqeshem.

I dyti, demethene Zef Mala, gati per te njejten arsye, ese me sakte sepe perkrahu deri ne nje fare mase Anastas Lunon, u perjashtua nga Partia, gaty nga 1942-ja. Qe atehere e dori me set ka mbetur jashte radheve te partise. Eshte tipi i intelektualit skelastik dhe personalisht nuk kam mundur te kuptoi kurre se si ka qene shef i nje grupi. Koci i Xoxes e kish arestuar, per me rrezimin e keti, u lirua nga 1949 dhe u emrua drejtor i Bibliotekes shteterore te Shkodres.

I treti, Koco Tashkua, ka qene kurdehere ne parti, per jo ne poste udhheqese. dhe set e kesaj dite eshte nje kuader i mesme, jo me teper per meritat e tij personale dhe aftesit ne pune, ^(se - s) ~~per~~ per te kaluaren e tij si veteran komunist qe nuk i ka sjelle asnjehere ngaterresa partise. Mendoj se muk do te jete shume e largme dita kur do te dale fare ne pension, jo sepse eshte aqe i kaluar nga mesha, por sepse s'ka se c'ti jape partise, as ne pushtet, as n'ekonomi, as gjetiue.

EkspONENTE TE TJERE kryesore nga pala shqiptare, me rol te rëndësishem ne krijimin e Partise komuniste shqiptare me ckrirjen e grupeve ne nje organizate unike, qene: (sipas rëndësise)

Ymer Dishnica, me pseudonimin "DOKTORI", mbaruar studimet universitare ne mjekesi, ne Paris (France), me 1940 dhe ardhur po ate vit ne Shqiperi, anetar i Partise komuniste franceze dhe kehe me pare pjesetar i Grupit komunist te Kerces;

Myner Hoxha, me pseudonimin "TAARASI", mbaruar studimet universitare ne France, ardhur ne Shqiperi me 1939, anetar i Partise komuniste franceze dhe pjesetar i grupit komunist te Kerces;

Kriste Themelke, me pseudonimin "SHULJA", puntor, pjesetar i grupit komunist te Shkodres;

Qemal Stafa, me pseudonimin "i MIU", student n'Itali, ^(grupi i rregulluar) denuar nga Zogu me vdekje dhe kthyer pastaj, si meshire, me burgim te perjeteshem, liuar me ardhjen e italianeve ne Shqiperi. ^(grupi i rregulluar) ~~u denuar nga Zogu me vdekje dhe kthyer pastaj, si meshire, me burgim te perjeteshem, liuar me ardhjen e italianeve ne Shqiperi.~~ ^{u denuar nga Zogu me vdekje dhe kthyer pastaj, si meshire, me burgim te perjeteshem, liuar me ardhjen e italianeve ne Shqiperi.}

SECRET

SECRET

Kaçi i Xexes, me pseudonimin "TRASHI", punter. Qe nga 1944 e deri me 1948 u be, me ndihmen e Beogradit, diktatori i vertete i partise. U pushkatua si "titist" me 1949. Nga grupi komunist i Kerces.

Pile Peristeri, me pseudonimin "ZYKUA", punter, gjithashtu nga grupi komunist i Kerces, sot kandidat i Byres politike dhe anetar i Komitetit qendror te PPSH.

Ramadan Çitaku, student ne Jugesllavi, me pseudonimin "BACA", pjesetar i grupit komunist te Shkodres. Anetar i Komitetit qendror deri sa u prene lidhjet Beograd-Tirane dhe tani drejtor i arkave te kursimit.

Liri Gega, me pseudonimin "MUZHIRU", mesuese, nuk e di nga cili grup. Ishte anetare e Byres deri ne tetor 1944, perjashtuar nga Komiteti qendror e me von edhe nga partia per arsye te "gabimeve te renda" qe beri ne Veri si perfaqesuese e plotfunishme e Komitetit qendror prane Divizionit te I-re, per te meta "bergeze" si "karrierizmi", "ambicja", etj.

Breth ketyre ~~te~~ eksponenteve kryesore te asaj kohe, vertiteshin edhe eksponente me te dyte, per qe me von muaren peste me shume rendesi, disa i mbajten, disa i fituan per t'i humbur, si:

Nake Spirua, Bedri Spahiu, Hysni Kapua, Tuk Jakova, Pandi Kristua, Mehmet Shehu, *Goga Nashi*.

~~Taxtjaks~~ Nje tjetër eksponent shume kryesor qe harrova ta ve ne kategorin e te pareve, eshte Vasil Shantua. Ay u vra buze liqenit te Shkodres me 1942, sepse kundërshet me arme t'u dërrzohet karabinierëve italiane qe e ndiqnin.

Me ndonje perjashtim te vogel qe nuk e di, pikerisht personat (emrat e te cileve kam nenevizuar: Imer Dishnica, Vasil Shantua, Enver Hoxha, Kriste Themelkua, Zemal Stafa, Kaçi Xexë, Pile Peristeri, Ramadan Çitaku dhe Liri Gega) perbenin edhe Komitetin e pare qendror te Partise se persafarmuar komuniste shqiptare. Ky Komitet qendror u quajt provizor. Ay u zgjedh me 8 nender 1941, ne Tirane, ne nje shtepi qe ndodhet ne Lagjen e Brakes, shtepi e cila eshte kthyer sot ne Muze. Te gjith anetaret qene te barabarte. Nuk kish Byre. Sekretar i perkeheshem politik ish Imer Dishnica; sekretar i perkeheshem organizativ ish Vasil Shantua. Sikurse e theksoi, qene funksione provizore, tamam sikurse ish provizor, edhe Komiteti qendror, i cili quheshe edhe Komitet qendror provizor pune. Ky komitet do te drejtonte krejt punen e Partise ne qender e qarqe deri sa te mblidheshe Konferenca e pare e Partise, ~~me shprehje te shprehura~~

SECRET

SECRET

- 7 -

delegatet e se ciles do te zgjidheshin pas ndonje viti, domethene pasi partia si teresi dhe Komiteti qendror si forum, te kishin kaluar nje periude prove. Keta delegate do te zgjidhnin, pastaj Komitetin qendror definitiv. Kje konference partie, domethene Konferenca e I-re e Partise si u quajt, (u mbledh ne marsin e 1943 ne Kabinot te Elbasanit.

Te gjith njerezit e Komitetit qendror provizer u rizgjedhen ne Komitetin qendror definitiv. U zevendesuan me persona te tjere te vrarit (Vasil Shantua e Zemal Stafa). Dhe, me qene se aktiviteti i partise ish zgjeruar, ne Komitetin qendror u shtuan elemente te rinj, pikerisht eksponentet e deres se dyte qe shenei ne faqen 6 di dhe disa te tjere qe ishin dalluar nderkone, fjala vjen Ujin Marku. Ne Komitetin qendror, ne post me rendesi, u zgjedh edhe nje figure e re qe persa kish ardhur ilegalisht nga Franca (me perpara funksionar i Kominternit te Moskës): Sejfulla Malesheva, me pseudonimin Lame Kodra.

Para se t'i jap fund kesaj pyetjeje e gjej te nevojeshme te shenei se krejt udheheqja e partis komuniste shqiptare shoshiteshe dhe seleksionohesh nga delegati jugosllav Miladin Popovic. Ay ishte i plotfuqishem.

Sikurse e theksol ne fillim ay eliminoi nga Komiteti qendror te gjith shefat e vjeter te grupeve, si te infektuar me frymen e tarafeve, si "udheheqes kafeneshe" e "politikane te vjeteruar". Ay zgjedhi jo nga "kasti i shefave lilipute te vjeteruar", qe e kishin bere kohen e tyre, ~~XXXXXX~~ as nga baza perberese e grupeve, per nga kuadri i mesme i grupeve, nga elementi jo shum i ri, per jo dhe i vjeter.

Opinionimi tim eshte se Miladin Popovici ka qene nje organizator me talent, shume i zoti dhe i afte. Sikurse do ta shpjegoj me peshte ay ka qene edhe nje njeri politik tejpames, i mprefte dhe shume i zhdervjellte per te manevruar ne situata te veshtira me nje elasticitet shembullor.

Per t'u skjaruar me mire reth kesaj pike dhe pyetjeve qe vijne, e shoh te nevojeshme qe ne kete pergjigje te pare te shtoj nje aneks mbi grupet e para komuniste ne Shqiperi.

ANEKS PYETJES SE I-re:

Grupet komuniste ne Shqiperi, para themelimit te Partise, qene: (sipas rendesise se tyre):

Grupi komunist i Korces; 2) Grupi komunist i te Rinjve; Grupi komunist i Shkodres; 4) Grupi i Zjarrit; 6) Grupi i Niko Xoxit.

SECRET

SECRET

- 8 -

GRUPI KOMUNIST I KORÇES.-- Ky grup ish organizuar aty nga 1930 prej Ali Kelmendit. Ali Kelmendi qe arratisur nga Shqiperia qe me ardhjen e Zegut ne fuqi, ne meshe shume te re. Kish mbaruar studime te larta ne shkollen e Kominternit ne Masi dhe qe derguar ne France per te punuar me studentet shqiptare dhe emigracionin shqiptar. Me urdher te Kominternit, dike perfituar nga falja e pergjitheshme e Zegut, u kthye ne Shqiperi, ndenji nja 2-3 vjet dhe u arratis perseri se se per aktivitetin e tij Zegu do ta kish arrestuar. Vdiq ne Marsej te Frances, aty nga 1937, prej tuberkulozi. Ne varrimin e tij ka patur kurroze te Kominternit dhe te Komitetit qendror te Partis komuniste franceze, shenja keto qe tregojne se ay ish nje fare figure politike. Vendin e tij e zuri Koco Tashkua, njeri, me sa kam degjuar, jo me meritat e Kelmendit. Perthama kryesore e keti grupi komunist qene punoret. Ky grup organizoi ne Shqiperi te parat lidhje sindikale (organizata embrionare) legale, demethene te njehura nga shteti, si "Bashkimin punor te marangozeve", "Bashkimin punor te rrobagesve", etj., kurdohere mbi baza profesionale. Kerverec ketyre lidhjeve mbi baza profesionale, ky grup organizoi, gjithashtu legalisht, disa shoqerira kulturele (Theater amator punoresh, Kerr amator punoresh, etj.).

Sado qe quheshe grupi i Korces, aktiviteti i ti shtriheshe edhe ne Tirane, Gjirekaster dhe ne ndenje qytet tjeter. Per qendra e aktivitetit te tij dhe e forces se tij qe Korca. esoi geditje te renda nga policia e Zegut me 1937, sepse shume pjesetare te keti grupi u arrestuan, u internuan, etj. mbaasi u tradhetuan nga nje aleat i tyre, dhe konkretisht nga Niko Xoxi.

Ka qene grupi me i organizuar. Celulat e tij qene "trisha", demethene te perbera nga 3 pjesetare dhe nga pergjegjesi (gjithesejt kater). Cdo anetar i keti grupi punonte ilegalisht me simpatizante te grupit, prej/te cileve rerekutoheshin pastaj anetaret. Puna ish aqe konspirative sa qe "simpatizantet" kujtonin se ishin antare. Intelktualet qene shume te pakte. Studentet gati mungenin fare. Deri me 1937 ky grup kish ne gjithë Shqiperine reth 250 - 300 antare maksimumi. Geditjet e Zegut e shpartalluan. Grupi, sipas direktivave te Kominternit, u shpernda i teri pas "tradhetis" se Niko Xoxite. Celulat "trisha", u prishen. Antaret e grupit filluan te punejne sipas kekes se tyre, ne forme individuale, me popullin. Shperndarja e keti grupi ish e perkeheshme. Aje ish nje periede prove dhe akoma me teper nje spastrim i domesodhsme sepse ne kete grup kishin hyre tyrlu elemente, sikurse edhe ne grupet e tjera, trackiste, anarkiste, etj.

SECRET

SECRET-

Grupi u riformua nje vit me von, aty nga fundi i 1938-es fillimi i 1939-es por me antare shume te kufizuar, te kontrolluar jashte mases dhe numuri i tyre nuk i kalente te 150 vetet; me krejt Shqiperine (Shumica perqendroheshin ne Kerces). Kete Tashkua ka qene shefi i plotfuqishem i keti grupi bashkepunetore te tij te afert qene: Stefo Grabockua, Llambi Dishnica, Pile Peršateri, ~~Koca~~ Koci Xexex, ~~Koca~~ Gago Nasta. Grupi nuk kish asnje forum udheheqes ne krye. "Shefi" ish forum dhe, vet'Ali-vet Kadi.

Ne krahasim me grupet e tjera, ka qene grupi qe ka patur idete me te shendesha mbi moralin e antareve te tij.

Ka qene grupi qe ka zhvilluar me teper aktivitet me popullin se te gjith te tjerit.

Dhe, permbe te gjitha, grupi qe ka mbajtur, relativisht me te tjerit, vijen politike me te drejte (si grup komunist).

a/E konsideronte fshataresin si aleate te mundeshme, si nje force eventuale rezerve te puntoris, dhe me te cilen duhesh punuar per ta afruar;

b/E konsideronte inteligencian si forcen e dyte, pas klases puntore.

c/E konsideronte si te domosdoshme aktivitetin ilegal dhe legal ne masat, me qellim qe te shtente autoritetin dhe radhet e veta. Ky aktivitet do t'i shkaketonte humbje e viktime nga geditjet e policis, por ish i domosdoshme sepse vendin e atyre qe do te vriteshin ose kapeshin nga policia do ta zinin te tjerit, me te shumte.

d/E konsideronte kallzimin ne polici si "tradheti" dhe te palejueshme, sado te medha qe te ishin torturat.

e/Rikerisht si regjimin e Zogut ashtu edhe okupacionin italian i konsideronte si aqrmiq qe duheshin luftuar.

f/Rikerisht meritat e keti grupi, ne krahasim me te tjerit, e bene edhe Miladin Popovicin qe t'u jape preferencat e tij dhe prioritet ne postet udheheqese anetareve te keti grupi.

GRUPI KOMUNIST I TE RINJVE.- Ky grup u organizua pas 1930, si fraksion dhe shkeputje nga grupi komunist i Kerces. Kryetari i keti fraksioni, qe me von u be "shef i plotfuqishme grupi", ish Anastas Lulua, me pseudonimin QORRI. Duheshe grupi i te rinjve sepse e konsideronte veten si me te ri nga grupi i Kerces. Qendra e tij ka qene Tirana. Por ka patur influence edhe ne Kerce, Shkoder. Organizativisht ish nje grup shume i izoluar. Jashte radheve te tij

SECRET

SECRET

muk zhvillonte asnje aktivitet. Muk kish asnje shoqeri kulturele, asnje lidhje puntore ~~shqiptare~~ legale.

Muk kish celula. Struktura organizative e keti grupi ish vertikale fare, qe nga kreu deri ne baze. Demethene: Anastas Lulua, qe ish "shefi" kish lidhje personale vetem me nje: me ^{Zef Malen} ~~Nasi Mariani~~, qe ish personi Nr. 2, dhe, teorikisht, vetem ky duhesh ta njihete. ^{Zef Misa me} (Nasi Mariani ~~me~~), i cili ish personi Nr. 3, e keshtu me radhe si litar me koktka-koktka, deri tek baza. Me fjale te tjera cdo anetar i keti grupi kish nje pergjegjes, ose nje shef dhe, njekehesisht poshte, nje vartes. Muk kish simpatizante. Te gjitha ishin antare. Intelektualiet, sidomos studentet e klasave te larta te Gjinnazit, qene baza e keti grupi. Runtoret numroheshin me gisht. Kish me teper anetare se Grupi komunist i Korces; por keta te fundit, se bashku me simpatizantet, qene me te medhenj ne numur. Goditjet e Zogut e demtuan rende edhe kete grup. Por ky ~~ishte~~ muk pranoi, si grupi i Korces, te shperndahet. Ay mbajti ne radhet e tij te gjitha elementet eterogjene dhe eteroklite qe kishin hyre gjate kohes. Anastas Lulua, thashe, ka qene shefi i plotfuqishem. Reth tij gravitenin: Nasi Mariani, Gele Mecari, Semal Stafa, etj.

Me grupin komunist te Korces, muk ka patur as ndenje here bashkepunim, perpara se te fermeheshe partia. Ka bashkepunuar, po per perieda shume te shkurtra, ~~me grupin e Shkodres dhe grupin e Mike Xoxit.~~ Nga grupet qe u shkruine ne partin komuniste, ka qene ay qe solli kundershtrimet me te medha.

Ka qene grupi qe ka patur idete me te ulta mbi moralin e anetareve te tij: anetaret e keti grupi lejeheshin te vidhnin prindrit (dhe jo vetem prindrit), per te pasuruar arken e grupit dhe per te majur "shefat". Ne mare-dhemit seksuale ~~ka~~ qene si kafshet dhe lidhjet burra-grua i konsideronin te teperta. Visheshin keq dhe me kasqeta per te treguar se ishin "proletare".

Ka qene grupi qe ka zhvilluar me pak aktivitet me popullin. Dhe, grupi me vijen komuniste me te gabuar.

a) Kishte bere per vete teorine e narendnikeve ruse mbi "heronjte". Dhe heronjte, si vetekuptohet, qene keta. Keta do ta benin revolucionin, keta "do ta shpetonin popullin", "keta do te shkruanin historine".

b) E konsideronin fshataresine ne nje rang me puntorine, dhe ^{me pak} ~~si~~ aleate te mundeshme. randa; muk qe neveja te punoheshe per ti afruar. Kur te vinte revolucioni, masat do ti ndiqnin vet-vetiu, si "heronj" qe qene.

SECRET

SECRET

c) E konsideronin inteligencian si forcen baze,

d) Aktivitetin, qeftin ilegal, qefte ilegal e konsideronin si te kote.

I jepnin rendesi te madhe, ne parim, teorise, njehjes se ideve komuniste. Mire po letersia e tyre ish fare e pakontrolluar. Krahas "enit mesonin dhe e konsideronin si leninist edhe princin anarke-narednik Kropotkin, krahas Marksit mesonin dhe e konsideronin si markist edhe shefin e ide-racizmit gjerman, sepse kenaqte pikepamjet e tyre mbi mbi-njeriun, Nietzsche, etj.

e) rikerisht si grupi komunist i Kerces, pohimet ese kallzimet ne polici i konsideronin si tradhete.

f) Megjimin e Zogut e konsideronin si te rrezikshem dhe qe duhesh luftuar, per vetem kur t'i vinte radha, domethene kur te binte kembana e revolucionit te armatosur qe do t'u jepte pushtetin.

g) Okupacionin italian e quajten si nje faktor pozitiv per levizjen revolucionare. rsej sepse fashizmi do te industrializonte Shqiperine, do te thyente format feudale ne bujqesi, do te shenonte nje perparim shoqeror brenda vendit, perparim i cili do te krijente kondita me te favoreshme per shpejtimin e afatit te revolucionit. Per 'ta, okupacioni italian dhe okupateret italiane nuk duheshin luftuar per disa vjetra.

h) "e krahasim me grupin e Kerces, qene me pak te varur nga Moska dhe Kominterni.

GRUPI KOMUNIST I SHKODRES.- Eshte i treti grup komunist qe u shkri ne Shqiperi me formimin e Partise unike komuniste. Lindi me von se grupi i Kerces, dhe me von se grupi i te rinjve, si fraksion dhe shkeputje nga ky i fundit. Kryetar i keti fraksioni, qe me von u be ne shembullin e Anastas Mules kryetar grupi, ish Zef Mala. Wuheshe grupi i Shkodres, sepse baza dhe qendra e aktivitetit te tij ish qyteti i Shkodres. Ka patur influence edhe ne Tirane e Durres. Ish nje grup me i izeluar se ay i Kerces, per me i gjere se ay i te rinjve. Kersa i perket veprimtaris ilegale dhe legale ndoqi shembullin e grupit te Kerces. Ne shembullin e keti, dhe ndryshe nga grupi-meme prej nga u shkeput, krijoi ne Shkoder lidhjet e para puntore, pikerisht mbi baza profesionale dhe shoqeri, perseri legale, me karakter kultural per te grumbulluar reth vetes elemente te popullit.

Nuk ka patur asnjehere strukture organizative te percaktuar. Here kish

SECRET

SECRET

celula "trische", here celula "shtateshe", here strukture vertikale. Ndryshe nga grupet e tjere, kish nje fare ferumi udheheqes ne maje te hierarqise. Shef i plotfuqishem: Zef Mala, bashkepuntere te tij imediate: Quk Jakova, Vasil Shantua, ~~Shantua~~ *Shantua*

Pesoi geditje te renda nga policia e Zegut me 1937. Kish je me teper se 100 antare, demethene shume me pak se grupi i te rinjve dhe, bile, akoma me pak se grupi i Korces. Ay grup, ne shembullin e grupit te te rinjve, refuzoi te shperndahet fare. Ay zgjedhi nje rruge te mesme: beri nje fare spastrimi, duke perjashtuar shume elemente qe nuk mbajten qendrim burrnor perpara organeve te policise.

Ka patur ne perioda te ndryshme nje fare bashkepunimi me grupin e te rinjve dhe ne perioda te tjera me grupin e Korces. Fer nje kohe edhe me te shkurter, ka bashkepunuar me grupin e Nike Aexit.

Nga grupet qe u shkrine ne parti, ka qene, je nga kuantiteti per kualiteti, grupi i dyte pas rendesis.

Baza e tij ka qene thujse gjysme per gjysme intelektuale-puntere. De me thene qendronte ne mes te grupit Korces (me predominence te theksuar punteret) dhe grupit te te rinjve (me shumice derrmuese studente).

Ne pikepamje morali qendronte gjithashtu ne mes te dy grupeve te tjere. Kish ide te shtremberuara, te marura nga te rinjte per je ne masen qe i kishin keta.

Ka qene grupi qe ka zhvilluar, pas grupit te Korces, aktivitetin me te madh ne popull.

Vija politike e keti grupi ka patur keto karakteristika themeltare: ka qene aje vije ndermjetese midis te dy grupeve te pare: nje vije ne pozita "kompromisi" dhe shume me kontradiktore e je konseguente. Konkretisht:

a) Sade qe kishin bere per vete teorine e narendnikeve mbi "herenje" nuk e mohenin as rolin e fshataresis, as ate te punterise.

b) Forca-baze e partise: punteret dhe intelektualet, ne nje rang te barabarte. Force aleate dhe rezerve: fshataresia.

c) Grupi i Korces i jepte prioritet absolut praktikes. Grupi i te rinjve - teorise. Ky grup i kish vane ne nje rang si teorine, si praktiken, pa mes i njehur asnjeres prej te dyjave prioritet.

d) Rohimet dhe kallzimet ne polici nuk i pranente.

SECRET

SECRET

- 13 -

e) Regjimin e Zogut e konsideronte si nje regjim qe duhesh luftuar.

f) Okupacionin italian, ne shembullin e grupit te te rinjve, e konsideronte si nje faktor pozitiv. Mirepo vetem ne terrenin teorik, dhe jo ne ate praktik. Ne terrenin praktik, bashkoheshe me grupin e Korces, duke njehur nevojën per ta luftuar kete okupacion italian, sepse ishte rruga me e mire per te fituar kredi morale dhe kapital politik.

Me fermimin e partise, pas grupit komunist te Korces, anetaret e grupit te Shkedres zune postet e dyta ne udheheqje dhe ne kuadrin e mesme.

Shenimi: Vetem keta tre grupe pranuan te shkrihen dhe te fermojne nje parti te vetme komuniste, me nje platforme politike e organizative shume te ndryshme nga ato te tyre. Dy grupet e tjere, demethene grupi i Zjarrit dhe Grupi i Niko Xoxit, nuk pranuan te heqin dore nga autonomia e tyre, as nga parimet dhe idet e teorit e tyre. Keta dy grupe te fundit qene me teper te Internacionales se katerte, me simpati me shume per Trockin se sa per Stalinin, qe urrenin njellloj si Rusine sovjetike ashtu edhe Angline, Francen ose Ameriken "bergeze kapitaliste". rikepamjet e tyre teorike kane qene me nje vule te theksuar ~~marksishtike~~ anarko-narednike. Me te shpjegoj karakteristikat e tyre.

GRUPI I ZJARRIT.- Eshte grupi me i vjeter qe vetekonsideroheshe komunist. Krijuar me perpara edhe se grupi i Korces, zakonisht nga elemente qe kishin kaluar kohe ne Greqi, qofte si studente, qofte si puntores. Ky grup kish vetem shefe dhe jo antare. Shumica e tyre qene intelektuale ose autedidakte. Numuri i tyre qe teper i kufizuar dhe, ne mes gaboj, nuk i kapexente te 40 vetet. Midis tyre permend: Spire Koleken, nje fare Xhelal Rusi etj., emrat e te cileve jane lene ne harrrese prej kohesh. Ky grup pretendente se kish vullen e Kominternit (genjeshter per ta vene vete-veten ne pozita me te privilegjuara), te sjelle gjeja nga Athina (Sade qe e urrente Bashkimin Sovjetik). Ky grup as aktivitet nuk zhvillonte, as perpjekje per te shtuar radhete. Qene me teper "komuniste te sallonit", "politikane kafenesh" dhe "perparimtare sepse keshtu e kerkente moda". Bagazhi i tyre politik permbante tere idete e trockit dhe, ne te njejten kohe, te gjitha teorite e "arhemarksizmit grek", (rryme deviacioniste brenda-per-brenda partis komuniste greke ne vitet 1930). Pas fermimit te partise, ky grup u shpartallua. Mjafte nga anetaret e tij, qe

SECRET

SECRET
- 17 -

ne këhen e shkrirjes se grupeve refuzuan bashkimin, e lane grupin e tyre dhe u bashkuan me partine, ne fillim si simpatizante partie dhe me von arriten te behen edhe antare dhe te marin, si Spiro Koleka, poste me pergjegjesi. Te tjerre, si Xhelal Rusi e Andrea Varfi, u pranuan ne parti gjate luftes, por pastaj, ndofta sepse nuk i fercuan kurre pozitave e tyre, u perjashtuan si te "pa deshirueshem". Ata pak qe mbeten autenome, si individe, heqen dore nga cdo aktivitet gjate kohes se luftes sepse ishin elemente te frikeshem, druanin hem arrestimin e italianeve hem vrasjet misterioze te partis komuniste. Zaten influenza e tyre ka qene zero. I permenda ketu si grup vetem e vetem per te plotesuar tablone historike te levizjes komuniste ne Shqiperi.

GRUPI I NIKO XOKIT.- U krijua thuhet se te njejtën kohë me grupin e te "rinjve" kryetari i keti grupi ish Niko Xoxi, puntor shume autodidakt, i cili sapo ish kthyer ne Shqiperi aty nga viti 1932. Me perpara kish qene ne Greqi per disa vjete.

Struktura organizative e keti grupi ka qene pikerisht si ajo e grupit te te rinjve, vertikale fare. Idet politike, morali, teorite, po ashtu identike. Zaten, per sakte si duhet te thekset se ne origjinen e fraksionit te anastas Mules dhe shkeputjes se tij nga Grupi komunist i Korces ne grup ~~paqendues~~ me vete, autonom, ~~qendron~~ qendron Niko Xoxi. Ky ishte "aminenca e hirte" e Qerrit, sepse kerkonte qe te shtinte ne dore fraksionin e keti te fundit. Mirepo QORRI preferoj te ruaje shefflekun per vete.

Antaret e keti grupi, pervec te tjerave, kishin edhe kete pikepamje: po te te zere policia, po te te torturoje, duhet treguar e kallzuar cdo gje qe di. Astaj ne gjyq duhen kundershuar, per ta kthyer kete ne nje tribune te komunizmit. E verteta eshte se kete "teori" te cuditeshme qe komunistet duhet te tradhetojne, "shoket e tyre", e cpiku vete Niko Xoxi nga koka e tij. Kjo sepse kur u arrestua nga gjendarmeria e Zogut, se bashku me shume komuniste te tjere te grupit te te rinjve, te Korces dhe te Shkodres, rrefeu cdo gje qe dihte. Te tjerit i ngordhen ne dru per nuk rrefyen gje, ky, demethene Nikua, me te ngrene kopacen e pare rrefeu cdo gje. Dhe, pikerisht per te justifikuar sjelljen e tij, kur u lirua (sepse organet e policis nuk e burgosen) nxerri "teorine" e tij.

Me te thekset, ketu, se influenza e grupit te Niko Xoxit qe identike me ate te grupit te zjarrit, ose, pak me e madhe. Baza e rekrutave te tij qene

SECRET

SECRET
- 15 -

studentet. Tere aktiviteti i keti grupi kufizoheshe ne luften qe u bente grupeve te tjere per t'u rrembyer anetare, me qellim qe te shtente radhet. Wxirrite dhe nje "Buletin jeshil", nje fare gazete te shaptillografuar ne ilegalitet, gadi ode dy-tre muaj nje here, ku ^{Caridzehele Nino Koci} ~~hasente vetem~~ tij (natyrisht me pseudonimi dhe ^{shahesku} ~~shante~~ te tjeret.

Vra misteriozisht nga partia aty nga 1943 sepse ekzistente frika se mes shkonte ne polici dhe tregente ate qe dinte. Ne kohen kur u vra, grupi i tij ish shperndare, ish okrire. Fjese e studenteve qe peruenin bazen e grupit te tij vjetra me pare, shkuan ne radhet e partise ose te rinise komuniste. Ay kish mbetur nje shéf pa vartes, nje kryetar grupi pa grup, krejt i izeluar dhe pa as me te veglen influence ne levizjen komuniste. Ay ka qene ne apegjen e tij aty nga ~~1937~~ 1937, perpara se te arestoheshe. Venderimi je burner perpara policis e diskreditet je vetem ne syt e grupeve te tjera, por edhe ne syt e anetareve te grupit te tij. Mjaft nga keta antare, bile, kaluan qe perpara formant te partis komuniste ne radhet e grupeve te tjera, si domes te grupit te Shkodres. Asnje nga anetaret e grupit te tij nuk arriti te behet ndenje here eksponent i partis komuniste shqiptare. Maksimumi arriten kuadroe te mesme partie. ^{Permes Nino Kocit, partia na merrte nga ekspozite e keti grupi, edhe disa te tjere, si "Dimitro Pjancin" ne "Korçe" (1943).}

SECRET

SECRET

- 16 -

Pergjigje pyetjes se II-te:Si fillimi aktivitetin dhe ne cilin qytet u organizuan celulat?

Duke filluar aktivitetin e saj klandestin si organizate unike, pas 8 Nenderit 1941, Partia komuniste shqiptare kishte si mbeshtetje kryesore ne punen e saj politike-organizative-ushtarake, si doren e djathte, organizaten e rinis komuniste shqiptare. Perpara se te fillonte punen ^{komuniste si organizate} ~~me~~ partia unike, ne Shqiperi nuk kish organizate rinie te posacme. Set eshte e qarte per te gjithine se pa organizaten e rinise komuniste, Partia komuniste ne Shqiperi nuk do te kish mundur kurren e kurren te zhvillente aktivitetin e vet ne ate stil e shkalle te gjere, me ate kombativitet e guxim. Rinia komuniste i dha atehere partise numurin me te madh te viktimave, gjak te ri, energji dhe forca te dhjetefishuara. Barren me te rende dhe peshen e keti aktiviteti e kombativiteti e kishte ne supet e saj ^{sidomos} rinia studenteske, shume lehte per t'u organizuar, sepse qe e grumbulluar, shume lehte per t'u genjyer, sepse i mungente eksperiencia e jetes, shume lehte per t'u hedhur ne aksion sepse e urrente hem Zogun hem fashizmin okupator, shume lehte per t'u bere revolucionare sepse te tilla jane aspiratat e meshes se re.

Duhet te theksoj, qysh tani, se ne nenderin e 1941 Partia komuniste shqiptare kish (domethene ne agimin e saj) jo me teper se 240 anetare partie. Nje sasi, sic shihet, jashtezakonisht e vogel, e kufizuar. Dhe ~~maxximisht~~ e ketyre anetarave perqendrohesh ne dy qytete: ne Tirane dhe ne Kerce. Vinin pastaj sipas rendesise: Shkoder, Gjirekastra, Durresi, Vlora, Elbasani. Krejt qarku i Beratit, me gjith qytetin, kish vetem nje celule; qarku i Peshkopise (se bashku me qytetin) nuk kish as edhe nje celule; po ashtu edhe qarku (se bashku me qytetin) i Kukesit. Kjo ndarje do te thote se nga dhjete qarqet e Shqiperise se atehereshme Tirana dhe Kerca kishin afro sejcila nga 60 anetare partie. Shkoder, Gjirekastra, Durresi, Vlora, Elbasani dhe Berati kishin (si qarqe) nga 10 deri ne 30 anetare partie. Kjo sasi shume e kufizuar antaresh te organizuar shpjegon edhe aresyen perse, ne fillim (domethene 1941) partia komuniste shqiptare kish Komitete qarkore vetem ne Tirane dhe ne Kerce. Ne Shkoder, Gjirekaster, Durres Vlora, Elbasan dhe Berat kish vetem nje te deleguar te Komitetit qendror i cili drejtonte dhe kish pergjegjesin e komunisteve te qarkut respektif. Gjashte qytetet e lart-permendur me siper, krijuan komitetet e tyre qarkore te partise

SECRET

SECRET

1 17 -

gjate vitit 1942. Dhe dy qarqe, ~~si~~ Peshkopia e Kukesi krijuan Komitetet e tyre te pare qarqore te Partise komuniste vetem nga fundi i 1944-es, demethene pas "clirimit".

Megjith kete numur te kufizuar duhet pranuar se ne fund te 1941-se influenca e partise komuniste shqiptare ish shume e madhe, shume ne disproporcione me numurin e antareve te partitise.

Si shpjegohet ky fakt? Me faktin se partia kish ne ate kehe nje numur identik, ~~si~~ ^{bi} me te madh, simpatizantesh partise, (me von u quajten kandidate partise):

Me faktin tjeter se ajo kish, te organizuar ne rinine komuniste, nje numur shume me te madh te rinjesh, ^{si shpesh} lart nga ~~100~~ njemije vete, te cilet ishin ne fakt antare partise (18 vje, deri ne 27). Kreth ketyre 1.000 te rinjve komuniste gravitenin, ne qytet e ne fshat, mijra te rinj te tjere, qe quheshin te rinj antifashiste.

Keshtu, dy muaj mbas fermimit te saj, Partia, sado qe ne vet'vete shume e vogel ne numur, drejtonte drejt-per-drejt mijra individe, sidomes ~~konkrete~~ elemente shume te rinj nga meshaq-predominencen absolute e kishin 20 vjecaret. Rekrutimi i rinise studenteske, puntore e fshatare u be ne mase. Cdo komunist, per shembull, anetar partise, u thosh miqve dhe shekeve te tij qe te merrnin me vete miqte dhe shoket e tyre dhe ne filan date e ne filan ore te mblidheshin ne shtepin e ~~tyre~~ vete. Kete mbledhje grumbullonin 50 e me teper te rinj. Tere ky grup quheshe ~~grupi~~ ^{aktiv} i rinise antifashiste. Midis ketyre 50 te rinjve, antari i partise komuniste zgjidhte me te hedhurit, me revolucionaret dhe u thoshte: pasneser do te mblidhemi ne filan shtepi. Mblidheshin keshtu reth 10-15 te rinj. Ky grup quheshe grupi i rinise komuniste. Pas nje stazhi ne rinine komuniste, elementet me besnike dhe qe kishin dhene prova guximi e vendosmerie, rekrutoheshin individualisht, jo ne grup, ~~me~~ anetare te Partise komuniste shqiptare. Keshtu, numuri i antareve te partise komuniste shqiptare arriti nga fundi i 1942 ne afro 400 vete. Shifra, sic shihet, ishte perseri shume e kufizuar. Mirepo Partia komuniste qe ne ilegalitet, ajo veprente ne klandestinitet e konspiracion te madh qe t'u ruheshe geditjeve te policise italiane e shqiptare. Prandaj, nuk duhet cuditur perse nuk i shtonte madhet e saj shpejt, ajo e bente punen me levat, me veglat e saj: Konkretisht me organizaten e Rinise komuniste dhe me anen e simpatizanteve.

SECRET

SECRET

- 18. -

Dhe me qene se arrita ketu, le te shpjegoj shkurtimisht strukturen organizative te atehereshme te Partise komuniste shqiptare; kje do te jape nje id e te qarte edhe mbi menyren e veprimit te Partise, ^{do te shpjegoje} metodat me te cilat drejtonte, format me te cilat ~~organizimit~~ organizonte dhe aktivizente masat.

- Shih tabellen A/I, qe shenj ketu peshte:

SECRET

SECRET

- 19 -

Tabella na tregon se me 1942, demethene me pak se nje vit pas fermimit te Partise komuniste shqiptare, kjo organizate kish nje strukture mjaft te pershtateshme dhe efektive per punen klandestine.

Aje tregon se Komitetet qarkore lidheshin direkt me Komitetin Qendror (Komitete rethe, sikurse ka sot Partia e Punes, nuk kish) Ne qark, imediatisht pas Komitetit qarkor te partise, vinte Komiteti qarkor i rinise.

Komiteto qarkor i Partise perbeheshe nga 7 veta zakonisht:

1.- Sekretari politik. Ky ishte i plotfuqishmi i partise. Ne ate kehe kur lidhjet me qendren qene shume te dobta dhe te veshtira, ky kish inisiativa dhe pergjegjesi te medha. Fjala e tij qe fjala e Komitetit Qendror.

2.- Sekretari organizativ. Ky ishte ndihmesi i tij i pare, dera e djathte. Kompetencat e tij kryesore kishin te benin sidomos me kuadrin, me vendosjen e personelit, gradimet, denimet, etj.

3.- Pergjegjesi ushtarak. Ne kompetencat e tij qene ketem ceshtjet e cetave partizane ne mal, Ky interesohehe me organizimin e tyre, shtimin e tyre, aksionet qe do te zhvillohin, etj. Terreni i punes se tij, pra, muk qe qyteti, por mali.

4.- Pergjegjesi i Agitacionit dhe i Finances. Ky mereshe me propaganden e Partise ne qark, me botimet ilegale, shtypjen e tyre dhe administrimin e fondeve te partise (qofshin keto te ardhura nga kuotizacionet e anetareve, qofshin nga "ndihmat" e popullise).

5.- Pergjegjesi i simpatizanteve te partise. Detyra kryesore e tij qe puna me simpatizantet e partise, kontrolli i tyre dhe percendrimi i aktivitetit te tyre.

6.- Pergjegjesi ose pergjegjesia e grave. Kjo perqendronte dhe drejtonte punen me grate, sikurse e tregon edhe emri.

7.- Pergjegjesi i rinise. (Shojegjimet jane te kota).

Afer Komitetit qarkor te partise ndodheshin zakonisht 2 anetare partie, pa qene anetare te qarkorit, por qe lidheshin direkt me te. Zakonisht qene njerez te besimit te madh. Aeta ishin:

a) Pergjegjesi teknik. Detyra e tij: Sigurimi i bazave ilegale ne qytet, perçjellja e ilegaleve jashte qytetit, korrespondenca epistolare e qarkorit, etj. (lidhesh me sekretarin organizativ).

SECRET

SECRET

- 20 -

Konstitucioni
 b) ~~Partia~~ i njesiteve guerrilje te qytetit (i dyti ne radhe, por jo nga rendesia). Thashe se cetat partizane, domethene formacionet e armatosura legale te partise, lidheshin me pergjegjesin ushtarak te qarkorit. Njesitet guerrilje te qytetit, qe perbesheshin nga elemente ilegale jo vetem per armikun por edhe per antaret e partise, dhe qe mereshin me sabotazhe, atentate, etj. brenda qytetit, lidheshin me kete. *(Hish. m. vedhënie me sekretarin politik)*

(Imediatisht pas Komitetit qarkor te partise kam vene Komitetin qarkor te rinise. Antaret e keti komitei qene te gjithë antare partie, dhe elemente qe konsideroheshin me kapacitet e besnike.)

Celulat, sikurse tregon tablleja, qene organizatat-baze te partise komuniste. Edhe ato, perbeheshin nga 7 antare partie. Secili me nje pergjegjesi te caktuar. Qene, ne miniature, komitete qarkore, vetem se me funksione me te kufizuara, gjeografikisht dhe organizativo-politikisht.

Nepermjet 7 anetareve te saj, celula lidheshe:

A-- me masen e grave - nepermjet grave simpatizante partie;

B-- me masen e rinise - nepermjet te rinjve komuniste;

C-- me njesitet guerrilje (te perbera nga antare partie, ose simpatizante partie, ose te rinj komuniste, ose te rinj antifashiste) - nepermjet pergjegjesit te njesitetit guerrilj;

D-- me krejt popullsine dhe shtresat e ndryshme te saj - nepermjet pergjegjesit te ~~grupit~~ ^{grupit} te simpatizanteve. (Grupet e simpatizanteve qene ne realitet celula partie te verteta; mbi simpatizantet ushtroheshe e njeja discipline e *qe ushtroheshe edhe mbi antaret e partise.* partise, qe nje forme tranzitore e cila i jepte mundesine partise te siguroheshe me mire dhe te kontrollonte elementin qe do te hynte me von ne parti, per t'u prere rrugen provokatoreve dhe ajerezve te dyshimte).

baqe mbi strukturen organizative te Partise komuniste ne vitin 1941- e si domos 1942. Duhet te theksoj, ketu, se kete strukture, me perjashtime e ndryshime jashtezakonisht te parendesishme qe nuk vlejne t'i permend, ruajti Partia komuniste shqiptare deri ne kohen e hikjes se gjermaneve nga Shqiperia, domethene deri sa mbaroj lufta dhe partia erdhi ne fuqi si e vetmia parti qeveritare.

Fame anen organizative te Partise komuniste shqiptare, qe persa u themelua. Do te shpjegoj tani aspektin politik. Dhe me duket se po mos shpjegenja format e punes, nuk do te kuptoheshë as ana politike.

SECRET

SECRET

- 21 -

Grupet e vjetra komuniste qe ekzistenin para 12 nendorit 1949 kishin nje program dhe nje vije politike qe nuk mund t'i afronte kurre me popullin.

• Ato qene shume sektare,

Ne ceshtjet e moralit: parimet e vjetra moraliste te grupit te te rinjve, qe kishin zene vend edhe ne grupin e Shkodres, u denuan. Komuniste me nje moral aqe te degjeneruar ishin te urrejtur je vetem per opinionin publik shqiptar, por ~~me~~ edhe per opinionin publik frances ase italian, qe njihen si mjaft "te lire" ne kete drejtim. Sipas udhezimeve te Miladin Popovicit, morali i partise u be shume i ngurte, qe te pershtateshe me traditat dhe zakonet shqipe. Ky moral, ~~qendronte~~ pa frike bergenjeshtrimi, ishte krejt puritan ne maredheniet burre-grua. Ay u leshua vetem ne pragun e "clirimit". Megjithe akuzat e "Ballit kombetar" kunder moralit komunist te asaj kohe, e verteta eshte se partia, deri ne pragun e clirimit ka ~~mbetur~~ qene teper ekzigjente. Jane pushkatuar partizane, antare partie dhe kuadro me pergjegjesi vetem e vetem sepse kane hyre ne maredhenie seksuale ~~me~~. Vjedhjet ne familje, te mxitura deri atehere, u ndaluan kategorikisht. Grindjet ne familje u eliminuan dhe ato lejoheshin vetem atehere kur prinderit beheshin penges ^{e munde} se per aktivitetin e te rinjve. Me perpara, elementet e grupeve e kishin per detyre te prisnin lidhjet familjare me te vjeterit, i pengonin ese jo ne punen e tyre, vetem e vetem qe te tregonin keshtu "indipendencen" e tyre dhe "revolucionarizmin" e tyre.

Ne orientimin politik: Propagandimi i Bashkimit Sovjetik u vu ne plan te pare. U denuan keshtu pikepamjet dhe opinioni i grupit te te rinjve se maredheniet e Shqiperise duhet te ishin ne nje plan ^{juve} te barabarte si me Bashkimin sovjetik ashtu edhe me shtetet kapitaliste. Grupi i te rinjve e kish akuzuar si shtet "kapitalist" Rusine kur sulmoi Finlanden. Kjo pikepamje u denua rende dhe u tha se ne asnje rast Rusia nuk mund te veproje si shtet kapitalist.

Orientimi brenda-per-brenda vendit, domethene ne kuadrin nacional, ndryshoi kryekeput. Grupi komunist i Korces bente nje politike shume klasiste. Ay kish ne program imediat "Shqiperine sovjetike" (Shih traktet e para te keti grupi). Miladin Popovici, sigurisht sipas udhezimeve nga jashte, vuri ne program "Shqiperine demokratike popullore". Ky ndryshim parulle ^{parmbulite ac vet vehte} ~~mbente~~ nje taktike krejt ~~te~~ re. Ajo niseshe nga parimi se Partia komuniste duheshe te kamufloheshe, te fshihte qellimin final ne menyre qe te grumbullonte reth

SECRET

SECRET

- 22 -

vetes te gjitha forcat e vendit, pavaresisht nga origjina e tyre. Jo "aleance me shtresat e shtypura, kunder elementit ofrytzues" -sic qe parulla e vjeter e grupeve, por "aleance me te gjitha klasat, edhe me bejleret, edhe me bajraktaret, kunder okupatorit te huaj". Pra, jo lufte per fitoren e komunizmit ne Shqiperi, per lufte per dbimin e Italisë fashiste. Prena private, qe ne kehen e grupeve luftoheshë si burimi i tere te keqijave, u deklarua e paprekeshme, e shenjte. Forma e qeverisjes se Shqiperise, kur te clikoheshë, pretendoheshë qe nuk do ish diktature, por demokraci. Reformat qe do te beheshin nuk do te beheshin me "rrugen sovjetike" por me "rrugen liberale". Etj. etj.

Te gjitha klasat, te gjitha shtresat, gruaja dhe rinia shikonin ne kete program e vije politike te perfaqesuara aspiratat e tyre dhe interesat e tyre. Sektarizmi i vjeter, i ngurrte, i kish lene vendin nje liberalizmi te ri, te ndritur. Ky liberalizem ishte i destinuar, sikurse kuptohet, te maskonte qellimet e verteta te Partise Komuniste, dhe ta paraqiste ulkun si qengj.

Ky program politik, pra, i ndihmuar jashtezakonisht nga idete atdhetare qe qendronin ne bazen e tij (lufte kunder okupatorit italo-gjerman) i dhane te gjitha mundesite Partise, qysh ne fillim, te afrohet me masat dhe te vihet ne udheheqje te tyre; ne qytete. Cetat e para partizane dhe sjellja e tyre e lidhen me masat e fshatit.

Kritja e autoritetit dhe e prestigjtit te Partise ne masat u be aqe e shpejte, sa qe 5 muaj pas themelimit te saj, partia organizoi njesitet e pare te armatosur. Duhet te shpjegoj se ne ate kohe okupacioni italian kish sjelle nje anarki ne vende. Karabinieria e okupatorit nuk mund te siguronte qetesine e fshatarit. Ne mal kishin dale hajdute, qe grabitnin sistematikisht fshataret e qete, tradite kje e lene ne Shqiperi qe nga okupacioni otoman. Ate qe nuk munden ta benin organet e gjindarmeris italiane, e bene cetat partizane. Komunistat ^{vendosen vendin dhe qetesine.} kundrejt ketyre cetave hajdute ^{ato} ndoqen kete vije: u perpoqen me ane bisedimesh t'i bejne per vete, t'i kthejne ne cetat partizane. Ata qe nuk prantuan te vihen nen kontrollin e komisarave, u ndoqen dhe u luftuan. Neper fshatrat, shteti kishte depo te medha me bereqet, melesh, domethene ajo qe queshë atehere xhelepi, e dhjeta, etj. Kete depo u hapen nga partizanet dhe iu shpermdane popullsisë fshatare. Sjellja morale e partizaneve me popullin qe shume rigoroze. Disiplina e tyre e hekurtë; nuk lejoheshë arroganca, te kerkuarit e gjelleve te mira, etj.

SECRET

SECRET

- 23 -

Ne fillim te 1942, ne mal, nuk kish asnje force tjeter te organizuar ushtarake. Balli Kombetar i nxori cetat e tij te para nje vit me von, nga fillimi i 1943.

Natyrisht, ky faktor, lidhur me orientimin e ri politik te Partise komuniste qe u pershtateshe te gjitha klasave, beri qe Partia te ngjitet me rithme te shpejta perhere e me lart.

Shkurtimisht: Partia komuniste cfrytezoi si jo me mire situaten e atehereshme. Eskperienca e grupeve te vjetra komuniste, sado qe e paretmesishme, i sherbeu jashtezakonisht per punen ilegale. Po aqe shume sherbyen edhe anetaret e ketyre grupeve. (Jo te gjith anetaret e grupeve te para komuniste u pranuan ne parti. Shume prej syresh mbeten jashte partise; nje pjese nga keta qe mbeten jashte u caktuan si simpatizante partie, pjesa tjeter, me e madhe, u caktuan ne rinine komuniste. Kjo shpjegon edhe arsyen perse, me 1941, parta kish vetem 240-250 antare partie efektive maksimumi.) Ajo veproj me guxim qe ne fillim, e sigurt se per cdo komunist te vrare ose te arrestuar, me programin e ri, do te vinin pas saj dhjetra te tjere. Ne kete pune e ndihmoi shume politika hezitante e Italisë. Organet e okupatorit ne Shqiperi e nenvleftesuan ne fillim rrezikun e Partise komuniste. Reaksioni i tyre qe i bute. Levizjen komuniste e nenvleftesuan edhe individet antifashiste nacionaliste ne fillim duke e konsideruar si nje "levizje cilimijsh", si "nje levizje studentesh te ekzaltuar", levizje te cilen mund ta shtinin ne dore kur te donin. E arthemja e afert tregoi se llogarite e tyre qene shume te gabuara. Kur filluan te hynin ne valle keta nacionaliste te vjeter, qe shume von. Ata qene te vjeter jo vetem nga moshe, por me e keqja ish se ata qene politikane te vjeteruar. Situata revolucionare e atehereshme kerkonte njerez energjike dhe guximtare. Ata u treguan te pjotes dhe pa eksperience. Pa frike pergenjeshtrimi avancej se ata ishin kapercyer nga kohet. Metodot e tyre dhe eksperienca e tyre qe mu ish in te mira nd te ~~lexojme~~ nje cerek shekulli me pare, ~~ishin~~ ishin te demoduara me 1940. Situata e atehereshme kerkonte disipline te hekurt. Ata jetonin dhe vepronin ne nje anarki te pjote organizative. Situata kerkonte aksione, qofte dhe vetem demonstrative; ata e kufizuan aktivitetin e tyre ne bisedime akademike neper kafenete. Tere pluset e partise qene minuse ne 'ta.

SECRET

SECRET

- 24 -

Pergjigje pyetjes se III-te.Kush e mori iniciativen per formimin e Partise komuniste shqiptare dhe cilat figura ndodhen edhe sot te gjalle. Pershkrimi i tyre.

Iniciativen per formimin e Partise komuniste shqiptare e muaren kryetaret dhe nenkryetaret e tre grupeve te vjetra komuniste (Grupi i Korces, Grupi i te rinjve dhe Grupi i Shkodres), te cilet qene:

Koço Tashkua dhe Miho Lakua (per grupin komunist te Korces); Anastas Lulua dhe Nasi Mariani (per grupin komunist te te rinjve); Zef Mala dhe Vasil Shantua Shkodres (per grupin komunist te ~~Korces~~ Kryetaret e dy grupeve te tjere komuniste: Niko Xoxi (per grupin qe mbante emrin e tij ose "Grupi jeshil") dhe nje fare mbiemri Vangjeli (~~Xoxi~~ i te cilit nuk me kujtohet (per Grupin e "Zjarrit") refuzuan shkrirjen dhe formimin e nje partie unike.

Nga keta persona:

KOÇO TASHKUA: Bron edhe sote. Duhet te jete rreth 50 vjec. Kryetar i Grupit te Korces. Nuk ka bere pjese kurre ne Komitetin qendror te Partise. Kur u arratisa nga Shqiperia kishte postin e nen/ministrit te ~~XXXXXX~~ jashtem, je per aftesite dhe kapacitetet e tij, por vetem e vetem si veteran komunist qe nuk i ka sjelle dallvera dhe veshtiresi partise. Mereshe me ceshtje administrative, me shkresa, etj. Gjate tere periudes se revolucionit ose luftes nuk ka ushtruar asnje funksion te caktuar. Qendronte prane Komitetit qendror dhe prane Shtabit te pergjitheshem me funksione "nderi". Caktoheshe nga nde nje here per bisedime me individe nacionaliste, me qellim qe te afroheshin keta prane Keshillit te pergjitheshem antifashist nacional-Clirimtar (KAMI shqiptar). Per kete arsye ish zgjedhur edhe anetar i ketij Keshilli.

Ka mare pjese ne levizjen revolucionare qe ne moshe te re, si anetar i Grupit te "Bashkimit" (keha e Fan Nolit ne Shqiperi). Me ardhjen e Zogut ne fuqi (1924), ~~XX~~ u arratis nga Shqiperia dhe shkei si emigrant ne Rusi. Rasi qendroi nje kohe shume te shkurter dhe frekuentoi nje nga kurset e atehereshem te Kominternit, eshte nxjerre jashte Rusise per te punuar me emigracionin shqiptar qe u arratis nga Shqiperia me ardhjen e Zogut ne fuqi. Eshte perzjere ne punet e KONARE-s (Komitetit nacional revolucionar), i cili grumbullonte perfaqesues te ndryshem, te se majtes, elemente antizogiste ne emigracion, dhe Komitet i cili falimentoi perpara 1939-es, mbasi u shpernda nga grindjet qe e brenin perbrenda. Ka qene per disa vjete si emigrant politik ne France, Itali, Austri dhe Shtetet e Bashkuara te Amerikes. Ardhi ne Shqiperi njaft

SECRET

SECRET

- 25 -

kohe perpara okupacionit ushtarak te Shqiperise nga ana e Italisë fashiste, duke perfituar nga falja e Zogut. Ka qene sigurisht i derguar nga Moska, dhe njeri nga bashkepuntoret me te ngushte te Ali Kelmendit (shih mbi kete emer pergjigjen I). Pas arratisjes se Ali Kelmendit nga Shqiperia ne France, mori kryesin e grupit te Korces, post te cilin e mbajti deri sa ky grup u shkri ne partine komuniste pas "clirimit" te Shqiperise, ka ushtruar funksione te ndryshme, kurdohere si kuader i Ministris se jashtme dhe ka qene respektivisht minister i plotfuqishem i Shqiperise ne Bashkimin Sovjetik, minister i plotfuqishem i Shqiperise ne Sofje (Bullgari) dhe me ne fund nen/minister i jashtem.

Njeri jo i qarte politikisht dhe qe mund te beje gafa politike po te mos kontrollohet nga afero. Keke forte e kapricioz si karakter. Nevrastenik dhe pak i shoqeruar. Partia nuk ka patur kurre konsideracion te mire, per aftesit e tij personale. Meritat e tij perqendrohen vetem ne kete: i bindur, pa pretendime te medha, komunist i kalibrit te vjeter; mendon jo me koken e tij por vetem me koken e te tjereve. Eshte perdorur keq nga Koci i Xoxes. Enveri e simpatizon dhe e don si "shef" i dikurshem i tij, ndofta me dashurin e nxe-nesit per profesorin dashamires. Mehmeti e perbuz per pazotesin e tij. Eshte nje kuader qe e ka bere koken e tij dhe s'ka c'i jep me partise. "espektohet vetem e vetem si nje nga "baballaret" e komunizmit ne Shqiperi.

MIHO LAKUA:-- Nenkryetar i grupit te Korces. Ka qene kurdohere ne Shqiperi dhe nuk ka dale ~~gjat~~ ne Ferendim. Per nje kohe, kur ish shume i ri, ka shkuar si puntor kepuceberes ne Rumani, ku kish far' e fis te tij. Ne Shqiperi e gjeti Ali Kelmendi nga 1931-1932 dhe e ka mbajtur shume afer vetes se tij. Eshte nje Koco Tashko i dyte. Gjate luftes nuk ka patur asnje funksion, jo vetem sepse i mungojne aftesite por edhe sepse qe ne moshe te re ka qene i semure rende si tuberkulloz. Ka qendruar vazhdimisht neper senatoriumet dhe shtepira pushimi te Partise, por kurdohere si anetar partie. Koci i Xoxes e kish nxjerre jashte partise si element "te pavlefshem". U rifut ne parti pas kongresit te pare, pa asnje funksion ne pushtet ose ne aparatet e partise. Nga 1954 (fillimi i vitit), Partia qe nuk dinte se c'ta bente dhe me qellim qe t'i krijojte kondita jetese me te pershtateshme per semundjen e tij, e caktoi minister te Shqiperise ne Bukuresht (Rumani).

SECRET

Edhe ky nuk ka asnje aftesie. Bron me lavdine e se kaluares si ~~ind~~ nje nga "baballaret" e komunizmit ne Shqiperi. Shume i dhene pas Partise.

SECRET

- 26 -

ZEF MALA:- Kryetar i Grupit komunist te Korces. Duhet te jete reth 50 vjec. Ndersa Miho Lakua eshte lindur dhe ka banuar kurdohere ne Korce, ky eshte lindur dhe ka banuar kurdohere ne Shkoder. Ndersa i pari eshte pa kulture, ky (domethene Zefi) ka shume kulture. Per kultura e tij eshte kulture prifti. Shume skolastik. Njeri biblioteke dhe jo aksioni. Eshte vene ne krye te grupit te Shkodres vetem nga rrethanat anormale te atehereshme dhe ndenji deri sa u shkri ky grup. Ka qene anetar partie (por ne anje forme) deri aty nga fundi i 1942-se. Ne atehere eshte perjashtuar si perkrahes i Anastas Lules (kryetar i grupit te te rinjve) dhe nuk eshte pranuar me ne parti. Ka ndenjur jashte levizjes revolucionare gjate gjith kohes se ~~revolucionare~~ luftes, si individ i braktisur ne perithore. Nga 1946 Koci i Xexes e arrestoi si element te dyshimte, ose me mire si element qe mund te perdoreshe per gjyqet e mepastajme qe kishte nder mend te trillonte ky person (sipas shembullit te Treckit e Tukacevskit) me qellim qe te odukte Enver Hoxhen dhe te tjeret qe kishte ne plan. Pas Kongresit te pare, domethene pas pushkatimit te Koci Xexes dhe prishjes se maredhenieve Beograd-Tirane, Zef Malaes iu dha nje pune si drejtor biblioteke shtetere, por pa u pranuar ne parti.

Njeri qe ka humbur edhe ate pak gjak qe mund te kishte sa ish "shef". Ka karandisur nje levereg dhe humbur cdo personalitet. Ndofta edhe sepse eshte aqe miop, sa qe praktikisht konsiderohet i verbere. Uj metra larg hundes se tij, edhe me gjyslyke, nuk dallon gje. Njeri ne te cilin partia nuk ka besim, por/deri ne ate mase sa ta konsideroje si te nevojeshme izolimin e tij ne burg ose ne kamp perqendrimi.

VASIL SHANTUA:- Ish nenkryetar i grupit komunist te Shkodres dhe ne fakt shefi praktik i keti grupi. Zef Mala qe sa per forme. Sekretar organizatif i Komitetit qendror qe me formimin e Partise. U vra buze liqenit te Shkodres, si ilegal, ne perpjekje me italianet, aty nga 1942.

ANASTAS LULUA:- Kryetar i grupit te te rinjve. Mbeti jashte Komitetit qendror me formimin e Partise komuniste, si gjith kryetaret e tjere. U vra nga partia, fshehtazi, ne verem e 1942-se (6) per aresyet qe shpjegoj ne pergjigjen I.

NASI MARIANI:- Lindur ne Korce. Vjec 45. Kryer tekniken e Tiranes (shkelle e mesme). Nenkryetar i grupit komunist te te rinjve. Anetar i thjeshte partie qe me formimin e partise komuniste. Per aresye se u ngaterrua me fraksionin e Anastas Lulos me 1942 u dbua per nje vit nga Partia dhe pastaj u

SECRET

SECRET
- 27 -

ripranua, por kurdohere ka qene nen nje fare kontrolli. Gjate luftes ka dale ne mal si partizan, por nuk i jane dhene funksione politike ose ushtarake. Ka qene ne perioda te ndryshme intendent batalioni ose pergjegjes transporti. Nga fillimi i 1945 ishte shef i transportit prane Korpusit te III-te ne Shkoder. Nga mezi i po atij viti eshte caktuar si nepunes i mesme ne Ministrin e rindertimit, ku qendroi deri nga 1947. Me 1947 Koci i Xoxes e perjashtoi nga partia si element antiparti. U ripranua pas Kongresit te I-re dhe i forcoi disi pozitat e tij. ^{Me 1984} ~~Ishte~~ me duket se ishte nendrejtor i Hidrocentralit te Dajtit LULIN, prane Tiranes.

NIKO AOXI:- Ish shef i grupit te jeshilte ose Grupi i Mike Xoxes. U vra me atentat nga partia ne Tirane me 1943 (Shih pergjigjen e I-re).

VANGJEL (mbiemri nuk me kujtohet). Shef i grupit te Zjarrit. As nje nga anetaret e keti grupi nuk eshte ekzekutuar. Por asnje nuk arriti te mare poste ne parti, edhe kur u futen, nje vit mbas formimit te Partise. Ben perjashtim vetem SRIRO KOLEKA, tani anetar i Komitetit qendror, anetar i Byroze politike, dhe shef i komisionit te planit. Koleka eshte njeri me kapacitet per perunden e tanishme. Ka kulture dhe zotesi. Eshte goditur nga Koci i Xoxes, i cili edhe e perjashtoi nga Komiteti Qendror, ku arriti te futet aty nga fundi i 1945-es. U rifut, me postin qe ka sot, pas Kongresit te I-re. Sipas rendesis eshte i fundit ne Byro. Kam degjuar se Mehmet Shehu nuk e simpatizonte; Enveri e ka perkrahur per aftesit e tij. Eshte jashtezakonisht punetor dhe organizator i mire. Nga vartesit e tij njihet si element qe punon 20 ore ne 24. Futur ne partine komuniste nga fundi i 1942-se. Duhet te mos qe nga elementet eksponente te grupit te Zjarrit, ndryshe nuk mund te ngjiteshe ne hierarkin e partise. Pse? Sepse Partia komuniste nuk ka patur kurre besim ne anetaret e ish keti grupi.

Te tjere personalitete qe lojten rol ne formimin e Partise komuniste shqiptare:

ENVER HOXHA. - Sot sekretar i pergjithesem i Komitetit qendror te PrSh. (Shenime komplementare nuk po shtoj, mbasi kam shkruar dender).

IMER DISHNICA.- Vjec 48. Lindur ne Korce dhe mbaruar studimet per mjekesi ne France. Nje nga kreret e komunisteve shqiptare jashte atdheut. Dikur, ne fillim te Partise, edhe sekretar politik i Komitetit Qendror. Njeri me kapacitete dhe me kulture te gjere. ^{Me 1984} ~~Ishte~~ udhheqesit e Partise qe duheshe me

SECRET

SECRET

- 28 -

teper dhe respektoheshe nga anetaret baze per aftesit e tij dhe sjelljet kur-
dohere shoqerore. Pozitat e tij iu shemben ne Konferencen e Mukjes, ku, si
delegat i Komitetit qendror te PKSh i njohu, me mareveshjen qe nereshkroi,
pales tjeter (domethene delegacionit te Pallit) te njejtat te drejta e pri-
vilegje qe kishte edhe Partia ne formimin e qeveris se ardheshme ne Shqiperi.
Per kete u cilesua si "kapitullant" bergjez, si njeri i deviazionit te djatht e
nga Miladini e Enver Hoxha, dhe si i tille u likuidua ^{nga Komiteti} ~~gradualisht~~ ^{ne Berat}
Qendror. Ne qeverin e pare shqiptare qe u formua ne tetor ne 1944/kishte
kryesin e Ministris se Shendetesise. E mbajti sa per forme vetem disa muaj dhe
pastaj katandisi mjek i thjeshte ne spitalin e Tiranes. Sot e kesaj dite eshte
ese me mire ishte ne fund te 1954-es, mjek ne Berat ose Durres.

Njeri i zoti dhe organizator i mire. Me me teper kulture se gjithe kre-
ret e tjere te PKSh. I dashur dhe i sjelle me vartesit, prandaj edhe duheshe
shume gjate luftes. Guxintar. Kishte nje te mete te madhe qe ishte shume pas
grave. Ne kundershtim me te gjith udheheqesit e tjere, eshte martuar me nje
grua shume te bukur ^{je antare partie} por fare boshe nga mente. Ne lidhje me kete, kish zaken
te thosh, ^{me ironi,} se e pranonte edhe vete: "Te te desha grua ^{je te desha grua me mend} (do isha martuar
me Sejfulla "aleshovene Gruaja nuk meret per mente". Njeri qe ka rojtur edhe
sot nje fare personaliteti, sado qe komunistet, edhe ata te vjetrit qe e nje-
hin, nuk e shoqerojne sepse kane friken e Sigurimit. Koci i Xoxes, pikerisht
si Zef Males, ~~pa~~ mendonte ta perdorte ne gjyqet e arthme qe kish ne plan. Mi-
repe nuk e burgosi. Sidoqofte ditet e lira te Ymerit qene te numuruara po mes
kish erdhur prishja e maredhenieve Beograd-Tirane me 1948. (Shih shenimet
biografike qe kam dhene mbi nenkolonelin e Sigurimit Shpend Dega). Eshte ele-
ment qe e ka pranuar me dinjitet disfaten dhe nuk eshte perulur.

KOCI I XOXES-- Ish sekretar organizatif i Komitetit qendror te PKSH pas
vrasjes se Vasil Shantos, domethene qe nga 1942 e deri sa u pushkatua, me
1949, si "titist".

KRISTO THEMELKO (me pseudonimin Shulja). Nje nga udheheqesit e Grupit
komunist te Shkodres. Anetar i Komitetit qendror qe me formimin e "artise.
Elemen^o punetor. E shkollu por i zgjuar dhe organizator i mire. Luftetar
individual e dalluar. Pas clikimit u bashkua me Koci Xoxen, i cili e kish
vene drejtor politik te Ushtrise, si kunder-peshe ndaj Enver Hoxhes i cili
qe Komandant i pergjitheshem. Me prishjen e maredhenieve Beograd-Tirane me

SECRET

SECRET

- 29 -

1948, u heq jo vetem nga Komiteti qendror e Byroja, ku ish qe nga 1941, por edhe nga posti si drejtor politik i Ushtrise. Qe nga 1948 u emerua president i Bashkimit te kooperativave te artizanatit dhe ne ate post e lashe kur u arratisa nga Shqiperia ne nendorin e 1954-es.

Njeri pa kulture por organizator i mire. Shume i dhene pas Kartise. Ra ambicje. Nuk qe element i lidhur me Kocin per te fituar pozita, por me teper viktime e tij. Shume i thjeshte ne sjelljet me vartesit e tij edhe ne kohen kur ish ne apogje. Uezion simpati per trimerin e tij, meritat e se kaluares dhe karakterin e shoqerueshem. Edhe sepse u ul ne post, konsiderohet me shume sy te mire sepse te tjerit nuk e druajne per aresye te modestis se tij.

QEMAL STAFI.- Ish anetar i Komitetit qendror qe me themelimin e Kartise, dhe sekretar i Komitetit qendror te Rinise komuniste. (Nako Spirua ish sekretar organizatife i Rinise komuniste, dhe pas vrasjes se qemalit zuri vendin e tij). U vra shume i ri dhe qe ne fillim te levizjes ne rruget e Tiranes me 1942.

RILO FERISTERI.- Lindur ne Korce. Anetar i te parit Komitet qendror te rKSh. Nuk u rizgjedh anetar i Komitetit qendror me Konferencen e I-te te vendit (mars 1943) sepse nuk qe treguar ne lartesisin e duhur ne kryerjen e detyrave qe i ishin ngarkuar. Ra shkelle, puntor hekurxhi, i ploget dhe pa asnje aftesi politike - cilesi e dommedeshme per udheheqsit. Gjate gjithë luftes arriti maksimumi zv/komisar batalioni, ne Brigaden e IV-te. Pas clirimit ish shef i policis kriminale ne qarkun e Korces. I forcoi pozitat e tij vetem pas Kongresit te pare, sepse u konsiderua si i goditur padrejtesisht nga Koci i Xoxes. Njeri qe perkrahhet shume nga Enver Hoxha sepse kane qene kurdhere bashke ne kohen e Grupit te Korces, si shoke.

Personalisht mendoj se eshte nje koke beshe. E kane vene ne Komitetin qendror dhe kandidat te Pyrose e president te Bashkimeve te pergjitheshme profesionale vetem e vetem sepse ka patur perkrahjen e madhe te Enverit. Vetem e vetem sepse eshte nga shtrese puntore, vete puntor, shume i dhene pas Kartise, modest dhe pa pretendime. Nuk i ka dhene kurre shkak Kartise qe ta shohet me bisht te syrit: as ngaterresa, as tarafe, as perpjekje per t'u ngjitur perpjetet. Eshte nje kale qe heq nje arabe pa ditur as ay vete me se eshte ngarkuar dhe ku shken.

LIRI GEGA.- Lindur ne Gjirokaster nga familje qytetare e mesme. Ra baruar

SECRET

SECRET

studimet per arsintare. Antare e Komitetit qendror qe me themelimin e Partise. Ne veren e 1944-es ish e deleguar e plotfuqishme e Komitetit qendror prane Divizionit te I-re i cili u hodhe nga Jugu ne Veri per vendosjen e pushtetit komunist edhe ne Gegerio. Me kete cilesi i forcoi shume pozitat e saj dhe aspironte te torpillonte Koci Xoxen nga posti i sekretarit organizativ. Ne plenumin e Beratit (tetor 1944) u akuzua per karrizme, arrivizme, sektarizme (politike personale kuadri me qellim qe te krijonte taraf), gabime te deviacionit te majte (vrasje te pajustificuara ne Veri) dhe u hoq nga Komiteti qendror. Ka qene pastaj, per nje kohe, presidente e Bashkimit te grave antifashiste shqiptare. Kur iu lekunden kembet edhe burrit te saj (Dali Dreut) sepse u akuzua per politike tarafi ne Veri nga Koci i Xoxes, Miri Gega u hoq edhe nga kryesija e grave, u dbua nga partia si element i pavlefshem dhe u emerua ~~XXXXXXXX~~ mesuese ne shkollen pedagogjike te Tiranes.

Organizatore shume e zonja dhe me autoritet te madh. Njeri qe nuk u trembej pergjegjesive dhe i inisiativave. E eger dhe arrogante. Ishte tmerri i kuadrove. Eshte nje Mehmet Shehu ne miniatyre. E zonja dhe me aftesi por e lige nga shpirti. E zgjuar dhe me kulture. Tani ka mbetur krejt e braktisur dhe e izoluar. Natyrisht duhet te jete teper e pakenaqur, sepse nuk eshte tipi i Kristo Themelkos. Jashtezakonisht ambicioze.

RAMADAN CITAKU (Me pseudonimin Baca). Anetar i Komitetit qendror qe me prane Komitetit qendror te Partise themelimin e partise. Ka patur kurdohere pergjegjesine e finances/dhe te furnizimit prane Shtabit te pergjithesem deri sa u cilrua Shqiperia. Njeri i muzget, pa fjale, i mbyllur ne vet'vete. Jo shum i kulturuar ~~xxx~~ dhe as person politik, por organizator i dalluar. Me ne qeverin e pare te Beratit ka pasur kryesin e Ministris se financave, dhe kete e ka mbajtur deri nga 1948. Me 1948, kur maredheniet Beograd-Tirane qene ne kulm te perzemersise (ne pragun e prishjes), Koci i Xoxes, per arsye qe kuptohen e kish emeruar ministri te plotfuqishem te Shqiperise ne Beograd. I humbi pozitat pas Kongresi te pare. Keshtu, me 1949 ~~xx~~ u emerua nepunes ne degen e arkave te kursimit ne Tirane. Me qene se eshte organizator i mire, me 1952 u ngrit ne postin e Drejtorit te pergjithesem te arkave te kursimit ne Shqiperi. Aty e lashe me nendorin e 1954-es. Shume i dhene pas Partise. Runtor i madh. Eshte tipi i komunisteve qe jane ne udheheqje.

SEJFULLA MALESHOVA: Lindur ne Maleshove te Gjirokastrës. Anetar i grupit

SECRET

SECRET

- 31 -

"Bashkimi", organizate e majte ne kohen e Fan Nolit. Arratisur nga Shqiperia qe me ardhjen e Zogut ne fuqi, qe me "triumfin e "legalitetit". Qe atehere iku ne Rusi ku ndenji per shume vjet. Mbaroj shkollen e Kominternit per kuadret e dhe u emerua profesor filozofie ne universitetet e Rusise. Ka qene pak kohe ne Ferendim e sidomos ne France. Erdhi ne Shqiperi kur ish formuar partia, por sapo erdhi u kooptua ne Komitetin qendror dhe zuri nje post me rendesi. Ka qene teoriku i Partise dhe eksperti i ceshtjeve ekonomike. Mbas clirimit, per pikepamjet e tij qe u quajten "te djathta" (ish kunder metodave revolucionare ne fushen ekonomike, kerkonte nje rithme me te ngadalshem) u perjashtua nga Byroja por u la per nje kohe ne Komitetin qendror. Ish minister i Arsimit-kultures. Kur u dbua nga Komiteti qendror, me 1946 u dbua edhe kryesia e ministrise. Pak me von, sepse nuk pranoi te beje autokritike, u dbua edhe nga partia. Me 1954 e lashe perkthyes te thjeshte. Njeri qe po mos ish rrezuar Koci i Xoxes do qe arrestuar dhe demuar.

Njeri politik, i zgjuar, me nje pregatitje te shendoshe kulturele e teoretike. Me teper person/politik se sa organizator i shkelqyer. I pelqen sporti dhe tere dite lot tennis; edhe kur ishte anetar i Byroese politike dhe personi Nr. 3 nuk mbylleshe shume brenda si te tjeret. Me kapacitet dhe merita nga e kaluara. Ka personalitet dhe koke-forte. Nuk shoqerohet sepse kuadrot kane friken e Sigurimit. Ferberja e sotme e partise, (element shume i ri) nuk e njuh mire. Eshte harruar sepse u largua nga skena politike ketu e 10 vjet me pare, duke qendruar, ne krye te Partise, vetem per 2-3 vjet, dhe keto, vite lufte e revolucionit.

NAKO SPIRU.-- Anetar i Komitetit qendror disa muaj pas themelimit te Partise. Njeri shume i zoti. Politik dhe organizator i dalluar. Vrauveten me 1947 ose fillimi i 1948-esej ne rrethana te cilat me bejne te thom se praktikisht u vra nga partia, e sidomos nga Koci Xoxes i cili pregatiteshe ta arrestonte si agjent te fuqive imperialiste mbasi ish ngritur kunder mareveshjeve shqiptare-jugosllave, mareveshje te cilat i konsideronte si te favoreshme vetem per parten jugosllave.

BEDRI SPAHIU.-- Anetar i Komitetit qendror qe ne Konferencen e I-re te ven mars 1943 dit, pergjegjes i partise per qarkun e Gjirokastrës qe me themelimin e Partise. Ka qene me radhe komisar i Zones se pare operative Vlore-Gjirokaster, anetar i

SECRET

- 32 - **SECRET**

Shtabit te pergjitheshem deri ne dliimin e Shqiperise, me graden gjeneral-major. Minister i Asistences sociale per nje kohe te shkurter, drejtor politik per nje kohe tjeter, prokuror i pergjitheshem i shtetit, deri me 1948. Ne kohen e Koci Xoxes nuk i kish aspak pozitat te shendosha. Ish perjashtuar nga Byroja dhe mbikqyreshe nga Sigurimi si element qe do te arestohesh nga Koci i Xoxes. I forcoi shume pozitat mbas Kongresit te I-re (1949) duke u bere sekretar per agitpropin ^{ne} ~~Byroja~~ Byrone politike. "er ambicje personale Mehmeti e akuzoi si njeri te deviacionit te djathte dhe ne Kongresin e II-te u hoq nga Byroja por mbeti ne Komitetin qendror duke u emeruar minister i Arsimit e Kultures. U torpillua nga ky post me 1955 dhe me sa kam degjuar eshte mesues ne Elbasan.

Politik i mire dhe organizator i dalluar. Njeri i bute dhe qe sillet mire me vartesit e tij. Ka gezuar kurdohete simpatin e masave te partise qe e njihnin. Ka nje kulture te mire te fituar me teper se sa ne shkollat ne menyre autodidakte. Konsiderohet si njeriu qe nuk eshte pajtuar me ^{ekstremizmin} ~~ekstremizmin~~ e majte te Mehmet Shehut, por nuk ka patur kurre guximin t'i beje balle burrnisht. Ka qendruar me teper ne pasivitet se sa ne aktivitet ne pikepamjet e tij, ndofta sepse e shikonte qe "ekstremizme" ish edhe orientimi i Moskes. Per te shpetuar pozitat e tij ne fund kish arritur edhe ne nje fare servilizmi ndaj Mehmet Shehut. Mund t'i permiresoje pozitat me orientimin e ri te Moskes, por jo imediatisht sipas mendimit tim. Dhe duke i permiresuar, do te arrije perseri shume lart. Njeri qe e do partine dhe ka idet e tij por nuk ka guxuar kurre t'i shprehe.

ISNI KAPO. Me pseudonimin Besniku. Ne nje moshe me Enverin, reth 46-47. Anetar i Komitetit qendror qe me Konferencen e I-re (mars 1943). Ne fillim sekretar politik per qarkun e Vlores, komisar i "brigades se V-te, ~~komisar~~ zevendes/komisar i Divizionit te I-re, komisar i Korpusit te I-re. Me 1945 u dergua si minister i plotfuqisem i Shqiperise ne Beograd. Zevendes/minister i jashtem me 1947, pastaj drejtor politik i ushtrise per nje kohe, zevendes-kryeminister pas Kongresit te I-re (1949) dhe minister i Bujqesise. Anetar i Byrore dhe njeri me post te rendesisem. Ne kohen e Koci Xoxes nuk ish nga elementet qe shikoheshin me sy te keq. Ka ruajtur kurdohere pozitat.

Njeri me nje squaresi otomane, per intriga dhe dallavera. Mban gjithmone nje pozite te mesme, pa u lidhur shume me ndonjerine. Luftetar personal trim,

SECRET

SECRET

- 33 -

i guximshem ne kohen e luftes. Por jo koke politike per peride ndertimi. Organizator i mire. Njeri jo i nisjativave dhe i planeve por element per te kontrolluar te tjerit dhe zbatuar nje plan te dhene. Di te manovroje nga te fryje era. Gezon konsideracion ne parti sepse ata qe e kane njohur nga afer ne kohen e luftes e donin si trim. Tani eshte bere arrogant dhe ekzigjent i madhe runder rutine dhe jo studiez.

TUK JAKOVA:- Anetar i Komitetit qendror qe ne Konferencen e pare te vendit (mars 1943). Delegat i K. Q. ne krahinen e Mokres dhe ne veren e 1943 komisar i Brigades se I-re, pastaj komisar i Divizionit te --re, komisar i Korpusit te III-te, kryetar i sindikatave shqiptare per nje kohe fill pas clirimit, minister i Shqiperise ne Beograd, ~~XXXXXX~~ minister i financave (ne vend te Ramadan Citakut, kur ky shkoi ne Beograd). I forcoi pozitat shume pas Kongresit te pare (1949) duke zene vendin e Koci Xoxes si sekretar organizativ i Komitetit qendror. U be keshtu personi Nr. 2 (Mehmeti, dhe bashke me 'te Bedri Spahiu, qene personat Nr. 3). Gradualisht Mehmeti e largoi nga posti i sekretarit organizativ, duke e odukur kete funksion. Qe atehere pozitat e Tukut u tronditene. U be nen/kryeminister dhe minister i financave, por nuk qendroi shume kohe. Me 1955, se bashku me Bedrine, u ddua nga Komiteti qendror (nga Byroja ish zbuar qe ne Kongresin e II-te te Partise) dhe humbi edhe postin si minister. Kam degjuar se tani eshte pergjegjes i nje zdrukthetarie. Fati i keti, qe nga 1949 e ketej ka qene i lidhur kurdohere me fatin e Bedriut. Mehmeti i ka torpilluar vazhdimisht per te bere "piazza pulita" reth vetese.

Organizator i zoti, person politik mjaft i sqaruar sado qe puntor. Trim gjate luftes dhe gezon simpatin e anetareve qe e njohine. I sjellshem dhe i mirekuptueshem. Eshte qendur si deviator i djathte. Mendoj se fati i tij edhe tani e tutje eshte i lidhur me fatin e Bedriut. Element i dhene e i vendosur ndaj partise. Jo koke-forte si Sejfulla Taleshova. Per te ruajtur pozitat, ka pruar cdo autokritike qe i ka kerkuar partia, ose me mire cdo autokritike qe i ka kerkuar Mehmet Shehu. edhe ketu i perngjet shume Bedri Spahiu.

PANDI KRISTO. - Anetar i Komitetit qendror qe ne Konferencen e fare te Partise (mars 1943). Eshte mare vazhdimisht me pune partie, me pune kuadri ne Komitetin qendror. Ka qene nje fare "eminence grise". Dera e djathte e Koci Xoxes dhe nje nga elementet me te besuar te Beogradit. U denua me 20 vjet burgim ne 1949, ne gjyqin e Kocit. Tani duhet te jete liruar. Koke trashë, arrogant, violent. Anatik i paduruar. Ka qene tmerr i kuadrove. Njeri i

SECRET

SECRET

- 34 -

heshtur, nuk shqerohet me njeri, mizanthrop. Ka nje fytyre te palevizeshme dhe syt e nje njeriu qe mund te pushkatoje njerez sikur te vraste rabecka. ra kapacitete udheheqesi, por zbatues i nje programi te dhene me mjete te egra. Nuk mendoj kurren e kurren te ngjitet ne hierarqin e partis, edhe sikur te pranohet ne parti. Gezon antipatin unanime te bazes se partise. Edhe ne kohen e luftes i thonin "xhandari".

MEHMET SHEHU:- Anetar i Komitetit qendror qe ne ~~Kongresin~~ Konferencen e I-re te vendit (1948). Anetar i Byrosee qe ne Kongresin e I-re. (Holesira te tjera nuk jap sepse kam shkruar dender mbi 'te).

GOGO NUSHI:- Anetar i Komitetit qendror qe ne Konferencen e I-re te vendit. (Mbi 'te shih shenimet biografike qe kam dhene me perpara).

Ketu mbyllet lista e eksponenteve te pare te artise komuniste shqiptare, lidhur kjo me eksponentet e grupeve te vjetra komuniste.

Le te nxjerrim konkluzionet.

Gjithesejt kam permendur 22 eksponente, 6 prej te cileve shefa dhe nen-shefa te grupeve te vjetra komuniste (Grupi i Korces, i Rinise, i Shkodres).

Si paraqitet, statistikisht, pozita e tyre sete.

Nga keta te 22 eksponente vetem 5 vete kane ruajtur pozitaten (domethene as nje e katerta) dhe konkretisht: Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Hysni Kape, Gogo Nushi, Rilo Aristeri.

rese (5) te tjere jane nxjerre jo vetem jashte Komitetit qendror, per edhe jashte artise, duke qene te braktisur gati rrugeve. Keta jane: Imer Dishnica, Miri VEGA, Sejfulla Maleshova, Zef Mala dhe Randi Kristua (dy te fundit kane qene edhe burgesur).

Shtate (7) te tjere, ne mos jane perjashtuar, jane mbajtur sa per formalitetet sepse nuk kane asnje post me rendesi. Konkretisht, keta jane: Kriste Themelkua, Ramadan Citaku, Tuk Jakova, Koce Tashkoja, Miho Mlakeja, Nasi Mariani, Bedri Spahiu.

rese te tjere (domethene sa jane gjalle e ne poste me rendesi) jane vrare: 2 nga armiku (Vasil Shantua e Kemal Stafa); 3 te tjere nga partia: Koci Koxes, Nako Spirua, Anastas Lulua.

SECRET

SECRETANEXS FYETJES SE III-te.

Ne organizimin e Partise komuniste shqiptare, pervec 22 eksponenteve qe shenova deri tani, qe te gjitha me kombesi e shtetesi shqiptare, nje rol shume te madh, rolin vendimtar bile, rolin udheheqes e kane lojtur dy shtetas te huaj, te cilet memzi e flisnin shqipen: Miladin Popovici dhe Dushan Migoshi, sidomos i pari, qe te dy antare te Komitetit krahinor te Partise komuniste jugosllave per krahinen e Kos-Metit (Kosoves e Metohise).

Qe te dy keta u cliruan nga kampi i perqendrimit italian te Durresit, me ndihmen e grupeve te vjetra komuniste. Sipas kerkeses shqiptare prane Titos, ata qendruan ne Shqiperi deri ne pragun e Clirimit, domethene gjer nga mezi i 1944-es. Nga mezi i 1944-es, vendin e tyre, ose me mire vendin e Miladin Popovicit qe ish pergjegjes i plotfuqishem dhe diktator i vertete i Partise komuniste shqiptare, e zuri Velimir Stoinici, anetar i Komitetit Qendror te Partise komuniste jugosllave, shef i misionit nderlidhes ushtarak ~~shqiptar~~ jugosllav prane Komandes se pergjitheshme partizane shqiptare, dhe me von, me vendosjen e maredhenieve diplomatike midis te dy vendeve me 1945, minister i plotfuqishem dhe i derguar i jashtezakoneshem i Jugosllavise ne Tirane. Kete te fundit, domethene Velimir Stoinicin, e lashe ne maj 1947 kryetar te komisionit te kontrollit te Republikes federative jugosllave (sepse, nderkohe, ish transferuar ne Beograd, dhe vendin e tij ne Shqiperi e kish zene Josif Gjergja, i cili, me prerjen e maredhenieve, ^{signature} Tirane-Beograd me 1949-1950 u dergua minister i Jugosllavise ne Delhi - Hind).

Tjeter person qe vinte kohe pas kohe ne Shqiperi, vetem kur kish ceshtje shume te rendesishme dhe per nje periode kohe jashtezakonisht te kufizuar - sic qe rasti i bisedimeve per krijimin e Shtabit te pergjitheshem ushtarak partizan nderballkanik me pjesemarrjen e Jugosllavise, Greqise dhe Shqiperise, etj - ish anetari i Byrose politike te Komitetit qendror te Partise komuniste Jugosllave, Svetozar Vukmanoviqi, me pseudonimin TEMPO, sot zevendes - kryeminister ~~president~~ i Republikes federative jugosllave, nemos gaboj.

Por le te kthehem tek Miladin Popovici dhe Dushan Migoshi.

I pari, domethene Miladini, me pseudonimin ALLU, ka qene nje organizator i shkelqyer dhe person tejpames politik. Per punen e tij te dalluar ne Shqiperi, u zgjodh edhe anetar i Komitetit qendror te Partise komuniste jugosllave. Ka qene tipi i personit qe te impononte me prezencen fizike dhe

SECRET

SECRET

- 36 -

aftesit e intelegjincen e tij. Kam patur rastin ta takoj disa here ne kohen e revolucionit. A frike pergenjeshtrimi avancoj se pa 'te partia komuniste shqiptare nuk do te kish mundur kurre te organizoheshe aqe shpejt, ne baza aqe te drejta dhe te korrtë sukseset qe korri.

U vra me 1946, ne ~~Shqipëri~~ Jugosllavi, ne zyren e tij, nga qe kosevar shqiptare. Ka qene tuberkulloz ne graden e fundit ne kohen e luftes, e megjithkete ka qendruar kurdohere ne mal, duke ndare jeten e veshtire te partizanit. Mjekimet dhe jeta me e rehateshme qe kish bere pas veres se 1944 e kishin permiresuar se tepermi gjendjen e tij shendetesore.

Dushan Migoshi, nuk ka qene nje figure politike. Ishte nje topall i zbe- te (krejt i ndryshem nga kolegu i tij qe ish ~~nje~~ ne dukje nje kollos i ver- tete fizik), i heshtur, por qe fliste me mire shqipen. Me teper se sa person politik, organizator i mire. Ne fakt ka qene nje ndihmes i Miladinit dhe nuk perfilleshe aqe shume. Ka qendruar kurdohere, edhe ky prane Shtabit te pergjithesem e Komitetit qendror te P.r.K. SH. Vetem per nje periude prej disa muajsh, dhe pikerisht vere-vjeshte e 1943 ka qene i atashuar prane Bri- gades se I-re, (reparti i pare i madh partizan ne Shqiperi, qe komandoheshe nga Mehmet Shehu dhe kish per komisar politik Tuk Jakoven), me funksione thjesht partie, thjesht organizative, si zv/komisar brigade, ne realitet si i deleguar i plotfuqishem i Komitetit qendror ne kete repart ushtarak. ~~Ky per- son non-edhe sot.~~ Me 1947, kur isha ne Jugosllavi para se te arestohesha, ~~duhet~~ qe kandidat i Komitetit qendror te Partise komuniste ~~me~~ te Maqedonise, parti perberese e Partise komuniste jugosllave. Duhet te rroje edhe sot, ne moshe reth 45-50 vjec.

----- 0 -----

SECRET

SECRET -

Pergjigje pveties se IV-te

Cila ka qene vepimetaria e celulave te Partise komuniste shqiptare gjate periodes para luftes se dyte boterore ne shoqeri, ne ushtri, ne rini, etj.

~~ndezim, propagandist, propagandist, propagandist~~

Sikurse e kam shpjeguar ne pergjigjen Nr.-I, perpara periodes se luftes se dyte boterore, ne Shqiperi nuk ka patur parti komuniste, por grupe te izoluara komuniste, pa asnje lidhje midis tyre qe e shkonin kohen me te madhe ne grindje midis tyre, ne nje lufte te nenedheshme mbi parime e idera krejt anarqiste.

Ne gjith kete nuk mund te thuhet se keto grupe nuk zhvillonin asnje aktivitet. Ne te shohim cili qe aktiviteti i tyre.

Grupi KOMUNIST I KORCES. Ish grupi qe zhvillonte nje aktivitet me te madh se gjith te tjeret. Ky aktivitet ish i dyaneshem: legal dhe klandestin.

Aktivitet legal: Grupi komunist i Korces organizoi te parat shoqeri sindikale, grupe profesionale, me baze mjeshtri dhe ndryshme. Per shembull kish nje shoqeri "Rinia" te rrobagesvesve, nje shoqeria "Rinia" te kepucarreve, nje Shoqeri "Rinia" te marangezeve, etj. Ne keto shoqeri profesionale mund te hynte cdo zanaci, natyrisht ne shoqerine respektive me zanatin e tij.

Qellimi i ketyre shoqerive ishte mbrojtja e te drejtave te tyre si zana-cinje. Nuk mund te thom se tere zanacinjte e Korces ishin te organizuara ne keto Shoqeri. Ne te kish hyre vetem nje pjese e kufizuar, e sidomos nga zana-cinjte e rinj nga mosha dhe cirket e tyre. Secila nga keto shoqeri organize-nte kohe pas kohe shetitje, ekskursione, mbremje defrimi, etj. Pikerisht ne kete mase te organizuar legalisht (sepse Zogu i kish lejuar) antaret e grupit komunist te Korces zhvillonin propaganden e tyre mbi luften e klasave, mbi komunizmin, mbi regjimin e Zogut qe e cilesonin gjakpires e feodal, etj/ etj. Nga radhet e ketyre te sindikuarve, grupi i Korces rekrutonte simpatizantet e tij dhe me von antaret efektive. Ne simpatizantet dhe antaret zhvilloheshe ne forme mesimi nje letresi marksiste, jo shume e kontrolluar, letersi te cil-len ata qe e lexonin ishin te detyruar ta mesonin.

Tjeter forme legale e cfrytezuar nga grupi komunist i Korces ish krijimi i grupeve kulturalre, jo ne baza profesionale por amatere. Kish, per shembull, nje korr amatoresh, nje teater amatoresh. Ne anen e ketyre grupeve kulturalre, grupi komunist i Korces jepte cfaqje me nje karakter te majte dhe me nje per- mbajtje qe vinin indirekt ne loje regjimin e Zogut dhe prefektet e tij; shem-

SECRET

SECRET

Ball "Revizori" i shkrimtarit rus Gogol, "Beu fajdexhi", pjese origjinale nga nje autor i ri qe vdiq ketu e 15 vjet me pare dhe emri i te cilut nuk me kujtohet, etj. Me nje kuptim qe godisnin indirekt Zogun ishin edhe kenget e korrit. Shpesh here, policia e Zogut dhe gjendarmeria ua kish prere cfaqjet ne mes sepse duartrokiteshin ne nje menyre provokuese per regjimin ne fuqi; cfaqje te tjera i kish ndaluar fare te jepeshin; etj.

Duke cfrytezuar kete aktivitet ilegal, grupi komunist i Korces arriti te organizoje edhe disa greva, ne fillim me karakter te kufizuar ekonomik, te bera nga ciraket ose puntoret. Numuri i pjesemarrësve ne kete greva dhe rendesia e tyre kane qene shume te vogla. Mirepo sidoqofte ato ishin agimi i nje lufte klasiste, se ciles grupi komunist i Korces i jepte nje rendesi te posacme. Nga fundi i 1956-es grupi komunist i Korces arriti te organizoje nje greve te madhe te rendeishme, me karakter politik, dhe jo vetem ekonomik, e quajtur "greva e bukes". Gjate greves u hodhen parulla edhe kunder Zogut. Bashke me puntoret, u bashkuan edhe studentet. U zhvilluan perpjekje te ashpra me gjendarmerine, pati disa te plagosur dhe kjo i dha shkak Zogut qe te kufizojte se tepermi aktivitetin e ketyre shoqerive puntore, gati t'i cduke fare. Mbi cfaqjet e grupit teatral amator dhe korrin u vu nje censure aqe e rende, sa qe arriti puna deri aty sa u imponoheshin pjeset qe duhej te loznin. Kjo beri qe Theatri amator dhe korri amator te shperndahen gradualisht, sepse grupit te Korces nuk i interesonte te propagandonte ato pjese qe u jepte te losnin artisteve te rinj, ish ministri i brendeshem i asaj kohe, Musa Juka.

Aktiviteti ilegal i keti grupi qe edhe me i kufizuar. Nuk kish pune te organizuar as me rinine, as me gruan, as me ushrine. Anetaret e grupit/punonin individualisht per vjete te tera me nje mik te tyren vetem e vetem qe ta benin simpatizant dhe vjete te tjera qe ta benin anetar te grupit. Nuk punohesh^{te} ne mase, sikurse u fillua te punohet pa frike me krijimin e artisteve. Nje nga kritikate qe i jane bere Grupit te Korces eshte se ne punen e tij ka qene teper i fshente, ka patur "nje konspiracion te kalbur" qe nuk i lejonte te dilte jashte guaskes se tij.

GRUPI KOMUNIST I TE RINJVE-- Ky nuk kish asnje aktivitet. E vetma gje qe interesohesh ky grup ish te rrebente ndonje anetar nga grupi komunist i Korces. Aktiviteti i anetareve te ketij grupi kufizohesh ne vjedhje e gra-

SECRET

SECRET
- 39 -

bitje qe benin neper familjet e tyre ose ku te mundin, me pretekstin se gjoja duhet te kishin nje arke te pasur per ta perdorur kur te vinte nevoja dhe ora e kryengritjes se rrufeshme. Ne fakt, keto vjedhje sherbenin vetem e vetem per te mbajtur shefat e grupit he fjale, te cilet, nen pretekstin se mereshin me pregatitjen e revolucionit, nuk benin asnje pune dhe e kalenin tere diten kafeneve. Zakonisht anetaret e ketij grupi qene intelektuale dhe gjysme intelektuale, krejt ndryshe nga grupi komunist i Korces ku predominencen absolute e kishin puntoret. Detyra e tyre kryesore ish studimi i teorise marksiste. Ne fakt, edhe si "marksiste" nuk qene me te mire se te tjeret. Kishin vetem nje qellim: te shtonin radhet e grupit, por natyrisht me elemente shume te kontrolluar. Kundrajt edhe puna e tyre qe individuale dhe punonin per vjete te tera qe te rekrutonin nje anetar ~~kont~~ ne grupin e tyre. Nuk kishin simpatizante, sic kish grupi i Korces dhe sic kish me von Partia komuniste. Komunistet e keti grupi, si edhe ata te Korces, kudo qe ishin ne ushtri apo ne shoqeri, synonin te rekrutonin. Por edhe keta vuanin njelloj nga "konspiracioni i kalbur" qe nuk u lejonte te dilnin jashte guaskes se tyre. Tamam si grupi i Korces, kohe pas kohe, nje here ne vit te shumten, perndanin ndo nje trakt te shaptillografuar ku shaheshe regjimi i Zogut dhe thirreshe per "Shqiperine sovjetike", brohoriteshe per "Internacionalen", etj. rikerisht hedhja e nje trakti nga ky grup i dha rastin Zogut te arrestoje disa komuniste te njohur nga grupi i Korces, ay i te rinjve dhe grupi jeshil. Midis te arestuarve ndodheshe edhe Niko Xoxi, i cili, me te rene ne duart e policise, tregoi te gjitha sa dinte. U zhvillua nje gjyq, qe u guajt gjyqi i komunisteve, dhe gjate ~~mbledhjes~~ atij shume nga te arestuarit u denuan me burgime dhe nje pjese akoma me e madhe me internime. U mbyllën disa revista, si "Bota e re" qe cfrytezoheshë indirekt nga grupi komunist i Korces per idete komuniste e te majta dhe, si pasoje, shpertheu nje ndjekje edhe me sistematike kunder cdo gjeje qe mund t'ishite komuniste ose e kamuruar komuniste.

GRUPI I JESHILTE, ose GRUPI I NIKO XOXES-- Ky grup nuk ndryshonte aspak nga ay i te rinjve. Kishte po ate moral te ulët, dhe po ate vije politike. Aktiviteti i tij kufizoheshë ne rekrutimin e elementit te majte. Trakte nuk nxirrte ky grup. Por botonte ne menyre klandestine nje Buletin "Jeshil" ku u beheshë propagande ideve me anarqiste dhe qesharake.

SECRET

SECRET
46

GRUPI KOMUNIST I SHKODRES.- Aktiviteti i tij qe identik me ate te grupit te Korces. Cfrytezonte te njejtat metoda legale dhe ilegale. "e shembullin e grupit te Korces edhe ky krijoi shoqerira puntore ne Shkoder dhe akoma me pak dhe ne Tirane (ne kryeqytet se bashku me mareveshje, me grupin e Korces)si dhe grupe kulturele amatoresh. Kur u mbylleen ato te Korces, u mbylleen edhe ata te Shkodres.

GRUPI I ZJARRIT.- Keta qene "komuniste aristokrate". Tere aktiviteti i tyre kufizoheshe ne propagandimin e ideve komuniste neper sallonet qe frekuentonin. Me teper se sa te punonin per komunizmin, kishin per qellim t'i habitnin grate qe frekuentonin me idet e tyre "revolucionare" e perparimtare. As Zogu nuk i ka trazuar ne kohen e tij, as Italia. Ndersa te tjeret qene ujq me lekuren e qengjit, keta qene qingja me lekuren e ujkut.

Si shihet, pra, aktiviteti i grupeve komuniste ka qene teper i kufizuar. ata nuk kishin as perspektiva mbi levizjen, as vije politike te caktuar, as strukture te pershtateshme per te punuar, as program efektiv qe te afronin masat. Me teper se sa dobi, keta grupe i shkaktonin den ko. u. i. Kjo shpjegon edhe aresyen perse Kominterni nuk i njihte dhe perse kerkoj shperndarjen e tyre, me shprese se pas shperndarjes (sikurse shpjegoj ne pergjigjen I) do te rikrijoheshin mbi baza te reja, me parime me te shendosha dhe me krere e udheheqes me te afte e te zotet. Me duket (dhe nuk gaboj) se ne krejt Evropen, vetem Shqiperia nuk kish nje organizate te majte te njohur si komuniste nga Kominterni (Internacionalja e III-^e). Greqia, Bullgaria, Hungaria, Jugosllavia, Rumania, pa permendur ketu Gjermanine, Francen, Italine, Angline / kishin ^{etj.} partit(nacionale) komuniste te njohura zyrtarisht nga Kominterni.

----- ° oOo -----

SECRET

SECRET

Organizimi i Levizjes se V-te.

Gili ka qene qendrimi i Partise komuniste shqiptare gjate te dy levizjeve antizogiste, dhe konkretisht kundrejt levizjes se Fierit dhe kundrejt levizjes se Et'hem Totos.

Gjate te dy ketyre levizjeve, Partia komuniste shqiptare nuk qe organizuar akoma. Ne fakt, si levizja e Fierit si ajo e Et'hem Totos, u shenuan nga tridhjetevjeteshit gjysma e ~~tridhjetevjeteshit~~ te shekullit XX-te. Partia komuniste ne Shqiperi u organizua ne fillim te dyzvezjetesisht, disa vjet me von. Ne ate kohe, domethene 1930-1940 ekzistonin grupet komuniste, autonome ne veprimtarin e tyre,

Konkretisht: Grupi i Jeshilte, domethene ay i Nako Xoxit, nuk mori asnje qendrim, si ne Levizjen e Fierit, si ne ate te Et'hemit. I konsideroi si levizje te drejtuara nga demokrate borgeze, ku proletariati nuk kish c'te bente. Ne fakt, edhe sikur te desh te bashkepunonte me keto levizje, ky grup ish fare i parendesishme rastaj, edhe sikur te desh te bashkepunonte, nuk kujtoj se kreret e ketyre dy levizjeve, do ta pranonin kete bashkepunim.

Grupi i Shkodres, me sa di, nuk ka mbajtur asnje qendrim gjithashtu, qofte pro, qofte kunder. Ndefta sepse nuk qe ne dijeni te ketyre levizjeve.

Grupi i rinise ka ndenjur gjithashtu si spektator i thjeshte.

Aje qendrim me aktiv, jo krejt pasiv, si te tjeret, ka mbajtur grupi i Korces.

a) Kundrejt levizjes se Fierit. - ka konsideruar si levizje perparimtare dhe te majte (qe duhesh perkrahur. Mirepo influenca e tij, si grup i izoluar, nuk mund t'u qe perkrahje reale krereve te levizjes se Fierit. Sidoqofte, disa antare te keti grupi muaren pjese ne levizjen (si Zylyftar Veleshnja). Natyrisht, po te ish shtrire kjo levizje, domethene levizja e Fierit edhe ne Korce e Tirane, ku ky grup kish te perqendruar shumicen e kuadrove te tij, ndihma do te kish qene dicka efektive. Mirepo levizja e Fierit u izolua qe ne fillim ne nje zone gjeografike ku influenca e grupit te Korces ish zero.

b) Kundrejt levizjes se Et'hem Totos. - ka konsideruar si levizje te djathte, jo shume perparimtare, te frymezuar dhe financiar nga Italia, me qellim qe te zevendesohesh Zogu nga nje diktator tjetër republikan, akoma me besnik se ish mbreti i Shqiperise. Me gjith kete, ^{Grupi i Korces} gjeti te udhes qe te behet bashkudhetar ne revolucion, me qellim qe nga levizje e djathte, ta kthente ne levizje te majte. Mirepo edhe ne kete rast, ndihma e keti grupi ka qene zero.

SECRET

SECRET

- 42 -

te organizuar
 Aresyet nenekuptohen: nuk kish as forca, as influence, as persona/ne poste ush-
 tarake ose qeveritare qe mund te lousnin nje fare roli ne keto pune (grushte
 shteti te vogla). Levizja u shtyp shpejt, keshtu qu nuk u mbeti kohe te impe-
 njoheshin shume thelle. rerseri si ajo e Fierit, edhe kjo levizje u kufizua
 ne nje zone ku organizativisht dhe politikisht Grupi i Korces nuk kish baza.

Rezolucioni i pare i Partise komuniste shqiptare, qe u hartua dhe aprovua
 nga konferenca gjate se ciles u shkrine grupet komuniste ne nje organizate
 unike, ne pjesen qe analizon veprimtarine e grupeve komuniste para formimit te
 Partise, kritikon te gjitha grupet komuniste sepse nuk muaren qendrim kundrjft
 ketyre levizjeve. Grupin e Korces e kritikon sepse nuk u angazhua shume ne
 keto levizje; e verteta eshte, sipas opinionit tim, se ky grup, me format or-
 ganizative qe kish, antaret qe dispononte, (shumica puntore ne Korce e Tirane)
 rethin e mbyllur gjeografik ku kish baza te vogla dhe influencen zero ne po-
 pull, nuk kish se c'te jepte me teper. Anetaret e ketij grupi qe ishin ne
 poste prej nga mund t'a jepnin ~~levizjet~~ ^{te dy levizjeve} nje fare perkrahje (si oficeret Nedri
 Spahiu, Asad Ndreu, etj., nenoficeret Shefqet ~~etj~~ dhane ate qe mundin,
 po ashtu edhe anetaret e ketij grupi qe ishin ne zonen e prekur nga levizjet
 (si Zylyftar Veleshnja).

- - - eOe - - -

SECRET

SECRET

Pergjigje pyetje se Vite.

Sa antare kish partia komuniste shqiptare gjate periodes 1934 - prill 1939. & Cili ka qene aktiviteti i ketyre antareve dhe cila forma e organizimit te tyre.

ryetjes se lart-permadur i jam pergjigjur ne pergjigjene e I-re. Sidoqefte, penderpikmeri, perserit: *

rarti nuk ka patur ne ate kohe. Kish grupe.

Grupi komunist i Korces. Ka arritur maksimumin si sasi anetaresh nga 1937. Rreth ~~250-300~~ 250 antare. ~~Nje grup i bashkuar me qendren~~ rreth 250 antare kish edhe nje sasi me te vogel "simpatizantesh" komuniste, ndofta nje 200 te tjere maksimumi. Nuk kish forum udheheqes. Kece Tashkua, kryetar i grupit, qendronte ne Tirane (sepse ish qendra politike e vendit). Miho Lakua, nenkryetar i grupit ~~shumegjegjes~~ qendronte ne Korce, si i plotfuqishme (sepse ketu ish baza kryesore e ketij grupi). Antaret e tjere me influence te ketij grupi drejtonia nga nje celule. Celulat quheshin "trische", domethene perbeheshin nga nje pergjegjes dhe tri antare te thjeshte. Kur u riformua ky grup me 1938 (fund i vitit), numuri i antareve te tij nuk i kapente te 150-et, por numuri i "simpatizanteve" ish permbi te 200.

Grupi komunist i te rinjve. Ka patur ne kohën e shkrirjes reth 300 antare ne tere Shqiperine, maksimumi. Ky grup nuk kish "simpatizante". Nuk ka patur forme organizative, ose me mire ka patur nje strukture vertikale. Domethene: Anastas Mulla, qe ish "shefi", kish lidhje vetem me ndihmesin e tij: Nasi Marianin; Ky, qe ishte personi Nr. 2 kish lidhje me ndihmesin e tij, e keshtu me radhe, si nje litar kotka-kotka, nga kreu deri tek baza. Me fjale te tjera: cdo anetar i ketij grupi njihte nje pergjegjes dhe kishte nje vartes. Nje strukture organizative, sic shihet, shume pak elastike, aspak efikace, por jashtezakonisht konspirative.

Grupi komunist i Shkodres. Ka patur jo me tepër se 150 antare partie. Dhe, me sa di, nje numur te barabarte simpatizantesh, sipas shembullit te grupit te Korces. Here kish celula trische, (si grupi i Korces), here kish celula "shtateshe" (kete forme celule adoptoi partia me krijimin e saj). Shef i keti grupi ish Zef Mala dhe ndihmesi i tij kryesor ish Vasil Shantua, qe te dy me qender ne Shkoder. Ne Tirane, pergjegjes i ketij grupi ish Kristo Themelkua. Forume udheheqes nuk ka patur.

-SECRET-

SECRETRezultate pveties se VII-teCili ka qene aktiviteti i Partise komuniste shqiptare qe nga prilli 1939 deri ne tetor 1940 (periode e okupacionit italian).

Ne nga prilli i 1939-es deri ne tetor te 1940 nuk ka patur Partia komuniste ne Shqiperi. Sa per perioden e okupacionit italian ne Shqiperi, kje pershin nje periude kohe me te gjate. Ne fakt, okupacioni italian ne Shqiperi zgjatet qe nga prilli i 1939-es deri ne shtator 1943 (domethene deri ne kapitullimin e Italise dhe krijimin e Republikes saliane me kryetar Benito Mussolinin). Okupacioni gjerman fillon vetem nga gjysma e shtatorit 1943 dhe mer fund ne mbarim te nendort 1944. Perpara shtatorit 1943 ne Shqiperi nuk kish asnje repart gjerman.

Do te flas, pra, shkurtimisht, per aktivitetin e Partise komuniste shqiptare per perioden e okupacionit ushtarak italian: 1939-1943.

Kjo periode ndahet ne dy pjese:

a) prill 1939 - nendort 1941. Eshte koha e grupeve komuniste. Pra, levizja eshte sporadike, e paorganizuar dhe aktiviteti kufizohet vetem ne disa demonstrata patriotike, te organizuara nga grupet sidomos me raste pervjetesh kombetare (28 nendort). Hidhen kohe pas kohe trakte kunder Italise fashiste, kryesisht nga grupi komunist i Korces, me parulla patriotike dhe me parulla shume te majta. Anetaret e grupeve zhvillojne nje propagande shume me te madhe me goje se sa ne kohen e Zogut per Shqiperi te pavarur, ~~shkruar~~ per dbimin e italianeve, per lufte, etj. Por tere aktiviteti i tyre kufizohet ne agitacionin ~~shkruar~~ oral; aktivitet praktik nuk ka: as sabotazhe, as atentate, as lufte te armatosur. Aty ketu rrihet me grushte ndonje njeri i italianeve nga njerez te panjohur, por nuk ka vrasje. (Te panjohurit jane anetaret e grupeve, sidomos te Korces, Shkodres dhe deri diku te te rinjve). Niko Xexi dhe grupi i Zjarrit qendrojne spektatore te thjeshte.

b) nendort 1941 - shtator 1943. Eshte koha e Partise komuniste. Brenda tre muajve, sepse situata qe pjekur ~~paorganizuar~~ ^{filluan} veprime praktike. Fillon rekrutimi ne mase ne rinine komuniste dhe nje rekrutim shum i kufizuar ne parti. Krijohen njesitet guerriljesh ne qytet dhe fillojne aktet e sabotazhit: atentate kunder personave me influence ne organet e polibis italiane ose shqiptare, diegie depush ose objektesh te fashizmit, prerje telefonash, Agitacioni oral, qe deri aty perpara qe ne forme individual, tani behet ne forme

SECRET

SECRET

- 45 -

masive Brenda 5 muajve nga formimi i partise, krijohen njesitet/te para te armatosura partizane (pranvere e 1942-se). Aksionet e ~~xykësive~~ nates dhe te fshehta te ~~xykësive~~ njesiteve guerrilje neper qytetet, pasohen dhe shoqerohen nga luftime te vogla, ditën, te hapeta, neper vijat e komunikacionit, postet e karabinieris neper katundet e izoluara, etj. Formohet nje ushtri e vogel ne mal, ushtria partizane, e cila ne pragun e "Clirimit", domethene ne nendorin e 1944-es numuronte nen arme reth 75 mije vete. (Sasi e tepert per Shqiperine qe nuk kish ~~xykësive~~ nje popullsi me te madhe se sa 1.200.000 ~~xykësive~~ banore).

Me pak se nje vit pas formimit te Partise, filluan organizimi dhe krijimi ne mase i keshillave nacional-clirimitare, organe te pushtetit komunist ne zonat e cliruara dhe organe te pushtetit embrionar komunist neper qytetet. Ne shtatorin e 1943, domethene perpara kapitullimit te Italisë, keto keshilla qeverisnin pjesen me te madhe te Shqiperis se Jugut neper zonat e cliruara dhe nen kontrollin komunist. Por ato ekzistonin ilegalisht edhe ^{ne} zonat e pa cliruara. Komunistet, me ushtrine partizane, kishin shtruar qe atehere shumicen dermuese te katundeve te qarkut te Korces, Vlores, Beratit, Gjirokastrës. Zona e kontrolluar nga Balli Kombetar ne ate kohe ish teper e kufizuar, gati e parendesishme fare. Italianet, me perjashtim te qyteteve dhe te vijave ~~xxx~~ vitale per komunikacionin e tyre, nuk okuponin asgje. Nje zone gjeografike, kryesisht e perbere nga katunde fusharake afer vijave te komunikacionit, ish zone neutrale. Ne kete zone neutrale ku mund te shkelte kollaj ushtria italiane, trupat partizane qendronin ne ilegalitet. Gjetke, qene te plotfuqishme: ato benin ligjin, vertiteshin hapur, kishin depot e tyre, bazat e tyre te sigurta etj. Popullsia njihte si pushtet per regullimin e ceshtjeve administrative, grindjeve, etj. keshillat nacional-clirimitare. Maredheniet e fshatit (ku sundonin partizanet) dhe atyre qyteteve (ku sundonin italianet) qene maredhenie dhenie-marrje vetem ne lemin e shkembimeve te produkteve, ne lemin tregetar.

"e nje suate te tille, kuptohet vetvetiu se aktiviteti i komunisteve qe i gjithaneshem: administrativ, ushtarak, politik, organizativ.

SECRET

SECRET

- 46 -

Fergjitja e vetes se VIII-teCili ka qene qendrimi i partise komuniste shqiptare gjate luftes italo-greke.

*arti nuk ka patur atehere. Shpjegoj qendrimin e grupeve vec e vec:

GRUPI I ZJARRIT. Ky grup nuk ka mbajtur asnje here qendrim zyrtar kundrejt ndonje levizjeje ose evenimenti politik. ~~Shprehur qendrimin e~~ Anetaret e ketij grupi, pa ndonje disipline partie, i komentonin gjerat si t'i mendonin vete. Sa per veprime praktike, nuk kane bere kurre.

GRUPI I NIKO XOXIT. E studioi situaten dhe arriti ne konkluzionin se anetaret e tij, kudo qe te ndodheshin, duhesh te qendronin neutrale. Lufta midis Italisë dhe Greqisë qe nje pune qe nuk i perkiste proletariatit ~~shqiptar~~ shqiptar. Proletariati shqiptar duhesh te perzjehesh vetem kur te vinte ora e luftes klasiste, per krijimin e nje Shqiperie komuniste. Italianet dhe greket mund te vrisnin njeri tjetrin sa te donin. Karakteri i luftes, sipas tyre, qe nga te dy anet kapitaliste: Italia luftonte per ta ~~sh~~ okupuar Greqinë. Greqia luftonte si shtet kapitalist per te mbrojtur interesat e Anglisë. (Qeveria Verlaesi) Grupi i Niko Xoxit nuk kish pse te merte pjese dhe te behesh pro Italisë, siç ese pro Anglisë, si qeveria e Metaksait.

GRUPI I GJODRËS. Per arsye se lufta italo-greke u kufizua ne Shqiperin e Jugut (Gjirokaster, Korce, Vlore, Berat), ku ky grup nuk kish as simpatizante as antare efektive, nuk e mori ne studim fare situaten.

GRUPI KOMUNIST I KORÇES. Per vete poziten e tij, sepse baza e tij qe tamam ne zonen ku u zhvilluan luftimet, u detyrua te mare nje qendrim dhe ta studioje situaten. Ky qendrim ish: Qeveria e Metaksait eshte nje qeveri kapitaliste, por lufta e Greqis kunder Italisë u intereson interesave te komunisteve. (Qeveria Verlaesi, duke shprehur lufta greke, do te merrte bashke te re. te ve shqiptare sepse dobeson tamam ate fuqi qe e kish okupuar Shqiperine. Duke u nisur nga kjo analize, grupi komunist i Korces vendosi t'i vije ne ndihme, natyrisht me mjetet qe dispononte, popullit grek ne luften e tij kunder Romes. Agitacioni i atehereshem i antareve te grupit te Korces ish pro popullit grek. Thuhesh se populli grek lufton per lirin e tij, sado qe me qeveritare dikta- tore fashiste dhe sado qe aleat i nje fuqie imperialiste, si Anglia. Grupi nuk pranonte qe Greqia te zinte, ne rast se do te fitonte, vendin e Italisë si fuqi pushtuese. Dista deklarata te atehereshme te Athines (se Greqia nuk hyn ne Shqiperi per ta pushtuar, por vetem e vetem per te dbuar italianet) u

SECRET

SECRET

priten me kenaqesi nga ky grup, dhe me teper me mirebesim se sa me dyshim. Grupi i Korces hyri edhe ne levizje praktike. Ne Korce e Gjirokaster, gjate periodes ndermjetese (perpara se te hynin greket dhe pas largimit te italianeve), u krijuan komisione dhe "rroje te qytetit", me antare ose simpatizante te ketij grupi, per te mbajtur qetesine dhe per te ruajtur depot me ushqime e municione qe kishin lene italihat me qellim qe t'u dorezoheshin te paprekura grekeve dhe keshtu u veprua. Grupi i Korces mendonte se autoritetet ushtarake greke do t'u ishin mirenjohese per kete qendrim dhe se per pasoje do t'u lejonin te zinin poste ne prefektore e bashki. Autoritetet ushtarake greke as qe i perfillen fare. Kjo ua ftoi shpresat. Por nuk i vuri ne anen tjeteter te barrikades. Vazhduan te mbajne qendrim miqesor. Kur u duk se autoritetet greke synonin, po te fitonin, te qendronin ne Korce e Gjirokaster si krahina te Verie-Spirit, qendrimi i ketij grupi kundrejt Greqise ndryshoi pak. U hodh parulla e re se "populli grek lufton per lirine e tij por qeveritaret greke luftojne per skllaverine e Shqiperis se Jugut" per te manifestuar kete orientim politik dhe per te treguar se Korca e Gjirokastra jane greke, grupi komunist i Korces organizoi ne nendorin (me 28) ne Korce e ne mos gaboj edhe ne Gjirokaster nje demonstrate me parulla patriotike, per pavaresin e Shqiperise si shtet me kufijt e njohur nga Konferenca e Londres. Megjith kete, vija e ketij grupi, ne themel, mbeti kjo: te mos u sillen pengesa dhe as behen veprime ~~xx~~ kunder trupave greke.

GRUPI KOMUNIST I TE RINJVE. Ne fillim, ky grup qendroi indiferent, si ay i Niko Xoxit, por me von u bashkua me pikepamjet e grupit te Korces.

Rezolucioni i partise qe analizon periuden e grupeve perpara themelimit te partise (adoptuar nga mbledhja qe vendosi shkrirjen e grupeve), percakton sa vijon ne kete drejtim: Kritiken ~~Kritiken~~ Grupin e Zjarrit e sidomos grupin e Niko Xoxit sepse vepruan si "antimarksiste" dhe si politikane miope, jo si revolucionare. Grupin e Korces sepse u besoj premtimeve te Athines mbi nje Shqiperi me kufijt e njohur nga Konferenca e Londres. Ky besim naiv dhe papjekuria politike e grupit, e bene qe te gaboje: a) ne ceshtjen e depove. Depot italiane te lene gjate terheqjes nuk duheshin ruajtur per ushtrene greke; Ushqimet u duheshin permdare popullsisë, ne menyre qe te afroheshe pas komunisteve; municionet te ishin fshehur, natyrisht sa te ish e mundur me shume, qe te perdoreshin me von kur te vinte koha. b) Duheshin te qene bere me teper aksione demonstrative, (jo te theksuara armiqesore, qe t'u tregohesh grekëve) te Korca e Gjirokastra jane shqiptare.

SECRET

SECRET

- 48 -

Perzligje s'voties IX-te.

Kur u themelua EAM-i shqiptar (Fronti nacional-clirimtar) dhe nga cilet, (pseudonime, emra te verteta). Muaren pjese organizata, vende ose fuqi te huaja. P'ershkrimi dhe aktiviteti i tyre.

Plafferma politike dhe bazat e para organizative te Frontit nacional - clirimtar shqiptar si organizate masash (ndryshe nga partia komuniste - organizate kuadresh) u hodhen nga mezi i shtatorit 1942, ne nje mbledhje qe u quajt "Konferenca e Pezes". Inisiaterja, frymezuesja dhe organizatorja e kesaj konference qe Partia komuniste shqiptare. Direktiven per nje orientim te tille, aje e mori, nepermjet Miladin Popovicit, nga Partia komuniste jugosllave; ~~Miladin Popovic~~ dhe akoma me lart e me larg, nepermjet kesaj te fundit, nga Moskë. Ne fakt, Fronti nacional-clirimtar shqiptar u krijua ne shembullia, dhe me po ate procedure, strukture organizative e platforme politike, qe u themelua ne Jugosllavi, Naredni Oslobodilacki Front. Keshtu, Fronti nacional Clirimtar shqiptar nuk ish gje tjetër vecse nje kopje identike, ne miniaturë, e Naredni Oslobodilacki Front-it jugesllav.

Qellimet e Partise komuniste shqiptare, me krijimin e kesaj organizate masash, ishin:

a) grumbullimi, organizimi dhe neneshtimi i te gjitha forcave nacionale shqiptare ne nje organizate te vetme, me kontrollin, influencen dhe drejtimin e Partise komuniste.

b) Mobilizimi dhe aktivizimi i ketyre forcave, kanalizimi i krejt veprimtaris se tyre, ne nje orientim te vetem: ne orientimin politik te Partise.

c) Zhvillimi i nje lufte te armatosur drejtuar ne radhe te pare kunder okupaterit te huaj dhe pastaj kunder "bashkepuneterëve" te tij te brendeshem.

Ne prapa-skenen e kesaj platforme, qellimi final ishte: Partia komuniste

Meqenqte patriotizmit. te beheshe meteri, forca udhëheqese, koka drejtuese e tere popullit shqiptar. *Çdo organizate jashtë frontit, të cilësoheshë lehtë e kollaj, si "brodhëtare".* Me parullat "demokratike" e "patriotike" te Frontit N.C., aje do te perderete

si leva e masha per qellimet e saj, qe shkonin tej dhe delnin jashte kufive te lufte patriotike se thjeshte e demokratike, te gjithë nacionalistet (ese te pakten ata qe do te mund te shtinte ne kete gracke), te gjitha forcat demokratike te Shqiperise. Keshtu, duke u vene ne krye dhe duke zene postet kyce te kesaj organizate politike masash, Partia komuniste do te qe ne gjendje qe ne te arthmen e afert, kur te largoheshin okupateret, te realizonte

SECRET

SECRET

- 41 -

programin e saj: vendosjen e diktatures se proletariatit, demethene vendosjen e diktatures se saj, duke shndruar gradualisht luften patriotike ne ~~lufta~~ revolucion komunist. Nje taktike, sic shihet, shume e pershtateshme per ate kohe dhe qe i jepte te gjitha mundesite Partise per te manevruar e kamufluuar, per ta bere sa me mire punen e saj duke fshehur qellimet finale.

P.K.Sh.

Del pyetja: A mund te kish hedhur parullen e nje konference te tille, per bashkimin e te gjitha forcave nacionaliste e antifashiste ne nje organizate te vetme politike, perpara vjeshtes se 1942? Kam bindjen qe jee Zeri i saj nuk de qe degjuar nga nacionalistet, nga njerezit qe akoma nuk kishin mare vendim mbi qendrimin e tyre politik. Pse nuk de qe degjuar? Sepse autoriteti i Partise perpara veres se 1942-se ishte i ulet. Aje kish, teretere, le muaj jete. Gjendja e saj, ne pragun e vjeshtes 1942, kish ndryshuar. Aje ish njohur si nje force politike e organizuar dhe numuronte ne aktivin e saj shume suksese: grumbullime aksioneve e rinise prapa flamurit te saj, kryerjen e disa ~~shkencave~~ te armatosura me shume sukses, organizimin e mjaft reparteve partizane ne mal (sidomos Kerce, ~~Shkencave~~ Gjirokaster, Berat dhe Vlone), akaparimin dhe ~~shkencave~~ shtirjen nen kontrollin e saj te disa cetave indipendente (si Myslim Peza). Ishte nje force, pra, me te cilen duhesh llogaritur. Shkurt, per te hedhur parullen e Konferences se Pezes, partia gjeti castin me te veliteshem: dy muaj me perpara ishte shpejt (sepse nuk kish akoma autoritetin e duhur), dy muaj me ~~para~~ ^{pas} ishte von (sepse atehere filloi ^{aktiviteti} ~~aktiviteti~~ i Ballit ^{pas formuar} ~~te~~ ^{formuar})

Duke hedhur parullen e Frontit nacional-cliristar, Partia komuniste shqiptare synonte te afronte, dhe pastaj neneshtronte, keto forca:

- a) Nacionalistet e vjeter me tradita nga e kaluara e largue dhe te cilet qe-ne figura ne shkallen nacionale. Shembull: Mid'hat Frasheri, Ali Kelcyra, etj.
- b) Nacionalistet e vjeter me tradita nga e kaluara e largue dhe te cilet qe-ne figura ne shkallen krahinore. Shembull: Nepsi Kerenxhiu ne Kerce, etj.
- c) Kleriket, qefshin keta ertedhokse, katolike, bektashinj, apo myslimane.
- d) Persona jo me ndenje te kaluar e tradita te vjetra patriotike, per nga posti i tyre, pasuria e tyre, tarafi i tyre, etj./ ~~me~~ ^{me} influence ne popullsin.
- e) Krere fisesh ose bajraqesh ne Veri; parine e krahinave ne jug.

A mund te thuhet se Partia komuniste ia arriti qellimit te vet? Perpara se t'i pergjigjem kesaj pyetje, le te shohim perberjen e Konferences se Pezes.

Ne konferencen e Pezes u perfaqesuan:

SECRET

SECRET

- 50 -

I.- Partia komuniste me eksponentet e saj kryesore: Enver Hoxha, Ymer Dishnica, Koci i Xexes, Nako Spirua, Kriste Themelkua, Gjini Marku, Bedri Spahiu, Keco Tashkua, Mustafa Gjinishi, Liri Uega, Pilo Peristeri, Ramadan Cita-ku, Hysni Kape, Pandi Kriste, Tuk Jakova, Gogo Nushi, ^{Haxhi Mleshi} etj. qe s'i di.

II.- Nga nacionalistet e vjeter, me tradita nga e kaluara e largme, figura ne shkallen nacionale, nuk kish shume. Persa i perket kesaj kategorie, Partia pessi disfate. Personalisht di qe nga kjo kategori ish prezent Omer Nishani, ^{Koste Boshnjaku} (dhe ndonje tjeter.

III.- Nga nacionalistet e vjeter, figura ne shkallen krahinore, pat mjaft: Nepsi Aerenxhiu, Ollga Plumbi, gruaja e Themistokli Germenjit, etj.

IV.- Nga grupi i klerikeve mungenin vetem katoliket. Kleri ortodoks perfaqesoheshe nga Pashko Vodica (Kryepishkopi i setme) dhe ndonje tjeter; nuk di kush e perfaqesoj klerin mysliman, por di qe ka patur perfaqesues. Kleri bektashik ishte perfaqesine klerike me te shenuar: Baba Faje Martaneshin, Bab Bun Karbunaren dhe, ndofta, edhe ndonje tjeter.

V.- Nga grupi i personave qe shenei ne piken (d), partia shenei nje fare sukcesi. Permend: Shefqet Bejen, (nga Durresi), ~~Ali Agan (nga Durresi)~~ Sami Bahellin (nga Elbasani), Medar Shtyllen (nga Korca), Myslim Kezen (nga Tirana) Riza Danin (nga Shkendra), ^{Spiro Moisiun (nga Kavaja), Gajo Tashku}

VI.- Nga kreret e veriut, partia, nemes gaboj, ~~raikunat~~ afro atehere: Ali Agen (nga Peshkopia), Abaz Kupin (nga Kruja) ^(dhe ndofta edhe ndonje tjeter) Nga jugu, prej paris krahinore, shenej: Kasem Radevicken, ^{Hasan Palon} Selaudin Totoni, ~~etj.~~

Rezultati, shic shihet, nuk qe ay qe shpresonte partia. Sidoqefte, qelli-
mi propagandistik, u arrite. Konferenca adoptoi teresisht programin e paraqitur nga Partia komuniste dhe strukturen organizative te propezuar prej saj. Konferencen se Pезes i beri nje reklame te madhe, duke bere keshtu lodren e komunisteve, edhe okupatori italian dhe qeveria kuislinge e Mustafa Merlike Arujes. Ne fakt, sapa mbaroi punimet Konferenca dhe u permdane delegacionet, trupat italiane (afro nja 30 mije vete) e sulmuan Pezen me artileri, aviacione e mjete te mekanizuara sikurse te ish ndonje Stalingrad. U rrenuan mjaft katunde por demet qe iu shkaketuan partizaneve qene zero. Sapa u terheqen italianet, ata rifilluan aktivitetin. Konferenca e Pезes u be keshtu nje simbol.

Fronti Nacional-clirimtar ishte krijuar Natyrisht je me personalitete qe mund t'i sherbnin shume partise. Por, fundi i fundit, u krijuar. Qe tani e

SECRET

SECRET

- 51 -

tutje epiqendra e aktivitetit te partise komuniste spjestohet dhe shperngulet nga qyteti ne fshat, ne mal. Eksperienca e mesoi Partine se me kreret e njehur khome nuk mund te kish sukses. Fusha kryesore e veprimit te saj duhet te ishin parite neper krahinat, masa e fshataresis, ne fund te fundit pikerisht forca e gjalle, kuantitative. Mjetet dhe format organizative qe do ta ndihmonin partine ne kete aktivitet ishin: Keshillat nacional-clirimtare te fshatrave, njesitet vullnetare-partizane te fshatrave (njesite ushtarake qe perfshinin sidomos adoleshentet, njesite jo permanente per qe mblidheshin sa here te thrriteshin per aksione te nje stili te madh) dhe kryesisht cetat partizane, njesitet e Ushtrise nacional-clirimtare. Pas konferences se Pezes, pra, kemi kete karakteristike: te gjitha perpjekjet e partise poshte, dhe jo lart. ^{ushtrise} Pse jo lart sepse bisedimet e deriatehere-shme me kreret nacionaliste treguan qe nuk mund te arriheshin kollaj rezultatet qe priste partia.

Nje faze e dyte ne Frontin Nacional-Clirimtar fillon me pranveren e 1943, domethene tamam kur u mbledh Konferenca e Kabinetit. Eksponentet nacionaliste ne kete konference kane qene edhe me te pakete (Abaz Kupi, per shembull, ish terhequr). Po ashtu edhe disa te tjere qe nuk i rik mbaj mend. Mirepo humbjet ne eksponente nacionaliste, partia i kish zevendesuar, nderkohe, me rekrutimin dhe afrimin prane saj te parive krahinore neper qarqet, me forcimin e lidhjeve te saj me masat fshatare poshte, me krijimin ne te gjitha katundet (sidomos ne Juge) te keshillave nacional-clirimtare, te cilat keshilla qene leva dhe organe te verteta te komunisteve. Kur Partia komuniste kish ngritur nje aparat te tere administrativ, dhe kish kaluar ^{para qe te shpallte forca ushtarake} ne fshat, ushtarake nga cetat ne batalionet (pranvere e 1943), Balli kombetar sapo filloi veprimtarin e tij aktive. Deri atehere, kreret e keti organizmi qene kufizuar ne nje qendrim pasiv. Nacionaliste si Myslim Peza, jo politikisht te sqaruar per me njerez te armatesur nga pas, ^{qe mund te ishin shpallur kollaj prane do organizate} kishin kaluar me arme dhe bagazhin e tyre ne kampin komunist. E keshtu me radhe per Kasea Radevicken ne Gjirokaster, per Mestan Ujanikun ne Berat, per Reshit Collakun ne Kerce, etj. etj.

Partia komuniste, edhe sepse pa figura te njohura nga e kaluara, ishte jashtezakonisht e fuqishme ne planin nacional. Per 'te, koha ishte flori; per elementet nacionaliste koshiente qe gurrshufti.

SECRET

SECRET

- 52 -

Fuqi e jashtme qe kontribuesi ne krijimin e Frontit nacional-clirimtar, ne eksperiencen e saj, ne direktivat e saj, ne orientimin e saj te dhene nepermjet njerezve te vet: Partia komuniste e Jugosllavise.

Force e jashtme qe i erdhi ne von ne ndihme Frontit Nacional-Clirimtar: Britania e Madhe, nepermjet oficereve te misionit nderlidhes englez ushtarak ne Shqiperi. Kjo ndihme erdhi tamam ne kohen e duhur, kur Partia komuniste kish jashtezakonisht nevojte te madhe per njesitet e saj te armatosura ne arme e te holla. Ne mos gabej, misioni i pare ushtarak nderlidhes englez ne Shqiperi erdhi nga fillimi i pranveres 1943, fill pas Konferences se Labinotit. Ky grup i pare i misionit nderlidhes englez erdhi jo direkt ne Shqiperi me parashute, por nepermjet Greqise, ne zonen e Gjirokastres. Ky grup kryesohesh, ne mbaj mend mire, nga majori Mak Klino^u rupi i dyte erdhi gjithashtu nga Greqia, nepermjet kufirit ne zonen e Eskovikut, domethene ne qarkun e Grupi i dyte kryesohesh nga nje fare kapiten Levid. Korces. Te dy keta grupe u bashkuan aty nga fillimi i veres 1943 ne Skrapar (qabku i Beratit) per t'u vendosur ne von ne Shtyllë, prane shtabit te pergjithesem te ^ushtrise nacional-clirimtare shqiptare.

SHENIM: Nga forcat qe u perfaqesuan ne Konferencen e Pezes, ~~xxxj~~ dhe ku u hodhen themelet e Frontit nacional-clirimtar, vetem Partia komuniste ishte e perfaqesuar si organizate ne tere kuptimin e fjales. Personat e tjere, jashte partise, nacionaliste te ndryshem, u perfaqesuan si individe. Bazi i Canes, ~~xxxxxxxxxxxx~~ (Abaz Kupi) per shembull, ishte si "zogist" por jo si perfaqesues i "Legalitetit", sepse Legaliteti akoma nuk^{ish} themeluar. Elemente^{te} tjere, si Myslim Peza, (jo anetar partie)^{u paraqite gjithashtu}, si individ, jo si perfaqesues i nje partie; Shefqet Beja, intelektual pasanik, u perfaqesua si element individ dhe jo si perfaqesues i nje organizate; Deletatet ne ~~Kongresin~~ Konferencen e Pezes perfaqesonin krahina, qarqe, ~~xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx~~ shtresa te ndryshme, besime te ndryshme, dhe aspak partira ose organizata politike. Ante perjashtim vetem delegacioni i Partise komuniste. Por edhe ky delegacion nuk u perfaqesua i teri si delegacion i Partise komuniste. Shume nga anetarët e ketij delegacioni mohonin^{z shihuni} qenien e tyre ne partin komuniste dhe paraqiteshin si perfaqesues te filan krahine, si perfaqesues te filan force te armatosur patriotike, etj. Shkurst, pra, edhe ne Konferencen e Pezes, komunistet u paraqiten ne nje maske nacionaliste. Vetem nje pakice e parendesishme u paraqit si delegacion i Partise komuniste.

SECRET

SECRET

- 53 -

Para se t'i japë fund kesaj pyetjeje, le te shtoj:

Pas konferences se Kabinetit, Fronti nacional-clirimtar pati edhe ~~tri~~ tri etapa te tjera:

ETAPA E BERATIT (7 tetor 1944) - PERMETIT (Maj 1944). Ishte nje mbledhje ku u muar vendime ne lidhje me formen e regjimit te ardhshem ne Shqiperi: Shqiperi demokratike popullore. Zogut iu ndalua hyrja ne Shqiperi. Shteti shqiptar i ardhshem nuk do te njihte mareveshjet "skllaveruese" te perfunduara prej tij qofte me Italine, qofte me Angline ose Shtetet e Bashkuara. Dokumentat e kesaj mbledhjeje kishin ne embrion, ne veze, faren e regjimit te arthme komunist. Vetem faren, ama. Partia vazhdonte te maskoheshe. Ajo e hoqi krejt masken vetem kur e mori mire pushtetin ne dore.

ETAPA E BERATIT.- (tetor 1944).- Keshilli i pergjitheshem i Frontit nacional-clirimtar, zgjedh qeverin e pare shqiptare, anetaret e se ciles ishin vendosur me perpara nga plenumi i Komitetit qendror. Mbledhja nuk beri gje tjeter, pra, vecse vulosi nje vendim te mare me perpara nga Partia.

ETAPA E FUNDIT E FRONTIT (Deri tani) - 1947. Partia, e vendosur mire ne fuqi, nuk kish me nevoje te maskoheshe. Elementet e fundit nacionaliste qe kishin mbetur ne kryesin e Frontit, dhe qe i sillnin nje fare bezdije sepse e kishin kuptuar tashme qe qene perdorur vetem e vetem si masha, dureshin te cdukeshin. Ata qene bere nje xx fare rreziku sepse kishin filluar te peshperitnin ose kundershtonin hapur, ne Kuvendin popullor ku ishin zgjedhur deputete, reformat ekstremiste te komunisteve ne fushen ekonomike dhe politiken e tyre ne pergjithesi. U vu ne zbatim me brutalitetin e njehur komunist dhe violencen e ashpër revolucionare, politika e "limonit te shtrydhur". Organet e Sigurimit sajuan nje proces te tere Gjiqinif grupit te deputeteve, gjeja te lidhur me fuqit imperialiste per rrezimin e pushtetit, me dhune. Te gjith deputetet nacionaliste qe ishin bere pengese ~~ndonje~~ ^{aste nese}, u eliminuan. Shume prej tyre ishin ne kryesin e Frontit qe ne Konferencen e Pezes. Permend: Riza Danin, Shefqet "Ejen", Ali Ager, Keste Bosnjaku, Selaudin Toton, Bab Bab Karbunaren, etj. etj. qe nuk me kujteshen. Denimi i tyre ka qene per shumicen dermanjese me vdekje.

SECRET

SECRET

- 54 -

ANEKS PYETJES SE IX-te.

Ne kete aneks do te jap biografine e personave qe kam përmendur ne lidhje me formimin e Frontit nacional-clirimitar shqiptar.

Per te mos bere perseritje te kota, ketu nuk do te përmend biografine e atyre personave te Partise komuniste qe kam dhene ne raportet e mepareshme, si Ymer Dishnica, Kristo Themeleko, Enver Hoxha, Nako Spiru, etjse, sado qe emrat e tyre permenden edhe ne themelimin e EAM-it shqiptar.

Do te përmend, pra, ^{vetem} biografine e atyre emrave per te cilat nuk kam dhene hollësira.

GJIN MARKU.- Lindur ne rrethet e Arujes dhe rritur si jetim. Duhet te jete rreth 40 vjec. Mbaruar studimet si agronom. Hedhur ne ilegalitet, si anetar i Grupit komunist te Korces, qe perpara formimit te Partise, domethene aty nga vera e 1941, sepse do arestohesh nga karabinieria italiane. Njeri qe ka bere nje karriere te shkelqyer ne fillim te luftes partizane, nga partizani i thjeshte ne pergjegjes i Partise ne Skrapar. Sukseset e reparteve partizane te kesaj krahine, kuq Gjini ish komisar politik, ia ngriten shume autoritetin (komandant ish Mestan Ujaniku). Keshtu qe, ne Konferencen e I-re te vendit (mars 1943) u zgjodh anetar i Komitetit qendror te Partise. Mirepo ne kete ferum te larte nuk qendroi shume, sepse 6 muaj me von, kur ndodheshe ne Berat, ra ne kompromis, jo zyrtar, me trupat gjermanet, dhe u dbua nga Komiteti qendror. Sot e kesaj dite eshte gjeneral major i ushtrise shqiptare, me funksione konkrete qe me jane te panjohura. Ne shtatorin e 1943, kur u perjashtua nga Komiteti qendror, u emerua per nje kohe komisar i brigades se VII-te dhe pastaj pergjegjes i partise ne Berat.

HAXHI LLESHI.- Vjec 48 afro. Lindur ne Peshkopi. Nga familje bajraktare dhe me influence. Ka lidhje far' e fisi ne krejt Veriun dhe familja e tij respektive si pasanike e antizogiste. Pikerisht per kete Partia e coi ne Peze. Me von u be komandant i forcave partizane ne qarkun e Peshkopi-Dibres. Gjate luftes i forcoi edhe me teper pozitat duke u bere anetar i Shtabit te pergjitheshem. U rekrutua ne parti ^{me 1943} (dhe sot e kesaj dite (qe nga 1952) eshte kandidat i Komitetit qendror te Partise. Ne qeverin e pare komuniste (tetor 1944) kish kryesia e Ministris se Brendeshme, nga e cila u haq sepse u zevendesua me von nga Koci i Xexes. Gjate krajt periudes se Koci Xexes ka qene gjeneral ne ushtari, prane Shtabit te pergjitheshem. Pas Kongresit te I-re ka ushtuar funksione te ndryshme me pergjegjesi per t'be bere, ne 1954, ~~Kryetar i Komitetit Presi-~~ ^{President i}

SECRET

SECRET

-, 55 -

diunait te Kuvendit popullor. Post ne te cilin e lashe.

MUSTAFA GJINISHI.- Anetar partie qe me themelimin e Partise. Pak i kaluar nga mosha dhe, njeri qe ish perzjere kurdohere, ne emigracion dhe brenda vendit, ne levizjet e ndryshme antizogiste. Person qe kishte lidhje e nje fare influence e miqesi me nacionalistet shqiptare sepse kish punuar me 'ta. Pikerisht per kete partia e dergoi edhe ne Peze. Ka qene element qe mbaheshe prane Komitetit qendror te partise dhe dergoheshe per bisedime me nacionalistet. Ne fillim, per t'ia lehtesuar kete pune edhe ne teper, partia e emerroi komisar politik prane Myslim Pezes. Cdo nationalist qe vinte per bisedime me Myslimin, gjente Mustafa Gjinishin. Myslimi ka patur nje simpati te madhe per 'te dhe kje shpjegon edhe arsyen perse i kish dhene liri te plote veprimi. Me von u dyshua si "element qe donte te lozte nje loder me dy faqe", sepse i pakenaqr nga qe nuk e futnin ne Komitetin qendror. U vra misteriozisht nga Liri Gega (partia) ne Veri te Shqiperise, ku ishte derguar si element per bisedime me nacionalistet prane shtabit te Divizionit te I-re. Ka qene komunist me funksione me rendesi, por je me shume besim tek partia.

KASEM RADOVICKA. - Oficer i Zogut per lidhur qe ne fillim me Partine. Nj Njeri me influence sidomos ne zonen e Gjirokastrës. U be anetar partie vetem aty nga fundi i 1944-es. Partia e dergoi ne Peze si element te sajne nationalist. Gjate luftes ka qene komandant i zones se pare operative Vlore - Gjirokaster (komisar ka qene Bedri Spahiu), pastaj anetar i shtabit te pergjithesem dhe me "clirimin e Shqiperise" ~~xxxx~~ deputet ne Kuvendin popullor. Vdau ne moshen 50 e ca vjetsh, i pushkatuar ne Tirane, si pjesetar i grupit te deputeteve. Edhe sepse u pranua ne parti, ishte element qe shikoheshe shtrember.

MYSLIM PEZA.- Duhet te jete reth 60 vjetsh e ca/ Njeri me influence ne Shqiperin e mesme. Arratisur ne kohen e Zogut dhe kthyer ne kohen e okupacionit ilegalisht, prane miqve te tij. Ka krijuar nje cete qysh ne fillim dhe pikerisht per kete partia u mitua t'i dergonte si komisar politik Mustafa Gjinishin e me von Aristo Themelkon. ~~Shume~~ I degjuar aty nga 1942-1943 per njesitetin e tij t'armatosur, qe ish me i madhi partizan i asaj kohe. ~~Shume~~ I lidhur pas partise, sado qe shpesh here hidhte vercka. Tere funksionet e tij qe nga 1944 e ketej kane qene funksione nderi. Vete eshte analfabet. Set e kesaj dite eshte nen/president i Presidiumit te Kuvendit popullor.

SECRET

SECRET

- 56 -

Sado qe jo anetar partie, ka lojtur rolin e partise sepse genjeheshe shpejt. Kjo shpjegon edhe arsyen e prezences se tij ne Konferencen e Pezes.

OMER NISHANI.) Vdiq ne 1953, kur ~~te shpallur~~ sado ish larguar nga posti i presidentit te Presidiumit te Kuvendit popullor. Politikan dallkav dhe servil i Partise. Njeri qe tere jeten e tij eshte mare me politike ne emigracion, sa kohe qe ish Zogu ne fuqi, here me njerem rryme, here me tjetren. Ka qene nje nga ata qe i shpune kurroren e Skenderbeut Vittorio Emmanuelit III-te dhe qe firmuan dekretin me anen e se ciles shqiperia viheshe nen suazem e Perandoris italiane me ~~1939~~ 1939. Partia e ka perdorur kurdohere si figure, sepse njiheshe me shumicen e nacionalistev, por duke ia fshehur tere te parlat e se kaluares ne syt e popullit. Qe me krijimin e Frontit nacional-clirimitar u emerua kryetar i Keshillit te pergjitheshem te ketij "eshilli dhe qe me zgjedhjet e para ne Shqiperi pas vendosjes se regjimit komunist mbajtiti postin e Presidentit te ~~Ku~~ Presidiumit, deri ne pragun e vdekjes. U zevendesua nga "axhi Mleshi.

NEPSI KERENXHIU.) ~~Njert~~ Nacionalist qe ka qene ne cetat e para qe u krijuan ne Korce per nje Korce shqiptare, e jo nen Greqine. Sot duhet te jete afro 85 vjec. U dergua ne Peze vetem sepse ish i lidhur pas Partise me anen e te ~~bi~~ bijve te vet (anetare partie). Roli i tij falimentoi shume shpejt sepse nuk kish c'ti jepte Partise vec emrit te tij. Sot e kesaj dite, ese me mire me 1954, ronte ne Korce, ku shteti i kish lene nje fidanishte personale dhe nje bashke mjaft te madhe me pene. Kjo ka qene, zaten, kurdohere mania e tij.

OLLGA PIUMBI.- Grua intelektuale me emer sidomos ne shtresat e larta te shoqeris shqiptare t'atehereshme. Mjaft perparimtare per jo komuniste Komunistet, ne fillim, e perkrahen shume, duke e bere presidente te grave shqiptare dhe anetare te Keshillit te pergjitheshem te Frontit N.C.. Edhe kjo ju dha emrin. Kur nuk ja ^{komunistik} paten nevojten, ja dhane drune. U zgjedh deputete ne legjislaturen e pare. Por qe ~~te shpallur~~ e deri me sot, ka mbetur udhheve.

Gruja e Themistekli Germenjit (emri i saj ne mos gaboj eshte Ollga). Tere meritat e kesaj permblidheshin ne nje gje te vetme: grua e nacionalistit te vjeter shqiptar Themistekli Gernmji, vrare nga francezet, sepse u dyshua se bashkepunonte edhe me austriaket per nje Korce brenda kufijve te Shqiperis. U dergua ne Peze vetem si simbole. Roli i saj mbarej aty. Ka qene edhe ne Korce si figure e FNC per praktikisht nuk bente gje. SECRET.

SECRET

- 57 -

PASHKO VODIGA.-- Prift ne Vodice te Kolonjes gjer me 1942. U dergua ne Pe -- ze sipse Partia nuk gjeti ndonje klerik ortodoks me te pershtateshem. Kish nje te kaluar deri diku nacionaliste (syrgjynosur nga turqit dhe , me sa di, edhe keqperdorur nga andartet greke ne levizjen e Verio Epirit). Gjysme analfabet. Sot e kesaj dite, eshte kryepishkop.

~~XXXXXXXXXXXX~~ MESTAN UJANIKU.-- Xhandar ne kohen e Zogut. Ilegalizuar ne kohen e italianeve sepse per ceshtje nderi vrau dy karabiniere italiane. Ne Skrapar, ku kish taraf te vet, krijoi nje cete gjysme hajdute, gjysme nacionaliste. Partia komuniste i dergoi per ta afruar Gjin Markun Ky e shtiri nen kontrollin e plote te vet, i ndihmuar edhe nga komunistet e tjere qe u derguan me von ne Skrapar. Analfabet dhe jo ushtarak i zoti. Arriti te behet nenkolonel, ^{vetem} ne poste nderi, u arrastua si anetar i grupit te deputeteve, u denua me 18 vjet burgim dhe vdiq ne burg nga tuberkulozi. Nuk ka qene kurre ne Keshillin e pergjitheshem nacional-clirimtar. E kam permendur ne pergjigjen time vetem si element qe mund te ish afruar ne nationalistet po te kishin punuar keta me perpara me 'te se sa komunistet.

RESHIT COLLAKU.-- Student ne akademin ushtarake italiane ne kohen e okupacionit shqiptar. "efuzoi te beje betimin dhe u arratis ne Jugosllavi. U kthye ilegalisht nga Jugosllavia ne Shqiperi aty nga 1941, ra ne kontakt me elemente nacionaliste e komuniste, keta te fundit u treguan me te zotet, e bene per vete dhe i ngjiten pastaj nje komisar kur, ne saje te influences qe gezo- nte si familje pasanike e gjysmebajraktare ne Moker, krijoi nje cete mali. Me von u be edhe anetar partie por u vra ~~ne bashke me~~ veron e 1943 nga italianet ne nje perpjekje. Edhe kete e kam permendur ne pergjigjen jo si njeri inisiator ose eksponent te FMC, por si element qe, se bashku me njerezit e ti dhe krhinen e tij do ish hedhur me nationalistet po te qe se keta do te ishin treguar me energjike dhe me te shpejte se komunistet.

Shefqet Bejae Pasanik nga Peshkopia per banues ne Durres e Tirane. Njeri me influence per kulturen e tij ne rethet intelektuale te Shqiperis se Mesme. Demokrat dhe antifashist. U cfrytezua nga komunistet per pikepamjet e tij gjysme-socialiste dhe kur u be i dyshimte, u implikua ne gjyqin e deputeteve dhe u pushkatua. Figure mjaft pozitive per ~~partine~~ ^{FNS} gjate luftes.

ALI AGA.-- Bajraktar progresist dhe me influence ne qarkun e Peshkepis.

SECRET

SECRET

- 58 -

Njeri i ndershëm dhe patriot i mirë. Figura e tij është përdorur shumë nga Partia në veri. U zgjodh pas luftës deputet, por pastaj, u konsiderua i dyshimë dhe u pushkatua si anetar i grupit të deputetëve.

BABA FAJA MARTANESHI. - Baba teqeje në Martanesh dhe figure e njohur jo vetëm si fetar, por edhe si taraf i madh, në miqësira të shëndosha në klasat e larta të Elbasanit. Lidhur me partinë që në fillim, la të qenë për të komanduar një pjesë të partizanëve në atë krahinë. U vra në rrethana shumë të errta aty nga 1946. (U tha se gjoja u qellua nga kryebabaj në një grindje personale. Edhe kryebabaj i bektashinjve u vra atëherë, sic u tha, nga Baba Faja. Shkurt që të dy vrane njeri tjetrin.)

SPIRO MOISIU. - Vjeç 50 e ca të shumtën. Gjeneral major pa kredi tani. Në kohën e luftës shef i shtabit të përgjithshëm (komisar Enver Hoxha). Njeri që lanoheshë nga partia si element patriot i madh që refuzoi të luftojë kundër Greqisë, në shenjë urrejtjeje për Italinë dhe sepse e kuptonte që në luftën midis Greqisë e Italisë, Shqipëria duhesh të merrte anën e Greqisë. ^{Ali Shkëpsani. (kinder Shëngjerç)} HUSEN SHENGLERÇI. - Fikërisht si Ali Aga nga Feshkopia, edhe ky kish influencë të madhe në Gërmenikë, Elbasan e përgjithësisht Shqipëri të mesme. Fisi i tij që shumë i madh dhe në taraf të fortë. Aa qenë nga peshëtetjet kryesore të komunistëve në Shqipëri e mesme, ku elementi bajraktar ish kundër komunistëve. U zgjodh deputet pas mbarimit të luftës (gjatë luftës kish qenë anetar i Këshillit të përgjithshëm të FNC), por ^{nga 1947} humbi kredin tek komunistet dhe u dënuar me burgim të përjetshëm në gjyqin e grupit të deputetëve.

HASAN PULJA.) Nga partia e Vlores. Aa patur kurdehere poste nderi, vetëm e vetëm për ndërshterimin e tij të njohur në popull dhe tarafin që kish në Juge. Në Peze, në Labinot, në Permet ka qenë vetëm një figure. Konkretisht nuk di se ç'behët tani. Vdiq, u pushkatua me grupin e deputetëve, s'maj mend.

BABE KARBUNARA. - Me influencë të madhe në Vlore. Nacionalist i vjetër. Njeri pa kulturë. U implikua në gjyqin e deputetëve dhe u pushkatua. ^{pa FNC}

RIZA DANI. - I vëmti përfaqësues në zemë muhamedaneve shkodrane. Njeri me kulturë dhe influencë por u gabua rëndë dhe u mashtrua si të tjerët nga komunistet. Kur s'ja paten në nevojën, e pushkatuan si eksponent të grupit të deputetëve. Naivitetin e tij politik, si shumë të tjerë, e pagoi me kokenë.

ГНАГО ТАИНО (shkëlqetjen XIV)

SECRET

SECRET

S H T E S A D H E K O R R I G J I M E

dhene

(Ne lidhje ne pergjigjen ~~En~~ pyetjes IX-te)

Ne faqen 50 te raportit tim te pergjithesem, paragrafi i ~~Vite~~ VI-te, emri i shenuar ne dore Hysen Shengjergji (2) duhet zevendesuar ne emrin Ali Shtepani. Hysen Shengjergji eshte gabim.

Ne po ate faqe, domethene faqe 50, ne paragrafin e V-te, pas emrit Spiro Moisiu (shenuar ne dore), duhet shtuar emri: Gage Tashke.

Ne po ate faqe, domethene faqe 50, ne paragrafin e II-te, pas emrit te Omer Nishanit, duhet te shtohet emri: Koste Bosnjaku.

Ne faqen 58 te raportit tim te pergjithesem, kur jap shenimet biografike mbi eksponentet e EAM-it shqiptar, emri Hysen Shengjergji duhet te zevendesohet ne emrin: Ali Shtepani. Shenimet biografike nuk ndryshojne. Duhet shtuar vetem se ka lindur ne katundin Shen-Bjergj.

Ne fund te faqes 58, pikerisht ku sharen lista e emrave me biografite e te permendurve, duhet shtuar :

a) GAQO TASHKUA (Biografia e tij e ka dhene ne pergjigjen e 14-te, kur flas mbi anetaret e qeveris se pare komuniste ne mal).

b) KOSTE BOSHNJAKU/- (Biografia e tij e jap ketu): Lindur ne ^{Durrës} ~~Shkollë~~ Perzjere ne levizjen e Fan Nolit kunder Zogut dhe pikerisht per kete u arratis ne triumfin e Legalitetit jashte atdheut. Ka qene per nje kohe ne Rusi por pa qene anetar i Partise. Eshte larguar shpejt nga Rusia dhe qe atehere eshte mare e perzjere me organizatat emigrante antizogiste. U kthye nga 1935 ne Shqiperi dhe nuk u perzjere me politike. Filloi nga aktiviteti politik ne kohen e okupacionit si demokrat i majte individual. U bashkua me partine ^(pa u bere kurre anetar partie) dhe mori pjese ne Peze, ku u zgjedh edhe anetar i Keshillit te pergjithesem. Ka qene kurdohere njeri i lidhur dhe mik i Partise. Mjaft i zoti per ceshtjet financiare dhe prandaj, qe me formimin e qeveris se pare komuniste iu ~~ngazdrua~~ dha posti i drejtorit te pergjithesem te Bankave per nje kohe dhe pastaj edhe posti i Drejtorit te pergjithesem te shoqeris shteterore IMPORTEKS. Njeri me pikepamjet e Seifulla Maleshoves. Humbi besimin e Partise per kete arsye ne 1946, dhe ne 1947, sado qe deputet, u arrestua, u implikua ne grupin e deputeteve dhe u demua ne burgim te perjetesem. U fal ne 1956; mirepo sapo delli nga burgu vdiq ne meshe mjaft te kaluar: afro 70 vjec. Nuk la asnje femije. Gruaja e tij qe nje gjemane, e cila, nuk e di se cfare ben tani ne Tirane.

SECRET

SECRET

- 38 -

PERGJIGJE PYETJES XIII-te
Geshtja Dhimitri Folia.

Mendoj se ketu eshte fjala per Dhimitër Fallo-n dhe aspak per Dhimitri Folia. Personalisht nuk di qe te kete ne historin e re shqiptare ndonje ceshtje Dhimitri Folia, dhe aqe me pak nje ceshtje Dhimitri Folia qe te kete lidhje me Zerven. Ka nje ceshtje, qe quhet ajo e Dhimitër Fallo-s, dhe pikerisht dijenit dhe njohurite qe kam mbi kete ceshtje do te shtroj ketu.

Dhimiter Fallua, me origjine nga Himarra, ka qene nje person rreth 45 vjet aty nga 1943. Per nje kohe shume te gjate, ne kohen e Zogut, ay ishte kryeredaktor i gazetës "Gazeta e Korces", e cila kish per drejtor dhe pronar pergjegjes Zhan Gorguzin. Kjo gazete, si i gjithë shtypit shqiptar i atehershëm, ndiqte vijen e Zogut, per Dhimiter Fallua njiheshë ne te gjitha shtresat e Korces si njeri perparimtar dhe demokrat i majte. Me perpara se te ish kryeredaktor i ~~XXXXXX~~ "Gazeta e Korces", Dhimiter Fallua kish kaluar vjete te tera ne Greqi (muk e di konkretisht me cfare pune). Sa kohe qe eshte mare me gazetari, Dhimiter Fallua eshte interesuar edhe per letersi. Ay ka perkthyer ne gjuhen shqipe shume autore greke (sidomos gati tere librat e Stratis Mirivillit: Jeta ne varr, Shkembia i kuq, etj-etj). Perkthinet e tij ishin zakonisht nga letersia e huaj e majte: Permend si shembull librin e Erich Maria Remark-ut me titull: "Ne frenetin e Perendimit asgje te re", nje liber ose broshure gati komuniste, te shkruar nga nje socialist anglo-sakson Louis, me titull: "Shkenca dhe Feja" (liber krejt atheist dhe me idera te theksuara socialiste). Ish perzjere shume me organizatat legale te grupit komunist te Korces, por nuk di qe te kete qene anetar i keti grupi. Sidoqoftë simpatite e tij per komunizmin kane qene te dukeshme. Per idete e tij, bile, organet e gjindarmeris zogiste e internuan per nje fare kohe, tamam atehere kur u bylleen rivisten ~~XXXXXX~~ "Bota e re", tek e cila riviste Dhimiter Fallua bashkepunonte. Mirepo gradualisht ^(ky) u largua nga levizja komuniste, sidomos qe kur u internuan. Dhe kur u themelua partia, ^(Fallua) u cilesua ^{nga Partia} si njeri frikaman, je i sakrifices dhe element i lekundeshem. Pikerisht per kete, gradualisht, Dhimiter Fallua u largua per here e me teper nga pozitat e vjetra si komunist. U afrua me elemente te Ballit kombetar, ^(dh2) sidomos me Zai Fundon, dhe aty nga 1944 kish arritur te ish anetar ese kandidat i Komitetit qendror te Ballit kombetar. Nga 1943 ish si delegat politik i Ballit kombetar ne cetat qe kish mundur te organizonte kjo parti, sado te pakta, n'ate kohe, me qarkun e Korces.

SECRET

SECRET

- 69 -

Fillimi i vitit 1944 e gjen Ballin Kombëtar në një pozitë shumë të vështirë. Dihet se në kapitullimin e Italisë, në shtatorin e 1943-se, dhe ardhjen e trupave gjermane, Balli Kombëtar, për të forcuar pozitën e tij, për t'u furnizuar me armë e municione, për të patur një përkrahje të shëndoshe (dhe zona të sigurta ku të ~~ishte~~ ^{ne luftën kundër partizanëve} terhiqte dhe vinte në siguri forcat e tij të armatosura sa herë që i shtrengonin trupat partizane (me të shumta, me të disiplinuar, me të afta për luftë), ra në marrëveshje me komandën gjermane në Shqipëri. Në sajë të kësaj marrëveshjeje, Balli Kombëtar mori armatime nga gjermanët, zona të sigurta (qytetet që ishin në duart e trupave gjermane) dhe një përkrahje ushtarake e politike nga okupatori. Nga ana e tyre, gjermanët fituan trupa shqiptare (në realitet bashibuzuke dhe pa as një vlefte ushtarake). Gjate dimrit 1943-1944, trupat gjermane se bashku me çetat balliste filluan operacione të madhë spastrimesi kundër forcave partizane dhe zonave partizanesh përgjithësisht në malet e krahut Jugut. Operacioni zgjati të shumtën ndonjë muaj. Trupat gjermane shkelen të gjitha zonat e çliruara nga partizanet. Prapa tyre vinin ballistët dhe ngrinin keshillat e tyre, komandat e tyre, punshtetin e tyre. Mirepo sa për mbaroi operacioni gjerman, trupat partizane, jo të impënuara në luftime me alpinistët dhe komandot gjermane, u kthyen kundër ballistëve. Keta të fundit, të përganizuar, pa kuadro, pa disipline, u thyen kudo shpejt dhe u terhoqën nga zonat që u muarën gjermanët përkohësisht partizanëve dhe që u dhane këtyre. Kështu, partizanët rifituan brenda dy javëve të gjitha sa humbën kundër gjermanëve. Balli dhe trupat e tij mbeten të ~~mbijellura~~ mbijellura e të izoluar në qytetet. Autoritetet gjermane, që kishin vënë në fillim disa shpresa mbi 'ta, as që u varnin me. E arthaja për organizatën e Ballit ish e erret. Që atëherë krerët e kësaj organizate filluan të ^{kerkojnë të} gjejnë jashtë Shqipërisë mbështetjen që nuk gjenin brenda vendit ose përkrahjen që nuk gjeten tek anglezët. U munduan që të bijen në kontakt dhe erdhën në Drazha Mihailloviçin në Jugosllavi, mirepo ndihmë që mund t'u jepte ky, ish zero. Në atë kohë, Drazha Mihailloviç ish vetë në pozitë të vështirë sepse epërsinë në vendin e tij e kish Titua (sidomos Mal të Zi), prej nga mund të kish ^{Balli} ndonjë ndihmë. Krahas orvatjeve për të rënë në kontakt me Drazha Mihailloviçin, Balli Kombëtar u përpoq të bëjë në kontakt me elementet nacionaliste greke (sidomos në krahinën e Çamurisë, zone kufitare me Shqipërinë), dhe konkretisht me Napoleon Zervën, me shpresa që të regullonin një fare programi për bashkëpunim e ndihmë

SECRET

SECRET

- 6 -

reciproke (ne realitet ~~nikush~~ me tepër kish nevojë për ndihmë Balli kombetar në zonen e Gjirokastrës nga Zerva, se sa Zerva nga "Balli Kombetar). Për këtë qëllim, Balli Kombetar (komiteti qendror i kesaj organizate) dergoi në Greqi si delegat të vet Dhimitër Fallonë ^{ky} ishte person me një kulturë të mirë, zëteronte ~~greqishten~~ greqishten, kishte njohuri mbi Greqinë dhe diçka të njohur të cilët mund t'ia lehtësonin punën. Për të zhvilluar bisedime sa më zyrtare me Zervën, Balli kombetar i dergonte në marsin apo prillin e 1944-es (nuk e mënja me ~~mirë~~) Dhimitër Fallonë, nga Tirana në Greqi, nëpunësit Komitetit qarkor të Ballit për Korçën, një leter kredenciale dhe një dokument me instruksione. Këto letra kredenciale dhe këto instruksione, Komiteti qendror i Ballit kombetar ua kish bësuar për dërgimin e tyre nga Tirana në Korçë, dy korrierëve të besueshëm: Hekuran Koprenckes (teger xhandërmarie) dhe një marshalli xhandërmarie (emri i të cilit nuk më kujtohet).

Autopullmani Tirane-Korçë ku kishin hipur të veshur civile këta të dy korrierët u ndalua rastesisht nga një kompani e batalionit të parë të brigadës së IV-të në grykën e Grabevicës, pikërisht ^{ne mes te} ~~distancës~~ (distancës) Rogradec-Korçë. Deri një ditë më parë, në atë zonë, nuk ishin dukur forca partizane. Repartet e Brigadës së IV-të u shtrinë në atë rrugë pikërisht disa orë më parë se sa të kalonte autopullmani, për t'u hedhur në anën tjetër të xhadesë. Kompania që ndaloi autopullmanin bëri një kontroll mbi personat. Rastesisht njëri nga partizanet njohu Hekuran Koprenckën si oficer xhandërmarie dhe një tjetër ~~shokun e shoqeruesin e tij marshallë~~ shokun e shoqeruesin e tij marshallë. Si pasojë, i arrestuan që të dy dhe bashkë me 'ta edhe Veli Vasjarin, një njëri që kish qenë në kohën e Zogut Prefekt në Korçë, ish arratësuar nga Shqipëria në prillin e 1939-es me Zogun në Turqi dhe ish kthyer nga Stambolli ato ditë për t'u larguar perseri nga Shqipëria.

Gjate hetimeve Veli Vasjari tregoi se ish derguar nga emigrantet shqiptare të Turqisë për të rënë në kontakt me krerët e Legalitetit dhe të Ballit; se kish biseduar me 'ta dhe kishin rënë dakord që të bashkoheshin. Pikerisht rezultatet e këtyre bisedimeve shkante të thesh ^{Veli Vasjari} në shokët e tij të turqisë. Fatkeqesisht, këto rezultate nuk arriti t'ua thote kurrsë. Nga shtabi i brigadës së I-rë ^{Velia} dergua në burgun e Komandës së vendit të qarkut të Korçës, në mënyrë që të pyetteshe më hollësisht. Një dy javë më vonë, ^{komanda} gjermane hyjné pa prituri në Lavdar (ku ish Komanda e vendit të qarkut të Korçës), e kapin dhe pa e pyetur shumë, e pushkatojnë ^{gabimisht} (Fundi i fundit ~~kontroll~~ këte fat i kishin caktuar edhe partizanet, sapo të mbaronin hetimet).

SECRET

SECRET

Togeri i gjindarmeris Hekuran Koprencka dhe shoku i tij marshall, treguan nga ana e tyre se po qonin nje poste shume te rendesishme, te cilen ua kish derzuar Mit'hat Frasherit, per Komitetin ~~qendror~~ qarkor te Ballit ne Korce. Se cfare ishte posta qe ata kishin ne vete, as Hekurani as shoku i tij nuk dinin. Me gjith kete, qe te dy, si korriere besnike te Komitetit qendror te Ballit Kombetar dhe si oficere te xhandarmerise, u pushkatuan.

Posta qe ata kishin ne vete, permbante:

a) Nje leter, me intestimin e Komitetit qendror, velen e Komitetit qendror te Ballit kombetar dhe firmen e Mid'hat Frasherit me anen e se ciles deklarohesh se Dhimiter Fallos eshte delegat zyrtar i Ballit Kombetar, i ngarkuar dhe i plotfuqishem per te bere bisedime me palen nacionaliste greke mbi ceshtje qe u interesojne si Ballit kombetar aq edhe Zerves, sidomos per te diskutuar wesh-tjen e nje bashkepunimi te dyaneshem ne luften kunder komunizmit. Sic shihet, ishte si nje nga ato dokumentat qe u jep shteti ambasadoreve kur i dergon ta perfaqesojne ne nje shtet tjeter: leter kredenciale. (Permbajtja e kesaj letre ish ne tre kopje: shqip, frengjisht, greqisht.)

b) Letra tjeter ish nje qarkore personale me intruksione, drejtuar vetem e vetem Dhimiter Fallos nga Komiteti Qendror i Ballit, dhe firmuar gjithashtu nga Mid'hat Frasherit. Ne kete leter, me sa mbaj mend, ^{Dhimiter Fallos} i viheshe ne dukje besimi i madh qe i ish ngarkuar dhe rendesia qe u jepte organizata ku ay bente pjese bisedimeve qe do te zhvillonte. I thuhesh se duheshe te bente omos per te siguruar nje ndihme te cfaredoshme nga nacionalistet greke: te holla, armatime, trupa te armaturesa. "Sa me shume aqe me mire". Instruktoheshe qe t'u thuhesh grekeve se Balli kombetar ^{do te mire priste hyrjen e trupave nacionaliste te} ~~mbaj mend te paretendim...~~ Zerves, kur ta shihnin rastin te arsyeshem dhe te favorshem ^{ne te - ne koren} ~~te...~~ shqiptare per ~~komandant~~ ^{shqiptare} te luftuar komunistet dhe ardhur ne ndihme nacionalisteve shqiptare. Mbjaj mend se ne nje eventual te tille, Balli do t'i hidhte te gjitha forcat e tij kunder komunisteve ne Gjirokaster. Indirekt i liheshe te kuptente Dhimiter Fallos se Balli Kombetar, ne masen qe do te ish kjo ndihme, ^{e nacionalistev greke} ish i gateshem, kur te terhiqeshin gjermanet, t'i njihte Greqise nje pjese te rivendikimeve te saj mbi Vorio Epirin.

c) Pervac ketyre dy dokumentave me rendesi, te mbyllura ne nje zard te posacem, korrieret e lart-permerrur (Hekuran Koprencka dhe shoku i tij) kishin edhe nje leter te Komitetit qendror te Ballit drejtuar Komitetit qarkor te Korces, ne lutjen qe ta dergonte sa me pare Zarfin e mbyllur, tek Dhimiter Fallos, me njetet qe dinte.

SECRET

SECRET

Nuk di c'te thom ne gjate mbi keteceshtje, domethene mbi ceshtjen e Dhimiter Falles.

A i dergoj Komiteti qendror i Ballit kombetar, Dhimiter Falles, pas kesaj disfate, leter kredenciale te reja dhe instruksione te reja. A insistoi ne te njejtat kerkesa dhe ne te njejtat koncesione. S'di si te pergjigjem.

Ajo qe di me siguri eshte fakti se partia, keto dokumenta politike shume te rëndesishme i cfrytezoi jashtezakonisht teper ne propaganden e saj politike kundër Ballit Kombetar, duke e paraqitur si "organizate tradhetare," si "organizate qe nuk u mjaftua vetem me tradhetine kundrejt Hitlerit, per qe punonte edhe per copetimin e Shqiperise nga monarkofashistet greke," etj. etj. Balli eshte zene x aqe shume ne befasi nga kjo goditje, sa qe edhe reaksioni i tij ka qene shume i dobet. Partia mobilizoi atehere reth kesaj ceshtjeje tere daultet, Balli nemzi iu pergjigj me nje tamburke. Natyrisht, fendit te vertete qe permbanin keto dokumenta, propaganda komuniste nuk mundoi t'u shtojte atehere edhe bishtra dhe ta paraqese me tyrli ngjyra.

SECRET

SECRET
- 83 -

PERGJIGJE PYETJES XIV-te.

Si, kur, ku dhe nga cilët u formua e para qeveri e malit. (Pseudonime-emra, pershkrimi i ketyre figurave).

Qeveria e pare e malit, u krijua nga Fronti Nacional-Clirimtar, ne fakt nga Partia komuniste shqiptare, ne muajin tetor te vitit 1944, ne qytetin e Beratit, nga nje mbledhje e Keshillit te pergjitheshem antifashist nacional-clirimtar. Kjo "qeveri" u quajt "Komitet drejtues" me atributet e nje qeverie provizore. Antaret e ketij "komiteti drejtues" me atributet e nje qeverie provizore (deri sa te beheshin zgjedhjet per ~~xxxxxxx~~ ^{assemblee} legislative, assemble e cila do te zgjidhte formen e qeverimit ne Shqiperi dhe qeverine definitive, pas qirimit te te gjith Shqiperise) qene:

Kryetar i Komitetit: Enver Hoxha;

Nenkryetar i Komitetit: Koci Xoxe;

Nen kryetar i Komitetit: Myslim Peza; (jo anetar partie, figure patriote)

Pergjegjes per ceshtjet e punave te brendeshme: Haxhi Lleshi;

Pergjegjes per ceshtjet ekonomike: Medar Shtylla. (Atehere nuk ish antar partie, por u be me von).

Pergjegjes per bujqesine: Gasp Tashkua. (Nuk ka qene as atehere, as eshte tani, me sa di, anetar partie)

Pergjegjes per rindertimin: Spiro Koleka.

Pergjegjes per arsim kulturen: Sejfulla Malesheva.

Pergjegjes per shendetesine: Ymer Dishnica.

Pergjegjes per asistencen sociale: Bedri Spahiu.

Pergjegjes per ceshtjet e politikes se jashtme: Enver Hoxha.

Komandant i pergjitheshem i ushtrise: Enver Hoxha.

Pergjegjes per ceshtjet financiare: *Romadan Çitaku*.

Fermalisht, dyort e ketij komiteti mbeteshin te hapura edhe per anetare te tjere, ^{zakthe LNC.} ne fakt, ato qene te hapura vetem per elemente qe i quante fare

te sajte Partia komuniste.

Ky Komitet drejtues, me atributet e nje qeverie provizore, u kthye ne qeveri provizore, me po kete permbajtje, ^{dy} ~~me~~ muaj me von, ne fund te nendrit 1944, domethene sapo u clirua krejt Shqiperia dhe hyri ne Tirane (duke ardhur nga Berati) klika drejtuese komuniste.

Cili qe evenimenti imediat i rendesishem politik qe precedoi formimin e qeveris se pare komuniste te Malit? (As Balli Kombetar, as Legaliteti nuk formuan ndonje qeveri ne mal). Ky eveniment ishte Kongresi, ese mbledhja e Permetit, e Keshillit te pergjitheshem nacional-clirimtar (maj 1944).

SECRET

SECRET

Ne fakt, pikerisht ne mbledhjen e Permetit te Frontit nacional-Clirimitar u vendos qe ne parim qeveria e arthme e Shqiperise do te ish nje Republike popullore. Monarkia e Zogut u shpallinekzistente. Zogut dhe dinastis se tij iu ndalua kthimi ne Shqiperi. Ne Permet u vendos gjithashtu qe Republika e arthme popullore e Shqiperise do te kish nje Kushtetute (ligjin themeltar te shtetit), kushtetute kjo qe duhesh te aprovoesh nga perfaqesuesit e popullit, ose me fjale te tjera, ^{nga} deputetet qe do te zgjidheshin nga populli sapa te cliroheshe krejt Shqiperia. Ky trup perfaqesuesish te popullit shqiptar qe do te vendoste mbi fatet e Shqiperis dhe ^{që} do te aprovente Kushtetuten e Republikes, do te quheshe: Asamblee ^{e pare} kushtetuese. Sapa te aprovente Kushtetuten dhe te shpallte de jure Shqiperiane si Republike (sepse de facto) Shqiperia u shpall Republike ne Permet,) Asamblee kushtetuese do te ktheshhe ne parlament te regullt shqiptar me emrinë Asamblee popullore e Republikes popullore te Shqiperise. *(Me vona qe ajo te Kuvendi Popullor)*

Ne veshtrimin te kesaj procedure, mbledhja e Permetit vendosi qe ne prapun e clirimit te Shqiperise, Keshilli i pergjitheshem i Frontit nacional-Clirimitar, si trupi i vetem perfaqesues i popullit shqiptar, te zgjidhte nga gjiri i tij nje Komitet drejtues, ne atributet e nje qeverie provizore, Komitet i cili, fill pas clirimit do te ktheshhe ne qeveri provizore me detyrën:

- a) te merte ne dore administrimin e shtetit dhe mbajtjen e regullit;
- b) te organizonte zgjedhjet elektorale nga te cilat do te zgjidheshe Asamblee ^{kushtetuese} ~~popullore~~.

Sikurse shihet, pra, Komiteti drejtues me atributet e nje qeverie provizore *(nga gjiri i Keshillit te Pergjitheshem N.S.)* u zgjedh pikerisht sipas vendimeve te mbledhjes se Permetit. Sipas po ketyre vendimeve, dy muaj me von nga lindja e tij, ky Komitet u shndrua ne qeveri provizore.

Kaloj tani ne pershkrimin e personave ose figurave qe perbenin Komitetin drejtues (qeverin e pare te Malit), persona e figura te cilat ndodhen edhe ne perberjen e qeveris se pare provizore.

Mbi: Enver Haxha, Koci Xoxa, Myslim Pezen, Haxhi Lleshin, Medar Shtyllen, Spire Kolleken, Sejfulla Malëshoven, Ymer Dishnicen ^{Rrasidan Ciban} (dhe Bedri Spahiun, antare te qeveris se pare komuniste auk do te jap ndonje shenim komplementar per arsye se kam dhene shpesh here. Do te jap per personin e 10 te ketij komiteti ase qeverie, per ministrin e bujqesise: Gace Tashkon.

SECRET

SECRET

GAQO TASHKO. Lindur ne Korce por kryer studimet e tij te mesme e te larta universitare ne France, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara. Duhet te jete reth 55 vjeteve te shumten. Rjedh nga nje familje pasanike dhe aristokratike. Tefta Tashko-ja, sopranoja e njohur shqiptare qe ka kenduar ne skenat lirike te Italise, Gjermanis e Amerikes ka qene motra e tij. Ky eshte kthyer ne Shqiperi aty nga 1936 dhe ka qene si drejtor ne Ministrin e Bujqesis. Ka qene figure e njohur ne rethet intelektuale, me pikepanje demokratike e liberale. Partia e ka afruar pas vetes se saj, si mik te partise, aty nga ~~1936~~ 1942, me qellim qe ta perdorte ne rethet intelektuale te kryeqytetit dhe si figure ne lidhje me nacionalistet shqiptare. Person i mdershen, me kulture, por skolastik dhe me teper njeri biblioteke se sa aksioni. Teknik i mire dhe ekspert per problemet e bujqesise. Ka mare pjese ne Konferencen e Pezes dhe eshte zgjedhur ne Keshillin e pergjithshem ^{NC} qe psepse kishte perkrahtjen e Partise komuniste, e cila kish nevojte ne ate kohe qe levizja nacional-clirintare qe ish sa me perfaqesuese dhe jo krejt komuniste, ne menyre qe te maskohesh. Ka qendruar kurdohere ne pozit e partise, pa qene fanatic por edhe pa kundershtuar. Nuk e di qe te jete ne Partine komuniste, por ka edhe mundesi qe te jete pranuar gjate 5-6 vjeteve te fundit. Ky njeri ka qene kurdohere ne krye te dikasterit te bujqesis qe nga viti 1945 e deri nga viti 1954. Me 1954, kur u be minister i bujqesis Hysni Kapua, ky u be zevendes-minister per ceshtjet e pyjeve/~~shumet~~. Ne ate detyre e lashe kur u largova. Njete qe nuk i ka sjelle kurrs pengesa partise; element qe i ka dhene te gjith ndihmen e mundur, brenda vijes se Komitetit qendror, ne ceshtjet bujqesore; si ekspert. Gezen besim ~~xi~~ dhe kane konsideracion per te si organizater e ekspert, por jo si njeri politik i dhene fanaticisht pas partise. Mendoj se karriera e tij ka mare fund ne Shqiperi. Gradualisht, ne vend qe t'i ngjite shkallet, do te zbrese.

SECRET

SECRET

PERGJIGJE PYETJES XV-te.Si anetare ka patur Komiteti qendror i Partis komuniste te Shqiperise (sot Partia e Punes se Shqiperise)?

Deri nga fundi i vitit 1948 perberja (qofte si sasi, qofte si figura) e Komitetit qendror te Partise ka qene e fshehte dhe konspirative jo vetem per masen e popullsis, por edhe per anetaret e partise. Bile, deri nga fundi i 1948-es edhe anetaret e Partise e kishin per detyre qe te fshihnin qenien e tyre ne parti ne syt e popullsis dhe te shokeve te tyre. Kete konspiracion te habiteshem, Partia komuniste shqiptare e kish adoptuar, qe me krijimin e saj, nga Partia komuniste jugosllave.

Partia komuniste shqiptare delli legalisht ne drite dhe filloi t'i beje mbledhjet e saj jo fshehtazi vetem pas prishjes se maredhenievet Tito-Kominform, pas shkeputjes se Tiranes nga Beogradit. Dekonspirimi i cdo anetari partie ne kete drejtim (edhe anetar me anetar partie) denohesh me perjashtimin imediat nga partia te atij anetari qe kish guxuar te thosh se ish anetar partie.

Prandaj, mbi numurin e anetareve qe kish Komiteti qendror i Partise ne perioden 1947-1948 une nuk di asgje. Per perioden e luftes (1941-1944) dhe per kohen qe pasoi imediatisht kete periode (1945-1946) kam thene te gjitha sa kam dijtur, nga posti qe ushtrenja, ne pyetjen time te pare, kur flas mbi krijimin e Partise komuniste shqiptare dhe figurat qe e themeluan ate.

Por qe nga fillimi i 1949, ~~konstatohet~~ domethene qe kur Partia delli nga ilegaliteti ne legalitet (sado qe e kish pushtetin vete ne dore) e deri tani numuri i pjesetareve te Komitetit qendror te partise komuniste shqiptare ka qene:

- a) Antare byroje politike: 9 vete ~~konstatohet~~ per kohen 1949-1951.
7 vete per kohen 1951-1955.
Kongresi i trete do te vendese sasine dhe perperjen per perioden pas ketej.
- b) Antare te Komitetit qendror: reth 25 vete (kurdohere, deri me sot, qe nga viti 1949).
- c) Kandidate te Komitetit qendror: reth 7 vete (kurdohere, deri me sot, qe nga viti 1949).

Emrat e anetareve te Byros politike, emrat e ~~kandidatave~~ anetareve te Komitetit qendror (shumicen, sepse te gjitha nuk i mbaj mend) si dhe emrat e kandidatave te Komitetit qendror per perioden 1949 e ketej i kam dhene, se bashku me shenimet perkatese biografike, ~~qe do te~~ timeve te para qe m'u bene ne Kestur e me von ne Glifadhe, ~~ketu~~ e nje vit me pare.

SECRET

SECRET

PERQJIGJE PYETJES SE XVI-ta

Mareveshja te fshehta ndermjet EAM-it shqiptar dhe gjermaneve gjate terheqjes se ketvire te fundit nga Ballkanet (lufta e Tiranës).

Gde gje qe ka lidhje me kete pyetje, e thom ne rezerva te nenekuptueshme. Ne fakt, personalisht, nuk di qe EAM-i shqiptar te kete bere mareveshje me gjermanet gjate periodes se terheqjes se ketvireve te fundit nga Ballkanet. Dhe aqe me pak nuk di qe te kete ekzistuar ndonje mareveshje e fshehte midis Partise dhe gjermaneve ne lidhje me Tiranen. Por, qe te skjarohem, fakti se nuk di gje une, nuk do te thote se pa tjetër s'ka patur mareveshje te tilla. Personalisht, me rast se me kerkohet opinionimi tim, thom : une nuk besoj qe Partia te kish bere atehere ndonje mareveshje te fshehte me gjermanet. Sado te fshehte qe ta mbante klika drejtuese kete mareveshje, dicka do te kish depertuar dhe do te kish arritur ne menyre indirekte ne veshet e mij ose te shokeve te mij. E verteta eshte se une nuk kam degjuar kurre per mareveshje te fshehta midis Partise dhe gjermaneve.

"Mareveshje" midis gjermaneve dhe disa reparteve partizane, por jo mareveshje zyrtare, ka patur vetem ne shtatorin e 1943, ne kohen e kapitullimit te Italisë dhe ardhjes se trupave gjermane ne Shqiperi.

Si kane qene keto mareveshje? ate, me teper se sa mareveshje, kane qene "akorde te hesitura". Shpjegojem:

Ne shtatorin e 1943 trupat italiane kapitulluan ne Shqiperi. Nje pjese e madhe e tyre nuk pranuan kapitullimin dhe as dorezimin e tyre tek partizanet: kjo pjese u rezistoi me arme trupave te ushtrise nacional-olibratate dhe u dorezua me von tek gjermanet. Pjesa e tjetër, me pak e rëndësishme, pranoi kapitullimin dhe dorezimin, ose me mire bashkepunimin me partizanet ne lufte kunder gjermaneve. Ne kete kohe depot e medha ne armatime, municione, veshmbathje e ushqime qe kishin trupat italiane ne Shqiperi mbeten te braktisura, neper qytetet. Italianet i lene per t'u grumbulluar ne zona me te sigurta, pa i hedhur ne ar. Gjermanet nuk kishin ardhur akoma ne Shqiperi me forca te mjaftueshme qe te zeteronin situaten. Ne ate dite, ne vende te ndryshme te Shqiperise, sidomos ne Berat (qytet) kishin hyre partizanet. Duke e ditur se se afermi do te vinin gjermanet me forca te medha, repartet e ushtrise N.C. filluan te rrembejne nga keto depe sa me shume armatime e furnizime te tjera qe mundnin. Gjermanet, me forca te pakta, qe hyjten ne Berat, filluan te veprojne ne te njejtën menyre: te rrembejne sa te mundin. As partizanet

SECRET

- 8 -
SECRET

dhe
i përguan gjermanet, sepse interesi i perkoheshem ish plackitja e depove, /as
gjermanet i trazuan partizanet, sepse nuk ishin ne forca te mjafta. Me te njejt-
ten menyre si u veprua ne Berat, vecse ne nje shkalle me te vogel e per nje pe-
riode kohe me te shkurter, u ~~veprua~~ veprua nga te dy palet edhe ne Bilisht te
Kerces, ne Sarande dhe ne ndonje vend tjeter. Keto akorde te heshtura (accord
tacite) u prishen brenda 24 oreve ne Bilisht e Sarande, sepse partizane e gjerman-
ne u kapez njeri me tjetrin per rrenblimin e materialit (Ne Bilisht, per shemb-
ull, akordi tacit u prish per nje varele me vere dhe disa arka me shaqer). Ne
Berat, akordi tacit vazhdoi per disa dite. Lufta midis gjermaneve e partizaneve
filloi ^{duj} ~~sa~~ trupave te okupatorit te ri u erdhen perforcimet e nevojeshme.

Di me siguri, sepse ne ate kohe isha ne gjendje te dinja, se keto akorde
tacite jane bere kudo ne inisiativen ^{personale} ~~politike~~ te komandanteve ose komisareve po-
litike qe ndodheshin ne zonat e lart-permandura. ^{K. A. J.} Partise i ka denuar me nje here
keto akorde dhe Gjijn Marku, pergjegjesi kryesor ne akordin tacit te Beratit,
u perjashtua nga Komiteti qendror dhe ~~niksi~~ qe atehere nuk i fercoi me pozitat
e tij ne parti. Deri ne ate kohe ish nje nga eksponentet kryesore te Partise
dhe nje nga figurat qe premtonte e dukeshe se do te ngjiteshe shume lart, si
nje "yll i partise".

Kthehem ne betejen e Tiranes: E perserit, personalisht nuk di qe te kete
patur nje mareveshje te fshete parti-gjermane. Dhe, ne bindje personale, nuk
e besoj nje gje te tille.

SECRET

SECRET

- 89 -

PERGJIGJE PYETJES XVII-te.Luftimet kryesore ndermjet Ushtrise nacional-clirimtare shqiptare dhe fuqive italo-gjermane (Forca, krahina, perfundime).

Pergjigja e ime reth kesaj pyetjeje ^{do te jete} ~~eshte~~ e kufizuar. Qe nga koha e luftimeve e deri tani kane kaluar afro 15 vjet. Vec kesaj, njeriu mban mend ato luftime ky ka mare vete pjese dhe jo ato qe ka degjuar; vjete me pare. Pastaj, njohja e forcave te kundershtrairit ne luften partizane eshte kurdohere ne hamedje dhe aspak skzakte. Sidoqefte, ketu poshta do te shenoj ato qe mund. Per njoftime te plota reth kesaj pyetjeje, ose me sakte, per dijeni ne komplementare, mund te shihet kalendari ushtarak i ~~Forcave~~ "LUFTETARIT", botim vjeter i organit te Ushtrise popullore shqiptare.

Keto perpjekje midis forcave te UNGI. shqiptare dhe trupave te italianeve e gjermaneve do t'i ndaj ne ~~ny~~ ^{tri} perioda:

- a) Luftime te partizaneve kunder trupave italiane ^{vjeshte 1942} (~~1942-1943~~ - shtator 1943).
- b) Luftime te partizaneve kunder trupave gjermane (shtator 1943 - nendor 1944).
- c) Luftime te partizaneve shqiptare ne token jucesllave (nendor 1944- mar 1945) kunder gjermaneve.

Perioda e pare. Perfshin kohen prej vjeshtes 1942 dhe mer fund ne shtatorin e vitit 1943, domethene deri ne kapitullimin e Italisë dhe ardhjen e trupave gjermane ne Shqiperi. Duhet te ~~thaksoj~~ ketu se perpjekje midis partizaneve e trupave italiane jane shenuar edhe perpara vjeshtes se 1942-se ne Shqiperi. Mirepo keto perpjekje (si ajo e Grabovices ne qarkun e Kordes, e Lesnjes ne pe kete qark, e Barmashit ne rethin e Kolonjes, etj) kane qene fare te parendesishme. Ato kane qene sulme ne ndonje post te izoluar ghandarmerie, prita kunder ndonje automobili, etj.

Operacion italian kunder Pezes. Eshte kryer gjate muajit shtator-teter te vitit 1942; ne qellim spastrimin e kesaj zone ~~partizane~~ nga trupat partizane te Myslim Pezes, qe vinin ne rrezik vijat e komunikacionit dhe rruget e perdorura nga italianet ne trikendeshin: Tirane-Durres-Lushnje. Efektivat e rregullta partizane kane qene maksimumi 200 vete. Forca vullgtare fshatare qe u bashkuan me partizanet: reth 300 te tjere maksimumi. Terreni: jashtezakonisht i veshtire per lufte te rregullt frontale, sepse me shume kodra qe pasojne dhe mbrojne njera tjetren, me keneta e mocale te mbuluara me kallama te larte. Gjate ketij operac-

SECRET

SECRET - 70 -

ioni, italianet, qe nuk dinin te perdormin trupa te vogla, te lehta, mobile, (lloje komandos) dhe qe druanin shume (ndryshe nga gjermanet) te hynin ne brendine e zoneve te cilruara dhe te kontrolluara nga partizanet pa forca imponante, vune ne ~~te~~ levizje nje ushtri te tere prej afro 30.000 neta, te armatosur me arme te renda (artilieri, tanke, aviacion), sikur do te sulmonin Stalingradin. Sulmi u krye ne fenne rrethi ^(mi) dhe nga shume drejtime. Avancimi i kembesorise italiane u be pas nje bombardimi te rende artilerie qe qe-llonte kuturu. Duke ndjekar taktiken e tyre, partizanet e refuzuan luften frontale, rezistencen ne vende. Ata i perdane forcat dhe, te perkrahur nga terreni e natyra, zhvilluan ~~perpjekje~~ luften me perpjekje te levizeshme, here ne njerin krah, here ne tjetrin. Kur u duk se krejt Peza u mbush me trupat italiane, forcat partizane u shpemdane ne njesite prej 5 vetash maksimumi dhe u pjeserisht u fshihen neper kanetate dhe kallamat, pjeserisht qane ^{ngatave} rrethimin dhe u hodhen ne zona te tjera. Italianet shkelen te gjitha katan-det e Pezes (afro nja 36), dogjen nje pjese te madhe te tyre por nuk munden t'u shkaketojne dene ne njerez fuqive partizane. Sapo u terhoqen italianet, partizanet u kthyen perseri. Sidoqofte ata bene njaft kehe deri sa ta mbledhnin veten.

Luftimet ne Gjorne dhe Vajze te Vlores. Me qene se trupat partizane kishin sulmuar nje autokollone italiane ne prite, ne kete krahine, autoritetet ushtarake te okupatorit, ne forme raprezaljeje, derguan (nga mendori ose dhjetori i 1942-se, me nuk mbaj mend mire, nje force prej afro 5.000 vete, maksimumi. Efektiva te regullta partizane qe muaren pjese ne kete luften: afro 100 vete. Forca fshatare vullnetare qe u erdhen ne mihme: afro 100 te tiere. Tarrani: jashtezakonisht i pershtateshem per luften partizane: gryka dhe pjerresira te thepisara. Para-roja italiane u gedit ne nje kanjen te ngushte e te thepisur, shume me perpara vendit te prites ku qe bere geditja 2 dite me pare. Te zona ne befasi, italianet e humben terruan dhe duke kujtuar se kane te bejne me forca te medha kundershatare filluan te terhoqen pa regull; dhe ne shpartallim. U zune lart nga 150 reber italiane, te cilet u liruan te gjitha dhe u vrane nje kolonel italian (emri i te cilit nuk me kujtohet tani) si dhe disa ushtare e oficere te tjere. Partizanet paten vetem disa te plagosur.

./.

SECRET

SECRET - (P)

Luftimi i Voskopojes (qarku i Korces). Zhvilluar ne dhjetorin e 1942-se. Voskopoja ishte nje kaposald i italianeve ne afersit e zonave te kontrolluara nga partizanet. Kishte depo te medha me municione dhe nje garnizon prej afro 300 italianesh. Per te dbuar kete garnizon dhe mare depot, partizanet e rrethuan. (Voskopoja eshte ajo qe quajne graket Moskopoli). Efektiva te regullta partizane: 200 vete. Forca vullnetare fshatare: 300 vete, maksimumi. Garnizonit italian te rrethuar ne Voskopoje i erdhe ndihma nga Korca, afro 2.000 ~~xxx~~ italiane. Ne saje te kesaj ndihme, trupat e rrethuara munden te cajne rethimin per lane krejt depot e medha me ushqime e municione qe kishin ne Voskopoje. Gjate terheqjes se tyre u zune nja 60 italiane rober dhe nja 300 shqiptare milice. Qe te gjithe roberit u liruan. Qe nga ajo kehe, Voskopoja u be qendra e shtabit te partizaneve te qarkut te Korces. Depot me municione i mbajten pjeserisht partizanet pjeserisht u dhane fshatareve; po ashtu u veproua edhe me depot e ushqimeve.

Luftimi i Snosmit (qarku i Elbasanit). Pikerisht si ishte nje kaposald ~~xxx~~ i italianeve ne qarkun e Korces Voskopoja, Snosmi ishte nje kaposald i tyre ne Elbasan. Garnizoni perbeheshe gjithashtu nga nja 300 italiane. Kishte depo. Forca te regullta partizane: 200 vete. Forca vullnetare qe u erdhen ne ndihme nga fshatrat: afro 1000 vete (sepse plackitja e depove me ushqime ne Voskopoje i emblesoi se tepermi). Forcave italiane te rrethuara ne Snosmi u erdhen ne ndihme afro 3000 trupa italiane; dhe ne saje te kesaj ndihme munden te cajne rrethimin. U zune nja 30 rober italiane (te cilet u liruan) dhe nje sasi materiali e ushqimesh, shume me i pakte se ne Voskopoje. Humbjet ne njerez te partizaneve fare te parendesishme. Keha e zhvillimit te ketyre luftimeve: janar 1943.

Operacioni partizan per marrjen e qytetit te Permetit dhe te *Kuqarit*.

Te inkurajuar nga kete suksese te lehta, trupat partizane vendosen te japin nje goditje te madhe: te sulmojne e clirojne Permetin dhe *Kuqarin*. Qe te dy keta vende, ishin qendrat ushtarake me te rendesishme italiane ne Juge. Garnizonet e tyre qane shume me te medha se sa ato te Voskopojes e Snosmit (lart nga 10 here me te fuqishme). Depot ishin jashtezakonisht te rendesishme dhe te pasura. Per kete qellim, italianet kishin bere edhe fortifikata moderne me beton arme, bunkere, llogere, etj. Efektiva te rregullta partizane qe muaren pjese: reth 500 vete. Forca vullnetare nga fshati: afro ~~300~~ ^{1.500} vete; ndefta dhe me teper.

SECRET

SECRET

Per te penguar ardhjen e ndihmave nga jashte trupave ~~korca~~ italiane te re-
 thura ne keto dy garnizone, forcat partizane u rjeshtuan ne nje front shume te
 gjere: prita ne Barmash (per te ndaluar ardhjen e ndihmave nga Korca); ne tre
 urat (per te ndaluar ardhjen e ndihmave nga Greqia); ne Mezheran (per te ndaluar
 ardhjen e ndihmave nga Vlora). Shkurt, u izolua tere qarku i Gjirokastrës. Si
 diversion, ~~meqenise~~ u godit ne fillin Permeti, me qellim qe trupat e garnizo-
 nit te Kuqarit te dilnin nga fortifikatat e tyre per t'u ardhur ne ndihme ^{Permetit,}
 kur keto trupa ndihmese ^{nga Kuqari} te ishin ne levizje, te sulmoheshin nga partizanet ne
 levizje e siper. Mirepo Kuqari/muk levizi ne ndihme te Permetit. Atehere u sul-
 mua edhe ky: Luftimet zgjaten nje dy dite, me sulme te perseritura nga pala par-
 tizane per pa asnje rezultat. Italianet, te mbrojtur mire prapa fortineve, bunke-
 rve dhe difezave me beton arme te tjera, nuk leviznin (zakonisht italianet mbro-
 heshin mire kur qene ne pozicion, por sulmonin shume keq kur ishin ne ofensive).
 Atyre u erdhen ne ndihme forca te konsiderueshme nga Vlora, pasi qane ^{me humbje} priten e
 Mezheranit. Rezultati i luftimeve: u vrane disa italiane ne gryken e Mezhera-
 nit, qe shkonin ne ndihme te Kuqarit e Permetit, por partizanet nuk bene asgje.
 As ne Kuqar, as ne Permet, nuk hynë. Paten njaft humbje. Shkurt qe nje aksion i
 madh per 'ta, por ~~konkret~~ qe deshtoi kryekeput. Koha e operacionit: mars 1943.
 LUFTIMI ^{me} Leskovikut (qarku i Korces) // Per te shpetuar prestigjin e humbur
 ne Kuqar dhe Permet, trupat partizane ~~mbledh~~ qytetin e Leskovikut, ku ish nje
 garnizon italian prej 500 vetesh maksimumi, i mbyllur gjithashtu ne fortine prej
 beton armeje. Italianet i rrezistojne sulmit, por ~~q~~ dalin nga qy-
 teti duke e konsideruar si kaposald te pambajteshem. Sulmohen gjate terheqjes,
 lene nje pjese te mire te materialit dhe municioneve qe kishin me vete dhe hikin
 te mundur. Kapen nje 30 rober italiane, vriten disa te tjere dhe nje majer. Kesaj
 here, roberit italiane, me qene se trupat e tyre i vane zjarrin Leskovikut per-
 para se te largoheshin definitivisht, pushtohen ne forme raprezaljeje nga parti-
 zanet. Ushqimet e kapura, shperndahen, sipas zakonit, ne vullnetaret fshatare.
 Kjo ishte nje taktike qe pordoreshe regullisht ne fillim nga partizanet, me qe-
 llim qe t'u vinin ndihma te shumta vullnetare sa here kishin nevojë per aksione.
 Koha e luftimeve per Leskovikun: prill ose maj 1943, muk e mbaj mend mire.

. / .

SECRET

SECRET 73 -

Sulmi partizan kunder Patosit - (pranvere e 1943, muaji nuk me kujtohet). Nuk eshte sulm ne forme rrethimi, por sulm i befasishem. Forca partizane qe muaren pjese afro 200 vete. Trupa italiane: nuk mund te thom asgje me siguri. Zgjati vertem nje nate. Italianeve iu lla qellimisht nje rruge daljeje per te shpetuar, me qellim qe te mos rezistonin ne fortinet e tyre prej betoni. Italianet bijen ne kete gracke dhe terhiquen shpejt. Rezultati: shkaterrimi i puseve vajgurore te kesaj zone; dhe diegja e depove me vajgurri qe kishin aty italianet. Autoritetet italiane e kuptuan gabimin qe bene duke u terhukur, ~~xxx~~ dhe u kthyen me njehere me forca te medha e aviacion, duke kujtuar se partizanet ishin te shumte ne njerez. Kur u kthyen, jo me von se disa ore, ishte vonj partizanet qene terhukur dhe depot digjeshin, ndersa puset e celura qene ~~xxxx~~ nga eksplozivat e vena prej partizaneve.

Operacioni italian kunder Vithkuqit (gusht 1943) - Ne veren e 1943, Vithkuqi, katund ne qarkun e Korces, ishte bere epiqendra e partizaneve. Aty qene mbledhur shumica e forcave partizane, trupave me te zgjedhura, sepse do te krijohesh Brigada e pare. Aty ndodheshe Shtabi i pergjithshem, qendra e Komitetit qendror dhe misioni ushtarak nderlidhes britanik. Italianet vendosin te japin nje grusht te reade. Por edhe ketu, si afro nje vit me pare ne Peze, ata nuk perdorin trupa te lehta, te shpejta, mobile. Vene ne front nje ushtri te tere prej afro 30 mijë vete; sado qe ~~Vithkuqi~~ Vithkuqi, ne vije te drejte, eshte jo me teper se 15 kilometra nga qyteti i Korces dhe lidhet me nje rruge automobilistike. Perparimi i kembesoris se precedohet nga nje bombardim i madh artilerie (pjese te rena) qe zgjat lart nga 24 ore. Asnje shtepi e Vithkuqit nuk mbetet me kemb; nga qitjet e kesaj artilerie. Arat lerohen nga predhat. Te gjitha trupat partizane terhiquen, pa mos bere asnje rezistence, ne Shtylle dhe malet qe dominojne katundin. ~~Kembesoria~~ Kembesoria italiane, e shoqeruar nga aviacioni, hyn pa luftime ne Vithkuq. Shtyhet deri ne Shtylle, dhe ketu geditet ne prita te ndryshme. Italianet djegin Shtyllen sikurse kishin shkaterruar me artileri Vithkuqin dhe terhiquen. Partizanet kthehen perseri. Rezultati i ketij operacioni. Partizanet nuk pesuan asnje humbje te rëndesishme, qofte ne njerez, qofte ne material. Po ashtu edhe italianet. Shkaterrohen krejt katundet: Leshnje, Vithkuq, Shtylle dhe Bellovode.

Operacioni italian kunder Veskopojes (nuk mbaj mend mire ne se precedej operacionin kunder Vithkuqit, apo e pasoi kete) ~~xxxxxxx~~ Sidoqofte u krye ne veren e 1943. Fikerisht si ne Vithkuq, italianet e bombarduan rende kete katund dhe hyn kur partizanet ishin larguar me ~~perpara~~ qitjet e dendura te artilerise.

SECRET

SECRET 74 -

Forca italiane qe muaren pjese ne kete operacion: afro 15 mije vete .

Humbjet qene te parendesishme dhe gati zero nga te dy palet. Voskopoja u shkaterrua e tera, qe nga themeli.

Luftimet ne krahinen e Maliqit (qarku i Korces) - U zhvilluan ne shtatorin e 1943. Efektivat partizane te regullta: afro 1.000 vete. Forca vullnetare fshatare qe u erdhen ne ndihme: afro 3.000 vete. Efektivat italiane: 30,000 vete; ndofte dhe me teper. (Ish me teper se nje divizion italian). Eshte koha e kapitullimit te Italis. Te gjitha trupat e qarkut te Korces, qe ishin te permdare ne garnizone te ndryshme, grunbullohen ne nje autokollone te vetme me drejtim nga Korca ne Pogradec per t'u hedhur ne Elbasan; ne qellim qe te dorezohen tek gjermanet (Elbasani ish me i sigurt se qyteti i Korces). Sulmohen dhe rrethohen ne udhen e automobilite qe shtrihet nga Maliqi deri ^{ne} Zboqerid. Qellimi i partizaneve eshte i garte: kerkojne te marin armatimin e tyre te shumte dhe ushqimet qe hiqning nga pas. Vendi i prites eshte shume i favoreshem. Luftimet zgjatin per nja 4-5 dite, duke qene italianet kurdhhere te rethuar, ne fushe dhe partizanet ne majrat qe dominojne fushen. Humbjet e italianeve ne njerz jane shume te medha, sepse nuk jane ne fortine, por ne terren te hapur. Kane frike te shpermbahen sepse nuk dine ku te shkojne. Perparimi i tyre i metejshe drejt Pogradecit behet i pamundur sepse mesojne qe edhe garnizoni i Pogradecit (iay/ ishin grunbulluar ~~nje~~ di sa garnizone italiane qe ishin ne Jugosllavi) eshte rrethuar nga forca te tjera partizane. Prandaj, vendosin te kthehen perseri ne Korce, dhe aty te presin gjermanet. Dhe keshtu veprojne. Gjate kthimit pesejne humbje akoma me te medha sepse gediten vazhdimisht nga krahjet dhe e kane humbur moralin. Sideqefte, partizanet nuk marin dot armatimet qe synonin te rremenin. As lufta, as premtimi qe u dhane italianeve se nuk do t'i trazonia po te bashkoheshin me partizanet, nuk i bindi kreret e trupave italiane qe te dorezoheshin ose te jepnin armatimet.

Luftimet e Pogradecit (shtator 1943) - Efektivat e regullta partizane :
1000 e ca vete (krejt brigada e pare dhe repartet territoriale partizane te Mokres) 2.000 vete maksimumi forca fshatare vullnetare. Trupat italiane: reth 15.000 vete (garnizoni italian i Pogradecit + disa garnizone te ardhura nga toka jugosllave - Oher, Struge, etj). Ne fillim komanda italiane pranon dorezimin. ^{me} ven, duket sipas instruksioneve nga Korca, refuzon. Sideqefte, partizanet kane hyre ne qytet; dhe depot jane ne duart e tyre. Italianet orvaten t'i marin perseri, por nuk mundin. Shkaterrhet nje pjese e mire e qytetit gjate luftimeve dhe italianet, ^{afro 5.000} ~~afro 5.000~~ (jo te gjitha, sepse nje pjese ~~afro 5.000~~ prej syresh bashkohet me parti-

SECRET

SECRET

- 75 -

zanet) marrin rrugen e terheqjes per ne Korce, me qellim qe te bashkohen me trupat e rrethuara ne Maliq e Zboqeri. Kjo kollone (afro 10 mije vete) san pritat ne rrugen e saj, bashkohet me kollonen e rrethuar ne Maliq dhe te dyja se bashku futen perseri ne qytetin e Korces; ku, nja dy dite me von u dorezohen trupave gjermane qe hyjten dike ardhur nga Ureqia e Jugosllavia.

Rezultati i kesyre luftimeve: Vriten njaft italiane. Afro 5 mije bashkohen me partizanet. Zihet nje sasi e mire armatimesh e municioni nga ana partizane.

Luftimet ne Kruje (shtator 1943) - Zona ne veri te Tiranës ishte nje qender e rendeishme trupash italiane. Nje pjese e kesyre trupave, pjesa me e madhe, dorezohen tek partizanet se bashku me armatimet, me premtimin qe te mbeten trupa autonome ne lufte kunder gjermaneve. Pjesa tjetere, me e vogel, refuzon. Kjo pjese sulmohet, por pa rezultat nga partizanet. Vriten disa italiane po nuk meret material.

Luftimet e Dibres (shtator 1943) - Me kapitullimin e Italisë, trupat italiane ne kete krahine e lene qytetin e Dibres dhe drejtohen per ne Elbasan. Ne qytet lene vetem nje prapavije me qellim qe te interesohet per transportin e depove. Pikesisht kete prapavije, te lene ~~ne qytet~~ ^{nga komanda e Tullianit} ne meshiren e partizaneve dhe te popullsisë, sulmojne forcat partizane te Dibres e Peshkopis, te grumbulluara ne nje komande te vetme (nen komanden e Haxhi "leshit") dhe te ndihmuara nga mija vullnetare fshatare te eteshem per placke. Prapa vija dorezohet, depot kapen, plackiten. Autokollona italiane qe ishte larguar nga qyteti, kur meson fatin e prapavijes se saj, kthehet, sulmon Dibren (afro 30.000 italiane) dhe e ben qytetin fertele. Gjysma e depove qe kishin mbetur akoma pa u plackitur, hidhet ne ere.

Skema - Gjate muajit shtator, luftime ne stil temp gjere kunder trupave italiane qe nuk praman te dorezohen tek partizanet pas kapitullimit te Italisë, jane zhvilluar me duket edhe ne qarkun e Gjirokastres, ~~me~~ Vlores dhe Beratit, por ne stil me te vogel se sa keto qe kam permendur. Sidoqofte, ne ato dite shtatori, humbjet e italianeve, te demoralizuar e te qorientuar kane qene te lartra ne luftimet me partizanet. Kjo shpjegohet nga vete situata e veshtire dhe pa dalje qe u krijua per ta.

Operacioni italian kunder krahines se Mallkastres - U be perpara shtatorit 1943, domethene perpara kapitullimit, por harrova ta vere sipas raches kronologjike. Kohen ekzakte, domethene muajin, nuk e mbaj mend. Sidoqofte, sy eshte nje nga me te medhenjte qe kane kryer italianet kunder trupave partizane dhe zenave te kontrolluara nga keta.

SECRET

SECRET - 36 -

Ky operacion, thashe, u krye nga italianet ne veren e 1943-se, muajin ekzakt nuk e mbaj mend. Ka qene operacioni i fundit italian ne Shqiperi. Trupat italia-
divizion
ne qe muaren pjese kane qene te perbera nga afro nje ~~trupa~~ i tere (30,000 vete). Nga pala partizane efektivat kane qene shume te pakta: maksimumi 500 vete. Me keto forca partizane, per heren e te pare dhe te fundit, bashkepunan edhe disa forca balliste, nen komanden e nje nacionalisti te ndershem, i cili u vra gjate luftimeve (emri nuk me kujtohet). Rezultati ishte katastrofal per Ushtrine Nacional-clirimtare dhe influencen e Frontit nacional-clirimtar ne kete krahine. Italianet shkelen krejt Mallakastren, degjen fshtra te tere dhe bareqetin e kantundareve. U zhvilluan luftime per 2 jave resht, por kudo, partizanet u terhoqen, pa pasuar humbje te medha por duke lene zona te tere qe me perpara ishin nen kontrollin e tyre. Terreni e ndihmonte mjaft komanden italiane, sepse eshte fushe dhe kodra te vogla; vendet malore jane teper te kufizuara, rrugat e komunikacionit mjaft te dendura dhe ~~mbrojtura me forca te shumta~~ jo me gryka te pershtateshme per prita.

Qe nga kjo kohe, influenca e madhe e Frontit nacional-clirimtar ne kete krahine humbi. P^a redominoi influenca e Ballit Kombetar. Fshataret, shumica fusharake, qe nga ky operacion as qe donin te degjonin per luftime kunder okupatoreve ne token e tyre. Per paseje, edhe bijt e ketyre fshatareve qe deshiti mobilizonte ne radhet e veta Partia, si partizane, refuzonin. Inflaancen e vet ne kete krahine, Partia e fitoi vetem ne pragun e clirimtar, kur ishte i cliruar krejt ose zati krejt Jugu i Shqiperise.

Nga te gjitha operacionet italiane, ky i Mallakastres ka qene ay qe i shkaktei me teper deme reale Frontit nacional-clirimtar dhe ushtrise nacional-clirimtare. Reaksioni i tyre i eger e trumbi popullsine, e largoi nga partia komuniste dhe e hodhi nen influencen e Ballit Kombetar, politika e te cilit ishte: "jo aksione te cmendura, qe sjellin si rezultat diegjen e fshatrave dhe vrasjen e popullsise mbivile nga ana e okupatorit, por lufte vetem ne momentin e fundit, kur forcat e armikut te mos jene me te afta per operacione spastrimi dhe raprezalje". Ne fakt, operacionet italiane ne Vihtkuq, Peze, etj. paten vetem nje ane me teper demonstrative se sa rezultate konkrete. Keto zona mbeten kurdohere te lidhura pas frontit, vatrave e Levizjes nacional-clirimtare, burimi i pashtereshem ne njerez dhe zonat me te sigurta, me besniket te Partise.

SECRET

SECRET

- 7 -

Perioda e dytë: Fillon që më ardhjen e trupave gjermane në Shqipëri (domethene fundi i shtatorit 1943) dhe shtrihet deri në terheqjen e tyre të plotë nga Shqipëria (fundit i nëndorit 1944). Shkurt, kjo periudhë përfshin një kohë prej disa muajsh deri në një vit. Në vijë të përgjithshme, luftimet në këtë periudhë të dytë janë shumë më të shpeshta. Por, karakteristika e tyre është krejt e ndryshme nga ajo e periodes së parë: Kësaj here, efektivat e partizanëve nuk janë të pakta, si në periudhën e parë; ato janë shumë më të mëdha nga ana tjetër, efektivat e kundërshtarit që marrin pjesë në luftime, janë të vogla (të vogla në krahasim me efektivat e italianëve). Nuk ka më operacione për një krahinë të vetme ku të marrin pjesë 30.000 ose 20 mijë ose 10 mijë gjermanë; si vepronin italianët. Kundërshtari i ri ndryshon edhe nga armatimi që përdor: jo artileri të rëndë, por të lehtë, malorë; ndryshon edhe nga përzierja e trupave që ve në luftim: jo trupa të rënda, por reparte të shpejta, të lehta, shumë mobile. Taktika e tij është në përshatje me taktikën partizane dhe jo ajo e luftës/frontale që viheshe në përdorim nga italianët. Italianët hezitonin shumë të hynin në brendin e zonave, po mos shpëtoheshin nga aeroplanet dhe artileria e rëndë; gjermanët, me trupa komandës/sulmojnë brenda ~~në~~ një nate, qendra partizane që ndodhen shumë më thellë se sa Vithkuqi ose Voskopoja. Me një tank të vetëm dhe me një forcë prej 50 ushtarësh ata depertojnë me shpejtësi, në kamiona, duke ndjekur rrugën automobilistike të Vithkuqit ose Voskopojes (urat e prishura i mbulojnë shpejtë e shpejt me drasë) deri në qendrat ku janë komandat partizane, zakonisht kur afër këtyre qendrave nuk ndodhen forca partizane (sapo informatorët e tyre u japin informacionin, nisen për aksion). Është, sikurse shihet, tamam taktika guerrilje e partizanëve.

Karakteristika tjetër: gjermanët nuk kanë garnizone të rëndësishme, qendra të palevizura në Përmet, Kuqar, Pogradec, Leskovik, Krujë, Korçë, Gjirokastër, Labint, ~~etj~~ Diber, etj. Ata kanë reparte shumë të vogla në këto vende, por të mbyllura nëpër fortine e bunkere të ngritura në poste strategjike. Trupat e tyre janë më tepër në levizje, jo vetëm brenda për brenda Shqipërisë, por edhe në një plan më të gjërë: here në Greqi, here në Jugosllavi, here në Shqipëri. Bëjnë përjashtim vetëm trupat e bregdetit, por këto janë vene në pozita të atilla që as mund të sulmohen.

Prandaj, gjatë kësaj periode, shumica e luftimeve partizane kundër gjerman-

SECRET

SECRET - 78, -

neve jane luftime pritash. Si ajo e Barmashit (rezultat: disa gjermane te vrare, por diegja totale dhe pushkatimi i kbejt popullsis, burra, gra e femije te keti katundi), si ajo e Maliqit (rezultat: disa gjermane te vrare, por nga ana tjetere krejt katundi Ciflig rrafshuar per toke dhe krejt burrat e keti fshati, nga 10 vjete e lart, pushkatuar); si ajo e Goskoves (rezultati identik me dy te parat), etj/ etj.

Sidoqofte, edhe gjate kesaj periudhe ka luftime te rehdesishme midis partizaneve e gjermaneve, por ne shumicen e rasteve, keto luftime jane te provokuara nga gjermanet, dhe jo nga partizanet, sic ishte rasti me italianet.

Shpjegohet: Duke erdhur ne Shqiperi me shtatorin e 1943, gjermanet gjeten nje situatë te veshtire. Vijat e tyre te komunikacionit ~~qane~~ ^{qane} shume te kufizuara, te prera nga forcat partizane ose shume afer zenave te ketvreve te fundit. Frike e pritave akzistonte ne odo kthese e gryke. Italianet i ishin nmashtuar kesaj situatë si dicka fatale. Gjermanet u orvaten ta permbysin, aq me teper, sepse ne kohen e kapitullimit te Italisë, zona nen kontrollin partizan ish zgjeruar edhe me teper.

Prandaj, qe pora e muare n mire situatë ne dore ne Shqiperi (aty nga fundi i tetorit fillimi i nendorit 1943-es), gjermanet organizuan dhe ndemuaen nje seri operacionesh spastrimi:

a) Kunder Dibres - Njje e rredesishme komunikacioni midis Jugosllavis e Shqiperise, ky qytet nuk mund te liheshe nga gjermanet ne dore partizane. Prandaj, komadna gjermane e sulmoi me forca te rredesishme. Luftimet zgjaten jashte qytetit dhe brenda qytetit per ndonja 10 dite. Rezultati: partizanet u thyen me humbje dhe e lane qytetin. Gjermanet e muaren qe atehere ne dorezim dhe e mbajten me nje garnizon prej te shumten 500 vete. Raprezaljet gjermane kane qene te medha. Qe nga keto raprezalje, qe pasuan ato te shtatorit te italianeve, Dibra dhe qarku i saj, qe kishin qene zona baze per Levizjen nacional-clirimtare, ^{me qete} pushuan qe qenuri te tilla. Influenca e partise zbriti ne zero. U deshën te vinen trupat e Divizionit te I-re, nga jugu, qe te ristabilizoheshë situatë. Qarku i Dibres, qe ~~pas~~ ^{me} shtatorit/numaronte lart nga 1.500 partizane, pas sulmit gjerman ne Diber dhe raprezaljeve te tyre, kish vetem disa njesite te shperndara andej ketej dhe qe leviznin vetem naten, neper baza te sigurta, pa bere asnje akstion.

b) kunder Fizes -- U be aty nga nendori ose dhjetori i 1943. Efektivat gjermane nuk ishin me te medha se sa 4/000 vete. Por ato shkelen shume me shpejt kete

SECRET

SECRET

-99-

krahine (vecse me humbje shume ne te medha) se sa italianet qe sulmuan me 70 mije vete. U rrenuan shtepite qe kishin mbetur neper ato katunde qe ishin baza kryesore te partizaneve dhe u pushkatuan qindra vete nga popullsia. Rezultati: Brigada e dyte/ qe porsa ishte formuar ne kete zone dhe trupat territoriale nen komanden e Myslim Pezes, (nuk e mbledhen me vehten e tyre, vecse atehere kur shkeli ne Veri divizioni i I-re.

Operacioni gjerman kunder Cermenikes dhe Shpatit (n'Elbasan). - Efektivat gjermane: afro 5.000 vete. U be nga dhjetori i 1943-se, pas operacionit kunder Pezes. Rezultati: te gjitha katundet e kesaj zone, sadoqe malere e me gryka, u shkelen shpejt. Humbjet kane qene te medha nga te dy palet: nga ana partizane u shpartallua krejt Brigada e III-te, qe porsa ishte formuar. Trupat territoriale te kesaj krahine, pjeserisht u shperndane dhe u hodhen ne ilegalitet, pjeserisht kaluan ne qarkun e Korces (Moker). Pikerisht si Dibra, qe nga kjo kohe, krahina e Cermenikes dhe e Shpatit humben per Levizjen nacional-cliristare. Raprezaljet e egra gjermane e tmerruan popullsin. Situata u ristabilizua pas ardhjes se Divizionit te I-re.

Operacioni gjerman kunder krahines se Mokeres (qarku i Korces). Trupat gjermane qe muaren pjese: maksimumi 1.500 vete. Trupa ndihmese: trupat e Ballit te zones s'Elbasanit. Luftimet edhe ketu, si ne Shpat, zgjaten nje 10 dite. Mbi humbjet e gjermaneve nuk di, por di qe Balli kombetar pati shume humbje, po ashtu edhe partizanet. Gjermanet shkelen tere Mokeren, dogjen, vrane. Trupat partizane, te mundura, por jo te shpartalluara e as te shperndara si ne Shpat e Cermenike, terhiqen ne krahinen e Gore-Oparit.

Operacioni gjerman kunder krahines Gore-Moker Opar. Trupa gjermane: afro 2.000 vete. Trupa ndihmese nga Balli. Koha e luftimeve: dhjetor-janar 1944. Sulmet e gjermaneve thyhen me humbje te medha per ta ne malin e Kamjes dhe Vertop. Te ndje kur nga partizanet ^{gjermanet te krahinave} (edhe nga Mokra, edhe nga Pogradeci qe kishin pushtuar me pare. Luftimet me e janarit ne Kamje u treguan gjermaneve se kishin arritur pikerisht ne zemren e rezistences partizane, ne krahinat ku ndodheshin forcat kryesore te shtrise nacional-cliristare. Sulmin e tyre qe e filluan ne Veri te Shqiperise, ne Diber dhe e vazhduan/etape ^{ne Juge} pas etape deri ne Gore (Korce), te nderprene tamam ne Kamje. Por, si do te shohia me poshte, jo per gjithnje. Nderpreja e ketij sulmi ishte momentan: gjermanet filluan organizimin e nje operacioni ne stil te gjere, me forca te medha dhe nga shume ane, ^{operacioni te cilin e shperthyen ne janar 1944.}

SECRET

SECRET

Te njejtjen taktike qe ndoqen ne ~~Korces~~ Veri Lindje te Shqiperise kunder trupave dhe zonave partizane, gjermanet ndjekin edhe ne Veri perendim te Shqiperise. Qe nga Peza, ata zbresin ne Juge.

Operacioni i tyre kunder Beratit. Qyteti i Beratit kish mbetur ne duart e partizaneve qe nga koha e kapitullimit te Italis. Ata qe bene kunder Dibres, bene gjermanet edhe ne Berat. E sulmuan ne forca afro 4.000 veta. E pushtuan dhe vazhduan, me humbje per 'ta, perparimin deri ne krahinen e Tomorrices e Skraparit. Ketu, pikerisht si ne Kamje, u thyen dhe u detyruan te terhiquen.

Operacioni i tyre kunder Drashovices. Vazhdoj per njezet dite. Humbjet gjermane kane qene nga me te medhate, por Drashovica u shkel e tera dhe raprezantet ishin te medha. (Koha e luftimeve: ne mos gaboj aty nga dhkatori 1 1943).

Operacioni kunder Kurveleshit. Penserit u zhvillua nga dhjtori 1 1943. Forca gjermane: afro 3.000 vete. Ofensiva gjermane ne kete zone ka qene shume e shpejtte. Ata nuk arriten te shkelin tere krahinen. Ka qene me teper nje rad se sa nje operacion spastrimi. Nuk pesuan humbje te medha por as suksese nuk korren.

Nga keto operacione gjermanet paten sukses vetem ne Diber, Peze, Garmenike e Shepat dhe deri diku Moker. Ne zonat e krahinat e tjera, suksesi i tyre ka qene shume i perkoheshem. Forcat partizane, efektivat e tyre, mbeten te paprekura. Gjermanet kuptuan se pikerisht kjo ishte edhe ~~vetem~~ vatra e rezistences dhe aktivitetit partizan. Prandaj, ne janarin e 1944-es, ata filluan operacionin e tyre te pergjitheshem kunder krejt Jugut: Korces, Beratit, Gjirokastrës dhe deri diku disa zonave te Vlores. Per kete qellim sulllen trupa nga Greqia e Jugosllavia. Operacioni kunder Jugut u nis nga shume drejtime: Nga Korca, Greqia, Beratit, Vlora. Zona qe duhesh shkelur nga gjermanet ishte tere maltesite e brendis se jugut. Ky operacion zgjati per ndonje muaj. "ane mare pjese ~~mbet~~ te pakten 15.000 ushtarë gjermane (shumica alpine) dhe si forca ndihmese te gjitha cetat e Ballit kombetar, dhe shumica e njesiteve te gjindameris shqiptare. Ky operacion eshte permendur, ~~kur~~ kur mbaroj, edhe ne komunikaten e Kuartierit te pergjitheshem gjerman. Nga ana partizane kane oren te gjitha trupat e ushtrise nacional-clivimtare (thom te gjitha, sense ne Veri, ne kete kohe, forca e armatosur partizane ishte zero).

Gjate ketij operacioni jane zhvilluar luftime te ashpra ne "Kullat e Gjer-gjeices" (qarku i Korces), ne Bofnje te Dusharit (Idem) ne qafe te Gjarprit (idem) ne Tenden e qypit te Skraparit (Berat qark), ne Kurvelesh (Vlore) ne disa krahina te Gjirokastrës, etj. Kudo, ne perjashtime te pakta, si ne Tenden

SECRET

SECRET

e Qypit, forcat partizane jane thyer. Relativisht me zonat qe shkelen, grykat qe kaluan dhe terrenin shume te papeshtateshem per ta, gjermanet nuk pesuan humbje te medha; por po ashtu edhe partizanet. Kur e shikonin ngushte, keta shpe- rmdaheshin dhe bashkoheshin ne nje vend tjetere. Sidoqofte, rezistenca ~~me~~ parti- zane ne disa pika kyqe (si ne qafe te gjarprit, tende te qypit, etj.) ndaloj ose ndrepriu fare avancaten gjermane, keshtu qe plani i rrethimit te tyre me xhepe - xhepe, deshtoi dhe efektivat partizane i shpetuan rrethimit duke ruajtur ~~shum~~ materialin e gjalle (njerezit). Humbjet partizane kane qene te medha ne material. Krejt depot e tyre u hodhen ne ere, po ashtu edhe nje radiostacion ilegal qe ish- te duke u ngritur nga Partia (Radiostacioni i Korces qe u rrenbye gjate kapitul- llimit te Italis). Krejt rjeti telefonik qe funksiononte ne Juge nga partizanet u derrua nga gjermanet. Me gjith kete, rezultati i ketij operacioni muk qe *shume* pozitiv per gjermanet. Dogjen, vrane, por fill pas largimit te tyre, ushtria nacional-clirimtare rifitoi me nje here zonat e humbura, shtoi se tepermi efek- tivat e saj dhe e shtriu perseri token e cliruar deri ne vijat qendrore te ko- munikacioneve ushtarake gjermane. Bile, qe ne prillin e 1944-es, ajo nderpreu fare rrugen Tirane-Korce, me pushtimin e Pogradecit (duke sulmuar dhe dbuar garnizonin e vogel qe kishin lene gjermanet), rrugen Vlore-Gjirokaster (duke pushtuar Permetin), etj.

Gjate krejt pranveres se vitit 1944 inisiativen e luftimeve e muaren parti- zantet dhe arriten te korrin suksese te mira:

Luftimet ne rreze te Korces (operacion gjerman qe deshtoi per te celur rru- gen e Pogradecit). Luftimet e Elinit (tjeter operacion krahnor gjerman qe desh- toi dhe qe kish qellin, nga krahu tjetere, celjen e rruges Elbasan - Pogradec - Struge). Clirimi i Gjirokastrës, etj. Me pranveren e 1944, partizanet kishin ^{ne} kontrollin e tyre thujse po ato toke e vija komunikacioni qe kishin edhe pas kapitullimit te Italisë, ndofta me teper ne Juge por shume me pak ne ^Veria.

Prandaj, ne majin e 1944-es, gjermanet sjellin perseri trupa nga ^Ureqia e Jugosllavia dhe fillojne operacionin e tyre te dyte te pergjitheshem kunder ^{- papesmend gjithashtu ne komandimenten e perditeshme te Korce qe i larte operuan} Jugut. Ky operacion (filloj nga po ato drejtime qe filloi edhe i pari. Efektivat gjermane ishin me te medha, por kualiteti i tyre shume me i ulet. Nuk qene me trupat e zgjedhura alpine te dimrit. Ne keto trupa kish gjermane, italiane, armeniane, poloneze, franceze. Kollona qe filloi sulmin nga Struga e jugoslla- vise u ndal ne ^Kamje dhe u thye, duke u terhequr. Kollona e nisur nga Elbasani

SECRET

SECRET

u sulmua ne prite kur ish duke kaperxyer shkumbinin dhe u thye me humbje te medha, duke u terhequr ne pozitat e nisjes. Kollona qe hyri nga Verisa, u godit ne ~~Raxhill~~ lumin Devoll, afer Gjnikasit dhe aty u ndal. Avancoj kollona e nisur nga ~~Kax~~ Pogradeci me drejtim Skraparin, kollona e Korces me drejtim Beratit, kollona e Beratit me drejtim Kolonjen, etj.

Ky operacion ishte nje red dhe jo ofensive e regullt. U shkelen disa fshatra ne u ndodhen ne rrugen e ketyre kollonave gjermane, u dogjen, u vrane disa fshatare por ne fund te fundit, partizanet muk pesuan as humbje materiale, as humbje ne njerez.

Fakti eshte se pikerisht kur ishte ne zhvillim e siper ky operacion gjerman, divizioni i pare qe ndaloi perparimin e kollonave gjermane nga Shqiperia e mesme drejt Korces, jo vetem qe ndali avancaten gjermane, por kaperxeu Shkumbinin ne formacione shume te regullta dhe u hodh ne Veri, duke zhvilluar me sukses:

- a) Luftimin per clirimin e Dibres (duke i dbuar gjermanet.)
- b) Luftimin per clirimin e Zabzunit (duke thyer gjermanet ne Homest.)
- c) Luftimet per clirimin e Peshkopise (duke i dbuar gjermanet.)
- d) Luftimet kunder bairaktareve te Knutes, Lures, Mirdites, ~~Kix~~ Lures, etj.

Ne kete mes muk tibat hapuar se eshte koha kur gjermanet e kane te humbur terruan dhe mendojne vetem te terniqen nga Ballkanet (vere e 1944-es). Ata muk kishin me forca disponibel ne Shqipwri qe te mereshin me ndjekjen e disa cetave fantazme ne malet e Shqiperise (qofte te ^{te cilat ceta} veriut, qofte te Jugut), ~~q~~/sa here e shikonin ngushte e linin fushen e luftes dhe cdukeshin. Gjermaneve u interesonte ne kete koha vetem mbajtja e disa rrugeve, ose korridoreve, per terheqjen:

- a) Vlore-Tirane-Shkoder- Jugosllavi.
- b) Kerce-Manastir- Kosove. (Jugosllavi)

Keto korridore, ata i kane mbajtur deri ne minuten e fundit, me kaposalde te aty-ketyshme si: Tiranen, Shkodren/ Kuketin.

Luftim i vacante dhe i rendesishem ne gjermanet ne kete periode te fundit ^{a partizaneve} eshte vetem beteja per Tiranen. Forcat partizane qe muaren pjese: Divizioni i I-re dhe disa Brigada autonome, se bashku me Divizionin e IV-te.

Fati i betejes se Tiranes (luftes neper rruget) u vendos nga beteja qe u zhvillua midis partizaneve dhe gjermaneve (bishtit te prapavijes se tyre qe vinte nga Greqia) ne Krabe, midis udhes Tirane-Elbasan. Ne kete beteje, gjermanet pesuan humbje shume te medha. Tere armatimi dhe furnizimet e kesaj prapavije te fundit gjermanegrane ne duart e partizaneve. Ne Krabe u vrane ose plagosen

SECRET

SECRET

ose zune rober lart nga 1500 gjermane. Tirana i ka kushtuar me teper humbje se cdo beteje tjeter ushtrise nacional-clirontare; jo ne Krabe, por brenda ne qytet. Partizanet as taktiken as armatimin e nevojeshem per luften e qyteteve nuk kihsin. Ata ishin te mira per prita, por jo per lufte shtepish, ~~xxxxxxx~~ rrugeshe. Pastaj, eshte e natyreshme qe ay qe sulmon ne qytet, peson kurdhare humbje shume me te medha se sa ay qe eshte ne difensive, si gjermanet, i mbyllur ne fortine.

Per marrjen e Shkodres nuk eshte bere asnje lufte.

Per marrjen e Korces jane hedhur vetem disa pushke nga partizanet, pasi u terhoqen gjermanet, sepse t'i sulmonje gjermanet brenda Korces do te thosh qe ta destanonje kete qytet me shkaterim te plote.

Kjo taktike eshte ndjekur nga partizanet edhe ne Vlore, Gjirokaster, Kukes.

Shenim: Shifrat qe jap ne kete pyetje jane te gjitha me rezerva. Diku mund te kem vene me shume, diku me pak. Po ashtu me rezerva jane edhe emrat e luftimeve: jo sepse i kam dhene gabim, por sepse mund te mos i kem vene te tera. Ku mbahen mend pas 15 vjetesh.

pp Perioda e trete: Fiklon qe nga nendori i vitit 1944 dhe shtrihet deri ne mu-
ajin maj te vitit 1945, domethene deri ne dorezimin pa kushte te Gjermanise. Gja-
te kesaj periudhe, trupat partizane shqiptare nuk zhvilloje luftime kunder gjer-
maneve ne vendin e tyre (sepse keta jane terhequr) por ne token jugosllave. Kete
trupa partizane perbeheshin nga dy divizione: Divizioni i V-te dhe ay i VI-te.
Efektivat e ketyre dy divizioneve kane luftuar kunder gjermaneve ne Mal te Zi,
ne Kosove, ne Serbi. Enra nuk mbaj mend per di se mjaft qytete ne Bosnje dhe Ke-
sove e Mal te Zi jane cliruar me lufte nga repartet e ketyre dy divizioneve. Mba-
rimi i luftes i gjeti ne zemren e Bosnje-Herzegovines. Me mbarimin e luftes keto
dy divizione u kthyen ne Kosove, ku u mbar me armatimin e popullsis shqiptare
dhe mbajtjtjen e rendit. Kjo eshte bere me kerkesen e Titos, mbasi shqiptaret e
Kosoves nuk u dorezonin as armet, as qytetet pa lufte trupave partizane jugoslla-
ve. Divizionet shqiptare, me flamurin shqiptar, e kane bere si jo me mire punen
e Titos.

SECRET

SECRET

PERGJIGJE PYETJES XVIII-te.

Mbi organizimin e "Ballit Kombetar": (Cilet kane gene organizatorët e tij, cilet ekspozimet kryesore, pershkrimi i ketyre. Sa anetare afersisht numuronte kronologjikisht. Ne cilat krahuina vepronte. Cili ka gene pergjithesisht aktiviteti i tij. Cilat kane gene luftimet kryesore me okupatorët dhe levizjen nacional-clirimtare. Cilat jane aresyet per te cilat deshtoi).

Kane kaluar me teper se 12 vjet qe nga koha kur eshte organizuar Balli Kombetar. Personalisht nuk kam gene as anetar, as simpatizant i kesaj organizate. Pikerisht per kete, te dherat e mia, persa i perkjet perberjes se kesaj organizate, ekspozimeteve, etj. do te jene te pakta. Dhe jo vetem te pakta, por me shume rezerva. Aresyet jane te kuptueshme. Shumicen e krereve te kesaj organizate as qe i kam pare ndonjehere. Emarat e tyre jane cdukur nga skena politike ne Shqiperi, ketu e ne teper se 10 vjet perpara. Lidhjet e mia me 'ta, ndryshe nga lidhjet e mia me Partine komuniste dhe ekspozimet e kesaj, kane gene zero. Sidoqoft, thom ato qe di.

Balli Kombetar, si organizate politike, u krijua nga individe nacionaliste, me pikepamje dhe idera jo fare te perbashketa. Zakonisht, organizatorët e tij kane ata nacionaliste shqiptare qe e kuptuan lodren e Partise komuniste, dhe nuk pranuan neneshttrimin e tyre tek kjo e fundit duke hyre ne radhet e Frontit Nacional-Clirimtar. Inisiativa per organizimin e Ballit Kombetar u mular nga:

a) nacionaliste antizogiste qe ndodheshin ne Shqiperi perpara 1938-es. Si: Mid'hat Frasherit, Fazli Frasherit, ~~Safet Butka~~ Hasan Dosti, Kol Tromara, ~~Libohova~~ ~~(Libohova)~~ ~~(Libohova)~~, etj., qe te gjithë elemente intelektuale, me nje te kaluar politike dhe me influence ne ~~xxxxx~~ sferat e larta te shoqeris se atehershme shqiptare;

b) nacionaliste antizogiste qe ndodheshin ne emigracion gjate regjimit te Zogut, dhe qe u kthyen pas 7 prillit 1939 ne Shqiperi. Si: Ali Kelcyra, Beqir Valteri, Bahri Omari, Koco Muka (i), Skender Gami, ~~etj.~~ ^{Jefan Ohri} etj. qe te gjithë, si te paret, elemente intelektuale, me te kaluar politike dhe influence ne sferat e ndryshme te shoqeris shqiptare.

c) disa intelektuale demokrate nacionaliste, pa te kaluar te gjate politike, ~~xxxx~~ zakonisht bij bejleresh e pasanikesh qytetesh, me influence ne rethet e avancuara te shoqeris se larte te atehershme shqiptare, si: Zef Pali, Safet Butka, Abaz Ermenji, etj./ zakonisht elemente me te rinj nga mosha se ata te dy kategorive te para.

SECRET

SECRET

- 85 -

d) Disa pronare te medhenj tokash, bejlere ose feodale, pa te kaluar politike, te cilet i trembte programi dhe vete Partia komuniste, si Bicakciu, Maliq Bushati, etj.

Shume nga keta eksponente te Ballit Kombetar dhe organizatore te tij, nuk jane me ne jete. Disa vdiqen nga vdekje natyrale brenda Shqiperise ose ne emigracion, disa te tjere u vrane gjate luftes (si Safet Butka, dhe te tjeret u denuan me vdekje nga gjyqet qe u zhvilluan pas "clirimit" ne Shqiperi, si Bahri Omari, ^{Beqir} Valteri, Mahy Bushati (?), Fazlli Frasherit, Jofan Chri.

Ata qe kane mbetur akoma te gjalle ne emigracion, nuk di c'bejne. Di vetem kete, sepas pas disfates se plote te Ballit dhe arratisjes se eksponenteve te kesaj organizate (ata qe munden) nga Shqiperia ne Itali e gjetiu kur e muar pushtetin ne Tirane komunistet, shumica e ketyre figurave vazhduan jeten politike, disa duke qendruar ne radhet e Ballit (i cili nderkohe ka pesuar spastrime te medha), disa te tjere duke krijuar parti me vete, disa te tjere duke kaluar ne organizata te tjera.

Shenime biografike mbi ~~kat~~ figurat qe organizuan Ballin Kombetar, nuk di. Dijenit e mia jane aq te pakta sa nuk ia vlen barra qirase te merem ketu.

Mbi numurin e anetareve qe ka pasur, sipas periodave te ndryshme kjo organizate, nuk di c'te thom. Zaten, Balli Kombetar as strukture organizative te percaktuar x/ka patur, as organizata baze, asgje. Brenda kesaj organizate ka sunduar e plotfuqishme, gjate gjithes kohes se luftes, anarkia feodale organizative. Kam bindjen se edhe vete Mit'hat Frasherit, kryetari i Ballit Kombetar, po te ronte dhe te pyeteshe tani mbi numurin e antareve qe numuronte Balli Kombetar krenologjikisht, nuk do te dinte c'te thoshte.

Dhe tani qe mbarova me anet/panjohura per mua te kesaj pyetjeje, kaloj ne ceshtjet ku mund te thom dicka me tepar, ne historikun e Ballit kombetar pergjithesisht, ne rrugen qe kaloj dhe proceset qe pershkei gjate viteve te pare te ekzistences se tij; perpara se te pesonte disfaten dhe te merrte arratine.

Per arsye sqarimi, historin e Ballit kombetar do ta ndaj ne kater peri-oda.

Perioden e pare do ta quaj: Periode pregatitore.

Perioden e dyte do ta quaj: Periode fillestare.

Perioden e trete : Periode e izolimit.

Perioden e katert : Periode e disfates.

SECRET

SECRET₈₆

PERIODA PREGATITORE.- "Balli Kombetar" del si organizate politike ne Shqipëri aty nga fundi i vitit 1942, nje vit pas themelimit te partise komuniste dhe nje stine pas krijimit te Frontit Nacional-Clirintar.

Deri atehere, kreret e kesaj organizate ekzistonin si nacionaliste individuale. Ata ishin mare tere kete kohe te vlereshme, kur Partia ish hedhur ne aktivitet te gjithemeshem e veprimtari aktive, me nje aktivitet jashtezakonisht paste, e qdotes me bisedime akademike ne tri drejtime:

a) midis tyre, domethene lart, per te rrene dakord me njeri tjetrin, per te percaktuar radhen e hierarqise, per te kenaqur ambicjet personale te ketij ase atij personi, per te pajtuar pikepamjet politike dhe programatike, etj.. Shkurt, ate qe grunet komuniste ne Shqipëri bene, nen diktatin e delegateve jugosllave, brenda disa mbledhjeve qe zgjaten me je ne shume se disa dite, keta elemente, me te semure se komunistet nga grindjet, ~~konflikte~~ ambicjet dhe tarafet personale, me pikepamje akoma me te ndryshme, bene vite te terax qe ta realizonin.

b) me perfaqesues te Partise komuniste shqiptare, kurdehere si individë, me qellim qe te shikenin me mire kartat dhe qellimet e Partise, para se te angazheshin me nje bashkepunim, pasejat e rrenda te te cilit i kishin parasysh. Rezultati i ketyre bisedimeve, dihet. Ate deshtuan. Dhe pikerisht si rezultat i deshtimit te ketyre negociatave u krijua si organizate independente nga Partia dhe Fronti nacional-clirintar (vegël e Partise), organizata e Ballit Kombetar.

c) me te njehur e miq personale, peshte, me qellim qe t'i afronin keta ne veshtrim te aktivitetit te mevoneshem te organizates se tyre, qofte ne mal, qofte ne qytet.

Deri ne fund te vitit 1942, pra, Balli kombetar, per arsyen e thjeshte se nuk ekzistonte akoma si organizate politike, nuk kish asgje pozitive ne aktivin e tij veprues. As nje trakt, as nje atentat, as nje aksion sabotazhi, as nje perpjekje me arme, asnje cete - asgje. Ky bagazh i varfër dhe dalja ne skene me vene se e kesaj organizate, ne nje kohe kur partia kish mare situaten dhe inisiativen, nuk mund te mos kish pasoja te hidhura per Ballin kombetar ne te arthmen.

PERIODA FILLESTARE.- Zgjatet qe nga fundi i 1942 (domethene qe nga dalja ne skene e Ballit kombetar) dhe shtrihet deri ne verën e ~~muajit~~ vitit te arthme 1943. Gjate kesaj periode Balli orvatet te fitoje kohen e humbur. Sidoqofte, sukseset e tij neper qytetet jane zero. Rinia, forca e gjalle e qyteteve, qofte kjo intelektuale, qofte puntore eshte lidhur ngushte me Partine nepermajet fermave organizative te Rinis komuniste. Balli nuk mundet ta shkepute. Popullsia e mocme, gjithashtu

SECRET

SECRET

neper qytetet, eshte nden ndikimin dhe influencen e Partise komuniste. Nje vit e ca me perpara, pikerisht si rinia dhe gruaja, kjo mase qytetare do te shkonte pas atij qe do t'i bente apel i pari. Apelin e pare e beri partia komuniste, pikerisht per kete kjo mase ish lidhur me 'te'. (Nuk duhet harruar ne kete mes se opinioni publik shqiptar ish deri atehere karte e bardhe. Pse e sepse ne tere te kaluaren, Shqiperia nuk kish patur asnjë parti politike, as tradita politike). Ndryshe nga qyteti, ne kete periode, Balli regjistron disa suksese ne fshataresine. Pse e sepse e favorizojne miqesite, tarafet, influenca e kreteve te Ballit kombetar mbi nje pjese te parisë krahinore. Keshtu krijohen disa ceta balliste. Ne krye, vjen qarku i Elbasanit (krahina e ~~Vllores~~ Verçes, e Rajces, e Gernikes se Zeze). Ne qarkun e Durresit, konditat gjeografike nuk lejojne ekzistencen e cetave te armatosura. Ne ~~Dibër~~ Peshkopi, influenca e madhe e Haxhi Lleshit dhe e tarafit te tij behen pengese per krijimin e cetave balliste ne kete periode. Ne tere krahinat e tjera te Veriut, Balli kombetar nuk zhvillon asnje aktivitet te organizuar. Me ane te lidhjeve personale, kreret e Ballit afrojne disa bajraktare, por nuk bejne asgje per t'i organizuar ata ushtarakisht. Ne kete periode, Balli korr disa suksese edhe ne qarkun e Vlores (sidomos krahina e Borshit), ne ate te Gjirokastrës (sidomos krahina e Tepelenes), ne ate te Beratit (sidomos krahina e Tomorices), ne ate te Korces (sidomos krahina e Kolonjes), ne qarkun e Tiranes (sidomos krahina e Lushnjes).

Ne krahasim me FNC, balli paraqitet keshtu, persa u perket forcave te armatosura, ne kete periode:

Ne qarkun e Shkodres, ka njesite partizane, sado te vogla, por asnje ceta balliste.

Ne qarkun e Kukesit ka njesite partizane, shume te vogla, por asnje te Ballit.

Ne qarkun e Peshkopise: Predominojne njesitet partizane.

Ne qarkun e Elbasanit : Balli ka me tepër se sa Fronti Nacional Clirimtar.

Ne qarkun e Beratit : Forcat jane gati te barabarta, ~~me~~ ndofta me ne predominance te vogel partizane.

Ne qarkun e Durresit : Ka njesite partizane por jo ceta balliste.

Ne qarkun e Tiranes: Ka njesite nga te dy palet, por predominojne partizanet sepse kontrollojne Pezen.

Ne qarkun e Gjirokastrës: Te dy palet kane forca, por epersine e kane partizanet.

SECRET

SECRET

- 88 -

Ne qarkun e Vlores: Te dy palet kane forca, por epersine e kane partizanet.
 Ne qarkun e Korces: Te dy palet kane forca, por epersine e kane partizanet.
 Sidoqofte, duhet te shtoj se epersia partizane, ne kete periode, nuk ishte absolute ne asnje qark. Si sasi, ballanca anonte ne pergjithesi nga partizanet, por jo ne nje mase shume te theksuar. Mirepo si cilesi, si disipline, si organizim, si forca e gjalle e luftarake, epersia e njesiteve partizane ~~nuk~~ ishte absolute, dermuese, mbi ate balliste.

Qenia e ketyre dy forcave te armatosura, partizane e balliste, "jo te bashkuara, gati kundershtrare qysh ne fillim, nuk mund te mos lindte konfliktin. Ky konflikt do te shperthente pa tjetër ne nje kohe, duke degjeneruar ne nje lufte vllavrasese; po qe se nuk bashkoheshin.

A ishte i mundur bashkimi personalisht kam bindjen se nje bashkim real, dhe jo nje neneshtim i njerës force tek tjetra, ishte i pamundur. Partia komuniste, ne pozita me te shendosha, nuk mund te pranonte kurre uljen e saj ne nje rang me Ballin kombetar. Nga ana e tjetër, Balli kombetar ishte shume veshtire te pranonte neneshtimin e tij tek Partia komuniste (sepse ne fakt, komunistet keshtu e kuptonin "bashkimin"). Ne keto kondita, pra, per deri sa as njera nga te dy palet nuk mund te bente koncesione ne kete fushe vendimtare, konflikti i armatosur midis te dy forcave ushtarake (balliste e partizane) ishte i paevitueshem.

Opinioni tim eshte ky: Sa me shpejt te provokoheshe ky konflikt, aq me mire do ish per Partine komuniste. Sa me von, aq me ne favor te Ballit kombetar. Pse?

a) sepse Balli, gjate kesaj periode, po i shtonte forcat e tij me nje rithme me te shpejte se sa rithmi komunist. Ne fakt, nuk duhet harruar se cetat balliste duallen me fillimin e 1943. Komunistet kishin nje avance prej nje viti.

b) sepse Balli, ~~gjate~~ kishte nevojë absolute t'i forconte organizativisht njesitetin e tij bashibuzuke, te mjafta ne sasi, por pa asnje vlefte si cilesi.

Me gjith kete, Balli Kombetar, ne kete fushe, veproi rrembyeshem. Ay ra pikrisht ne pozitrat ku deshja ta shtynte Partia komuniste, duke mare inisiativen e konfliktit te armatosur, - shkurt duke iu pergjegjur provokacionit komunist.

Rezultati i keti konflikti te armatosur, nuk vonei te dukeshe. Zona e kontrolluar nga ballistet u zvogelua; njesitet e armatosura te tij shpartalleshin nga ne odo luftim, ~~ne~~ partizanet. Puna ideologjike ishte aq e debet ne ushtrene balliste, sa qe pjesetaret e kesaj ushtrie dezertonin sa here t'u tekeshen. Ne keto kondita, rekrutet e rinj vullnetare preferonin te shkonin me mire me ate pale qe dilte fitimtare, se sa me ate pale (demithe balliste) qe mundeshe.

SECRET

SECRET

Mbarimi, pra, i kesaj periode, domethen fundi i veres 1943, e gjen Ballin Kombetar ne pozita jo te favoreshme, dhe me ~~xxix~~ perspektiva akoma me te errreta. Te mbash nje gje qe ke, eshte shume me kollaj se sa te rrmabesh ate te tjetrit. Kjo ndodhi edhe me Ballin. Gjate perpjekjeve me partizanet (te para), ay humbi shume nga zonat e tij (e rjedhimisht edhe burimin e ketyre zonave ne njerez); t'i rrembente pas ketej nga partizanet, do ish akoma me veshtire aq me teper sepse ~~xxxxxx~~ njaft nga forcat e tij dezertuan. Gradualisht, por sistematikisht, Balli ishte i destinuar, qe nga kjo kohe, te mbylleshe perher e me teper ne zona me te kufizuara gjeografike, te humbte per here e me teper forca te gjalla ne njerez.

PERIODA E IZOLIMIT.- Fillon me vjeshten e 1943 dhe mbaron nga fundi i veres 1944. Dihet se ne shtatorin e 1943, trupat italiane ne Shqiperi kapitulluan. Partizanet e cfrytezuan ne maksimum kete situat te favoreshme per 'ta. Zgjeruan zonat nen kontrollin e tyre, u armatosen mire dhe i dhane disa geditje te renda te tjera ushtarake Ballit. Pozita e ketij te fundit ish bene deshoeruese. Per te ristabilizuar situaten, sepse vete me forcat e tij ishte i destinuar te falimentonte qe atehere, deshi s'deshi, ^{qella} u lidh me gjermanet. Njesitet balliste lane ~~xxx~~ shumicen e zonave te tyre qe u kishin mbetur dhe hyjten neper qytetet, ku sundonin gjermanet. Keta iu dhane armatime dhe i perdoren si trupa ndihmese. Per nje kohe te shkurter, iu lane edhe mbajtjen e rendit neper qytete (Korce, per shembull). Keshtu, te armatosura dhe te perkrahura nga gjermanet, trupat e Ballit Kombetar ndihmojne repartet gjermane ne operacionin e tyre te dimrit 1943-1944 me qellin qe te rifitojne zonat e humbura. Ferball ~~remarteva~~ gjermane ne operacionin ne kete ofensiva, trupat partizane u tashkruan nga shum krahina te tyre. Ne keto krahina u rivendosen ballistet, ngriten spitale, komanda ushtarake, etj. Mirepo qendrimi i tyre ishte shume i shkurter. Gjermanet, pasi shkelen dhe pershkuan krejt Shqiperin e Jugut qe ish nen influencen dermuese partizane, i hoqem ^{ndeshmuese-operative} trupat e tyre nga Shqiperia ne Greqi-Jugosllavi. Partizanet qe ishin futur vrimeve gjate kesaj kohe, rikthehen me forcat e tyre te paprekura dhe ne disa perpjekje te vogla i dbojne perseri ballistet. Situata ~~gthehet~~ shume shpejt, ne gjendjen e mepzreshme. Per, jo ne te gjitha qarqet. Partizanet fitojne ato qe humben dhe dicka me teper ne qarkun e Korces, Beratit, Vlores, Gjirokastrës. Ne Elbasan, Diber dhe Tirane, ku ne perpara kishin baza te tyre te rëndësishme, ~~kom~~ komunistet kane falimentuar si force ushtarake. Balli e cfrytezon kete situat vetem ne Elbasan,

SECRET

SECRET

duke forcuar organizativisht njesitet balliste dhe duke i shtuar. Ne Diber e Tira-
ne gati nuk ben asgje. Ne qarqet e tjera te Veriut, as qe can koken te organizoje
dicka.

Kete gabim trashanik Balli kombetar e pagoi shtrenjt. Ne fakt, qe ne veren
e 1944, Partia komuniste gon ne Veri, nga Ugu, Divizionin e I-re sulmues (Brigada
e IV-te, e V-te, e I-re). Vetem ne kete divizion, komunistet sundojne krejt si-
tuaten ne Veri dhe behen praktikisht zoter te vendit. Bajraktaret balliste, pa
forca te organizuara, u zune ne befasi. Po ashtu edhe bajraktaret legaliste. Cetat
balliste te Elbasanit shpartallohen qe ne goditjet e para; Forca tjetere organi-
zuar, thjesht balliste ne Veri, muk ndeshen partizanet. Ata kane ndeshur ne trupa
bashibuzuke, te padisiplinuara, te mbledhura shpejt-e-shpejt nga individe feodale
por keto forca muk qene ne gjendje t'i rezistonin disiplines, kombativitetit, dhe
armatimit te Divizionit te pare.

Perioda e trete, pra, ne historine e Ballit kombetar, periode izolimi, per-
fundon ne nje perspektive te vetme te afert: disfaten totale jo vetem ushtarake
te Ballit, por, per pasoje, edhe politike.

PERIODA E DISFATES TOTALE.- Përfshin muajt qe shtrihen nga fillimi i vjeshtes
1944 ne fund te nendorit 1944. Eshte perioda kur Balli, praktikisht, mbetet pa
force ushtarake. Njesitet e tij shperndahen, kthehen neper familjet ose marrin
rrugen e arratise, prapa autokollonave gjermane. Disfata ushtarake eshte fare e
qarte dhe e pandreqeshme, dhe kjo kuptohet mire ~~me~~ nga krceret e Ballit. Ne kete
situatë, ata orvaten te regjistrojne, qofte edhe formalisht, nje fitore politike.
Bijen ne mareveshje me elemente te Legalitetit dhe mblidhen ne Preze (afër Tiranes)
ne nje konference nacionaliste per krijimin e nje qeverie, ^{mali} me qellim qe te kene
shkak dhe pretext ne te arthman, kur te clirohët Shqiperia, ^{te} kerkojne nga ale-
atët, perfaqesimin e tyre ne qeverine e Shqiperise se cliruar. Mirepo Preza (je
Peza) rrethohet, sulmohet nga partizanet dhe delegatët ua mbathin kembëve duke
lene te paprekur ~~shkak~~ dhe te shtruar darken qe do te mbyllte me sukses negociatat
e tyre. Tamam si ndodhia e Pompeut me Qezarin!

Nendori i 1944-es, domethene terheqja e gjermanit te fundit nga Shqiperia,
mbyll pa lavdi kete periode disfate totale per Ballin.

Qe atehere e deri tani, per kete organizate ka filluar nje periode e re mbi
te cilën njohurite e mija jane hic.

Kaloj, tani, ne aresyet qe percaktuan pergjithesisht disfaten e Ballit:

SECRET

SECRET

Keto aresye do t'i ndaj ne dy grupe:

- a) shkaqe organizative;
- b) shkaqe politike.

ORGANIZATIVE.- Gjate tere historis se tij, Balli kombetar ka vuajtur nga mungesa e organizimit. Ne 'te kish bere fole anarkia feodale. Analizoj nje per nje ato shkaqe qe me jane dukur me te rendesishme te kesaj natyre:

1/ Balli kombetar delli me vonese te pajustificuar ne mal, me vonese te pajustificuar si organizate politike, me vonese te pajustificuar si program. Kur Balli delli ne skenen politike te Shqiperise, Partia komuniste e kish mare situaten ne duart e veta.

2/ Kreret e kesaj organizate nuk ishin elementet dhe personat qe kerkonte situata. Situata qe revolucionare. Duheshin njerez te aksionit, energjike, te inisiativave te guximshme. Shumica e krereve te Ballit qene njerez biblioteke. Ata dinin metodat e luftes dhe te aksionit qe mund te jepnin rezultate ne kohen e shembjes se Perandoris otomane, ketu e l/p shekulli me pare; ata as qe u orvaten qe mund te ckeputen nga keto metoda te vjeteruara dhe/te jkaluara nga koha. Ata nuk pane se ne shoqerine shqiptare, vitet e fundit, qe bere nje ndryshim i madh social.

3/ Balli kombetar dhe kreret e tij sidomos nuk kishin eksperiencen e luftes ilegale te qytetit. Dhe qyteti, sikurse dihet, ushtron influencen e tij te madhe mbi fshatin. Kete plus te madh qe kishin komunistet (te fituar nga eksperienca e punes ilegale ne kohen e grupeve) e injoronin udheheqesit e Ballit. Organizimi i tyre neper qytetet, ka qene zero.

4/ Ballit kombetar i mungonin ne nje mase te madhe kuadröt e përgatitura te mesme, pikerisht heronjte e panjohur qe kane te bejne direkt me aksionin. Partia komuniste, sadoqe me nje numur antaresh te kufizuar, kishte me dhjetra e dhjetra komisarë politike, puna praktike dhe ideologjike e te cileve ne mal ishte vendimtare. Kuadröt zgjidhin cdo gje. Idete, teorite, planet jane vetem programe ne leter.

5/ Balli Kombetar, si organizate ne vet'vete ishte amorfe, pa strukture, pa organizata-baze. Nje shtab qe eshte i organizuar vete nuk mund te udheheqe dhe organizoje masat poshte.

6/ Tere puna e Ballit bazoheshë ne tarafet dhe miqesite. Komandantet e njehsiteve te tyre ishin ne keto post jo sepse qene ushtarake, por sepse kishte lidhje

SECRET

SECRET
- 192 -

far' e fisi me ndonje eksponent. Ballisti i ~~fuqit~~ bazes shkonte pas eprorit te tij jo sepse ishte bere nje pune ideologjike me 'te, ~~xxx~~ jo sepse e deshte Ballin por sepse e kish mik ose taraf filan komandant, filan figure te "allit. Po te ndronte mesalle ky komandant, ndronte edhe ballisti i bazes.

7/ Disiplina e "allit qe nje discipline karagjozi. Secilido bente si t'i thosh koka. Kjo ndodhte jo vetem poshte, por edhe ne udheheqje. Shuma te ralla ishin ato njesite te Ballit qe ~~ix~~ i bindeshin udheheqjes lart. Cdo komandant ~~ix~~ ~~ix~~ kish principaten e tij prej nga nuk largoheshe, ku nuk pranonte nderhyrjen e ballisteve ne te medhenj, ku vepronte si t'ia deshin interesat e tij personale. Ay ishte feodal ne nje anarki organizative feodale.

8/ Mungese e plote uniteti. Jo vetem poshte, por edhe lart ne udheheqje. Cdo ballist me nje fare pozite kishte programin e tij, parimet e tij, idete e tij. Ne vete Komitetin qendror te Ballit, anetaret e tij perfaqesonin secili rrymen e vet. Njeri jepte nje udhezim qe anuloheshe nga tjetri dhe anas-sjelltas-

9/ ~~ku~~ ^{balli mik} kuptoj dhe as qe veproj ne menyre qe te organizonte ushtarakisht bajraktaret e Veriut. Veriu, nga vete traditat, zakonet, perberja shoqerore, ishte nje keshtjelle ^{matkuese} e Ballit Kombetar. Balli kombetar e injoroi kete keshtjelle. Sot ka nje thenie amerikane: "ku ka nje rus, duhet te jete edhe nje amerikan". Balli veproj pikerisht keshtu. Ay ngriti njesite te armatosura vetem ne ato krahina ku ekzistonin partizanet. Pse te mos ngrinte ne Veri, ku i kish te gjitha te dhenat?

10/ Sjelljet e cetave balliste ne popull qene prej bashibuzukesh. Mungesa e kuadrove te pregatitura politike, i bente keto ceta te silleshin dendur si ceta hajdutesh e cubash mali. Si mund te fitonin simpatin e popullsis njerez qe nen pretekstin se ishin patriote e luftetare kerkonin deshinj te pjekur e byreke te mbytur ne gjalpe?

11/ Balli kombetar, ne analize te fundit, injoroi fare punen ne shtresat e ndryshme te popullsis: as nje forme organizimi per rinine, asnje forme organizimi per gruan, asnje forme organizimi per moshataret.

POLITIKE. Pikerisht si ne ceshtjet organizative (zaten si rjedhim i tyre) Balli kombetar ka bere gabime te renda edhe politike. Anarkia organizative shoqeroheshe nga anarkia politike. Analizoj vecmas, sipas opinionit tim, gabimet politike te Ballit kombetar gjate kohes se luftes.

SECRET

SECRET

1/ Kreret e "allit kombetar nenevleftesuan ne fillim Partine komuniste dhe levizjen e organizuar prej saj. Ata e konsideruan si nje levizje ciliminjsh, studentesh te ekzaltuar, te cilen mund ta shtinin ne dore sa here dhe kur te domin. Ata mbivleresuan jashte mases rendesin e personit te tyre dhe meritat e se kaluares se tyre. Ata mendonin se sapa te dilnin dhe te proklamonin emrin e tyre, rinia dhe populli do t'i mirdte nga pas, te zgurritur per 'ta.

2/ Agitacioni i tyre ishte i varfer dhe pa perspektiva. Vete programi i tyre nuk u premtonte asgje masave: fshataresis, rinise, gruas. Komunistet cene jashtezakonisht hovardhenj ne keteg drejtim, demagoge sharlatane dhe primitive, por parullat e tyre zinin vend ne masat e propozuara shqiptare. Opinioni tim eshte se lufta kunder okupatorit duhet te filloj ne tiber me nje te arthre me te mire. Masat duhet te terhiqeshin jo vetem ne perspektiven e nje Shqiparie te lire, por edhe ne perspektiven e nje Shqiparie te lire, te begateshme, demokratike, etj. Balli nuk duhet te ket program reformash.

3/ Balli Kombetar u tregua me nje miopi te theksuar politike edhe persa u perket maredhenieve qe duhet te kish me aleatet. Ay refuzonte edhe aksionet demonstrative kunder okupatorit, aksione te cilat ishin te demodoshme per te justifikuar, qofte edhe formalisht, ndihmen materiale te aleateve, ose me sakte te englezeve ne Shqiperi. Ay gati-gati i vinte ne nje plan maredheniet me Gjermanet dhe englezet. Opinioni tim eshte se englezet, po te kishin vepruar me takt e zgjuaresi ballistet, do t'u kishin dhene ^{shume} me teper se sa komunisteve. Mirepo ne vend qe te afroheshe tek englezet, Balli neneshkruante protokollin Dalmazzo.

4/ Antare me influence dhe krere te "allit kombetar hyjten ne qeverit e ndryshme kuislinge, si pjestare qeverish ose kryetare. Kjo taktike e gabuar, i bente objektiva te kenta per t'u sulmuar nga kundersharet e tyre politike, u humbte prestigjin dhe influencen ne popull, i mirdhte ne barrikaden e okupatorit.

5/ Balli kombetar arriti deri atje sa te beje mareshje te hapta me italianet, si neneshkrimi i protokollit Dalmazzo, me te cilin Balli angazhohesh te mos sulmonte trupat italiane ne Shqiperi.

6/ Ne analize te fundit, trupat e armatosura te "allit kombetar ~~xxx~~ u vune haptazi nen komanden gjermane dhe pushuan keshtu se qenuri, ne syt e popullit, qeta nacionaliste. Ato u bene forca bashkepuntore, si milicia italiane, xhandemaria shqiptare e gjermaneve, etj.

SECRET

7/ Balli ra ne te gjith frontin ne pozitrat ku e shtynte te binte partia.

SECRET

Shkurt, tere historiku i Balli eshte nje varg gabimesh te renda politike te nje-pas-njeshme dhe nje mori te metash organizative. Tere pluset e Partise, per Ballin kombetar ishin minuse.

Ne keto gabime politike e te meta organizative duhet kerkuar edhe gjetur edhe disfata e plote e Ballit kombetar ne lemin ushtarak, ~~me~~ ate politik dhe ne ate te mapastajme, qeveritar.

Opinionimi tim personal eshte se edhe sot e kesaj dite Balli kombetar nuk ka forca ne Shqipëri. Regjimi komunist ka kundershatare, por nuk besoj qe keta kundershatare te konsiderohen balliste ose adepte te ~~Ballit~~ Ballit kombetar. Pershtypjet e popullit shqiptar nuk e nderojne kujtimin e Ballit te vjeter kombetar dhe, mendoj, as qe e afrojne kete popull tek Balli i ri Kombetar.

SECRET

SECRET

PERGJIGJE PYETJES XIX-te
Mbi organizaten e "Legalitetit" (Shenime te pergjitheshme).

Pikerisht si Balli Kombetar, edhe Legaliteti dolli ne skenen politike me vone. Ay dolli, bile, me von edhe se Balli Kombetar, por jo me diference te madhe. ^{- bile akoma me keq -}

Pikerisht si Balli kombetar, edhe Legaliteti ka qene (nje organizate amorfe, pa strukture. Por ndryshe nga Balli Kombetar, ku qene grumbulluar zakonisht nacionaliste antizogiste, ne partin e Legalitetit qene grumbulluar ademtet dhe partizanet e Zogut. Pikerisht kjo perberje shpjegon edhe arsyen ~~perse~~ Legaliteti ekzistoi vetem ne Veri te Shqiperise. Influenca e tij ne Jug te Shqiperise ka qene absolutisht zero. Ndryshe gjithashtu nga Balli Kombetar, elementi intelektual ka qene shume i pakët ne kete organizate. Ne vija te pergjitheshme pjesetare te kesaj organizate ~~kanë~~ ^{dhe per pasoje} qene feodalet e veriut, bajraktaret, elemente jo te qarte politikisht, jo te pershtateshem per luften politike. Aktiviteti i ~~kesaj~~ ^{kesaj organi.}

20te gjate gjithë kohes se okupacionit, qofte politik, qofte ushtarak, qofte organizativ, eshte shume prapa dhe i kufizuar jo vetem ^{ne arshimin} ne Partine komuniste, por edhe nga Balli Kombetar. Disa intelektuale te vjeteruar qe ndodheshin ne krave te Legalitetit, perkrah bajraktareve feodale, nuk mund t'i jepnin kesaj organizate influencen e duhur politike ne shtresat e avancuara ose politikisht te formuara te shoqeris shqiptare te atehereshme.

Dihet se eksponenti kryesor i kesaj organizate ka qene qvsh ne fillim Abaz Kupi, njeri gjysme analfabet, matuf dhe pa asnje formim politik. Ne fillim, ky bajraktar u bashkua me partine komuniste, mori pjese ne Konferencen e Pezes, ku u hodhen themelet e "Frontit nacional-clirimitar, u zgjodh ne Meshillin e Pergjithshem te ketij fronti ne perkrahjen e Partise (e cila deshte ta lidhte pas vshites per qellimet e saj, per ta perdorur si leve), por pastaj, ne Konferencen e Labinotit, sigurisht nden ndikimin e krereve te Ballit kombetar dhe te miqve te tij zogiste (si Brok Cera, etj) u shkeput nga Partia, u largua demonstrativisht nga Fronti ^{ne} me anen e nje deklarate, dhe organizoi "partine" e Legalitetit. ^{ekzistonte}

Sikurse thashe, kjo parti ~~ekzistonte~~ vetem si eme. Ne realitet, qe nje kosh me karavidhe ku gumezhitnin kapidanet e Zogut dhe bajraktaret. Asnje strukture organizative, as nje komitet qendror te percaktuar, as nje organizate baze poshte, asnje pune propagandistike. Odo anetar i "Legalitetit" ish kryetar ne vete, komandant me vete, pergjegjes me vete. Te gjithë ishin kryetare; asnje nuk e konsideronte veten anetar.

SECRET

- 9 - SECRET

Per arsye qe dihen, Zogu nuk ka gezuar kurre simpati ne Juge. Jugë e ka urryer kurdohere kete "parvenu". Per arsye te sundimit te tij feodalo - policor, ay nuk gezonte as simpatine e qyteteve/ jo vetem te jugut, por edhe te Veriut (Shkodra, Durrresi, Elbasani). Masa e rinise, qofte kjo puntore, qofte intelektuale, e urrente. Pikerisht per kete arsye, Legaliteti nuk mund te kish influence e ndikim ne Juge, ne qytetet, ne rinine. Zogu gezonte vetem simpatin e bajraktareve te Veriut, te cileve ua ruajti privilegjet prej kasti mbasi keta qene edhe mbeshtetja e tij politiko-ushtarake. Pikerisht per kete arsye edhe influence e Legalitetit perqendrohesh vetem e vetem ne Veri, domethene ne shqerine me te prapambetur shqiptare, ne shtresat shoqerore me te feodalizuara. ~~shqiptare~~ Dihet se kurdohere forca ~~politike~~ politike e ketyre shtresave -ne odo vend te betes- eshte zero. Keto forca jane te forta vetem ushtarakisht, por jo ne kuptimin modern te fjales. Prandaj edhe Legaliteti ishte nje "parti" pa ndikim politik ne Shqiperi por me rezerva te ^{mba} ~~shqiptare~~ ushtarake.

Megjithkete, Legaliteti nuk dijt t'i cfrystezoje keto rezerva ushtarake. Ay as qe i organizoi, as qe iinkuadroi ne reparte ushtarake nacionaliste. Per kundrazi, uajft nga keto rezerva ay i shtiri ne gjindarmerine kuislinge, me shprese qe kur te permbyseshe situata me largimin e gjermaneve nga Shqiperia, te sundonte situaten nepemjet tyre. Llogari e gabuar; sepse largimi i okupatorit kishte si pasoje te paevitueshme, per situaten e atehereshme ne Shqiperi, edhe dezagregimin dhe shpartallimin e gjindarmeris kuislinge. Dhe ne fakt, keshtu ndodhi. Sikur te ~~ky~~ kish organizuar Legaliteti formacione ushtarake ne (mbasi i kish te gjitha mundesite) Veri, sikurse Partia komuniste ne Juge, s'ka dyshim se fati i regjimit te arthme ne Shqiperi mund te ishte i ndryshem nga ay i sotai.

E kam thene edhe me perpara: Partia komuniste e shkeli krejt Veriun, i demtoi bajraktaret, i shpartalloi forcat e tyre vetem, e perserit, vetem me nje divizion, efektivat e te cilit arrinin ne maksimumi, kur kapexyen Shkumbinin me 26 qershor 1944, ne 2.500 partizane! Sado paradaksale qe duket, kjo eshte e verteta. Te tri brigadat e Divizionit te pare (nga te cilat ne korrik kishin mbetur ^{ne fakt} ne Veri vetem dy: e katerta dhe e pesta, sepse e I-ra u detyrua nga goditjet qe hengri ne Fush-Allaj te hidhej per nje periode kohe te shkurter ne token maqedonase) kane shkelur me radhe: krejt qarkun e Elbasanit, krejt qarkun e Dibres, ~~krejt~~ Krujen, Lumen (ku ish Muharem "ajraktari"), Resin, Luren, Matia (ku ish Abaz Kupi), Mirditen (ku ish Gjon Marka Gjoni), etj.

SECRET

SECRET

Vete trupat e Bazit te Canes, qe ishin me te organizuarat, jane thyer me nje nate lufte, sado qe te vendosura ne pozita natyrale jashtezakonisht te forta dhe te armatosura me se miri. Ne fakt, depot e Bazit te Canes (Abaz Kupit) qe kane zane partizanet ne zonen e tij i kane sherbyer Divizionit te I-re per te vazhduar luftimet dhe operacionet ~~per te vazhduar~~ mbasi englezet refuzuan n'ate kohe t'i hedhin furnizimet partizaneve ne Veri (Aresyet jane fare te qarta).

Le te shtoj ne keto shenime te pergjitheshme mbi Legalitetin, se kjo parti, ndryshe nga Balli Kombetar, veproi me me shume takt ne lidhje me aleatet. Abaz Kupi, per shembull, ka mare njaft furnizime nga englezet. Vec kesaj, Legaliteti nuk beri gabimin e madh qe beri Balli Kombetar. Ay nuk i vuri trupat e tij hap-tazi ne sherbim dhe nen komanden gjermane. Esht' e vertete se Legaliteti nuk u beri nje lufte te hapur gjermaneve, por po aq e vertete eshte se ay nuk goditi as partizanet. Perkundrazi, ~~kur gjeten kohen dhe oren e voliteshme e sul-~~ ^{nd mbi partizanet} kuan ne befasi. A ka patur ndonje kompromis "Legaliteti" ne gjermanet? Opinioni tim eskue qe po.

Perpara se te amharohet kete pyetje le te shtoj se ne pergjithesi, Balli Kombetar dhe Legaliteti ~~ka~~ ^{kan} patur nie fare akordi midis tyre, natyrisht jo shume te pazemert e te singerte. Por fakti eshte se anticheta trupat e Legalitetit nuk jane perpjekur me trupat e allit, sikurse jane geditur trupat e Ballit me trupat partizane.

Me gjate nuk di c'te thom mbi kete parti. Por fundi i fundit nuk mendoj se ka edhe per te thene ndonje gje te madhe. Roli i Legalitetit ne kohen e okupacionit italo-gjerman ne Shqiperi ^{sado qe englezet kane bere cmos te lanqem} ka qene rol subretje-teatri. Dhe ne praktike, tere aktiviteti i tij, perqendrohet ne aktivitetin e nje hajraktar feodal ^{Abaz Kupit,} qe nuk e di te shkruaj dhe te lexoj. ~~Englezet kane bere cmos, per shembull, qe ta lancojne ate dhe partin e tij (ose te Zogut) mirepo nga pleshti, thote nje fjale popullore, nuk mirret dhjame.~~ ^{ne srenen politike shqiptere kesaj kohe si force te rëndësishme.}

SECRET

SECRET

PERGJIGJE PYETJES XX-te

Cfare takime dhe cilat mareshje jane bere ndersjet tri organizatave te Rezistences ne Shqiperi (FNÇ - Balli Kombetar - Legaliteti) gjate kohes se okupacionit italo-gjerman. Kush i perfaqesoi keto tri organizata dhe cilat kane qene rezultatet e ketyre takimeve?

Me sa di une, midis tri organizatave te Rezistences ne Shqiperi, eshte perfunduar vetem nje mareshje ne kuptimin e plote te fjales. Mareshja e Mirkjes (1943). Takime jane bere shume, por rezultatet e ketyre takimeve kane qene ne thelb fare te parendesishme.

Shpjegohen:

1 - Midis perfaqesuesve te Ballit kombetar (here Ali Kalcyra, here Hasan Dosti, here Kole Tromara, etj) dhe perfaqesuesve te Frontit Nacional-Clirintar (here Ymer Dishnica, here Mustafa Gjinishi, here Omer Nishani, here Enver Hoxha etj) jane bere shume takime sidomos nga fillimi i 1943 ne qellim bashkimit e te gjitha forcave antifashiste nacionaliste ne nje front te vetem, hartimin e nje programi te perbashket, percillimin e nje plani ne te cilin te caktoheshin rruget, raketet dhe metodat e ketij bashkepunimi. Me gjith kete, nga keto takime te here pas hereshme nuk u arrit ne asnje rezultat konkret, te gjate. Keto takime zhvilloheshin ne nivelin ne te larte, domethene ne Tirane ose Peze, midis krereve te Ballit Kombetar dhe te Partise komuniste; po ashtu edhe ne nivelin e mesme, poshte, neper krahinat, midis perfaqesuesve ~~krahinor~~ qarkore e krahinore te Partise komuniste (FNÇ) dhe atyre te Ballit kombetar.

2.- Takime midis perfaqesuesve te Partise komuniste (FNÇ) dhe perfaqesuesve, ne nivel te larte, jane bere edhe ~~midis~~ ne partine zogiste te Legalitetit. Nga keto takime eshte arritur ne nje mareshje formale, superficiale, sikurse edhe me Ballin kombetar ne fillim te 1943-44. Ne keto mareshje formale njiheshe neveja e luftes se perbashket kunder okupatorit dhe shuangia e cdo perpjekjeje midis forcave ushtarake te dy paleve. Mirepo qe nga njohja e nevojës, ~~me~~ ne forme abstrakte, e luftes kunder skupatorit dhe e evitimit te perpjekjeve vellavrasese e gjer tek zbatimi i ketyre varimeve ne praktike, ne jete, ka nje distance aq te madhe sa qe nga njohja e nje vajze se eshte e bukur/deri tek martesë me 'te. Sidoqefte, konflikti direkt dhe i hapet i armatosur midis FNÇ dhe Legalitetit, u be shume ne von se sa konflikti i armatosur Ball-Parti. Pse? Sepse njesitet e Ballit ishin ne kontakt fizik te vazhdueshem ne formacionet ushtarake te Partise, ne krejt Jugun. Ne Veri, ku kish cetat e tij te pakta Legaliteti, Partia nuk kish

SECRET

SECRET
- 199 -

gati fare formacione te vetat ushtarake. Mungesa e ketij kontakti fizik midis dy forcave te kunderta, shpjegon edhe arsyen perse konflikti Legalitet-Parti u hap me vonese.

3.- Ndërsa Partia komuniste nuk mundi te perfundoje me nje mareveshje konkrete dhe efektive as me Ballin, as me Legalitetin, keto dy organizata te tjera te Rezistences shqiptare mundën te arrijne ne mareveshje midis tyre. Konkretisht cilat kane qene pikat kryesore te kesaj mareveshjeje Ball-Legalitet.

- a) Evitimi me cdo mjet i konfliktit te armatosur midis te dy paleve;
- b) Nevoja per te ndihmuar, sipas mundesis, njera pale tjetren;
- c) Pjesemarrja e te dy ketyre organizatave ne qeverit kuislinge, ne gjindamerine kuislinge;
- d) Nevoja e luftes kunder okupatorit, por jo sa kohe qe ky ishte ne shendje te bente raprezalje te egra mbi popullsinë civile, por vetem atehere kur do te ndodheshe ne buzen e gremines dhe te katastrofes finale.
- e) Nevoja per t'u konsultuar bashkarisht, sa here qe te paraqiteshe nevoja, mbi probleme ushtarake, politike ose qendrimi ndaj Partise komuniste.
- f) Pas clirimit te Shqiperise organizimi i nje fare plebishiti per te pare formen e qeveris se ardheshme shqiptare: monarqike, apo republikane.

Me sa kam degjuar, ne mos gaboj, kjo mareveshje midis Ballit Kombetar dhe Legalitetit mori formen e saj te rrere ne mbledhjen e Zall Herrit. Por ne fakt, duhet pranuar se divergjencat e thella qe i ndanin keto organizata, ambicjet personale te kreteve te kesaj ase asaj pale, i kane kufizuar ne maksimum zbatimin ne jete te pikave mbi te cilat arriten mareveshjen.

Thashe ne fillim te kesaj pyetjeje, se mareveshje reale, konkrete, e neneshkruar regullisht dhe e aprovuar nga te tri organizatat e Rezistences shqiptare (FNQ - Ball - Legalitet), ka qene vetem mareveshja e Mukjes, neneshkruar ne vitin 1943 (vered).

Mareveshja e Mukjes- Mori kete emer sepse pikerisht ne kete katund te Shqiperis se mesme u mbledhen perfaqesuesit e Partise komuniste, Legalitetit dhe Ballit per ~~kat~~ bashkim dhe ndjekjen e nje vije te perbashket. Mbledhjen e Mukjes e kishin preceduar nje seri takimesh paraprake e pregatitore nga delegacione te te tri paleve. Puna ishte qe te odukeshin pengesat e fundit dhe te hidheshin ne leter parimet, mjetet dhe rrugët qe do te ndiqte pas ketej Fronti i perbashket Ball-Legalitet-FNQ.

SECRET

- 100 -
SECRET

Di se kryetar i delegacionit te Partise komuniste ne Mukje ka qene Ymer Dishnica, nje nga eksponentet me ne pah te Komitetit Qendror. Nga anetaret e delegacionit komunist ishte edhe Gogo Nushi, ~~Mustafa Gjinishi~~ Mustafa Gjinishi, ~~etj~~ e te tjere qe nuk i mbaj mend.

Nga pala balliste di se ka qene ne delegacion Ali Kelcyra, Mid'hat Frasherri dhe te tjere qe s'i di.

Delegacioni i Legalitetit perفشinte, midis te tjereve qe nuk i njoh, Abaz Kupin, Sterjo Spasen, etj.

Qe atehere kane kaluar afro 15 vjet. Klauzolat konkrete te mareveshjes se Mukjes (sepse u arrit ne mareveshje reale) nuk i mbaj mend. Di se ne radhe te pare qe te tri organizatat angazhoheshin te luftonin okupatorin e huaj, te mos benin asnje kompromis me 'te. Qe te tri organizatat do te shqyrtoheshin dhe konsultoheshin me njera tjetren per odo problem te rendesishem politiko-organizativo-ushatarak ne shkalle nacionale; Balli, Partia dhe Legaliteti rusin sejcila formacionet e veta ushtarake; ne te gjith vendin do te zgjidheshin keshilla te reja ku te perfaqesoheshin te tri organizatat e Rezistences shqiptare. Te tri partite angazhoheshin t'i vinin ne mihme njeri tjetrit dhe te kryenin me formacionet e tyre ushtarake aksione te perbashketa. Mbi formen e regjimit te ardheshem ne Shqiperi do te behesh nje plebishit dhe ~~xx~~ pastaj zgjedhje demokratike. Balli, legaliteti dhe Partia komuniste kishin te njejtat te drejta, dhe ne mareveshjen e Mukjes viheshin ne nje nivel. Per koordinimin e veprimtaris politiko-ushtarake-organizative u vendos te zgjidhesh nje Komitet i perbashket konsultativ ekzekutif, me perfaqesues te barabarte nga te tri palet.

Kjo ishte, ne parim, mareveshje e Mukjes. Mirepo kjo mareveshje nuk zgjati as dy jave. Para se te fillohesh nje veprimi per te vene ne praktike qefte edhe piken me te parendesishme te kesaj mareveshjeje tripaleshe, Partia komunist e deklaroi ate te pavlefshme, shpalli si te anuluar delegacionin e saj qe e kish perfaqesuar ne Mukje dhe e akuzoi Ymer Dishnicen si "kapitullant", "kompromisaxhi", "element te devianionit te djabathte borgez" qe ra ne pozitat e Ballit, tradhetoi me punen e tij Frontin Nacional-Clirimitar duke e ulur kete, qe kish nje aktiv te pasur ne aksione e forca morale e materiale shume me te medha se sa dy palet e tjera, ne nje nivel me Ballin e Legalitetin. Shkurt partia nuk desh nje bashkim real e te barabarte; ajo desh nje bashkim ku te kendonte kendezi komunist, nje bashkim ku palet e tjera t'i neneshtrroheshin programit, influences dhe autoritetit te Partise komuniste.

SECRET

SECRET

Anullimi i njeaneshem, arbitrar i mareveshjes se Mukjes nga Partia komuniste
^{Reshta,}
mbylli (praktikisht rrugen e takimeve dhe te bisedimeve te metjme midis Partise
komuniste nacionaliste
nga njera ane dhe dy paleve te tjera/nga ana tjeter.

Partia, me kete gjest, tregoi sheshit se ajo kerkonte brenda bashkimit pre-
dominencen absolute, postet kyqe.

Balli dhe Legaliteti kuptoj qarte se po mos neneshtroheshin, nuk kish bashkim me Partine komuniste.

Qe nga konferenca e Mukjes, pra, rruget e Ballit dhe te Partise komuniste
qe ecnin si dy paralele, me tendenca, sado te zbehts, bashkimi me ndonje moment
te velteshem, fillojne te largohen perhere e me teper si dy rruge pa shprese
bashkimi. Mukja, ose me mire ajo qe pasoi Mukjen nga pala komuniste, mbylli nje
etape dhe shenoi fillimin e nje etape te re: ate te luftes se paevitueshme midis
Ballit e Partise ne fillim, e me von, midis Partise e Legalitetit.

SECRET

SECRET

- 102 -

PERGJIGJE PYETJES XXI-te.Si u prit ndihma britanike qe iu dha Shqiperise fill pas clirimit.

Te dhenat e mia reth kesaj pyetjeje i kam me rezerva, per arsye se qe nga 1 marsi i 1945-es jam larguar jashte Shqiperise me detyra te ndryshme deri nga viti 1947. Sidoqofte, them ato qe di.

Ndihma e pare aleate Shqiperise, fill pas clirimit, ka qene ndihma e UNRRA-s. Mirepo ajo i eshte shperndare popullsis shqiptare nga qeveria komuniste Tiranes pa iu thene se eshte ndihme e Perendimit. Arsyerja e kesaj heshtjeje eshte e qarte. Ne 1945, Partia komuniste, qe e kish mare fuqine ne dore ne krejt vendin, kish filluar nje politike te theksuar diferencimi ne planin nderkombetar. Kjo politike diferencimi konsistonte kryesisht ne kete: Bashkimi Sovjetik paraqiteshe si i vetmi aleat besnik, si i vetmi mik i Shqiperise, si i vetmi perkrahes, mbrojtës dhe ndihmes. Fuqite perendimore te madha, ~~si dhe Shtetet e Bashkuara~~ dhe ^{si dhe Shtetet e Bashkuara} Shtetet e Bashkuara paraqiteshin si "aleate" qe ia kish popullit shqiptar ne "lesh ne bark", si fuqira imperialiste qe kishin synime grabitqare dhe qe enderonin te kthehin "te kaluaren e erret". Si vetekuptohet, nje orientim i tille ne lemin nderkombetar, i impononte vet'vetiu partise nevojen qe t'ia fshihte popullsis ndihmen e Perendimit, dhe ne rastin konkret ndihmes e UNRRA-s. Pikerisht per kete arsye, Partia komuniste shqiptare (neperajet qeveris se Tiranes) nguli kembë qysh ne fillim qe ndihma e UNRRA-s te ndaheshe ne popullin shqiptar nga organet qeveritare shqiptare dhe jo nga te deleguar ose te ngarkuar te UNRRA-s. Konform me kete vije, qeveria komuniste e Tiranes beri qysh atehere nje rezistence te madhe qe misioni i UNRRA-s ne Shqiperi te ishte me nje personel sa me ^{te} pak ~~me pak personel~~ dhe me te drejta kontrolli sa me te kufizuar ^{me} ~~me pak personel~~ shperndarjes se kesaj ndihme. Por nga ana tjeter, ajo (domethene qeveria komuniste e Tiranes) kerkonte qe kjo ndihme te ishte sa me e gjere ne automobila, traktore, artikuj veshmbathejeje, sende ushqimore, etj. Preteksti i perdorur nga Tirana ishte i lehte: Shqiperia ishte demtuar rende nga okupacioni i huaj ushatarak italo-gjerman. Se ne c'mase u realizua ~~nga~~ kjo ndihme e UNRRA-s kundrejt Shqiperise, une nuk di gjera konkrete. Por ase kohe mbaj mend se kam degjuar nga disa personalitete te Partise qe misioni i UNRRA-s ne Shqiperi, i pakenaqur nga menyra e shperndarjes se kesaj ndihme nga organet qeveritare shqiptare, nxirrte tyrlë pengesa e shkaketonte qellimisht ^{me} pengesa per t'iu shmangur detyrimeve qe kish mare persiper. "SECRET

SECRET

Por fundi i fundit, opinioni tim ishte se ky qendrim i misionit te UNRRA-s ne Shqiperi kundrejt qeveris se Tiranes nuk ish gje tjetere vecse nje pergjigje e merituar ndaj intrigave dhe mos permbushjes se detyrimeve ~~te~~ kundrejt UNRRA-s/~~ngazpalarkeuniskokshokkzox~~ (Shumica, per te mos thene krejt personeli, i misionit te UNRRA-s ne Shqiperi verbeshe nga oficeret ose eksperte britanike).

Ndihma e dyte qe iu propozua Shqiperise nga Perendimi, ishte ajo e M.L. (Nderlidhja Ushtarake - M. dhe L. jane iniciallet inglisht). Qeveria e Tiranes ishte gati ta pranonte edhe kete ndihme, me konditen qe ta shpermdante ajo si te desh, pa thene se nga kush vinte, dhe pa lejuar hyrjen ne Shqiperi te shume kontroloreve e oficerëve te huaj per mbikqyrje. Mirepo eksperiencia e UNRRA-s i mesoi shume gjera Britanise. Pikerisht per kete M.L. e lidhi paraprakisht akordin e ndihmes se tij Shqiperise me pranimin, nga pala shqiptare, te nje neni te domesdoshem; ky nen ishte qe pala shqiptare ~~duhet~~ te pranonte ne token (me duket, ne mos gaboj, njaloo vete) e saj nje mision te M.L. me nje personel te mjaftueshem, Mirepo perberja e ketij personeli iu duk Tiranes i ekzagjeruar; po ashtu i ekzagjeruar iu duk edhe kerkesa tjetere britanike qe ndihma e M.L. te kontrolloheshe nga afer prej eksperteve e teknikeve te tij. Duhet te shtoj, me kete ~~xxx~~ rast, se Partia komuniste e Shqiperise, ne kete kohe, jo vetem qe bente cmos, me presione te gjithaneshme per te kufizuar numurin e oficerëve engleze ne Shqiperi, por ne te njejten kohe kish kufizuar edhe me teper levizjet e oficerëve britanike brenda vendit. Tirana mendonte ne kete kohe se keta oficeret ishin perfaqesues te nje fuqie armike, e cila fuqi ~~xxxxxxx~~ "perpiqeshe te organizonte brenda vendit reaksionin, me qellim permbysjen me dhune te regjimit te ri".

Refuzimi i Tiranes per te pranuar komitat e M.L. ne lidhje me ndihmen e tij, solli si rezultat refuzimin e kesaj ndihme Shqiperise. Pikerisht per kete, dergesat e para te M.L. ne portet e Shqiperise, pas refuzimit te Tiranes, u kthyen perseri ~~nga qeveria shqiptare, per te shprehur~~ *aty prej ne ishin nisur. Ne vija te freshta* /Kjo ndihme konsistonte ne furnizime ~~xxxx~~ per nevojat e popullsisë, dhe ne furnizime te tjera shume te nevojshme per qeverin shqiptare e cila kish filluar nga aktiviteti per rindertimin e objekteve te shkaterruara nga lufta. Bile, me sa kam degjuar, sado qe nuk jam ne gjendje te jap shifra, kjo ndihme ishte mjaft e konsiderueshme jo vetem ne cilesi, por edhe ne sasi. *Vatkesisht nuk u zbatua.*

Hollësira te tjera reth kesaj pyetjeje nuk di.

SECRET

SECRET

- 104 -

PERGJIGJE PYETJES XXII-te

Organizimi i pare i shtetit shqiptar fill pas mbarimit te luftes. Cilat kane qene veshtiresite qe u hasen ne rruge - ekzekutimet e para sipas listave te paracaktuara.

Motori i vertete dhe i vetem ne organizimin e shtetit shqiptar fill pas mbarimit te luftes, ka qene Partia komuniste. Rruga e ndjekur prej saj ne kete periode perfshin dy drejtime kryesore te dy fusha kryesore:

- a) ne fushen e pushtetit legjislatif;
- b) ne fushen e pushtetit ekzekutif.

NE FUSHEN E PUSHTETIT LEGJISLATIF.- Qysh ne tetor te 1944-es, domethene nje muaj perpara se te cilroheshen krajt Shqiperia, ne Berat (shih pergjigjen Nr. 14) Keshilli i pergjitheshem nacional-cilrimtar u kthye ne trup legjislatif te shtetit shqiptar. Ne menyre qe ky trup legjislatif te ish, natyrisht formalisht, sa ne perfaqesues, Partia komuniste kooptei ne gjirin e tij ~~me~~ si ne Berat, ashtu edhe ~~me~~ pak me von, nje sasi elementesh te parive te qarkut, ne influence ne popullsi, dhe qe njiheshin si elemente te ndershem e neutrale deri atehere. I rinforcuar dhe i shtuar me keta persona te rinj, Keshilli i pergjitheshem i Frontit nacional-cilrimtar u shndrua gradualisht ne Asamble legjislativ. Me kete cilesi, gjate vitit 1945, kjo "asamble" nxori shume dekrete e ~~ligje~~ ligje te rini, te bazuara ne vendimet e Kongresit te Partimit, dhe konkretisht: ligjin mbi shtetezimin e Bankes kombetare dhe shndrimin e kësaj ne "Banken e shtetit shqiptar"; ligjin mbi shtetezimin e pyjeve, kullotave, ujrave; ligjin mbi shtetezimin e pasurive te fuqive te huaja (sidomos italiane); ligjin mbi konfiskimet e "bradhetareve te popullit"; ligjin ~~me~~ ^{nga trojetoret} taksave mbi fitimet e berë gjate viteve te luftes; ~~me~~ ligjin mbi reformen agrare, etj. Ne te njejten kohe, kjo Asamble aprovoi edhe ligjin mbi zgjedhjet e arthme te Asambles kushtetuese, Asamble, detyra kryesore e ^{do te} se ciles/ishte hartimi, diskutimi dhe ~~aprovimi~~ i Kushtetutes republikane te Shtetit shqiptar. Me te aprovuar kete ligj elektoral dhe vendosur daten e zgjedhjeve per Asamble kushtetuese, Asamble legjislativ (ne fakt Keshilli i pergjitheshem i Frontit) pushoi se qemuri trupi legjislativ i Shqiperis se re.

Ne baze te kete ligji te ri elektoral u bene ne fillim te 1946 zgjedhjet per deputetet e Asambles kushtetuese. Pikerisht keta deputete aprovuan edhe

SECRET

SECRET

- 105 -

Kushtetuten, shpallen de jure Shqiperine si Republike Popullore, aprovuan masat e marura ne fushen legislative deri atehere dhe vendosen qe emrin: Asamble kushtetuese ta shndrejne ne Kuvend Populler te Republikes popullore te Shqiperise, ne fjale te tjera ne parlament te zakonshem te Shqiperise.

Thashe se brenda nje viti e ca trupi legjislatif hqiptar aprovoi nje seri ligjesh, beri nje varg reformash, mori nje numur vendimesh etj. Mirepo keto vendime duheshan zbatuar nga nje fuqi tjetere. Kjo fuqi tjetere ishte pushteti ekzekutiv. Ky pushtet ishte i nevojeshem edhe per te perballuar situaten, per te qeverisur vendin, per te mbajtur rendin, per te realizuar problemet qe prisnin nje zgjidhje imediate ne te gjitha fushat e jetes, aqe ne teper, sepse pushteti i vjeter ishte shpartalluar dhe dermuar nga rrenjet, ~~Shkollat~~ Pra, kaloj ne piken dy:

NE FUSHEN E PUSHTETIT EKZEKUTIV.- Organi kryesor i ketij pushteti, eshte qeveria. Kam per mendur ne pergjigjen e 14-te se qeveria e pare komuniste (aje e malit) u organizua ne Berat, ne muajin tetor, me emrin: Komitet drejtues". Perberja fillestare e ketij komiteti ishte si pason:

Kryetar: Enver Hoxha.
 Nen/kryetar: Myslim Peza
 Nen/kryetar: Koci Xoxe
 Komandant i pergjitheshem i ushtrise: Enver Hoxha
~~Ministria e Punes~~ Pergjegjes i puneve te jashtme: Enver Hoxha
 Pergjegjes per ceshtjet e puneve te brendeshme: Haxhi Lleshi
 Pergjegjes per ceshtjet ekonomike: Medar Shtylla
 Pergjegjes per ceshtjet bujqesore: Gaqo Tashko
 Pergjegjes per rindertimin: Spiro Koleka Gjergj Kokoshi.
 Pergjegjes per ceshtjet e arsimit e kultures: ~~Sejfu Kostaq Cibu~~
 Pergjegjes per shendetesine: Ymer Dishnica
 Pergjegjes per asistencen sociale: Bedri Spahiu.
 Pergjegjes per ceshtjet financiare: Ramadan Citaku.
 " " e drejtesis: Manol Kocani.

Me po keta persona dhe me po kete perberje, Komiteti drejtues hyri ne muajin nendor ne Tirane, kur u clirua krejt Shqiperia, dhe ketu u shndrua ne qeveri demokratike provizore. "e kete ~~qeverie~~ ^{shndrim te Komitetit ne qeveri.} pergjegjesit e sektoreve te ndryshem, pa asnje kembim ose zevendesim, u shndruan ^{automatistik} ne kryetare dikasteresh ose ministra te qeveris. Vetem ne von, shume ne von bile (pas ndonje viti) u bene keto zevendesime:

- a) Haxhi Lleshi u hoq nga posti i Ministrit te brendeshem dhe u emerua ne shtabin e pergjitheshem; vendin e tij e zuri Koci Xoxes.
- b) Medar Shtylla, u hoq nga minister i ekonomis dhe u emerua minister i Shendetesise. ^{Vendin e tij e zuri Nono Spira,}
- c) Ymer Dishnica, u hoq nga minister i shendetesise dhe u emerua mjek i thjeshte spitali.
- d) Gjergj Kokoshi u ~~ngarkua~~ ngarkua nga funksioni (pse u burgos) dhe vendin e tij e zuri Kostaq Cibu, per t'u zevendesuar me von nga Sejfulla aleshova, dhe akoma me von nga Fadil Pacrami, Naxhije Duma, etj.
- e) Bedri Spahiu u emerua prokuror i pergjitheshem, sepse dikasteri i asistences sociale u ~~eliminua~~ fare.

SECRET

SECRET 106 -

~~Ndajto shprehja e ashpër e qeverisë së Medar Shkëlqes si ministër i Ekonomisë~~
 Ministrat e tjere ruaiten postet e tyre per nje kohe shume te gjate, per vite te tera. Me kalimin e kohes, gradualisht, sipas nevojave, u krijuan ministri te reja: si ajo e minierave, e industris, e tregëtis, e komunikacioneve, e kontrollit, e ~~kami~~ planit te shtetit, etj. etj.. Vazhdimisht dikasteret e ndryshme te qeveris shqiptare kane pesuar ndryshime, dhe vazhdimisht kane ndryshuar edhe ~~titullaret e tyre~~ titullaret e tyre. Keto ndryshime jane kaq te shpeshta qofte ne vitet e pare, qofte me von, sa me eshte e pamundur te permendim emra personash. Jo vetem sepse nuk i mbaj mend, por/sepse do te delte nje mish mash emrash e personash qe jane odukur nga skena politike tashme ose ruajne akoma postet e tyre drejtuese. Jane dhjete vjet jete qe kane kaluar qe atehere, dhe gjate ketyre dhjete vjeteve ~~qumaxx~~ eshte ndruar njeqind here struktura organizative e qeveris shqiptare dhe po aqe here jane ndruar, ne mos me teper, titullaret e tyre. Ku t'i mbaj mend? Nje gje e tille me eshte absolutisht e pamundur.

Kthehem, pra, ne idene kryesore te ekspozese sime.

Qeveria provizore e Shqiperise qe u vendos ne Tirane ne nendorin e 1944-es/ me po ate perberje e strukture qe kish Komiteti drejtues/ e drejtoi aktivitetin e vet ekzekutiv ne te gjitha fushat. Ne te gjitha keto fusha, ajo hasi veshtiresi te medha dhe kjo eshte e natyreshme. Gdo gje duhesh nisur nga fillimi dhe nemes te nje anarkie te plote e shkaterrimesh te medha te lena nga tarheqja e gjermaneve dhe shembja e pushtetit te vjeter nga themelet.

Nuk do te prek ketu ato sektore qe kane patur atehere nje rëndesi te dores se dyte, si sektorin e arsimit-kultures, ate te shendetesise, ~~te bujqesise~~ te asistences sociale.

Perpjekjet me te medha te partise komuniste, si forca levizese e tere punes qeveritare, kane qene drejtuar atehere ne keto drejtime:

a) ne sektorin financiar: Shteti shqiptar nuk dispononte as nje kilogram ar ne depot e Bankes (arin shqiptar e kishin mare italianet, me von gjermanet dhe pastaj englezet). Pikerisht per kete, te gjitha reformat e shtetit nuk mund te evitonin inflacionin. Sidoqofte mund te thom se po te mos ish bere me von pariteti (i monedhes midis lekut shqiptar dhe ~~monedhes~~ jugosllav, ~~me~~ me pasojat e tjera te ketij pariteti, monedha shqiptare nuk do kish rene aqe shume.

b) ne sektorin e bujqesise: problemi kyç ishte reforma agrare, zbatimi i se ciles ndiqeshe me kujdes te madh.

SECRET

SECRET

- 107 -

c) ne sektorin e drejtesis: u aprovuam nje varg ligjesh kunder kundersh-tareve politike dhe u krijuan ne te gjithë vendin gjykata speciale te cilat kane dhene shume denime me vdekje. (Ne bashkepunim teper te ngushte, bile nden dik-tatin, e Ministris se brendeshre)

e) ne sektorin e rindertimit: te gjitha urat e rëndesishme qe shkatërrohet; po ashtu te gjitha instalacionet portuare; te gjithë minierat dhe pusët e vajgurrit ishin demantuar nga gjermanet; ne oindra fshatrat e djegura. Nje si-tuate e tillë ben te qarte gjithë barren e madhe qe ~~ishte~~ i era qeveris ne kete drejtim dhe vështirësite qe duhesh te kapërcente.

f) ne sektorin e ministris se brendeshme. Ketu do te zgjerohem dicka me te-per. Para se gjithash e gjej me vend te jap nje sqarim: lufta kunder kundersh-tareve politike te komunisteve, odukja fizike e ketyre nuk ka qene ne fillim aspak ne kompetencat e Ministris se brendeshme, qofte edhe indirektisht. Kjo lufte ishte ne kompetencat e Drejtoris se Mbrojtjes se Popullit, ~~ne~~ drejtori krejt autonome nga Ministria e brendeshme, gati ministri me vete, me titullar nen kryeministrin e atehereshme dhe sekretarin organizatif te Partise, Koci Xoxen, dhe nen/titullar ~~si sekretar i Drejtoris se Mbrojtjes se Popullit~~ "Esti Kerenxhinë.

Pikerisht kjo Drejtori e Mbrojtjes se Popullit, qe ne von u quajt Drejtori e Sigurimit kur iu atashua Ministris se brendeshme, me minister Koci Xoxen (aty nga 1946), ka qene dikasteri qe, se bashku me organet e tij, ka zhvilluar luften, ~~kyre~~ ne perioden e pare te pushtetit komunist, kunder kundersh-tareve politike te Partise, kunder mbeturinave te "allit e Legalitetit, kunder elementeve te dyshimte (Shih hollësi qe nuk i permend ketu ne pergjigjen: Historiku i Siguri-mit).

Organet e kesaj drejtorie kane qene atehere:

- a) Komandat e vendit
- b) Brigadat e Mbrojtjes se popullit
- c) seksionet e Mbrojtjes se popullit neper qarqe.

Seksionet e mbrojtjes se popullit neper qarqet kishin listat e pregatitura paraprakisht nga Partia ne personat qe duheshin arrestuar si "armiq". Keta "armiq" u perkësnin dy kategorive: 1) atyre qe duheshin arrestuar, hetuar dhe gjykuar; 2) atyre qe duheshin arrestuar dhe, pa hetuar e gjykuar, duheshin pushka-tuar shpejt-e-shpejt. (Lista te hartuara paraprakisht me emra te tilla ka patur kryesisht Tirana dhe Shkodra. Pikerisht per kete, ne keto dy ovtete perfshihen edhe ~~njere~~ viktimave qe jane edhe mister

SECRET

SECRET

riozisht ne ditet e para te clirimit.

Elementet "arabis" te destinuar per betime dhe gjyqme ishin kryesisht ne kompetencat e seksioneve te sigurimit.

Elementet e destinuar te shkonin ne betime dhe gjyqme ishin kryesisht ne kompetencat e "Brigadave te mbrojtjes se popullit".

Komandat e vendit kishin, ne kete mes, vetem nje funksion ndihmes qofte tek seksionet e sigurimit, qofte tek "Brigadat e mbrojtjes se popullit".

Hollësira te metejme mbi Drejtorinë e Mbrojtjes se Popullit atehere dhe mbi Sigurimin tani nuk po jep me gjate kete, per arsye se te gjitha sa kam ditur, i kam thene ne pergjigjen e vecante ~~historike~~ Historiku i Sigurimit.

Perpara se te mbaroj kete pyetje dua te theksoj se nga viktimat e Brigadave te Mbrojtjes se Popullit ne ditet e para te clirimit, nuk mbaej mend ~~emra~~ / Zakenisht kane qene oficere te gjindarmerise, te trupave te tjera kuizlinge, komandante te nesme te Ballit qe u kapen rober, elemente te njohur si kundershtrare te Partise komuniste gjate viteve te okupacionit, / ^{etj} gjyqet e te cileve, dhe sikur viktimat te zhvilloheshin, ne qene se/nuk qene persona te degjuar shume, nuk paraqesnin ndonje ~~interes politik~~ interes politik per regjimin e ri, sikurse paraqesnin, ^{gjyqet kundër} per shembull, ish anetare te Komitetit qendror, ish ministrave, kuizlinge, ish anetare ^{kundër} te Regjences, etj.

SHENIM:- Nuk verjashtohet mundesia qe, kur bej fjale ne fillim te kesaj pyetjeje mbi pushtetin legjislativ dhe ate ekzekutiv ~~ne Shqipëri~~ te ardhur fill pas clirimit ne Shqiperi, te kem ngaterruar ndonje gje te vogel, ndonje fakt ose eveniment. E perserit: Qe atehere kane kaluar vjete te tera dhe une shkruaj tani pas patur asnje dokument perpara, vetem e vetem sa mban mend truri tim.

SECRET

SECRET

- 109 -

PERGJIGJE PYETJES XXIII-teNga cilet u formua qeveria e pare e pas-qirimit.

Qeveria e pare e pas-qirimit, qe quheshe "qeveria demokratike provizore", e Shqiperise, perbeheshe nga po ata anetare qe ndodheshin ne "Komitetin drejtu-ues" me atributet e nje qeverie.

Dhe keta ishin: Enver Hoxha, ~~Kaxix Kaxa~~ (sot sekretar i pergjithshem i Partise se Funes)

~~Myslim Peza~~
Myslim Peza, sot nen/president i Presidiumit te Kuvendit Popullor, jo anetar partie.

Koci Xoxe, pushkatuar nga Partia me 1949

Haxhi Lleshi (sot president i Presidiumit te Kuvendit Po- pullor, anetar i K.Q. te Partise)

Medar Shtylla (sot me post nderi ne Keshillin e pergji- thshem te Frontit demokratik, atehere jo anetar partie por bere pas 1949)

Gaqe Tashko (sot z-vendes-minister i bujqesise, ndofta edhe anetar partie, por atehere jo)

Spiro Koleka (atehere jo anetar i Komitetit Qendror, por sot anetar i Byroze dhe kryetar i komisionit te planit shteteror)

Gjergj Kokoshi, (~~atehere~~ jo anetar partie, burgosur si Ar- mik popullit me 1946 dhe tani ne burg)

Ymer Dishnica (atehere anetar partie, por perjashtuar nga K.Q. ndonje vit me pare. Sot me duket se qe- ndron jashte partis)

Bedri Spahiu (atehere anetar i Komitetit qendror, perjas- htuar nga ky forum me 1954 dhe tani, me sa di, mesues)

Ramadan Citeku (atehere anetar i Komitetit qendror, perja- shtuar nga ky forum -jo nga partia- me 1948. Sot duhet te jete drejtor i arkave te kursit)

Manol Konomi (atehere anetar partie, perjashtuar me 1952, sot jurist pranë Presidiumit te Kuvendit Po- pullor).

Keta persona kane qendruar ne qeverin shqiptare te pare ne teper se nje vit, disa per vjete te tera. Ne fillim u largua Bedri Spahiu sepse u emerua prokuror i pergjithshem i Republikes, pastaj Ymer Dishnica sepse u perjashtua nga Partia, pastaj Gjergj Kokoshi (sepse u burgos dhe vendin e tij e zuti Kostaq Cipua, vde- kur natyralisht nga 1952).

Fundi i fundit, kesaj pyetjeje i jam pergjigjur ne pyetjen 22, prandaj edhe po i jap fund qe te mos perserit me gjate.

SECRET

SECRET

- 140 -

PERGJIGJE PYETJES XXIV-te

~~Cilat qene ne perioden e pare te pas-clirimit anstaret e Komitetit qendror te Partis komuniste shqiptare dhe sa prej syresh xjodhen akoma gjalle-sete~~

Perpara se te filloj te shenoj listen e emrave, e quaj te nevojshme te jap, ne lidhje me sa me siper, disa skjarime:

1.- Komiteti i pare qendror i Partise, qe quheshe Komitet qendror provizor, zgjati prej nendorit 1941 deri ne xxx shkurtin e 1943. Ay u zgjodh prej Miladin Popovicit, kreteve ~~xx~~ te grupeve te vjetra komuniste qe u shkrine ne partine dhe ventes se ~~xx~~ tyre.

2.- Komiteti qendror i dyte i Partise, u zgjodh nga delegatet e Partise ne konferencen e I-re te Partise (Labinot) ne marsin e 1943. Ky Komitet qendror zgjati deri ne Kongresin e I-re (dhjetor 1948), domethene deri sa u prishen marredheniet Beograd-Tirane. Mirapo perberja e ketij komiteti qendror ka anetare ndryshuar vazhdimisht sepse disa/dboheshin, disa kooptoheshin nga lart.

3.- Komiteti qendror i trete i partise ka qene ay qe u zgjodh nga Kongresi i pare i partise dhe drejtoi aktivitetin e vendit ~~xxx~~ deri ne 1951.

4.- Komiteti i katert qendror i Partise u zgjodh ne Kongresin e II-te te Partise ne 1951 dhe i le vendin, ne majin e keti viti, sivllaut te tij qe do te zgjidhet nga Kongresi i III-te i Partise qe eshte ne celje ne Tirane.

Shenimi:- Dy komitetet e pare qendrore te Partise komuniste kane qene te fshehte jo vetem per popullin, por edhe per anstaret e Partise. Popullarizoheshin si anetare te Komitetit qendror vetem 2-3 figura, personalitetet e majes se hierarqise. Te tjeret kishin per detyre te fshihnin ne konspiracionin ne te madh qenien e tyre ne Komitetin qendror.

(i ga dhe i 4 te)

Perberja e dy komiteteve qendrore te tjere (ka qene ne dijenin publike sepse emrat e anetareve jane botuar ne shtyp.

Kaloj ne listen e emrave:

Komiteti i pare qendror perbeheshe nga: Enver Hoxha, Ymer Dishnica, Vasil Shantua, Kristo Themelkua, Qenal Stafa, Koxi Xexex, Pilo Peristeri, Ramadan Citaku, Liri Qega (dhe ndofta ndonje tjetri qe nuk e di).

Komiteti i dyte qendror, kur u zgjodh nga Konferenca e I-re ~~xx~~ e vendit e Partise (mars 1943) perbeheshe nga: te gjithet te lart permendurit (ne perjashtim te Vasil Shantos, Qenal Stafes, vrare nga italianet dhe Pilo Peristerit, Sejfulla Maleshoda (ardhur ng gjastte per shkurime me 1946) perjashtuar si i pazoti plus: Nako Spiru, Bedri Spahiu, Hysni Kape, Tuk Jake

SECRET

(vase me 1948) (per shkurime me 1954) (vethe sot u llogariti)

SECRET

(perjashtuar nga 1951) (kongresit me 1949) - 141 - (që ka dy adresat në pergjithësi)

va Pandi Kristo, Mehmet Shehu, Gogo Nushi, Gjini Marku (perjashtuar 6 muaj me von). Me kalimin e kohes, deri nga vera e 1948, ne kete komitet qendror Nashije Dams (perjashtuar nga Kongresi I-te) jane keoptuar nga lart edhe keta persona: Dali Ndreu (perjashtuar nga 1947), Petre Papi (perjashtuar nga Kongresi i I-re), Nesti Berenxhiu (perjashtuar nga Kongresi i I-re) Vaske Koleci (perjashtuar nga Kongresi i I-re) nje fare Dhimitri (mbiemri i te cilit nuk me kujtohet gjithashtu, president i Rinise (perjashtuar nga Kongresi i I-re), Fadil Pacrami (perjashtuar nga Kongresi i I-re por rizgjedhur nga Kongresi i II-te), Liri Belishova (perjashtuar me 1947 por rizgjedhur hem nga Kongresi i I-re hem nga Kongresi i II-te), Manol Kononi (perjashtuar nga 1952 edhe prej Partise), Xhoxhi Blushi (perjashtuar nga Kongresi i I-re), Pellumb Dishnica (perjashtuar nga Kongresi I-re), Kico Ngjela (perjashtuar nga Kongresi I-re por rizgjedhur nga Kongresi II-te), Mamush Myftiu (ka mbetur deri me sot si anetar i Komitetit qendror) Rahman Berlaku (perjashtuar nga Komiteti qendror prej Kongresit te I-re) Beqir Ba- ~~lluku~~ lluku (mbetur edhe sot anetar i Komitetit qendror), Spiro Koleka (mbetur edhe sot anetar i Komitetit qendror), Alqi Kandi (vra - re aksidentalisht me automabil ne Tirana me 1945), Misto Mame (vrare nga italianet me rruget e Tiranes), nje fare Kadriu (mbiemri nuk me kujtohet, per me 1945 ka qene shef i misionit ushtarak shqiptar prane Komandes aleate te Mesdheut ne Itali, perjashtuar edhe nga Partia me 1947 dhe burgosur, li- ruar me 1953). Ndofta edhe ndenje tjeter, i cili nuk me kujtohet.

Komiteti i katert qendror i Partise komuniste, zgjedhur nga Kongresi i II-te i Partise, ka patur shume elemente te rinj. Dhe kjo shihet nga nu- mri i madh i te perjashtuarve qe permend me lart, ~~që kanë adresat në~~ ^{adresa te K. Q. te katert} ~~te katert qendror. Derat e~~ / i kam permendur ne hetimet qe me jane bere ketu e nje vit me pare me Kostur e Glifadhe.

Para se t'i jap fund kesaj pyetjeje, shenoj se nga anetaret e Komitetit te trete qendror, zgjedhur nga Kongresi i I-re i Partise, jane perjashtuar: Nje fare Spiro (mbiemri nuk me kujtohet), minoritar, i cili arriti per nje kohe te shkurter te behet edhe sekretar (je i pergjitheshem, por sekretar thgeshteli Komitetit qendror, nje fare element me pseudonimin Taberi (as emri, as mbiemri nuk me kujtohet) qe u vra nga Partia (ose vete veten) kur deshi te arratiseshe ne Jugosllavi (ish ministri nenuinister i brendeshem) aty nga viti 1950, Abedia Shehu (perjashtuar si antisevjetik), Niazi Islami

SECRET

SECRET

- 142 -

i cili vrau veten ne rrethana misterioze aty nga 1951/ Nexhip Vinçani, u cili u perjashtua si tarafçi, imeral, etj. Shyqri Killezi, perjashtuar gjithashtu si antisovjetik, Kahreman Ylli, perjashtuar si element borgez dhe qe i kish fshehur sekrete partise, Theodar Heba, si element i deviacionit te djabathte, Manel Konomi, gjithashtu si element i deviacionit te djabathte, Beqir Ndoe, per arsye qe me jane praktikisht te panjohura por i implikuar me Taboria ^{Beqiri} (u internua qe nga 1951) dhe ndonje tjeter qe nuk me mbahet mend. Anetaret e tjere te Komitetit te III-te qendror ndodhen ne perberjen e Komitetit te katert qendror, ^{katere} te cilit, sikurse e permend me lart, jane ne pjesen me te madhe elemente te rinj ne kaxhi ferumia me te larte te Partise.

SECRET

SECRET

- 143 -

PERGJIGJE PYETJES XXV-teCilat qene organizatorët e ~~xxxxx~~ hua; ne perioden e pare te pas-çlirimit (emra, pseudonime, pershkrimi i tyre).

Organizatori kryesor i hua; ne Shqiperi, ne kete periode, nuk ish ne Miladin Dushani. Ay u largua nga Tirana, ne urdher te Beogradit, qe ~~xxxxxxxxxxxx~~ Shqiperise, qe ne vjeshtem e 1944 dhe vendin e tij e zuri nje anetar i Komitetit qendror te Jugosllavise, Velimir Steinici, i cili erdhi ne Shqiperi si shof i misionit ushtarak jugosllav prane Shtabit te pergjitheshem partizan shqiptar. Me von, me vendosjen e maredhenieve diplomatike Tirane Beograd, Velimir Steinici ^(shk.) (atehere me graden kolonel) u emerua ne krye te Legates jugosllave me titullin: minister i plotfuqishem dhe i derguar i jashtezakoneshem i Jugosllavise ne Shqiperi.

Ne kete kohe, lidhjet e Tiranes me Beogradin behen jashtezakonisht te ngushta. Koha e kontakteve te izoluara, e vetekuptueshme per vete konditat e atehereshme ne te cilat mrodheshin partite komuniste te jugosllavise e Shqiperise, per vete mungesen e mjeteve te transportit dhe te korrespondences epistolare, ia le vendin nje kohe te re: perodes se vizitave te shpeshta te krereve komuniste shqiptare ne Beograd. Lidhjet, pra, midis te dy palave nuk mbahen me si perpara vetem me anen e nje personi (-ic ishte Miladini), por me anen e shume personave. Sideqofte, Velimir Steinici eshte i plotfuqishem, sado qe, per vete konditat e reja, ne nje mase me te kufizuar se sa Miladin Popovici.

Pikerisht sikurse merita e ~~xxxxx~~ organizimit te krejt Partise komuniste shqiptare ^(me 1944) i bje Miladin Popovicit, ashtu edhe merita e organizimit te krejt aparatit te pare shteteror komunist ^(me 1945) i takon Velimir Steinicit. (natyrisht sipas udhezimeve te Beogradit, sepse Tirana, me fund te fundit, nuk beate gje tjeter vecse kopionte si majmuni cdo gje nga Jugosllavia e Tites).

Te dhena mbi Velimir Steinicin di shume pak. Ay ka qene i rrethuar nga nje shtab i tere jugosllavesh te tjere, secili me nje specializim te vacante: Niazi Dizdarevici, per shembull, ka qene i deleguar i Beogradit per ceshtjet e rinis komuniste ne Shqiperi; nje fare Velo (mbiemri nuk me kujtohet), kolonel, ishte i deleguar i Beogradit per ceshtjet e Ushtrise shqiptare; nje tjeter, me mbiemrin Kecish, ishte posacerisht per ceshtjet e tregetise shqiptare, etj. etj. Mirepo ^{direkte E} te gjithë keta, sikurse vetekuptohet, qene nea urdherat dhe vartesine e Velimir Steinicit, i cili ishte personi politik dhe anetar i Komitetit qendror te Jugos-

SECRET

- 144 -

SECRET

llavise. Ky person u largua nga Shqiperia aty nga fundi i 1946-es, ~~shkruant~~ per t'u emeruar shef i komisionit te kontrollit ne Jugesllavi. Opinioni i atyreve qe e njihnin se afermi ne Tirane ishte ky: Velimir Steinicic ~~me~~ muk qe ace i afte dhe i zeti sa Miladin Popovici. Per ndryshe nga ky, ishte me brutal ne nderhyrjet e tij prane Komitetit qendror te Partise komuniste shqiptare dhe shume me intrigant se sa Miladini.

Me largimin e Velimir Steinicic nga Shqiperia, vendin e tij e zuri nje fare Josip Gjergja, jo anetar i Komitetit qendror te Jugesllavise, por, ne mos gaboj, kandidat i ketij Komiteti. Ky ishte akoma me i pa afte, sipas te thenave, dhe muk gezonte as autoritetin e Miladinit, as ate te Velimirit ne Tirane. Ndefta are- syeja e derimit nga Beogradi, ne kalimin e kohes, te personave jo shume te aft e ne Shqiperi shpjegohet me faktin se Titua, ne ate kohe, per vete kontaktet shume te ngushta, ~~me~~ komunikacionin dhe vajtje-ardhjet e shpeshta ne mes te te dy shteteve ua kish kufizuar inisiativem te deleguarve te vet ne Tirane (inisiativete qe ishte shume e madhe dhe e gjere ne kohet e luftes dhe ditet e para qe pasuan clirimin, per vete mungesen e lidhjeve fizike ndermyjet te dy shteteve). Josip Gjergja ka qendruar ne Tirane deri nga 1950, demethene deri sa u preme maredheniet diplomatike Shqiperi-Jugesllavi. Pak me von, ay u dergua ambasador i Jugesllavise ne Delhi (Hind). Tani muk di se c'behet.

Tjeter person i huaj qe nderhyrte ne organizimin e shtetit shqiptar, per ne nje mase shume te kufizuar, sepse Shqiperia i ishte lene nga Moska ciflik Beogradit, ishte atehere ~~me~~ perfaqesuesi i Bashkimit Sovjetik ne Tirane, emri i te cilit muk me kujtohet tani. Di se ky perfaqesues, perpara se te vinte mi- nister sovjetike Shqiperi, ishte keshilltar i Legates se BRSS ne Beograd. Pasi u largua nga Shqiperia, aty nga 1950, ^{du} u emerua perkehesisht funksionat ne Mini- strin e jashtme te BRSS dhe nje vit me von u dergua si ambasador sovjetik ne Kanada. Perkrahe ministrit sovjetik te atehereshem, nje tjeter organizator i huaj ishte ne Tirane (por me funksione me te kufizuara se Velua) koloneli (qe me von u bej gjeneral-majori sovjetik: Sokolof.

Le te shtoj me kete rast se roli dhe nderhyrja e perfaqesuesve sovjetike ne Shqiperi eshte shtuar shume pas prishjes se maredhenieve Tirane-Beograd, pas shkeputjes se Tites nga Kominformi. Dhe percaktoj se ne kete kohe, ne Shqiperi ka ardhur si ambasador sovjetik, pra si krye-organizator, Dmitri Leviskini, i cili u zevendesua nga nje tjeter vije ^{njoh.} sovjetik, demethene ne 1955. ^(Emri nuk eshte di.) Organizatore te tjere sovjetike muk ~~me~~ Po ashtu muk njoh edhe juhesllave te tjere.

SECRET

SECRET

- 145 -

Sidoqofte, me qene ne ndodhem ne kete oke, le te theksej se vazhdimisht ne Shqiperi, ata qe kane bere ligjin, kane qene ne fillia jugosllavet (deri nga vjeshta e 1948) dhe pastaj sovjetiket. Se kush do te sundeje ne te arthmen, me kthesen qe ne marim evenimentet tani se fundit pas vizites se Hrushciovit e Bulganiat ne Beograd, me eshte veshtire te prononcohem konkretisht dhe me bindje. Kete do ta tregoje ~~.....~~ e arthmja:

- - -

SECRET

SECRET

- 145 -

PERGJIGJE PYETJES XXVI-tePershkrimi i gjyqeve me te rendesishme qe jane zhvilluar ne Shqiperi qe nga clirimi e deri ne sot.

Do te mundhem t'i pergjigjem se te me jet e mundur me plote kesaj pyetjes, por e cuaj te nevojeshme te theksoj avsh ne fillim se boshllecat ne kujtesen time jane te medha.

Zakonisht, shumica e gjyqeve ne Shqiperi (e gjyqeve politike) eshte zhvilluar me dyer te mbyllura; sidomos persa u perket viteve 1947 dhe 1948, periode ne te cilen jane denuar nje shumice e madhe vetesh. Pikerisht per kete aresve, te dhenat e mia mbi keto gjyqe dhe njohurit e mia jane gati zero.

Le te theksoj, si parim orientues, se gjyqet kunder kundersh-tareve politike te regjimit, ne Shqiperi, ndahen ne disa perioda shume karakteristike/me ~~orientim~~ krejt orientimin e Tiranës.

Perioda e pare: ajo perfshin sidomos vitin e pare ~~1945-1946~~ qe pason pas-clirimit, domethene perfshin vitin 1945. Gjyqet e kesaj periode ne Shqiperi drejtohen ne shumicen derrmuese kunder elementit qe bashkepunoi me okupatorin italo-gjerman dhe kunder elementeve te njohur si balliste e legaliste. Aresyeja qe "drejtesia" komuniste godit ne keto ~~gjyqe~~ kohe, ne Shqiperi, kete kategori njerezish, eshte e lehte per t'u kuptuar. Para se gjithash eshte fjala qe te denohen njerezit qe u vune ne sherbim te pushtuesit; mirepo nen masken e "sherbetoreve te okupatorit", partia godit me keto gjyqe te gjithë kundersh-taret e saj politike te kohes se okupacionit, e me radhe te ~~gjyqeve~~ elementin pasanik te fshatit e te qytetit. Qellimi i Partise eshte: te diskreditoje levizjet e Ballit e te Legalitetit, te derrmoje mbeturinat e ketyre organizatave qe ekzistonin akoma ne Shqiperi, ^{dhe} te monopolizojë nacionalizmin per tere kohen e okupacionit, duke i paraqitur te gjithë kundersh-taret e saj si tradhetare, si vegla te Italisë ose Gjermanisë.

Tri jane gjyqet me te rendesishme te kesaj periode:

a) Gjyqi/^{special}kunder bashkepunetoreve kryesore te fashizmit. Trupi gjykues qe zhvilloi kete proces, kishte per kryetar Koci Xoxen, sekretar organizatif i Partise dhe nenkryeminister; dhe per prokuror Bedri Spahiun. Te pandehurit, ne shumicen e tyre derrmuese qene ish ministra te qeverive kuislinge, ish anetare te Komitetit qendror te Ballit, publiciste te degjuar te propagandes italo-gjermane ne Shqiperi, oficere madhore, etj. si Irfan Ohri, Bahri Omari, Hilmi

SECRET

SECRET

Leka, Gjergj Bubani, Rrok Gera, Kocë Kota, Tefik Mborja, Bezir Valteri, Gjeneral Mirdashi, Abedin Nepravishta, etj. etj. Shunica e ketyre te pandehurve, u denuan me vdekje ose me burgim te perjeteshem. Ky gjyq eshte zhvilluar ne muajin mars te vitit 1945. Nderkohe, ne ~~xxxxx~~ qendrat e qarqeve, poshte, zhvilloheshin po ne kete kohe, e bile edhe me von, gjyqe te tjere kunder "bashkepuntoreve te okupatorit", por me te pandehur te nje kalibri me te vogel, le te themi te kalibrin krahnor.

b) Gjyqi special kunder ushtarakeve bashkepuntore te okupatorit. Edhe ky gjyq, pikerisht si i pari, kishte te pandehur me nje rendesi ne planin nacional, dhe jo krahnor. ~~xxxxx~~ ^{For} ne kete gjyq te pandehurit ^{vetem} ishin/oficera madhore (majore, kolonele), ne fshin keta te ushtrese shqiptare, qofte te gjindarmerise shqiptare qe e mbajten uniformen dhe sherbyen edhe ne kohen e okupacionit. Zakonisht nuk kane qene ushtarake politike, ^{ose vetem persona politike} dhe me poste shume te rendesishme, sic qene ata qe u denuan ne gjyqin e pare. Emrat e tyre nuk me kujtohen dot. Por mbaj mend kolo- ~~xxxxx~~ nel Osman Gazepin, kolonel Hasim Velon, etj. etj. Emrat e personelit te trusit gjykues nuk me kujtohen, as edhe nje. (Ne mos gaboj ka qene prokuror Nevzat Leskoviku). Denimet e ketij gjyqi, pikerisht si te te parit, kane qene jashte- zakonisht te renda: me vdekje ose me burgim te perjeteshem per shumicen dermo- njese te te pandehurve. (Gjyqi eshte zhvilluar ne shtet te ndryshme, nga pranvera dhe vera e 1945, dhe ka shoqyrtuar rastet e nje 100 te pandehurve).

c) Gjyqi special kunder Regjences. Prokuror i ~~xxxxx~~ gjyqit me duket se ka qene Misto ~~xxxxx~~ Treska. Te pandehurit kane qene anetaret e re- ^{(Peter Pilon Harapli,} hjences qe kohen e okupacionit gjerman ne Shqipëri; ^{te pandehurve} (fatkeqesisht nuk me kujtohet asnje emer tani. Numuri i ketyre/ka qene shume i kufizuar ^(ne 3) dhe ne mos gaboj, te gjithë te pandehurit u denuan me vdekje.

Perioda e dyte. Kjo periode perfshin sidomos vitin 1946. Goditjet e partis ne kete kohe kunder "bashkepuntoreve te okupatorit" kane mare fund. "Drejtësia" komuniste qellon ne kete kohe sidomos kreret e klerit katolik ne Shkoder. Dhe kjo, sepse ne kete periode, kleri katolik i Shkodres eshte e vetmia force kund- dershtare e komunizmit ne Shqipëri disi e organizuar. Shumica ex ketyre gjyqeve -sado qe zhvillohen ne Shkoder- kane nje karakter te gjere nacional. Akuzat e komunisteve kunder te pandehurve jane: kreret e klerit katolik, ne mareveshje me fuqit e huaja imperialiste, orvaten te rrezzojne me dhune pushtetin legal te komunisteve. Pretendohet se ~~xxxxx~~ ^{xxxxx} arme te fshehura neper kishat katolike,

SECRET

SECRET

- 148 -

dokumenta qe vertetohet lidhjet e te pandehurve me Vatikanin per veprimtari subversive kunder Republikes shqiptare, etj. Te pandehurit jane te gjithë klerike, si Pater Shllaku, Pater Bernardini, Pater Prendushi, etj, etj. Emrat e anetareve te trupit gjykues nuk me kujtohen. Denimet, edhe ne kete rast, jane te renda: me vdekje ose me burgime qe i kapërcejne te 15 vjetet prvim lirisë. Krahas gjyqit qendror kunder "klerikeve kryesore subversive", zhvillohen edhe gjyqe te fshehta kunder te pandehurve, me pak te rëndesishem, te afiliuar me ekspozentet kryesore.

Si rezultat i keqve gjyqve terrorizohet tere kleri katolik, thihet rezistenca e tij e hapet, behen zevendesime ne hierarkine e larte te kishes katolike ne Shqiperi dhe forcohen, me rruzen e violences, pozitat e Partise ne kete keshtilla te atehereshme te antikomunizmit ne Shqiperi, sic ne Shkodra. Perioda e trette: Ndersa perioda e pare perfshin vitin 1945, e dyta vitin 1946, kjo periode perfshin vitin 1947-1948 (viii).

Ndersa ne perioden e pare goditet ne planin kombetar Legaliteti e sidomos Balli me anen e drejtesise, dhe ne planin nderkombetar Italia fashiste e Gjermania naziste, dhe ne perioden e dyte, ne planin nacional kleri katolik dhe ne ate nderkombetar Vatikan, ne perioden e trete goditen: ne planin nacional elementi nationalist qe kish bashkepunuar me Partine gjer atehere, por qe reformat dhe ekstremizmi i koheve te fundit i komunisteve i kish larguar nga pozitat e Partise (qie qe dukeshen edhe ne debatet e ketve nacionalistev ne Kuvendin Popullor ku ishin deputete), dhe ne planin nderkombetar Shtetet e Bashkuara dhe Anglia. Gjyqi qendror i kesaj periode eshte i ashtuquajtur "gjyq kunder grupit te deputeteve".

Trupi gjykues i ketij procesi ka per kryetar Niko Ceten dhe per prokuror Josif Mashkon. Te pandehurit jane te gjithë deputete, nacionaliste: Riza Dani, Shëfqet Deja, Bat Karbunara, Koste Boshnjaku, ^{Koste (i) Kugali} Ali Aga, Ali Shtepani, etj/ etj, qe te gjithë deputete te listes se Frontit demokratik, domethene te listes komuniste (sepse ishte e vetmia). Sqaroi se keta elemente i kishin dhene Partise tere ndihmen e tyre morale e nolitike gjate luftes nacional-clirimtare dhe ne perioden imediate te pas-clirimit. Mirepo "majtizmi" i mevoneshem i partise ne fushen ekonomike, politike, shonore, i largoi keta nga Partia dhe i ktheu ne nje fare opozite legale parlamentare. Per arsye qe kuptohen, Partia deshi ta dermoje kete opozite dhe duke e dermuar ate te dermoje bashkeudhetaret e deri

SECRET

SECRET

- 149 -

atehereshem te saj qe kishin filluar t'i shkaketonin bezdira ne kohet e fundit. Edhe ne kete rast, denimet kane qene jashtezakonisht te renda.

Duke mare pretekst nga organizata e grupit te deputeteve, dhe me qellim qe te terrorizoje edhe me teper elementin kundershtar, Partia e lidh kete organizate (personalisht dyshoj qe te kete patur nje veprimtari te ketij grupi ~~si~~ sikurse u paraqit ne gjyq) me nje varg organizatash te tjera ~~q~~ ilegale dhe subversive. Keshtu, bra, krahas gjyqit special kunder grupit te deputeteve zhvillohen nje seri gjyqesh me dyer te mbyllura kunder:

a) Grupit tekniko-intelektual. Shumica e te pandehurve te ketij procesi ~~ix~~ (kryetar Gjon Banushi dhe prokuror Faik ~~Minarolli~~ ^{Macrolli}) ishin inxhinier ose teknike ne puset vajfurrore te Kufoves, mekanike ne centralet elektrike ose motorat, si Pandi Korça, Ali Zajmi, inxhiner Petraqi, etj. Ky gjyq ka qene nje kopje ne miniatyre e "gjyqit te spiuneve ~~shakiste~~ ^{shaktiste}", drejtuar kunder teknikeve te vjeter ne Rusin e 1926-1927. Te pandehurit akuzoheshin per lidhje me Shtetet e Bashkuara ne planin nderkombetar dhe me grupin e deputeteve ne planin kombetar.

b) Grupit social-demokrat. Shumica e te pandehurve te ketij procesi, zhvilluar gjithashtu si i mepareshmi me dyer te mbyllura (kryetar Gjon Banushi, prokuror Faik ~~Minarolli~~ ^{Minarolli}) ishin antare partie qe shikoheshin me sy te dyshimte nga Partia, si Arif Gjyli, Nexhmi Ballka, Sabri Dajlani. Pikerisht si te parit edhe keta akuzoheshin per agjente te SHBA dhe per bashkepunore ~~te~~ te deputeteve.

c) Grupit SBS (Secret Balkans Service). Shumica e te pandehurve te ketij procesi ishin ~~komuniste~~ ^{antare te Partise} komuniste shqiptare, qe kishin qene internuar nga okupatori ne Itali, cliruar nga trupat amerikane dhe kthyer nga 1944 ne Shqipëri. Edhe ky gjyq eshte zhvilluar me dyer te mbyllura (kryetar Gjon Banushi, prokuror Faik ~~Minarolli~~ ^{Minarolli}) dhe me te pandehur: Spiro Dhima, ~~Gjone~~ ^{Hoson Rogi} Ndori, Ndue Gjoka, Vasil ~~Vesili~~ ^{Vesili} etj. Te pandehurit akuzoheshin se ishin vene ne sherbim te spiunazhit amerikan qe ne kohen kur ishin cliruar nga trupat amerikane ne Itali, se kishin zhvilluar kurse te posacme, etj.

Shenim: te gjithë keta gjyqe jane zhvilluar ne Tirane. Mirepo krahas ketyre, nje varg tjeter gjyqesh, ne qarqet, jane zhvilluar kunder filialeve te Grupit te deputeteve ne Korce, Gjirokaster, Shkoder, etj.

Karakteristika kryesore e ketyre gjyqeve ka qene goditja e Shteteve te Bashkuara si fuqi imperialiste e agjenturale. Duhet te theksoj me kete rast se goditja e Shteteve te Bashkuara si fuqi imperialiste e agjenturale eshte bere,

SECRET

SECRET

organizuar

por jo ne nje forme kaqe te eger nga komunistet e Tiranes, edhe nga 1946, kur u larguan misionet amerikane e engleze prej Shqiperise, ne gjyqin e ~~xxx~~ sabotatoreve te Maliqit. Te te shpoj me kete rast se gjyqi kunder sabotatoreve te Maliqit pati per prokuror Nevzat Leskovikun (ose Haznetarin) dhe par te pandehur: Hanz Valen (shtetas shqiptar), Gaco (i) Manon (shtetas shqiptar), Zorika Manon (shtetase jugosllave), Mario Guarnierin (shtetas italian), doktor Rizzo-n (shtetas italian), etj, etj. Te pandehurit akuzoheshin se kishin sabotuar punimet per tharrjen e kenetes se Maliqit, sipas udhhezimeve te marura nga misioni civil amerikan ne Tirane dhe misioni ushtarak englez.

Para se te perfundoi me perioden e trete, qe shtridhet deri nga viti 1948, dua te theksoj se shume nga elementet e implikuar ne keto gjyqe ishin arrestuar e burgosur me nje perspektive qe i kapexente, per te arthmen e afert, kufijt e grupit te deputeteve, dhe brekte (plani i Koci Xoxes) Nako Spinin, Sejfulla Maleshoven, Zmer Dishalocen dhe ndofta edhe Enver Hoxhen, se bashku me personat litete te tjera komuniste, si Bedri Spahiu, Mehmet Shehun, Liri Delishoven, etj qe nuk shikoheshin mire nga ~~xxxxx~~ titisti Koci Xoxe, atehere i plotfuqishme.

Perioda e katert - Fillon me fillimin e 1949, domethene pak kohe me von se sa te prishen maredheniet Tirane-Beograd. Kete periode e dominon nje gjyq i madh: Gjyqi kunder Koci Xoxes dhe bashkepuntoreve te tij te ngushte. Personi qe e drejtoi tere kete gjyq ka qene Bedri Spahiu. Te pandehurit e tjere, pervec Koci Xoxes, qene: Pardi Aristua, Vaske Koleci, Vango Mitrojorgji, Nuri Huta, Niko Opari. Duhet te theksoj se ky gjyq nuk eshte nje kopje e gjyqeve te Rajkut ne Hungari, te Kostovit ne Bullgari, te Slanskit ne Cekoslllovakia. Keta gjyqe kishin nje karakter shume te theksuar kunder Titos. Gjyqi i Kocit ishte ne nje kuader shume me te ngushte, me te kufizuar. Ndersa ne gjyqin e Rajkut ose Kostovit, ver shembull, denohet ne personin e te pandehurve Titua si agjent i sherbimeve te fshehta amerikano-britanike, ne gjyqin e Kocit denohet Koci si person (Titua nuk permendet fare si agjent) dhe njerez te dores se fundit te ~~Rax~~ Komitetit qendror te Partise komuniste jugosllave, si Velimir Stoinici e Josif Gjergja. Sherbimet e fshehta amerikane ose engleze as qe permendenen fare ne kete gjyq. Eshte gjyq i ~~titos dhe p sishket vass~~ *juposllavis me tapir ne ne Titos dhe p sishket vass* i ~~titos dhe p sishket vass~~ *shket* Vashinktonit, por si ~~shket~~ *shket* kolonizues i Shqiperise, si ~~armik~~ *shket* i Shqiperise; ~~shket~~ *shket* independent. Peri-oda e katert, pra, karakterizohet nga kjo gje: goditet jo imperializmi amerikan ose englez, por "imperializmi" jugosllav ne terrenin nderkombetar dhe arjentet e tij ne planin nacional.

SECRET

- 191 - **SECRET**

Kjo periode mer fund brenda po avij viti, domethene brenda vitit 1949, ose te shumten fillimi i vitit 1950.

Le te shtoj se gjyqi kunder Koci Xoxes, drejtuar ne terrenin nderkombetar jo kunder imperializmit amerikan por kunder imperializmit jugosllav, jo kunder spiunazhit anglo-sakson por spiunazhit titist dhe njerzve te tij ne Shqiperi, shoqerohet pak me von nga nje gjyq teknik, me nje karakter shume me te kufizuar, nga gjyqi kunder teknikeve shqiptare te hekurudhes, "agjente te sherbimeve te fshehta titiste". Nuk me kujtohet as perberja e trupit gjykues, as emrat e te pandehurve. Di vetem se te pandehurit kane qer shefa stacioni e teknike hekurudheshash ne Durres e Tirane, te akuzuar se kishin bere sabotazhe ne kete vije hekurudhore sipas udhezimeve te agjenteve jugosllave. Ky gjyq u zhvillua ne Durres dhe i pandehuri kryesor e mihnesi i tij u denuan me vdekje. Te tjeret me burgime me te lehta.

Perioda e peste: Fillon nga kreu i vitit 1950 dhe zgjatet deri ne qivasma e 1954. Thashe perioda e pare drejtohet kunder nje kategorie ^{vetme:} kunder "bashkepunteoreve te okupatorit". Perioda e dyte drejtohet kunder nje kategorie tjeter: kunder "sherbetoreve te Vatikani ne Shqiperi". Perioda e trete drejtohet gjithashtu kunder nje kategorie te vetme: kunder nacionalisteve qe kishin qene deri atehere bashkeudhetare te komunizmit; Perioda e katert drejtohet gjithashtu kunder nje kategorie te vetme: "kunder agjenteve te Jugosllavise (me taper se sa te Titos) ne Shqiperi". Perioda e peste ka nje karakteristike tjeter: Tere gjyqet politike te kesaj periode kurdisen ne nie menyre te atille qe te pandehurit te dalin si agjente jo vetem te nje funde, por te te gjitha fuqive "armike te Shqiperise": hem te Jugosllavise, hem te Greqise, hem te SHBA, hem te Angli. Te pandehurit ne kete periode jane vetem kuklla dhe prapa tyre synohet te tregohet se spiunazi amerikan ka mobilizuar te gjith armiqte popullit shqiptar ne nje agjenteve te vetme duke rekrutuar per kete qellim edhe Roman, edhe Beogradin, edhe ^{edhe ~~London~~ Berlin} Londren. Kete fryme dhe ngjyre politike kane, ne fakt, gjyqet:

- a) ay i Et'hem Çakos dhe grupit te tij hedhur me parashute ne Shqiperi, duke ardhur nga Italia.
- b) ay i Esad Toptanit (i), dhe shokëve te tij hedhur ne Shqiperi duke ardhur disa nga Franca, disa nga Jugosllavia, disa nga Greqia.
- c) ay i Hamit Matjanit dhe shokëve te tij, hedhur ne Shqiperi duke ardhur disa nga Greqia disa nga Gjermania Perendimore disa nga Egjypti.

SECRET

SECRET 192 -

Te gjithë keta gjyqe zhvillohen me nje buje jashtezakonisht te madhe dhe nje publicitet qe kalon cdo kufi. Zakonisht kryetar i ketyre gjyqeve ^{speciale} jka qene Shuahip Fanariti dhe prokuror *Siri Çarçani*.

Pervec "imperializmit amerikan", keto gjyqe synonin te godisnin edhe emigracionin shqiptar (Komitetin e Shoqeris se Lire), duke e paraqitur edhe kete jo si organizate politike por si agjenture te thjeshte spiunazhi. E perserit: me teper se sa gjyqe ligjore, kane qene fushata politike me domethene jo ne planin nacional, por ne ate nderkombetar.

Tirana, ne fakt, ndjek edhe ne kete rast nje vije e orientim te dhene nga Moskë, ne lemin internacional. Kjo vije ishte: paraqitja e SHBA si fuqi nderhyrese ne punet e brendeshme te demokracive popullore, me mjete agresive, domethene me dergime spiunesh, diversantesh, sabotatoresh, etj. te rekrutuar keta te fundit dhe pregatitur, ose futur nga Greqia, Italia, Jugosllavia, "sipas nje plani te koordinuar nga lart, nga Vashinktoni".

"e gjate nuk di se c'te thom mbi kete pike. Sa per perioden qe pason vitin 1954 (domethene dy vitet e fundit) nuk di gje sepse ndodhem ne Greqi qe atehere."

SECRET

SECRET

- 194 -

Brevet Enver Hoxhen duke ia dobësuar shume pozitat e tija brenda per brenda hierarkisë se Partise dhe duke forcuar shume pozitat e tyre. Koci i Xoxes, keshtu, u vu ne nje rang me Enver Hoxhen. Qe nga ky moment, kurdohere me perkrahjen e Velimir Stoinicit, ay i forcon vazhdimisht pozitat ne parti, sadoqe humb si aleat, ne fillim, Sejfulla "aleshoven (sepse perjashtohet nga Komiteti qendror) dhe me von edhe Nako Spirun, sepse ky bashkohet me Enver Hoxhen dhe fillon te shprehe simptoma pakenaqesie per menyren me te cilen e trajtojne Shqiperine njerezit e Beogradit. Pozita e Nakos ne Parti dhe influenca e tij e benin lodren e jugosllaveve dhe te Kocit brenda per brenda partis shqiptare shume te veshtire. Pikerisht per kete, udheheqja jugosllave e Beogradit pre-gatit ne pranveren e vitit 1947 nje goditje te rende kunder Enver Hoxhes dhe sidomos Nako Spirut, duke perdorur edhe ne kete rast njeriun e saj: Koci Xoxen. Kjo goditje u dha ne plenumin e 8-te te Partise. Qe nga keto kohe, pra, fillon pika e trete.

Pika e trete, pra, fillon me pranveren e 1947. Dihet se ne plenumin e 8, Komiteti qendror i PKJ akuzon elementin intelektual te KQ te PKSh se nuk i shikon me sy te mire relatat "eograd-Tirane, se ka bere gabime te djathta ne politiken ekonomike te saj, se ka influencuar qe te favorizohet elementi intelektual ne parti ne dem te elementit puntor. Keto akuza ia sjell Komitetit qendror te PKSh nga "eogradi Velimir Stoinici, i cili pertrahet ne te gjithë frontin nga Koci i Xoxes. Ky i fundit, sigurisht sipas sugjerimeve te Beogradit, shkon edhe me larg. Ay akuzon Nako Spirun se ka probabilitete qe ^{Nekuvete} te flete edhe i lidhur me fuqit e huaja imperialiste. Ay akuzon Enver Hoxhen se ne krye te K.Q. te Partis nuk duhet te flete nje intelektual i ardhur nga shtresat pasadomethene ay Koci. nike, si Enveri, por nje proletar, i ardhur nga shtresa puntore. "Tamam ne ke" te kohe hidhet parulla: "Udheheqja e Partise eshte berthama proletare e Komitetit qendror" (domethene se udheheqja nuk eshte Enveri, por Koci i Xoxes). Konform kesaj parulle, qe nga plenumi i 8-te ndiqet nje taktike krejt e re. Kooptohen ne K.Q. shume elemente te lidhur me miqesira personale me Koci Xoxen, zakonisht ~~kontaxe~~ me origjine puntore dhe goditet elementi intelektual lart dhe ne baze te partise. Duke qene ne krye te Sigurimit (Ministris se brendeshme) Koci i Xoxes organizon ne kete kohe edhe nje seri gjyqesh, ku imolikon elemente te cilet me von, sipas planit te tij, parashikon t'i perdore ne nje gjyq te madh drejtuar kunder Nako Spiros, Mehmet Shehut, Enver Hoxhes,

SECRET

SECRET

Koci
 etj. ~~ky~~/shkon aqe larg ne kete rruge sa organizon gjurminin e Bedri Spahiu,
 Liri Pelishoves, Nako Spirut, Mehmet Shehut, etj. Ne nje atmosferë te tille,
 Nako Spirua vret veten. Koci e peruor kete vetevrasje si rast per te forcuar
 edhe me teper pozitën e tij dhe per ta perdorur si pretekst se akuzat e tij
 ne plenumin e 8-te qane te verteta. Vetevrasja e Nakos i dobeson edhe me teper
 pozitën e ~~ky~~ Enverit, partizanet e te cilit ~~ky~~ n'ate kohe (si Bedri Spahiu,
 Mehmet Shehu, Liri Pelishova, Beqir Balluku, etj) jane izoluar dhe e kane hu-
 mbur forcen ne dobi te partizaneve te Koci Xoxes (Kristo Themelko, Pandi Kristo,
 Nesti Berenxhiu, Xexhi Blushi, etj). Situata eshte e tille sa qe cdo gje le
 te parashikohet se fraksioni Koci Xoxist brenda partise eshte ne prapun ^{je te jape} e nje
 goditje ~~je~~ te re, goditje e cila do te eliminoje nga udhheqja Enver Dohnen dhe
 mbeturinat e partizaneve te tij ne K.Q. te PKSh. Mirepo pikorisht ne kete mo-
 ment dalin letrat e K.Q. te Partis komuniste boleshevike te Bashkimit Sovjetik
 drejtuar K.Q. te Partis komuniste jugosllave, me von denimi i Titos nga Kom-
 nformi dhe, si pasoje, shkeputja e Beogradit nga Moska. Ne kete situatë, Enveri
 vepron me energjikisht se Koci i Xoxes, e cfrytezon rastin, dhe shpeton pozitën
 e tij dhe ndofta, edhe koken e tij. Koci i Xoxes, qe ishte ne vigjiljen e
 triumfit, falimenton. Plenumi i XI-te i Komitetit qendror te PKSh vendos, ne
 dualitetin Moske-Beograd, te ~~ky~~ mare anen e Moskes.

Dhe qe ketu, domethene qe nga gushti i 1948 fillon pika e katert. Tere
 plani jugosllav, zbatuar ne Shqiperi me anen e Koci Xoxes, falimenton. Enveri
 e paraqet veten si kundërshtar te Beogradit (ne fakt, kundërshtar i Beogradit
 ishte Nako Spirua). Enveri, ^{na qane, me teper, nje "neutral"} per jugosllavet, ~~si te personi i padosur dhe ne~~
~~ky te Komitetit qendror~~ Megjithkete, ^{at} Enveri mer edhe meritat e Nakos, e pa-
 raqit veten ~~ky~~ si shpetimtar te partise, "si element qe ka kundërshtuar ju-
 gosllavet", etj. Qe nga ky cast, pozitën e Kocit ne parti e qeveri jane zero.
 Partizanet e tij izolohen politikisht. Ay, domethene Koci, akuzohet per tradh-
 eti ndaj partise e popullit. Dhe se bashku me 'te edhe dora e djathte e tij:
 Pandi Kristo, e me radhe: Vaske Koleci (drejtor i Sigurimit), Kristo Themelkua
~~ky~~ (minister i luftes), Nesti Berenxhiu (president i Komisionit te pla-
 nit), etj. etj., pa permendur ketu persona te dores se dyte si Vango Mitrojo-
 rgji, Nuri Huta, Niko Qari, ~~ky~~ qe u denuan me burgim.

Dhe ketu, me pushkatimin e Koci Xoxes ne majin e 1949 mer fund "ceshtja
 Koci Xoxes", ne kuptimin e ngushte. Per hollesira me te gjera reth kesaj pye-
 tjeje shih peggjigjen e meposhteme.

SECRET

SECRET

PERGJEGJE PYETJES XXVIII-te

Pas denimit te Koci Xoxes cila ishte situata ne Shqiperi, Me cilen menyre ven-
roi titizmi ndaj P.K. shqiptare. Kush dhe sa nga elementet e njohur titiste
ruajne brenda partis e gjirit te qeveris pozitivat e mepareshme. Cili ka qene
orientimi i Moskës ne lidhje me situaten e re te krijuar ne Shqiperi.

Dihet se per te realizuar planin e tij te torpillimit, (ne krye te Nakos) e pastaj te Enverit, Koci i Xoxes e rethoi veten me nje numur komunistesh miq personale te tij, te cilet gradualisht, gjate periodes 1945-1947, i ngriti nga ^{deri} ~~nga~~ ^{deri} ne udheheqaje te Komitetit qendror ose deri ne Byron politike. Nga keta persona te njohur si besnike te Kocit dhe njerez te tij, vemend:

Naxhije Dumen (grua e Nesti Kerenxhiut), bere edhe ministre e aresimit ~~aty~~ nga 1947, Nesti Kerenxhine, ne fillim drejtor i Sigurimit dhe pastaj president i Komisionit te planit (ne vend te Nako Spiros), Petro Papin, president i Bashkimeve profesionale te Shqiperise (ne vend te Tuk Jakoves), Vaske Kolecin (bere drejtor i Sigurimit) nje fare Dhimitri ^{mbiemri} ~~(nuk)~~ /nuk me kujtohet) dhe bere president i Rinise shqiptare; Xhoxhi Blushi (bere shef i komisionit te kontrollit te Republikes) Pallumb Dishnica (bere drejtor politik i ushtrise shqiptare), Kico Ngjela (bere nendrejtor i kuadrit prane Komitetit Qendror), Rahman Perlaku (bere gjeneral).

Krahas kesaj politike, per te ngritur ne poste me pergjegjesi njerez te rinj te tijte, Koci i Xoxes afron ~~me~~ pas vetes elemente te vjeter te Komitetit qendror, si: Pandi Kriston, ~~Kristo~~ Kristo Themelkon dhe Ramadan Citakun.

Se treti, av izolon ose perjashton nga Komiteti qendror dhe postet e tyre te tjera me rendesi nje varg eksponentesh te tjere te vjeter te Partise si: Bedri Spahiu, Mehmet Shehu, Nako Spirun, Liri Delishoven, Spiro Koleken, Manol Konomin.

Pas kongresit te pare (qe shenon fitoren e Enver Hoxhes mbi Koci Xoxen) dhe pushkatimit te ketij te fundit, njerezit e Koci Xoxes i humbin pozitivat e fituara me perkrahjen e tij:

Pandi Kristua dhe Vaske Koleci (pa permendur ketu Vango Mitrojorgjin, Muri Hutin, Niko Oparin qe jane te dores se dyte) u burgosen.

Naxhije Duma, Nesti Kerenxhiu, Petro Papi, Dhimitri S, Xhoxhi Blushi, Pellumb Dishnica, Kico Ngjela, Ramadan Citaku, Rahman Perlaku dhe Kristo Themelkua, antare te Komitetit qendror ose disa prej tyre edhe te Byrose politike, perjashtohen nga cdo forum i Partise ~~me~~ me pergjegjesi.

Perkundrazi, elementi i njohur si fillo-enverist rifiton dhe me bollek,

SECRET

- 107 -
~~SECRET~~

bile, pozitë e patura. Te tille janë: Mehmet Shehu, Bedri Spahiu, Liri Be-
lishova, Pilo Peristeri, Tuk Jakova, Manol Konomi, Spiro Koleka, etj. (Disa
nga këta, si Bedri Spahiu, Tuk Jakova e Manol Konomi u topilluan nga Mehmet
Shehu, politika e të cilit ka qenë sa më pak konkurrenca të rrezikshme reth
vetes).

Ne këtë mënyrë, pra, elementi i njohur si fillo-kocist brenda udhëheqjes
se Komitetit Qendror të P.K. shqiptarë, u eliminua. Duke humbur pozitë të
kishte, atë nuk që në gjendje t'i sillte demë dhe pengesa partise, aqë më të-
per sepse, në përfitësi, shumica e tyre qenë "parvenu", njëzëri pa influ-
-enca personale në parti, të ngritur në poste udhëheqëse vetëm e vetëm nga
politika sektariste dhe personale e bërë gjatë kohëve prej Koci Xoxes. A mund
të konsiderohen këta elemente si njëzëri me parime titoiste, si persona poli-
tike që kanë ndjekur një vijë të tyre personale nuk besoj. Ata kanë qenë
me 2.3 (vetëm vegla të përdorura nga Koci i Xoxes; me fjalë të tjera, jo kuaj race
ose hipodromi, por kuaj bartjeje dhe parmendë.

Eksperiencë e imë dhe njohurit e mija më bëjnë të avancoj gjithashtu një
teze tjetër: tezen se në Komitetin Qendror të Partisë komuniste nuk ka
asnjë tani një rrymë titoiste. Elementet që ishin koshiente të lodrës
se tyre (si Koci i Xoxes, Pandi i Aristos, Nesti Berenxhiu) janë prerë
me kohë thonjtë. Elementet e tjerë, si Naxhi Plushi, Petro Lapi, Xhaxhi Kollari
Dhimitri etj., as që mendoj se do të hyjnë ndonjë herë në Komitetin Qendror.
Pse? Sepse/meritat e tyre kanë qenë zero dhe janë zero, qoftë si njëzëri poli-
tike, qoftë si njëzëri organizatore.

Përpara se t'i jap fund kësaj pyetjeje dua të theksoj orientimin e ri
dhe në Tiranë pas shpërndarjes së saj prej Beogradit. Ky orientim synonte:

1.- Partia komuniste, që deri atëherë kishte qenë sekrete, ilegale, të
dilta hapur në dritë sepse nuk kishte asnjë kuptim që një parti që dominonte
vendin të qëndronte e panjohur nga masa e popullit.

2.- Në lëmin e politikës se jashtme. Bashkimi Sovjetik është "drita, feta,
miku i vetëm dhe i madh i Shqipërisë". Besnikëria ndaj Bashkimit Sovjetik është
metri që matëdo parti komuniste. Parulla e vjetër: "Bashkimi me Moskën kalon
nëpërmjet Beogradit", denohet si anti-komuniste.

3.- Në lëmin ekonomik: Të forcohet lufta e klasave, të krijohen sa më
shumë kooperativa në fshat, sepse prapa e vogël individuale lind gradualisht
dhe sistematikisht elemente të rinj kapitaliste në strukturën socialiste të

~~SECRET~~

~~SECRET~~

regjimit te ri ne Shqiperi.

4.- Ne lemin industrial: Te shpejtohet ritmi i industrializimit, sepse industria eshte baze e sukseseve.

5.- Ne lemin propagandistik: Gjerija e veshtire ekonomike t'i hidhet blac-
kitjes jugosllave; te gjitha gabimet brenda partis dhe jashte saj t'i hidhen
Koci Aoxes, si zbatues i urdherave te Beogradit, dhe krahas me kete, te premtor-
het sa me publikisht se te gjitha padrejtesite kunder individeve dhe antareve
te partis do te ndreqen me orientimin e ri; te ashpersohet demaskimi i fuqive
perendimore, si "fuqi imperiaiste, borgeze, kapitaliste", si fuqi "armike te
Shqiperise, si agjentura spiunazhi, etj. duke futur ne kete numur edhe Jugosla-
vine me Titon".

Dhe ketu i jap fund edhe kesaj pvetjeje per te kaluaren ne ate qe pason.

SECRET

SECRET

PERGJIGJE PYETJES XXIX-te

Pas rivendosjes se maredhenieve Moske-Beograd cila ka qene narshtypja ne radhet e bazes se partise. Cili nga eksponentet e partise konsiderohet fillo-titist.

Pyetja e lart-permandur permban dy ceshtje.

Pikes se dyte i jam pergjigjur ne pyetjen e XXVIII, domethene ne pyetjen e nepareshme.

~~Rikonsiderohet~~ Mbi piken e pare kam te thom sa vijon:

Personalisht nuk kam qene ne Shqiperi kur eshte kryer rivendosja e maredhenieve Beograd-Moske. Kam gati dy vjet qe ndodhem ne Greqi, dhe pikerisht qe nga nondori i vitit 1954. Megjithetete, jam opinionin tim personal, duke u bazuar vetem ne eksperiencen time te fituar gjate qendrimit ne Shqiperi.

Qe rivendosja e maredhenieve Moske-Beograd ka shkakeluar nje ~~pergjigje~~ pershtypje habije ne parti dhe ne popull, ne pergjithesi, kjo vet-kuptohet. Mirepo, ne kete drejtim duhet pranuar se ~~partia~~ e zoteron mire situaten, se ajo ka nje aparat shume te gjere e te afte me anen e se cilit eshte ne gjendje ta perballoje habine dhe ta beje masen e partise qe te besoje se rivendosja e maredhenieve Beograd-Moske eshte shume pozitive edhe per Shqiperine. Ne fakt, asnje anetar partie ne Shqiperi nuk e pelqente dhe as e shikonte me sy te mire rethimin ~~gjeografik~~ gjeografik te Shqiperise nga shtete armiq (Italia ne perendim, Jugosllavia ne Lindje, Greqia ne Juge). Qenia e Jugosllavise si shtet jo amik i Shqiperise, pra, nuk mundet vecse te kenaqe nje aspirate te thelle te komunisteve shqiptare. Dhe kjo, jo vetem sepse thyhet "rethimi gjeografik" i Shqiperise, por edhe sepse lidhjet tregetare e ekonomike te Shqiperise behen me te lehta me shtetet e tjere te lindjes, per vete faktin se celet nje korridor neper token jugosllave, korridor qe ish mbyllur ^{edhe per korrespondencen postale} (sa kohe qe maredheniet Moske-Beograd ishin te acaruar. Pastaj Shqiperia ka interes direkt qe te importoje dhe te eksportoje sende nga Jugosllavia, sepse transporti eshte jashtezakonisht i lehte dhe i pakostueshem.

Por, ketu del pyetja: A do te deshte baza e Partise dhe populli shqiptar qe Tirana, sikurse ne te kaluaren, te kthehet perseri ne nje gjysme koloni te Beogradit, ku ligjin ta bejne jugosllavet? Personalisht thom se as Partia, as populli nuk do te donin qe te viheshin nden thundren jugosllave. Duan maredhenie ne nivel te barabarte, por jo neneshtim.

A ka ne plan Moskta t'ia lere vendin e saj, si ne te kaluaren, Beogradit? ^{ne Shqiperi} ^{po evaluan eventualisht drejt nje zgjidhjeje te tille,} Na Shenjat tregojne se ~~drejtimi~~ situata ~~te moske-beogradit~~ ^{te moske-beogradit} shkojne prap, ne baze sht me

SECRET

SECRET

shumë ~~konkrete~~ natyrisht me shumë gadal, me shumë kudes, me shumë takt. ^{for veçem shenja - e persent.} Opinioni tim është se Partia komuniste shqiptare, po të jete ~~duke~~ i tillë orientimi final i Moskës, do t'i bindet këtij udhezimi, sado që me gjysmë zemre. Por opinioni tim është: Ky eventualitet, eventualiteti që Beogradi të marrë perseri në Shqipëri tërë autoritetin, prestigjin dhe lirinë e veprimt qe kishte në Shqipëri në vitet ~~1945~~ 1946-1947, duke zëvendësuar kryekeput Moskën, me duket të perserit personalisht - se është një konkluzion ~~shumë i rëndësishëm~~ i nxjerrë ngutëshëm. Aqë më tepër është konkluzion i ngutëshëm - gjithmone sipas meje - po të parashikohet që ky eventualitet të behet në të ardhmen e afërte.

SECRET

SECRET

- 131 -

PERGJIGJE PYETJES SE XXX-te

Cilat jane veprat e krijuara deri me sot nga pushteti komunist ne Shqiperi.
Ç' rezultate ka arritur deri me sot ky regjim ne lëmin politik-ekonomik.

Pyetja ne fjale ka dy nenepika. Per t'iu pergjigjur se pares nevojiten me doemos qe te disponoj disa dokumenta, sepse boshlleqet ne kujtesen time jane teper te medha. Ku te mbaj mend c'ja-ne ndertuar ne Shqiperi brenda ll vjeteve qe kane pasuar 1944-enë Megjithëte, deri sa me kerkohet, do te perpiqem te rjeshtoj ketu poshte ato objekte te cilat i mbaj mend. Sidoqofte, e perse-rit, jashte listes qe poshte-shenoj mboten nje numur ~~xx~~ i madh veprash te nder tuara nga komunistet qe s'me kujtchen ose nuk i di.

Per t'u shpjeguar me lehte, keto ~~xxxxx~~ vepra te ndertuara do t'i ndaj ne 5 kategori:

- a) Vepra te ndertuara ne fushen e kultures.
- b) Vepra te ndertuara ne fushen e bujqesis.
- c) Vepra te ndertuara ne fushen e industri-minierave
- d) Vepra te ndertuara ne fushen e ndertimit
- e) Vepra te ndertuara ne fushen e transportit.

NE FUSHEN E KULTURES: Ne kete fushe, regjimi komunist ka ndertuar vetem nje objekt material te rendesishem qe vlen per t'u shenuar.

Ky objekt material i ndertuar eshte Kino-Studioja "Shqiperia e Re". Inaugurimi i kesaj vepre u be aty nga 1958. Ndodhet ne Veri te Tiranes. Jane nje varg godinash me arkitekture te bukur (ne krahasim me objektet e tjere te ndertuar ne Shqiperi) dhe te patisura me makineri e mjete moderne per prodhimin e filmave kinematografike. Di se regjimi komunist eshte bere pishman qe ndemori dhe harxhoj per ndertimin e ketij objekti artistik fonde jashtezakonisht te medha per buxhetin e varfer te Shqiperise, aco me teper, sepse per mungese artistesh, kuadri te specializuar e fondesh, godinat dhe ^{sidomos} pajisjet mekanike te Kino-technikave Studios "Shqiperia e re" qendrojne te pa cfrytezuara. Bullgaria, me mjete ~~xxx~~ shume me te varfra se sa te Shqiperis ne kete fushe ka arritur te nxjerre disa filma bullgare; Shqiperia, / me mjetet teknike qe disponon / ka arritur te prodhoje vetem disa dokumentare te zakoneshem propagandistike, dhe te qarkullueshem, per kalitetin e tyre, ^{te dabet,} ~~vetem~~ brenda vendit. Pikerisht per kete, ndertimi i Kino-Studios eshte konsideruar nga te gjithë si nje "lluks i teoert", ~~shox~~ "harxhim i kote" dhe "investim inrentable".

Objektet e tjera materiale te ndertuara ne fushen e kultures, si shkolla, gjimnaze, etj, jane fare te zakoneshme keshtu qe nuk ia vlen barra qirase t'i permendesh.

SECRET

SECRET

- 132 -

Ne fushen e kultures realizime te mira (si sasi, jo si cilesi) jane arri-
tur ne krijimin e grupeve artistike. Permend ne kete drejtim:

a) Theatrin e Shtetit (si grup artistik, jo si objekt material). Me per-
para Shqiperia nuk kish as nje grup teatral profesionist.

b) Filharmonin e shtetit (si grup artistik, jo si godine). Perfshin mal-
simumi nja 60-70 instrumentiste. Eshte e para orkester simfonike ne Shqiperi.

c) Baletin e shtetit. Perfshin maksimumi gjithashtu 40-50 te rinj ~~xxx~~ e
te reja, qe me teper se sa danse klasike, bejne ~~gjin~~ gjimnastike suedeze!
Me gjith kete, ky grup ka vene ne skene disa cfaqje klasike ("Esmeralda",
"Shatrivani i Bahçi Sarajt", etj). Eshte i mire si grup folkloristik.

d) Estrada e shtetit. Perfshin maksimumi 40 vete. Eshte nje fare cir-
kusi ne embrion.

e) Korri i Shtetit. Perfshin reth 60-70 vete. Ndofta realizimi me kua-
litativ nga te gjitha krijimet e tjera ne kete fushë.

f) Opera e shtetit. Perfshin disa soliste. Ka dhene dhe jep cfaqje lirike
kurdoqare ne bashkepunim me korrik. "Rusalka", "Ivan Susanjini" e pergjithe-
sisht njese te lehta operash ruse.

Krahës ketyre grupeve artistike, jane krijuar:

- a) Muzeumi i shkencave te natyres.
- b) Muzeumi etnologjike-arkeologjik
- c) Muzeumi i Luftes Nacional-Glirimtare
- d) Galeria e piktures dhe skulptures
- e) Biblioteka qendrore shteterore e Tiranes, qe ~~me shpejti~~

Ne analize te fundit le te shtoj krijimin e disa instucioneve te ndr-
vshme si:

a) krijimin e Institutit te shkencave qe meret me kerkime ne fushat e
ndryshme shkencore: klima e Shqiperis, gjuha e Shqiperis, historia e Shqiperis,
bijqesia shqiptare, etj.

b) krijimin e ~~shkencave~~ fakulteteve te arsimit te larte (Politeknikum,
Mjekesi, Drejtesi, Pedagogji, Shkenca politike, etj). Jane te parat shkolla te
arsimit te larte ne Shqiperi. Funkcionimi i tyre ka filluar aty nga 1950. Fre-
kuentohen shume.

Pervec ketyre, ne fushen e kultures, shenohet nje zgjerim i ^{marthi} rjetit arsi-
mor te mesem e fillor, nje zgjerim i sallave kinematografike, krijimi i disa
stadiumeve moderne sportive (Tirane, Korçe, Shkoder), perkthime e botime me

SECRET

SECRET

te shpeshta e me te shumta se sa ne te kaluarene ne letersi, krijimin e shume kurseve ~~kurse~~ kunder analfabetizmit, etj.

Ne pergjithesi, re kete fushe, ne fushen e kultures, realizimet jane te medha e te rëndesishme ne Shqiperi. Mirepo ato jane te medha vetem ne sasi dhe shume te vogela ne cilesi. Shojgohem: Ka shume shkolla, shume grupe artistike, shume qendra te ndryshme kulturalore por edukata qe merret nga keto shkolla, grupe dhe qendra te ndryshme eshte shume e nje-aneshme. Ato jane mjete propagande, mjete ~~mbledhje~~ per edukimin e masave me vijen e Partise, dhe jo burime edukimi real. Cdo gje, ne kete front, i neneshtrohet interesave te Partise, vijes se partis.

NE FUSHEN E BUJQESIS.- Ne kete fushe, politika e partis ka qene kurdohere, gjate te ll vjeteve qe pasojne clirimin, e paqendrueshme, hezituese. Here shteti terheq nga fondet buxhetare parashikuar per investimet ne industri dhe i harxhon per sektorin e bujqesis, here terheq nga fondet e parashikuara ne bujqesi dhe i investon ne objekte industriale. Here e ka konsideruar sektorin e bujqesis si te dores se pare, dhe here tjetër (kjo ka ndodhur me shpesh) e kaluar ne plan te dyte, duke i dhene -sipas udhezimeve dhe orientimit sovjetik- prioritetin absolut sektorit industrial. Keto fluktuacione nuk mund te mos kene patur pasoja te rënda per bujqesine shqiptare, aq me teper, sepse edhe vete programi i kulturave bujqesore ~~konstruksion~~ qe duheshin mbjellur sipas parashikimeve here i jepte prioritet bimeve industriale (pambukut, lule diellit, duhanit, panxhar-sheqerit) here bimeve cereale (grurit, miserit, thekerit). Pa keto sondazhe te demeshme here me te djathte here me te majte, pa kete politike hezitimi qe here i jepte rendesi bujqesis here e kalonte ne plan te dyte, kam bindjen se nje politike konsequente ~~me~~ e ^{shpesh} përpilluar e studiuar mire, do te jepte rezultate pozitive ne Shqiperi. Sado qe vend malor, Shqiperia (me pak me qepet se me nallin baltore) nuk eshte e varfer ne toka pjellore. E keqja eshte se shumica e tokave te pershtateshme per bujqesi (Vurgu, Myzeqeja, Zadrima, fusha e Durrësit, etj) jane te mbuluara nga ~~kaneta~~, ose pa kanale kullues, gje qe shkaketon inondata te shpeshta pikerisht ne zonat me pjellore.

Parmend ne kete drejtim, objektet me te rëndesishme te ~~konstruksion~~ ndertuara nga shteti shqiptar ne lëmin e bujqesis:

a) Tharrja e kenetes se Maliqit ne Korce, tharrje e cila i dha bujqesis -ne mos gabojme- ndonje zero ne fund- reth 2500 hektare toke te re shume ~~mbjellur~~ pjellore.

SECRET

SECRET

- b) Celja e kanalit vadites Vjose-Levan-Fier, afersisht 60 kilometra i gjate, ne Juge te Shqiperis.
- c) Punimet ne vazhdim e siper per kanaline e Gjadrit ne Zadrane (qarku i Shkodres) me anen e te cilit, nemos gaboj do te fitohen 2/000 ha toke te reja.
- d) Punimet ne vazhdim e siper per tharrjen e kenetes ne Terbufit ne qarkun e Beratit.
- e) Celja e kanalit Naum Panxhi ne Elbasan. Mbi dobite e tij nuk mund te permend ndonje shifer se s'me kujtohet.
- f) Disa kanale (shume me te kufizuar se sa ay i Vjose-Levan-Fierit) ne qarkun e Tiranes, qarkun e Kukesit, qarkun e Dibres, qarkun e Gjirokastrës dhe qarkun e Durrësit e Beratit.

Perveç punimeve ne lëmin e bonifikimit, ne sektorin e bujqesis duhet te permend edhe ndertimin e fermave shteterore (disa prej ketyre teper te pasura, si ajo e Kamzes, e Sukthit, etj), krijimin e disa stacioneve zo^{e nderymi}oteknike (per permiresimin e racave te bagetive (Shkodra ka stacionin zo^{e nderymi}oteknik me te madh) krijimin e shume fidanishteve pemore (qofte ne Juge, qofte ne Veri te Shqiperise) dhe, ne analize te fundit, planin pesevjecar te pyllzimeve, plan i cili ka qene i studiuar mire dhe eshte i vetmi qe eshte realizuar objektivist e realisht me shpejt se sa parashikimet, pa pesuar ndryshime e zvogelime ne prapaskene.

Duhet pranuar se ne krahasim me kohen e Zogut, prodhimi bujqesor ne Shqiperi eshte situar shume, sidomos persa u perket bimeve industriale (edhe gruri e misri shenojne shtesa te mira), mirepo duhet ditur se prodhimi i bujqesis jashtezakonisht te prapambetur e primitive shqiptare te kohes se Zogut nuk mund te sherbeje si baze reale per te krahasuar perparimet. Cili vend i botes, nuk ka shenuar perparime ne prodhimet bujqesore brenda ~~ibrojstaxx~~ vjeteve qe pasuan mbarimin e luftes. Mundësitë reale te Shqiperise, baza e saj, kane te gjitha te dhenat qe prodhimi bujqesor te ishte shume me i madh se sa sot po te ish^o ndjekur nje orientim jo i influencuar nga interesa te huaja.

NE FUSHEN E INDUSTRI & MINIERAVE.-- Ne kete fushe, sukseset jane shume me te medha se sa ato te sektorit bujqesor. Kjo per dy arsye kryesore:

- a) sepse i tille ka qene orientimi i partis ne fushen ekonomike: Prioritet

SECRET

SECRET

absolut industrise.

b) sepse vete nenetoka e Shqiperise eshte e pasur.

Le te permend, ketu poshte, ato objekte materiale qe jane ndertuar ne kete fushe gjate viteve te pushtetit komunist ne Shqiperi. (Me mire le te thom ato objekte qe mbaj mend).

- 2-3 fabrika per cveshjen e orizit (sidomos Shqiperi euge-Lindore), kapaciteti i te cilave eshte i mjafte per krejt prodhimin shqiptar te orizit.

- 2-3 fabrika vaji te rendesishme (nuk permend punishtet e vogla), si ajo se bashku me ato qe ekzistonin perpara e Vlores e Fierit, me kapacitet/per krejt prodhimin shqiptar te ullirit dhe farerave oleogjinoze te prodhuara ne vend.

- 2 fabrika per cveshjen e pambukut (ne Shqiperin e Mesme) me kapacitet per te plotesuar nevojat e vendit dhe, edhe per eksport.

- 1 Fabrike cimentoje ne Vlore, e cila, duke iu shtuar fabrikes se vjeter te Shkodres, duhet te plotesoje, sipas parashikimeve, te gjitha nevojat e vendit.

- Nje fabrike konservash ne Vlore (kapaciteti nuk me kujtohet, por parashikoheshe ~~maximal~~ si objekt i rendesishem, natyrisht jo i afte per te plotesuar nevojat e popullsisë).

- Nje fabrike sheqeri (nga panxhari), ne Maliq (narku i Korces), me kapacitet vjeter 100.000 tonellata ne vit, domethene i mjafte per konsumin e krejt popullsisë shqiptare.

- Nje kombinat druri (kontraqlaqe, drrasa, rimesso, trane, etj) ne Elbasan -kapaciteti i te cilit nuk me kujtohet, por di se konsideroheshe nje nga veprat me te medha qe kishin filluar nga funksionimi.

- Nje oficine mekanike, Uzina "Enver", ne Tirane me reparte saldatoresh, tornituroresh, skrirjeje, etj.

- Nje Kombinat tekstili, me emrin "Stalin", me afersit e Tiranës, me kapacitet vjeter 20.000 metra linear te pambukta ne vit (domethene me prodhim te mjafte per nevojat e krejt popullsisë shqiptare ne tekstile).

- Nje fabrike per stofra te leshta, afer Kombinatatit te tekstitit, me kapacitet vjeter 9.000 metra linear ne vit (pra, jo me prodhim te mjafte per nevojat e popullsisë).

- Nje kombinat zdrukthetarie, ay me emrin "Misto Mame", ne afersit e Tiranës, per prodhimin me shumice e ne seri te mobiljeve dhe prodhimeve te tjera te kesaj natyre, me kapacitet nuk e di por me reth 2.500 puntore (nemos gaboj).

SECRET

~~SECRET~~

- Nje fabrike per fermentimin e duhanit ne Shkoder, ~~ndosha s'hoj ne kava-~~
~~ndosha s'hoj reth 10 kv. ne vit (Prodhim duhani i caktuar krye-~~
 sisht per eksportacion).

- Centrali hidroelektrik "Lenin", ne Dajti, se bashku me kondotin e ujit
 per nevojat e popullsis se kryeqytetit. Me perpara Tirana furnizoheshe me ener-
 gjji elektrike te prodhuar me lende djegese. Kapacitetin e ketij hidrocentrali
 e kam harruar. Por di se punimet per ndertimin e ketij hidrocentrali i kane
 kushtuar lesht e kokes popullit shqiptar. Eshte numuar qe nga 1946 deri me
 1951. Jane celur tunele e galeri qe kane thethitur miliona leke, brenda malit.
 Me nje projekt te studiuar me mire, Shqiperia mund te kish bere 10 centrale
 te tille, ne vende te tjera me te favoreshme, duke harzhuar po ato te holla.
 Sot pranohet ne Shqiperi nga te gjithë se ndertimi i ketij hidrocentrali ishte
 nje ndermarrje e marrezishme. Shteti dha 3 para qe te hynte ne fillim ne valle
 por do te ish i kenaqur sikur te paguante 100 grshe dhe te dilte. Mirepo ruaj-
 tja e prestigjii (sepse ishte objekti i pare i madh q'u fillua te ndertoheshe
 me buje), e detyroi partine, desh i s'deshi, ta hiqte vallen deri ne fund. Ky
 objekt ka nje histori te vacante: filloi si objekt qe duhej mbaruar brenda pla-
 nit te pare njevjecar, u kalua ne planin e dyte ~~xxvjetor~~ dyvjecar - por edhe
 ketu nuk u realizua dhe, sado qe nuk figuror ne objektet e planit te pare pe-
 sevjecar, ky hidrocentral mbaroi brenda pesevjecarit. Partia perhapi indirekt
 parullen, atehere, se hidrocentrali "Lenin" iu imponua qeverise nga injoranca
 dhe pazotesia e teknikeve jugosllave, te cilat i bene, ne projektin e tyre, hesa-
 pet pa hanxhine.

- Hidrocentrali elektrik i Matit. Veptra me e miche ne Shqiperi. Ndertimi
 i tij ishte parashikuar brenda pesevjecarit te pare (domethene duhet te kish
 mbaruar ne fund te 1955). Kapacitetin e tij ne kw nuk e mbaj mend por di se
 ky hidrocentral parashikohet te furnizoje me energji elektrike gati krejt
 Shqiperine, qytete e fshatra, duke perfshire tere vendin ne nje rrjet te vetem
~~energjetic~~ ^{energjetic}. Ndertimi i tij parashikon krijimin e nje liqeni artificial ne gryken
 e Matit, barazhe te larte, ~~at~~ shpernguljen e disa katundeve te perhapura ne
 kete zone, etj. Investimet teper te medha qe kerkonte dhe orientimi i ri sovje-
 tik e detyruan Partine ^{komuniste shqiptare qe te} ~~te kerkonte~~ shtyje afatin e ndertimit te tij deri nga
 fundi i 1957-es. Punimet ne kete kantier kane thethire nje pjese dermuese te
 buxhetit shqiptar per pesevjet resht dhe mijra krahe pune. Eshte nje

SECRET

SECRET

veper ndertimi i te cilit mund te priste te pakten edhe 10 vjet^e bile edhe
 me terer po te meren parasysh se ver Shqiperine/ ^{e sotme,} ky kollos eshte si nje kollan
 xhevahresh ne qafen e nje dose; ose si nje brillant i cmueshem ne ~~xxxx~~ ^{gishtin} e nje
 lopesix te uritur e te reckosur^e.

- Kombinati i distileris dhe i Rafinerise ne Cerrik. Kapaciteti i tij nuk
 me kujtohet. Por eshte edhe ky, nje nga ndermarjet me te medha ne Shqiperi,
 ndofta i dyti pas hidrocentralit te Matit. Bikerisht si ky i fundit, edhe
 punimet e Cerrikut qe parashikoheshin te mbaroheshin ne mbarim te pesevjecarit
 (1955), ~~me~~ u shtyne deri nga fundi i 1957. (6) Dobia e ketij kombinati do te
 jete rafinerimi dhe distilimi i vajgurrit te Kucove-Patosit. Kapaciteti i tij,
 parashikohet te mjaftoje per konsumin shqiptar dhe te mbetet edhe per eksport
 (deri me sot, Shqiperia ^{e?} eksporton vajgurrit brut).

- Ndertimi i nje kantieri ne Durres per riparimin dhe fabrikimin e var-
 kave ose anijeve me nje tonelazh te vogel, per udhetime ose transport gjate ^{qendret}
 bregdetit shqiptar.

- Ndertimin e disa sharrave per prerje drunjesh, me kapacitet te mjafte
 per nevojat e vendit dhe eksport, sidomos ne Veri te Shqiperise: Fuke, Balze,
 etj.

Parpara se te kaloj ne minierat, le te shtoj se gjith industria e vogel
 e perodes zoviste e italiane, qe ishte prone private, eshte shtetezuar, per-
 qendruar me pak qendra (jo e decentralizuar dhe ~~xxxx~~ dhe pak rentable sic qe).
 Keshtu ndodh, per shembull, me disa fabrike kepucesh, se cilave u jane shtuar
 edhe mjete te reja, me disa fabrika lekuresh (te pajisura ^{edhe} me mjete te reja),
 me disa fabrika te vogla marmelladash, cigaresh, porcelanash, tekstili e cora-
 pesh, oficina mekanike dhe qendra te tjera riparimi (sidomos keto jane pajisur
 me mjaft makineri te reja), centrale elektrike me lende djegese, etj. etj.

Ne sektorin e minierave nuk mund te thuhet se ka objekte ~~matxirike~~ qe kane
 filluar nga cfrytezimi vetem pas clirimit. Por keto objekte, qe norsa ishin
 vene ne cfrytezim nga italianet, ose ndofta sapo ishin zbuluar, tani japin nje
 rendiment te madh. Kucova e Patosi, per shembull, japin lart nga 8000 perqind
 me terer se perpara, minierat e Kromit (ne Krabe etj) lart nga 6000 perqind,
 po keshtu (edhe per minierat e qymyr-gurrit, te pises, trunxhit ase bakrit,
 hekurit, etj. Ne sektorin e minierave jane bere edhe shume zbulime te reja
 minerale por cfrytezimi i ~~xxxx~~ ^{tyre} nuk ka filluar ne stil te gjere. Parashi-
 kime te medha ne kete drejtim ~~parashikim~~ ^{ben} sidomos plani i dyte pesevjecar, i

SECRET

~~SECRET~~

cili ka si orientim kryesor dhe bazal shtimin e produkteve te nenetokes per perioden 1956-1960, dhe jo, si i pari, ndertimin e objekteve industriale.

Mendoj se ne pergjithesi nje politike industriale qe te drejtoheshe ne vija me te trasha drejt prodhimeve te mallrave te konsumit te gjere (konserva, peshkim, artikuj korrente) do t'i ishte shume me i nevojshem Shqiperise.

NE FUSHEN E NDERTIMIT/- Realizimet me te madh te ketij sektori jane bere gjate viteve 1945-1946, domethene gjate periodes se rindertimit te shkaterrimeve te lena nga lufta dhe okupacioni. Nuk ka objekte te medha te rindertuara (me perjashtim te portit te Durrasit, puseve te Kucoves, ~~etj~~ dhe ndonje objekti tjeter), por shume kilometra rruge, shume ura, shume shtepi te perhapura ne te gjith vendin.

Sidoqofte, vitet e fundit, ne kete sektor, ~~XXXXXXXXXX~~ vlen te permeniden disa ndertime:

- Godinat e ^{ngritura} ngritura ne Tirane gjate viteve 1952 e ketej, kapaciteti i te cilave, deri me 1954, ishte, vetem per brenda qytetit, ne afro 20.000 vete maksimumi. (Te shtrydhur sikurse banojne familjet ne Shqiperi, ku mungesa e banesave, sidomos neper qytetet, eshte jashtezakonisht e madhe).

- Godinat e ndertuara per fjeteje prane qendrave te medha te punes: Kucov Patos, Maliq, ~~Tirane~~ rrethet e Tiranes, ferma bujqesore shteterore, etj. Pikerisht keto qendra te punes kane ngrene edhe fondin me te madh shtetror parashikuar per ndertime banesash.

-Disa spitale, si ay i Gjirokastrës, shkolla dhe Fakultetet e Tiranes.

Shukurt, gjera shume te pakta dhe jashtezakonisht te pamjaftueshme per nevojat e popullsisë. Sa per dijeni le te permend se ka familje, te perbera vetem nga dy veta, qe nuk jane martuar akoma dhe qendrojne te fejuara per 3 dhe 4 vjet, ^{me sakte,} vetem e vetem sepse nuk gjejne nje strehim te perbashket per dy vete qofte ^{me sakte,} dhe nje ~~dhomë~~ te jetese!

NE FUSHEN E TRANSPORTIT.- Rruget e reja automobilistike te ndertuara nga regjimi komunist ne Shqiperi jane jashtezakonisht te pakta. Ky regjim eshte kenaqur me riparimin (dhe riparim i keq) e rruzeve automobilistike ekzistuese. E vetmia rruge e re automobilistike ne shkalle nacionale qe u ndertua, ishte ajo e Kukesit qe e lidh me Peshkopine. Kjo rruge kish nje rendesi sa qene maredheniet grure me jugosllavet. Kur u pre rruga e importimeve nga Jugosllavia, kjo rruge mbe ti fare e paperdorur dhe sot e kesaj dite eshte me dite te hallit. Vete punimet per ndertimin e saj, me qene se u be me pune

~~SECRET~~

SECRET

- 149 -

krejt vullnetare nga Rinia dhe u projektua e mbikqyr nga teknike jugosllave fare te pa-afte e tuafe, ishna shkel-e-shko. Keshtu qe, edhe pa filluar mire nga perdorimi, ne pjeset me te rrezikshme, rruga u rrezua dhe haxhet vajten dem.

Vija te reja ka celur regjimi komunist vetem persa i takon rrjetit hekurudhor. Me perpara se 1949 Shqiperia nuk dinte c' ishte treni. Jane ndertuar keto vija hekurudhore.

- a) Nga Durresi ne Tirane (nja 48 kilometra).
- b) Nga Durresi ne Elbasan, duke kaluar nepermjet Rogozhines.
- c) Nga Elbasani, kjo vije po shtohet ne Cerrik (shume me e gjate)
- d) Nje vije e shkurter qe pret gjysme rethin Tirane-Rogozhine, bikerisht ne lartesine e Khasharit. (Shume me e shkurter se vija Durres-Tirane).

Suksese te tjera ne kete fushe nuk ka shenuar regjimi komunist ne Shqiperi. Por duhet pramar se volumi i transporteve dhe i pasagjereve eshte situar shume brenda per brenda vendit me mjete automobilistike, ne krahasim me te kaluaren. Me gjith kete, mjetet e transportit kane qene kurdohere te pakta e te mangeta gjate regjimit komunist. Kjo shpjegon edhe arsyen perse ne planin e dyte pesevjecar parashikohet shtimi i mjeteve te komunikacionit rrugor. Me fakt, mungesa e mjeteve te transportit sjell nje anarqi e vonese ne vete ~~XXXXX~~ prodhimin ekonomik shqiptar. Komunikacioni eshte sistemi arterial i shtetit.

Me gjate mbi kete pike nuk di c' te thom.

*Perparime te mira per shpallje ne personele te reja,
me shpallje e mblidhjeve, agencione, njerzore e redaksion
te shpallje te rezeve, perparime per shpallje te rezeve
Lauda vendlit.*

SECRET

SECRET

PERGJIGJE PYETJES XXXI-te

Si e shikojne masat e gjera te popullit shqiptar gjendjen e krijuar nga regjimi i sotme.

Ne radhe te pare, ne lidhje me kete pyetje duhet te theksoj sa vijon:

Lufta nacional-clirimtare kunder okupatorit italo-gjerman beri atehere qe Partia komuniste shqiptare te fitonte nje prestigj, autoritet dhe besim te madh ne masat e popullit. Ne fakt, fitorja e komunizmit ne Shqiperi, fitorja e Frontit nacional-clirimtar gjate viteve 1941-1944, nuk ishte vetem nje imponim i Partise komuniste mbi popullin shqiptar me anen e forcave ushtarake. Opinioni tim personal eshte ~~se~~ se para se te ishte nje fitore ushtarake, nje diktature u vendosur vetem me anen e forcave, ardhja e komunisteve ne fuqi/pas largimit te gjermaneve ishte ^{nga 1945} ~~para se 1945~~ nje fitore e madhe politike, nje regjim, ose me mire nje ~~xx~~ pushtet i pranueshem me vullnet te lire nga shumica demonjese e popullsisë. Kjo do te thote se propaganda e Partise ne ate kohe, programi i saj qene perqafuar nga masa e popullit, e ne radhe te pare nga forcat e avancuara te shoqeris ~~shqiptare~~ qe kane peshe dhe lozin rolin e tyre ne odo ~~shoqerike~~ regjim.

Fshatari mori token me reformen agrare. Pakica e prekur nga kjo reforme ne fshat ose qytet ishte nje pike ~~xx~~ ujë ne oqeanin e fshatareve. Nje mase e tille, per pasoje, nuk mund ta demtonte partine, por i a shtoi rezervat e saj ne fshat.

Inteligencias ju premtuar posti qe meritonte ne shoqeri.

Puntoria u be klasa shoqerore me e preferuar.

1945-sa, pra, ishte nje vit gjate se cilit Partia komuniste gezonte perkrahjen dhe mbeshtetjen morale e materiale te shumices demonjese te shtresave te ndryshme te shoqeris shqiptare.

A mund te thuhet e njejta gje edhe sot? Apak. Baza e Partise komuniste ne shoqeri n shqiptare eshte zvogeluar sot ne krahasim me ate kohe. Ajo nuk ka me perkrahjen qe kishte atehere dhe as gezon simpatine qe gezonte. Humbjet e saj ne fushen morale e politike jane te ndjeshme e te medha. Kjo, si pasoje e orientimit ekstremist ndjekur ne te gjitha fushat e jetes, si pasoje e reformave ekstremiste te marra qe pasuan 1945, si pasoje e detyrimeve te medha ne natyre vena fshataresise, etj, etj.

Mirepo me gjith kete, dhe ky eshte opinionimi tim personal, une nuk mund te thom se Partia komuniste mbahet sot ne Shqiperi vetem me anen e terrorit. Ajo ka akoma nje mbeshtetje e perkrahje ^{morale} te konsiderueshme nga disa shtresa te caktuara.

SECRET

SECRET
- 141 -

Puntoria, kjo klase qe shtohet vazhdimisht me dekompozimit e fshataresis, e grumbulluar ne kantiere e qendra te tjera ndertimi e puna prodhimi, mbetet nje mbeshktetje e madhe e Partise; nje mbeshktetje e regjimit komunist. Rastet e vecanta qe bejne perjashtim nga ky rregull, me duket se nuk e heqin vleren e kesaj se vertete.

Po ashtu mbeshktetje e Partise mbetet fshataresia e varfer, e cila, ne te kaluaren, ronte edhe me keq se sot.

Mendoj gjithashtu se rinia, kjo force e gjalle e cdo shoqerie, eshte me tepar pro regjimit te sotme se sa kunder.

^{Nga shtimi e jetes. me}
Vleresimin e situates ne Shqiperi, opinioni tim eshte se nuk duhet harruar nje fakt shume i rendesishem: populli shqiptar, ekonomikisht, ka rrojtur ^{hurrohet}

^{ne te mbaresuesi} shume varfer, ne nje nivel material jashtezakonisht te ulet. Pa frike pergenjeshtrimi ay ka qene nje anakronizme ne Evropene e shekullit te XX-te. Regjimi i Zogut, qe pasoi po thuhajse imediatisht krijimin e Shqiperise si shtet independent, nuk i dha asgje popullit shqiptar. Deri ne 1945, nje e treta e krejt tokes se puneshme ishte prone e vetem 7 familjeve, midis se cilave permend Toptanasit, ~~Vrionasit~~ Verlacet, etj. 50 perqind e cete fshataresis (domethene me tepar se gjysma) nuk dispononin asnje metro katror ~~katror~~ toke; ata qene gjyqmatore, dhe vec faktit se ishin gjysmatore, mbi ta rendonte edhe e dhjeta, xhelepi, e nje ~~xxxi~~ varg tjetar taksash mesjetare e feodale. Puntoria, sado ne vogel, ne sasi, vuante vazhdimisht nga papunesia.

Situata nuk qe me e mire ne lemin politik. Lirite e njeriut, te drejtat e tij, qene jashtezakonisht te kufizuara.

Injoranca ishte predominuese ne lemin kultural.

Nje situat e tille e atehreshme nuk mund te favorizojte retrospektivisht Partine komuniste sot.

Populli shqiptar nuk eshte, pra, as populli gjerman, me nje standard te ngritur kultural e material, as populli cek, as ay polonez, as ay hungarez. Nje gjendje e tille, si e sotmja ekonomike ne Shqiperi, do te kish shkaketur pa tjetar ne keta popu te perparuar nje levizje aktive revolucionare. Kjo levizje aktive revolucionare nuk ekziston ne Shqiperi. Populli shqiptar nuk ka njohur nje situat me te mire qe t'i rendoje shume situata e keqe sot. Une mendoj se e mira dhe e keqja jane relative.

Pikerisht per kete sot ne Shqiperi thom me bindje se nuk ka nje rezistence

SECRET

SECRET

aktive kunder regjimit komunist, ka një vetem një rezistence pasive, kryesisht ne fushen ekonomike. Në fjale të tjera ka një rezistence të tillë: Fshataresia do të deshte që detyrimet të ishin më të pakta, inteligjencia që të traitoheshë me mire, puntoria që të paguheshë me tepër.

Pastaj nuk duhet harruar se kundërshtarët aktivë të regjimit komunist në Shqipëri janë sot, nëmas gaboj, ish-tregetarët, ish-officerët e regjimeve të kaluar, ish-nepunësit e lartë të Zogut etj. Mirepo tregetarët dhe nepunësit, me duket, se asnjë herë në ndonjë shtet nuk kanë qenë forca e vendosur revolucionare. Këto shtresa i tremben ~~aksionit~~ ^{aksionit} violent sic i trembet djalli temjanit. Në përgjithësi, pra, me duket se situata reale në Shqipëri interpretohet ^{njëanshëm} nga shumë vete në Perëndim, ^{me lirin e pas} ~~me lirin e pas~~ dëshirave dhe pasioneve personale.

Partia ka humbur në krahasim me 1945. Por ajo duhet ditur se e zoteron akoma situatën. Personalisht mendoj se gjendja në Shqipëri nuk mund të përbyset nga brendaj, jo vetem tani por -ndofta do të duket e avancuar- as në të ardhmen. Pa ndërhyrje të jashtme të armatosur nuk ka ~~ndryshim~~ ^{ndryshim} përbyset situatën në Shqipëri. Partia sundon në ~~komitetet~~ ^{komitetet}:

a) me anën e terrorit, drejtpërdrejt sidomos kundër kundërshtarëve të saj të njohur.

b) me anën e influencës politike (sepse ka një influencë të tillë) dhe të influencës morale (edhe një përkrahje të tillë e sezon) në shtresat e klasës puntore, që rritet vazhdimisht, në shtresat e fshataresisë së varfër, në shtresat e rinisë.

c) me anën e tërë aktivitetit të vet propagandistik, aktivitet që nuk duhet nënvlefësuar sepse ze vend në masat.

Në analizë të fundit unë mendoj kështu.

Populli shqiptar ndahet sot në tri kategori:

a) në kategorinë e njerezve që përkrahin aktivisht regjimin. Këtu bëjnë pjesë anëtarët e partise, pjesa më e shëndoshë e rinisë së organizuar në radhët e organizatës së rinisë, puntoret, etj.

b) Në kategorinë e njerezve që janë kundërshtarë të regjimit. Këtu bëjnë pjesë fshataresia e pasur (të ashtuquajturit kulake), paria e Veriut, tregetarët dhe nepunësit e lartë të ish-regjimeve të para.

c) Në kategorinë e trete bëjnë pjesë shtresat më të gjera të popullsisë, shumica e popullit shqiptar (fshataret e mesme, fshataret e thjeshtë, nepunësit e vegjël, etj. etj.). Kjo kategori është asnjanshë, s'ka hyrë në levizjen politike.

SECRET

SECRET

Kategoria e pare eshte me e madhe se sa kategoria e dyte.

Kategoria e dyte, per pasoje, eshte me e pakte, shume me e pakte bile, se sa e para.

Kategoria e trete eshte dominuese, ajo eshte me e madhe se sa te dy te parat se bashku. Por kjo kategori eshte "neutrale". Ajo nuk eshte rezerve e se dytes, qe te hyje ne levizje aktive kunder pushtetit.

Del pyetja:

e popullsis, neutrale dhe aktive,
A ka shumicen/me vete Partia ne Shqiperi? Une mendoj se jo. Por kete shumice nuk e ka as kundarshtare.

Nga forcat aktive te shoqerise, domethene nga forcat qe kane mare nje qendrim ndaj situates se krijuar ne Shqiperi, partia ka me vete shumicen dhe, kundarshtaret e saj, ~~XXXXXX~~ perbejne pakicen.

Domethene: 30 perqind e popullsis kane mare nje qendrim ndaj situates ne Shqiperi. Nga ky 30 perqind, shumica, ~~XX~~ 20 perqindshi, jane me Partine (qofte si antare te saj, softje si simpatizante ose perkrahes). 10 perqind ~~XXXXXX~~ jane kunder saj. Pjesa qe mbetet, domethene 70 perqindi i popullsis nuk jane as me Partine, as kunder saj. Kjo shpjegohet, gjithmone sipas opinionit tim personal, nga fakti se popullsia shqiptare eshte shume e prapambetur ne lemin kultural dhe ate politik, nga fakti se ajo nuk ka tradita politike, nuk ka pare dicka me mire; nga fakti se pompohet vazhdimisht me nje propagande e agitation qe synon ta ktheje ne robote.

ekonomik,
Nga te gjitha sa thashe, pra, nxjerr konkluzionin: nje permiresim, sado pak i rendesishem (natyrisht jo formal) ne Shqiperi, do t'i forcoje edhe me teper pozitat e partise. Kerkesat politike nuk veprojne ne Shqiperi me forcen ~~qe veprojne~~ ^{qe veprojne} ne vendet e tjera te Lindjes, si ne Cekoslovakia, Gjermani Lindore, Poloni, Hungari, etj. Pak koromane me teper e konaq masen primitive dhe te prapambetur shqiptare. Ajo nuk ka konceptin e idealeve politike qe kane qelore ne Angli, France, SHBA, etj.

paletin
Se fundit me shprehim ne menyra te shprehur me qarte, per gabimet e Dacia nege Balli e Regaliteti, etj. meqenese ne shprehim dhe ar shprehim ne te njeje hube e te thella ne Shqiperi. Partia na pathe mendohet qe: mundeshtaret e saj me shprehim shqiptare, ne Dacia dhe partit shqiptare, nisme qe mundohet te detyrohet e te shprehim.

SECRET

SECRET

- 144 -

PERGJIGJE FYETJES XXXIII-te.Ceshtja "Koco Kotta". Arrestimi i tij, denimi, perfundimi.

Edhe mbi kete ceshtje, njohurit e mia, per arsye te kohes se gjate qe ka kaluar qe atehere, jane te pakta. Percaktoj:

Koco Kotta, me Vasil Avramin dhe ndofta me ndonje tjeter, ka qene nga te vetmit orthodhokse shqiptare qe kishin pozita me rendesi ne pushtetin dhe qeverin e Zorut. Personalisht Koco Kotta ka qene, ^{gjate mbretimit te Zogut} (me perjashtime shume te pakta, kurdohere, ose pothuaj, kryeminister i Shqiperise.

Pikerisht per kete arsye, ne prillin e 1939-es, kur u okrua ushtarakisht Shqiperia, Koco Kotta, se bashku me Zogun mori arratine duke kaluar nepermjet Greqise per ne Turqi e, me duket, me von, se bashku me Zogun, edhe ne Egjypt.

Deri nga viti 1943, mbi Koco Kotten nuk kam degjuar te flitet konkretisht gje mbi veprimtarine e tij. Nga fillimi i 1944-es, kur, si Balli Kombetar nga njera ane, ashtu edhe Legaliteti nga ana tjeter fillojne te kerkojne dhe gjejne aleanca neper organizatat nacionaliste ekzistuese ne shtetet fqinje me Shqiperine (si Greqia e Jugosllavia), per te perfituar nje fare ndihme ne luften e tyre kunder komunizmit shqiptar ne planin nacional, Koco Kota duket perseri ne horizontin politik te politikes shqiptare, jo brenda vendit, domethene jo brenda Shqiperise, por sidomos jashte atdheut, ne Turqi e Greqi, me funksionet e nje delegatit dhe perfaqesuesi te levizjes nacionaliste shqiptare prane perfaqesuesve te levizjes nacionaliste greke dhe prane emigranteve politike shqiptare (te hikur qe ne prillin e 1939) ne Turqi.

Konkretisht se ku ka konsistuar veprimtaria e tij, qofte ne Greqi qofte ne Turqi, une nuk mbaj mend. Por di se ay ka qene nje mberlidhes me tober i Legalitetit. Veli Vasjari, per shembull, (Shih pergjigjen XIII: Ceshtja Dhimiter Fallo), kur u kap nga partizanet deklaroi, midis te tjerave se bashkepunonte me Koco Kotten ne emigracion per te bashkuar dhe lidhur elementin shqiptar me ndosheshe ne arrati (Turqi, etj) me partine e Legalitetit dhe per ta afruar kete ne bashkepunim me Partine komuniste (Frontin nacional-olirintar shqiptar). Ne fakt, Koco Kota, nga te gjitha aksonentet e Legalitetit ka qene ay qe ka dashur me sinqeritet dhe si nje nje te domosdoshme bashkepunimin e nacionalisteve me Partine komuniste. Kam degjuar, bile, se ay ka ardhur per nje kohe ne kontakt ne Shqiperi edhe me perfaqesues te Partise per nje zgjidhje pozitive te kesaj ceshtjeje, dhe ne fakt se nuk jane arritur rezultate, mendoj se

SECRET

SECRET

faji nuk i bje atij per kete deshtim. Mund te thom se ka qene nje legalist duke qene, ne te njejten kohe, edhe nje mik i sinqerte i Levizjes nacional-kreret clirimtare. Por me teper se sa nje nga/legalistet^{kreret} qe ndodheshin ne Shqiperi, ay ishte nje nga eksponentet e legalisteve qe ndodheshin jashte Shqiperise; dhe deri diku perfaqesues i nje fraksioni brenda legalitetit, le te thom perfaqesuesi i kraut me demokratik, i fraksionit me liberal te kesaj partie. Mund te shtoj gjithashtu, si opinion personal, se ky fraksion i Koco Kotes ishte mjaft independent ne mendimet dhe punet e tij, por forca e tij, influenza e tij, qe-ne zero. Dhe me teper se sa nje fraksion me mbeshtetje ne popull, poshte, ay ishte nje fraksionⁱ/disa personaliteteve, i kufizuar vetem ne sferat e larta te Legalitetit; dhe te disa personave ne gravitonin reth Legalitetit.

Sidiqofteq ne praktike, buna e Koco Kotes ka qene zero.

Ay eshte arrestuar nga EAM-i grek ne Selenik, pikerisht ne ditet qe pasuan imediatisht terheqjen e gjermaneve; dhe si element shqiptar, i eshte berzuar Partise komuniste shqiptare, e cila, me kete rast, kish derguar ne Greqi nje delegacion per njohjen e te arrestuarve, ne te cilin delegacion, me sa midis te tjereve- mbaj mend dhe kam degjuar, benin pjese/Kico Samaraj dhe Naum Gedeshi.

Si element i Legalitetit dhe me akuzen "se ka qene perfaqesues i kesaj partie per mareveshje me reaksionin grek dhe si i ngarkuar i Legalitetit jashte atdheut per organizimin e emigracionit te djathte ne gjirin e partis se Zogut", Koco Kotta eshte denuar nga gjykata speciale kunder bashkepunatoreve Ezyesore te okupatorit me 10 ose 15 vjet burgim (mars 1945). Si nje nga kreret e reaksionit, ay eshte derguar, pas denimit te tij, ne Burgun e armicve te Popullit ne Burrel, ku edhe vdiq.

Denimi i tij dhe vdekja ne burg, bene qe i biri i Koco Kotes, i quajtur Nuci Kotta, i laureuar me diplomen e drejtesis ne Paris, te kaloje nga miqte e ~~Partise komuniste~~ Frontit nacional-clirimtar shqiptar ne France, ne radhet e armicve te ketij Fronti, dhe te behet, me sa kam degjuar, nje nga eksponentet e Komitetit Shqiperia e Lire. Me gjate nuk di cte thom mbi te birin e Koco Kotes, por di se ne Shqiperi ay konsiderohej si nje "amik" dhe "tradhetar i popullit". Di gjithashtu se perpara se te deklarohet "armik", "tradhetar" e "agjent i fuqive te huaja imperialiste", Partia komuniste shqiptare ka bere mjaft perpjekje qe ta afroje Nuci Kotten, ^(aty nga 1945-1946) me shprese qe ta perdore kapitalin politik qe ky gezonte nga i ati, (sado te vogel) per interesat e saj dhe propaganden e saj ne radhet e shqiptareve qe ndodhen ne France, sidomos ne radhet

SECRET

SECRET

e intelektualeve.

Perpara se t'i jap fund kesaj pyetjeje, le te shtoj gjithashtu se influenca e Koco Kotes ne shoqerine shqiptare dhe ne popullin shqiptar ka qene dhe eshte zero. Partia mund ta perdorete kete njeri (dhe ndofta e perdori deri ne nje fare mase) vetem perkundra, disa individeve te organizuar ne gjirin e legalitetit, sepse midis ketyre kish njerez qe kishin konsiderate per Koco Kote,; jashte kesaj fushe, Koco Kotta nuk mund te vlente per gjë.

Vete fakti se e shvetoj koken ne dite dhe momente kur njerezit vriteshin si mizat ne Shqiperi, tregon, per hesapin tim, se kunder tij Partia komuniste nuk kish akuza konkrete; dhe jo vetem qe nuk kish akuza konkrete, por e konsideronte si person qe nuk kish zhvilluar ndonje veprimtari te radhe armiqesore kunder Partise dhe Frontit nacional-clirimtar.

Me gjate mbi kete pike nuk di c' te thom. Prandaj, i jap fund.

Per hollësira me te medha, mendoj se duhet kerkuar gazeta "Bashkimi", e muajit mars 1945, ku jane te shtypura, thuaje tekstualisht, ter akuzat kunder te pandehurve te gjymit special (kryetar Koci Xoxes, prokuror Bedri Spahiu) si dhe apologjia e tyre, pra edhe "ceshtja Koco Kotta".

- - - - -

SECRET

SECRET

- 15 -

PERGJIGJE PYETJES XXXV te
Kur dhe ne cilin vend u be takimi i pare i perfaqesuesve te EAM-it dhe te LNCSh.
(Cilet qene perfaqesuesit e te dy paleve?)

Kesaj pyetje nuk mund t'i jap asnje pergjigje konkrete. Johurit e mia jane zero. Per pasoje nuk di c'ke thom. Fercaktoj vetem sa vijon: ^{shiptare greke me qarkun}
Takime midis EAM-it dhe LNCSh jane bere ne krahinen e Korces dhe ate te Gjirokastrës (nga perfaqesues te te dy paleve) qysh nga 1943. Po ashtu edhe brenda tokes greke. Une di vetem keta persona, nga pala shqiptare, qe jane takuar me perfaqesues te EAM-it, por as kohen, as vendin ekzakt, as objektin e bisedimeve, as rezultatat e arritura:

a) Rendi Kristo, atehere sekretar politik i qarkorit te Korces ~~XXXX~~, me 1954 ~~XXXXXX~~ ndodheshe ne burg si dora e djathte e Koci Xoxa dhe si agjent i Tites.

b) Nesti Kerenxhiu, atehere sekretar politik i qarkorit te rinis per Korcen, me von kandidat i Byrose politike te LNCSh, Me 1954 domethene kur u arratisa nga Shqiperia) drejtor i Importeksit ne Ministrin e Trehetise.

c) Bedri Spahiu, sekretar politik i qarkorit te Gjirokastrës, atehere, anetar i Byrose politike te LNCSh/ me von; dhe tani, me sa kam degjuar, perjashtuar nga Komiteti qendror dhe emeruar mesues.

d) Kemal Paragjozi, atehere anetar i qarkorit te partise ne Gjirokastrë, me von humbar pozicat ne parti dhe perjashtuar fare nga partia si element borgjez qe nga 1947. Me 1954 e lasne jashte partise me banim ne Tirane.

Te tjere nuk di.

SECRET

SECRET

- 158 -

PYETJE XXXIX-teMekanizmi i shtetit: Artikulacioni minister-nenminister: Fershkrimi i ministrave dhe zevendes ministraveqarket: Rrethet:Struktura organizative e Drejtesis: Fershkrimi i eksponenteve:

Mbi mekanizmin e shtetit, strukturen organizative te ministrive, sasine e tyre, shkurt mbi odo dikaster te Keshillit ministror dhe organet vartese te ketyre dikastereve, kam dhene te gjitha sa kam ditur ketu e nje vit me pare gjate hetimeve qe me jane bere ne Kostur e sidomos gjate hetimeve vazhduese qe me jane bere ne Glifadhe nga autoritetet amerikane. Ne bashku me sa me siper, atehere kam shpjeguar edhe lidhjet parti-pushtet si dhe format organizative me ane te te cilave -artia udhetoj dhe drejton pushtetin, me fjale te tjera format me ane te te cilave Komiteti qendror i R.S. kontrollon, udhezoi dhe drejton Keshillin ministror e organet e tjera vartese te pushtetit, qe nga Komitetet ekzekutive te qarkut e deri ne keshillat popullore te fshatrave. Per nje skjarim me te mire, aso kohe kam dhene edhe skema te vizatimeve. Njehkohesisht kam dhene edhe te gjitha shenimet biografike mbi personalitetet qe permendnja.

edhe te dua te perserit tani te gjitha ato sa kam thene atehere do te me jete e pamundur. Se pari, per mungese kohe: atehere kam qendruar plotesisht i mbyllur lart nga 3 muaj, duke punuar mesatarisht lart nga 10 ore ne dite. Ne dyti sense gjerat, aso kohe, i kisha shume te fresketa ne kujtesen time. Tani edhe te dua t'i perserit, nuk i mbaj mend me aq hollesi (Ka kaluar nje vit e gjysme).

Fersa i perket strukture organizative te Drejtesis gjithashtu kam dhene atehere sa kam ditur. Njeserisht ne Kostur dhe akoma me teper e gjeresisht ne Glifadhe. Mbi strukturen organizative te drejtesis ne -hqiperi kam dhene ~~shenime~~ (ato qe dinja), ne Athine, para se te shkonja prane familjes ne Pelenik, tek majori grek vhimitri Koliopullos, Bruga Merlin, Nr. 6.

Fikerisht per keto arsye, pra, e quaj te kote te riperserit, me boshlleqe te natyreshme, ato qe kam dhene tekstualisht ketu e nje vit perpara.

Pyetja perfshin ne vet-vete edhe ndarjen gjeografiko-administrative te Shqipërisë. Përcaktoj: Si ne kohen e Zogut edhe tani, Shqipëria ndahet ne 10 qarqe: dhe konkretisht ne qarqet e: Gjirokastrës, Vlores, Korces, Beratit, Elbasanit, Tiranës, Durrësit, Peshkovise (ose Dibres), Kukësit, Shkodrës. Odo qark ndahet ne 4 ose 5 rrethet, dikush dhe ne 6 rrethet. Berat e Gjirokastrës nuk me kujtohen. ~~Shqipëria~~ ^{plota te rrethave}

Do te mund te pergjigjegja drejt qarkut po te dispononja nje harte te madhe te Shqipërisë.

SECRET

SECRET

- 159 -

RIEJTJE NO E XI-te.

Te dhena statistikore mbi regjistrimin e fundit te popullsis ne Shqiperi (sidomos mbi Gjirokastrën dhe Korçen).

Te dhena statistikore ne kete fushe nuk di me siguri. Jane shifra dhe nuk mbahen mend. Sidoqofte, regjistrimi i fundit i popullsis shqiptare (1955) tregonte se mbare popullsia e Shqiperise arrinte ne ^{shume part me lart se} nje milion e 300 mije banore. Te dhena te posacme mbi qarkun e Korces dhe Gjirokastrës ~~shprehin~~ nuk di. Mbjaj mend se regjistrimi i pare i ^{regjistrimit} popullsis nga regjimi komunist ne Shqiperi eshte bere nga viti 1945 dhe i dyti nga viti 1949. I fundit, sikurse e pemend me lart, eshte bere me 1955, kur une ndodhesha ne Greqi. Shifren prej nje milion e 300 mije banore (lart poshte) e kam degjuar nga Radio Tirana.

Regjistrimi i pare, domethene i 1945, ka dhene ^{vet} nje milion e 200 mije banore. Regjistrimi i dyte, dicka me teper, duke iu afruar nje milion e 300 mije banoreve. Regjistrimi i trete dicka me teper se nje milion e 300 mije banore.

Regjistrimi pare, domethene ay vitit 1945, nuk eshte bere shume ne regulle. Di se nje pakice e popullsis nomade te Veriut dhe nje pakice e kurbeteve i shpetuan regjistrimit; sepse organizimi nuk qe i persosur (komunistet s'ishte kishin mare pushtetin).

Regjistrimi i dyte (ay i vitit 1949) eshte i plote, sepse organizimi ka qene i persosur. (Une, persh. nuk isha regjistruar me 1945, qeshe harruar dhe u regjistrua me 1949.)

Ro ashtu edhe regjistrimi i trete, mendoj, me 1955, duhet te jete i plote.

Del pyetja: a i shton qellimisht shifrat e banoreve regjimi komunist? Personalisht mendoj qe jo. Vete diferenca ose shtesa e vogel qe shenohet ne popullsi nga viti 1945 ne vitin 1955, me jep te kutoj se ne kete fushe nuk ka shtremberime. Sidoqofte ky eshte vetem opinion personal.

SECRET

SECRET

ARTIJA VII E XII-te.Qendrimi i artise se kunes kundrejt komuniteteve fetare. Cilet drejtojne sot kishat ne Shqiperi, si qendruan kata:

Qado qe edhe kesaj brytjeje i jam pergjigjur ne Kostur e Glifadhe, percaktoj disa gjera te rendesishme:

~~Qendrimi~~ Kisha eshte e ndare nga shteti ne Shqiperi:

Te gjitha kryesite fetare (kisha ortodokse, kleri muhamedan -myslimane e bektashinj-) jane autoqefale. Kisha katolike ka nje pozite ndermyetese. Ajo nuk eshte fare autoqefale, domethene krejt e pavarur nga Vatikanit. Por nuk eshte as e neneshtuar dhe e varur ~~ndodhur~~ nga atikani si kisha katolike franceze, belge, argjentinase, etj. Kisha katolike ne Shqiperi, bile, ka me tepër autonomi ne mardheniet e saj me Vatikanin, se sa edhe kisha katolike e Kolonise, hungarise, Cekoslovakise.

As nje komunitet fetar nuk gezon, si ne te kaluaren, prona te palujteshme te medha. Kishes ortodokse, per shembull, i jane mare tokat qe kishte (sidomos neper mjet manastireve). Manastiret kane mbetur prona te kishes, por tokat dhe pyjet qe ato dispononin u jane mare me reformen agrare. (Duhet te theksoj ketu se kisha ortodokse kurre nuk ka qene e pasur ne Shqiperi, edhe ne kohet e Zogut). Njejtat gje ka ndodhur edhe me klerin muhamedan. Tokat e teperata u jane mare, por teqete kane mbetur prona te klerit. Ajo qe ka ndodhur me keto besime, ka ndodhur edhe me klerin katolik. Ketij i jane mare shume godina, shtyeshkronja, etj.

Sot per sot, te gjitha komunitetet (fetare) kryesit e tyre, rrojne ne Shqiperi me dy lloje te ardhurash:

a) me te ardhurat e tyre direkte, te inkasuara nga sherbimet fetare, ceremoniate, dhuratat e vogla te besimtareve individe.

b) me te ardhurat indirekte, te paguara nga shteti (sasi shume te vogla per rroga prifterinjsh, mirembajtje Kishash, xhamish, teqesh, etj. te parashikuara ne buxhetin shteteror ne kapitullin: "shpenzime ne lemin e kultures"). Prifterinjtat, pra, ne Shqiperi, jane rrogtare tek shtetit.

Politika e artise kundrejt komuniteteve fetare:

Kryesisht eshte goditur kleri katolik. Sepse ay ka qene me i organizuari, me i kulturuari, me antikomunisti. Kleri katolik i ka bere nje rezistence jo vetem pasive, por edhe aktive pushtetit komunist. Ne krye te ketij kleri jane ndodhur ^{per nje kohet te gjate} ~~deri ne kohet e fundit~~ elemente qe nuk pranonin t'i neneshtroheshin artise. Per t'i thyer dhe zhdukur fizikisht, si ~~si~~ ^{si} ~~si~~ pushteti ka zhvilluar nje seri

SECRET

SECRET

-174-

gjyqeshme Shkoder, gjate se cileve jane demuar me vdekje personalitetet te klerit katolik, si: atar Shllaku, atar Bernardini, atar Gjoni, etj. etj. qe nuk me kujtohen. Ndene goditjet e perseritura te ketyre gjyqeve dhe presionit te madh te pushtetit, kleri katolik u detyrua me se fundi te gjunjezohet dhe te pranoje statutin qe i imponoi vereria. Por nuk mba j mend kush qendron ne krye te kishes katolike por di se edhe kreret e sotme te katoizizmit ne hqiperi nuk jane aqe te bindur e servile, aqe te neneshtuar e te gateshem te batojne cdo rekomandim te artise, sikurse eshte ~~xxx~~ kryesia e sotme e klerit ortodoks, ajo e klerit mysliman dhe ajo e klerit bektashian. Mbeshtetja e artise ne klerin katolik eshte shume e dobet edhe ne baze, domethene ne prifterinjt e thjeshte. Me fjale te tjera mund te thom se artia nuk ka as nje prift katolik, qofte te vogel qofte te madh, qe te jete vegel e thjeshte e saj, qe te kete simpati per regjimin komunist.

Ne perpjasetim me kamunitetet e tjere fetare, me duket se komuniteti katolik vjen pas komunitetit mysliman, si sasi, domethene eshte me i vogel; vjen perpara komunitetit bektashian (domethene eshte me i madh ne numur); me komunitetin ortodoks me duket se eshte thujse i barabarte; ndofta me nje diference te parendesishme, pak me i vogel.

Komuniteti bektashian eshte ay me i vogli ne hqiperi -or diferenca e tij me komunitetin katolik nuk eshte jashtezakonisht e madhe. Ky komunitet ka qene mjaft i lidhur me artine, dhe me duket se deri diku qendron i lidhur edhe tani. Gjate luftes, baballaret (domethene hierarket e ketij sekti) i kane dhene nje ndihme te gmeshme artise. Kryetari ~~ideti qe komuniteti i krishteror me 1946 qe komandant i~~ dhe nenekryetari i ketij komuniteti vrane njeri tjetrin me 1946. Emri i kryetarit nuk me kujtohet, por di se ka qene kurdishtar i artise komuniste; nenekryetari ka qene Paba Faja artaneshi, element i lidhur shume ngushte me artine, ka qene qysh ne fillim anetar i meshillit te pergjithesem Nacional-Ulirimtar dhe komanant i nje reparti te madh partizanesh ne qarkun e Dolasanit. Me 1946, pas vrasjes se kryetarit te bektashinjve dhe Paba Fajes, u vu ne krye te bektashinjve nje element tjetër i artise, emri i te cilit nuk me kujtohet. Por edhe ky, pak me von, u hoq nga kryesia dhe tani, ne ~~xxx~~ vend te tij (emri nuk kujtohet) eshte ~~aj~~ ^{i treta} i cili eshte tepër i lidhur pas artise, pikerisht si Paba Faja sepse ka qene qe me 1942 kryetar i nje cete partizane ne ~~xxxxxxx~~ krahten e ezes. Duhet te shenoj ne kete mes se kryetari i bektashinjve ne hqiperi eshte edhe kryegjyshi boteror i bektashinjve (domethene eshte Papa i bektashinjve). Ne fakt, qendra e kryegjyshates boterore te bektashinjve eshte ne ~~Tirane~~ prej 20 vjetesh. Me perpara, Kryegjyshi

SECRET

SECRET

- 193 -

boteror i bektashinjve (ose Dede-ja, sic quhet edhe ndryshe) e ka patur qendren e vet ne Turqi; mirepo qe ketej e dboi, per arsye qe me jane te panjohura, ndofta sepse erdhi ne konflikt me politiken e ~~Ataturku~~, ~~qendrore~~ wemal Ataturku. Nga te kleriket bektashiane jane ata qe gjithë komunitetet fetare, ~~kliriket ortodoks~~ konsiderohen si me afer pushtetit te sotme. (Megjithkete duhet te percaktoj se 'artia ka ekzekutuar disa baballare, si gjate luftes, sepse ishin me Ballin, F. sh. Baba Zyflon e Teqes se Turanit, ashtu edhe pas luftes, sepse pashuan se qenuri bashkeudhetare te 'artise ne ~~frankos~~ kohen e pas-clirimit, si Babaj i Karbunares).

Kleri mysliman. Kryetari i ketij komuniteti fetar ka qene qe ne kohen e luftes ballist, dhe prandaj, pas clirimit, eshte hequr nga kryesija. Vendin e tij e zuri ~~me~~ ^{nje} element i lidhur me 'artine, emri i te cilit nuk me kujtohet tani. (Por e kam dhene ne hetimet qe me jane bere nje vit / me pare, si dhe emrin e kryegjyshit te sotme boteror te bektashinjve, se bashku me emra te tjere ~~XX~~ qe nuk me kujtohen tani). Kleriket myslimane kane qene te corganizuar dhe gati analfabete, ne shumicen e tyre, si kleri ortodoks. Megjith kete, pas clirimit, ne hierarkine e larte ka patur nje fare rezistence kundrejt 'artise. Kjo ka bere qe 'artia, per ta thyer, te organizoje disa gjyqe, (te pandehurit nuk me kujtohen) nen akuzen e komplotit kunder shtetit. Nuk di qe te jene dhene denime me vdekje ne keto gjyqe. Kane qene me teper gjyqe qe te hiqnin nga postet elementin e padeshirueshem nga partia dhe ta zevendesohin kete element me njerez te lidhur pas 'artise. Sot, maredheniet e krereve klerike myslimane me 'artine jane te perzemerta, sepse ne krye te komunitetit muhamedan qendrojne njerez te bindur, servile, dhe miq te regjimit te ri.

Kleri ortodoks. Gjate luftes, kleriket e vegjel kane qene nje mbeshtetje e mire e 'artise. Pas luftes, partia eshte orvatuar te mbahe maredhenie te mira. Mirepo kreret e klerit ortodoks, qe e dinin lodren e 'artise, nuk iu neneshtuan. Ajo beri qe pikerisht sikundre me te tjerit, edhe me klerin ortodoks partia te perdore violencen. Emra nuk me kujtohen shume, por mbahe mend dhespot Visarionin, dhespot Panushin, etj. qe jane derguar si "armiq te popullit" neper gjyqe. Aasi spastroi, ne kete menyre, vendin, 'artia vuri ne krye te klerit ortodoks njeret te sajte, pa kulture dhe pa ndonje influence ne masen ortodokse, por sidoqofte elemente te sajte, si Kryepishkop Rasko Vodicen (sot 'aisi), deri me 1943 prift ne katundin e Vodices, dhespot Kokoneshin ne Korce (deri me 1944 prift ne Plenge) etj. etj.

SECRET

SECRET
- 153 -

Dhe tani qe mbarova me analizen e vecante te komuniteteve fetare ne "hqiperi, kaloj ne pergjithesine.

Ofensiva e -artise kunder klerikeve te ndrveshme ka qene shume violente gjate viteve 1946-1947 dhe 1948. -erioda qe pason kete kohe, eshte me tepar diplomati-ke. Kundershtaret ishin eliminuar deri me 1948, qofte me odukuje fizike, qofte me burgime. Ishte hapur rruga, pra, per regullimin e maredhenieve shtet-kishe.

Keshtu, nga 1947 ose 1950, nuk e mbaj mend mire, u be ligji qe regullon maredheniet e komniteve klerikale me shtetit, ligj qe eshte tamam sikurse e desh partia.

Ne pergjithesi, tani, nuk ka mbaroveshje shtet-kishe. Konsideranca e krahut te fundit u bry... olitika e -artise eshte zbutur. Nuk ka patur qe nga ajo kohe gjyqe kunder ~~klerikeve~~ klerikeve.

Ka viza te dhena ne lidhje me politiken e -artise kundrejt mases se besnikeve (jo klerikeve), domethene kundrejt laikeve besimtare.

Ceremonite fetare jane krejt te lira. As nje kisha nuk eshte kthyer ne biblioteke, kllub ose ent shtetor. As nje njeri nuk eshte ndjekur dhe as qe ndiqet per arsye se shkon ne kisha te degjoje ceremonite fetare. Formalisht, pra, -artia nuk i pengon besimtarat ne besimet e tyre. Mirepo asnje komunitet nuk disponon fonde per propaganden e saj. ~~As~~ Nuk ka as nje fletore fetare. Me popullin, jashte kishes, nuk organizohet as nje konference deiste. Nga ana e saj, -artia, me te gjitha mjetet, ka liri te plote te zhvilloje propaganden e saj atheiste, materialiste. Dhe kete propagande, -artia e ben, sidomos jo aq shume ne popull, por brenda raseve te saj. Kualifikimi i klerikeve eshte per toke. Kleri katolik qe kishte nje seri shkollash per priftrinjt, per djem individesh, etj. nuk disponon -ne mos gaboj- asgje, (pervec nje shkolle elementare prej nga pregatit kuadrin e ulet klerikal. Kleri ortodoks, nuk di ne se ka akoma te celur nje seminar qe ka patur dhe ku pregatiteshin ne vitet e fundit te regjimit zogist priftrinjte e rinj, brengi i ri i klerikeve te vegjel. Personalisht nuk kam degjuar qe te ekzistojte akoma ky seminar. Kleri muhamedan ka ruajtur akoma Medresene e Tiranese, ku pregatitreshin hoxhallaret e rinj. Mirepo kjo medrese eshte me dite te hallit. I mungojne jo vetem fondet, por edhe profesoret.

Thashe pak me perpara se kishat nuk jane kthyer ne kllube. Por as nuk jane ndertuar kisha te reja. Ato qe ekzistonin jane duke u vjeteruar gadal-gadal. Ne mos gaboj jam nje statistike. Dicoq... klastres ka sot 147 kisha me 92 prifte-

SECRET

SECRET

rinj tere-tere. (Por nuk duhet harruar se ky fenomen, domethene me shume kisha se sa prifterinj, me duket se eshte i zakonshem per gati te gjitha vendet kristiane). Le te percaktoj me kete rast se diocezi i Gjirokastrës eshte me i madhi e me i rendesishmi ne Shqiperi per orthodoksizmin. Ras atij te Gjirokastrës, vjen Korca, ~~që është më e madhe~~ me nje ndryshim mjaft te konsiderueshem, e pastaaj, shume prapa (sepse tere popullsia ortodokse e Shqiperise eshte perqendruar ne masen demuese ne keto te dy qarqe), vline: Vlora, Elbasani, ^{Tirana} Durres, Shkodra, etj. Te tjera hollesira, nuk di. randaaj e mbvll edhe kete s'vetje.

SECRET

SECRET

- 145 -

RYEJJE XXXIX-te

Ceshtja e "Cameve". Sa, kur dhe njerse u shpërngulen camet nga Greqia. Ne cilin vend u vendosen ne fillim dhe ku ndodhen tani. Si i priti populli shqiptar dhe c'masa mori Partia per instalimin e plote te tyre. Si u perdoren camet gjate kohes se luftes rebele ne Greqi; cilat jane eksponentet e tyre dhe c'vend zene sot ne pushtetin pergjithesisht. Jane te kenaqur me gjendjen e tyre te ree. Mendon Partia e Funes se Shqiperise per te arthmen, ne lidhje me ta. Ekzistojne came ne brezin kufitar te Shqiperise, afer tokes greke. Sa mund te jete numuri i ketyre te instaluarve ne afersit e kufirit grek.

Kur eshte bere shpërngulja e cameve nga Greqia ne Shqiperi, une jam ndodhur ne Jugosllavi. Me duket se ky eksod eshte kryer aty nga viti 1946 (fillimi i vitit), ose ndofta edhe pak me perpara, fundi i vitit 1945. Kohen e eksakte nuk e mbaj mend mire. Me sa di une, shpërngulja e cameve nga tokat e tyre ne Shqiperi eshte bere pa vullnetin e tyre te lire. Shpjegohem: gjate kohes se okupacionit italo-gjerman, camet (nen udhëheqjen e disa krereve te tyre si Vehip Luma, etj.) bashkepunuan ne mase me forcat pushtuese te huaja dhe kryen akte armiqesore si kunder levizjeve nacionaliste te 4erves, ne krahinen e yamerise ashtu edhe kunder AM-it; ne nje mase te madhe, camet kryen akte armiqesore edhe kunder popullsis greke te krahines se tyre. Ndofta per kete arsye, nga frika se mos pesonin raprezaljet e popullsis greke pas clirimit dhe terheqjes se gjermaneve nga "allkanet, (ndofta sepse u bene ne fakt objekt raprezaljesh per veprimtarine e tyre te deri-ateheshme, camet, ndofta te dbuar me force ndofta nga frika e raprezaljeve (une nuk di as gje te sigurt), lane vendin e tyre dhe kaluan kufirin duke ardhur ne mase ne token Shqiptare ku mendonin se do te gjenin mbrojtje dhe perkraheje.

A e deshte kete mase te ardhur nga Greqia ne Shqiperi, Partia komuniste dhe qeveria e Tiranes. Personalisht mendoj qe jo. Kur-bhere, keto masa njerezish te shpërngulura ne nxitim e sipër, pa pasurira dhe te ardhura te tjera, jane goje te reja qe duhen ushqyer, installuar, strehuar, vendosur, etj. Fikerisht per kete arsye, pushteti komunist ne Shqiperi i pranoi me zor keta emigrante te padoshitshme dhe aq me tepër sepse nuk mund te vepronte ndryshe. Me nje ndjenje mos-besimi, antipatie dhe gati urrejtjeje i pranoi edhe populli shqiptar. Sidoqofte, nje here te pranuar, partia komuniste mendoj t'i perdore/atehere gjeresisht per qellimet e saj prolitike e propagandistike ne terrenin nderkombetar, sidomos persa i perkjet fushates se saj kunder Zerves (vecanerisht si reaksionar grek ballist) dhe kunder Greqise ("monarkofashiste" (vecanerisht si shtet armik).

Keshtu, ne veshtrim te ketij plani, partia komuniste organizoi atehere nje fare Komiteti te camerve te shpërngulur. Zakonisht ne kete Komitet kane qene

SECRET

- SECRET

elemente bashibuzuke, kryesisht nga paria e camerve, pa ndonje te kaluar qe mund te vliente, me biografira me teper negative dhe as gje pozitive per t'i lancuar si figura politike. Kjo, sepse vete perberja e camerve te emigruar ish e tille: asnje intelektual, asnje i kulturuar, asnje me ndonje te kaluar ~~exkx~~ te degjuar e me tradita ndershmerie, patriotike ose demokrate. Shumica e njerezve te ketij Komiteti cam ish in njerez na parti, elemente qe deri atehere nuk i kishin dhene asnje ndihme ~~te~~ partise komuniste shqiptare (bile me teper se sa ndihme, i kishin ~~shkak~~ shkaktuar deme e veshtiresi). Krandaj edhe besimi i partise ne anetaret e ketij Komiteti ish zero. Per ta batur situaten ne dore brenda ketij Komiteti dhe per ta drejtuar me mire ate, partia komuniste shqiptare futi ne kete Komitet, krahas "eksponenteve" camuriote te porsa ardhur, edhe disa njerez te vet, antare te partise komuniste, me origjine camuriote por instaluar ne Shqiperi vjete e vjete me pare dhe qe kishin qene militante te "evizjes nacional-clirimtare shqiptare, - nga kuadri i mesme i partise. -ga keta elemente te partise futur ne Komitetin cam di:

a) Vehip Demin, anetar partie qe me themelimin e PKSh, ^{por} ~~ixoxi~~ pa asnje merite dhe post ne parti ose pushtet deri atehere. Preferencat e partise shkuan tek ky person sepse ishte nga familja e vjeter dhe me influence pasesie ne masen camuriote te emigruar. Ky person u zgjodh atehere edhe sekretar i pergjithesem i Komitetit cam dhe firmonte abelet e Komitetit drejtuar Kombeve te bashkuara per te nderhyre ne kete ceshtje, per t'u dhene fund "masakrave" dhe "terrorit" qe ushtronin "monarkofashistet greke" mbi pakicen shqiptare te Greqise (domethene mbi camuriotet), per te mare nje vendim qe "viktimat" te ktheheshin ne tokat e tyre, ne shtepit e tyre, -tje -tje.

Kete fushate, domethene propaganden per te denuar aktet e monarkofashisteve greke" dhe "nderhyre qe camet te kthehen ne tokat e tyre, ne pasurit e tyre" pran Kombeve te bashkuara dhe ne shtyp, partia komuniste e zhvilloi ne stil te gjere per nje kohe prej disa muajsh. Mirepo kur u duk sheshit se nga ky stan nuk dilte gjalpe, PKSh u detyrua, pasi beri nje zhurme demonstrative te madhe, te heqe dore nga orvatjet e perseritura dhe te mos e ngrere me kete ceshtje. Keshtu, qe nga 1948 nuk eshte degjuar me te flitet ne Shqiperi per problemin cam as ne terenin kombetar, as ne ate nderkombetar. Komiteti i camurioteve u shpernda, pjeserisht nga grindjet e anetareve midis tyre, pjeserisht nga mos-perfillja e partise per ceshtjen came.

SECRET

SECRET

Vehib Memin, qe ka qene eksponenti Nr. 1 i ketij Komiteti kam patur rastin ta njoh personalisht. Eshte nje sharlatan dhe karagjoz jo vetem ne pamje, por edhe ne permobajtjen e tij. Me nga 1947 artia e la fare ne perithor dhe ne mos gaboj, aty nga viti 1948, ^{pa} r/artesin e tij e dboj edhe nga radhet e artise me akuzen "element i pavlefshem". Me 1954 e lashe ne Tirane (para se te arratisesha), ne Drejtorine e "Radio-Tiranes, si nepunes, me pergjegjesi ~~komuniste~~ pregatitjen e emisioneve nga ana artistike. Nuk kishte as konsiderate, as simpatira, as vleresoheshe. I ishte dhene nje post sepse nuk kishin c' ta benin. Di se ishte shume i pakenaqur per trajtimin qe i ishte bere nga artia, por se deri ku shkante kjo pakenaqesi, eshte veshtire te avancohem. Sidoqofte opinioni tim eshte se kjo pakenaqesi nuk kish arritur deri ne ate mase sa te beheshe nje armik i fshehur i artise.

b) Tjeter anetar partie qe ish futur ne Komitetin e cameve ish Taho Sejkuva dhe kete person kam patur rastin ta njoh se aferme eshte i zoti dhe me talent si organizator e gazetar; ka kryer studime per ekonomi politike ne Greqi, gjate regjimit te Zogut. Me perpara ka mbaruar liceun frances te Korces. Gjate okupacionit ka qene per nje kohe shume te shkurter kryetar komune ne qarkun e Gjirokastrës. Me nga fillimi i 1948 u hodh ne mal, u be anetar partie dhe me von komisar politik i nje batalioni partizanesh. Pas clirimit ka qene per nje kohe kapiten i I-re, pastaj eshte emeruar shef seksioni ne Komisionin e planit te shtetit dhe me 1949 eshte emeruar pergjegjes i redaksise ekonomike te Drejtorise se organit qendror te rrSH "Zeri i Popullit". Ky person ish futur ne Komitetin cam vetem e vetem sepse ishte me origjine camuriote, nga paria e vendit, por vete ka rojtur dhe eshte rritur ne Shqiperi.

c) -ersoni i trete anetar partie qe ka qene ne Komitet, ishte Hilmi Beiti. Edhe ky, si Taho Sejkuva, rritur ne Shqiperi, por me origjine camuriote. (Mbi kete person shih shenimet biografike qe kam dhe me mbi oficerat e Sigurimit).

Sikurse shihet edhe nga kualiteti i anetareve te artise te futur ne gjirin e Komitetit cam, partia nuk dispononte kuadro dhe as eksponente me te degjuar, me origjine came, qe t'i futete ne kryesin e emigrantëve came.

Mbi sasine e camerve te shperngulur nga Greqia ne Shqiperi, mua nuk me kujtohen shifra. Por, theksoj per cdo eventualitet se mjafton te shihet shlytypi shqipuar i atehereshme per t'u gjetur. dofta (por pa sigurime) me duket se kjo sasi e camerve te shperngulur ne Shqiperi vertiteshet rreth 20 mije veteve (shifer e dhene me rezerva).

SECRET

SECRET
- 158 -

Ne ku u installua kjo mase ne ditet e para te ardhjes se saj ne Shqiperi, nuk di sepse, servec te tjerave, sikurse e thom edhe ne fillim te kesaj nyetjete, une aso kohe ndodhesha ne Jugosllavi. Por nga bisedimet e mevoneshme, kam degjuar se kjo mase u vendos kryesisht ne ~~xx~~ qarkun e Vlores, ne rrethin e Fierit, e Lushnjes dhe Tirane. Ne qarkun e Forces nuk kam degjuar te jene installuar camer. Pak, por shume pak, mund te jene installuar ne qarkun e Ujrokastrës. Nuk kam degjuar gjithashtu qe te jene vendosur camer ne gegeri.

Nuk di qe te jene installuar emigrante camer ne afersit e kufirit greko-shqiptar. Nuk di gjithashtu qe emigrantet came te jene perdorur ne ndonje menyre ose tjeter ne luften rebelle te Greqise. Partia nuk ka patur kurre besim ne kete mase te emigruar dhe e ka trajtuar si nje mase te padeshiruar por ~~komunist~~ se ciles nuk mund t'i refuzoheshe e drejta e strehimit.

Nuke u nisur qe ketej, sot, pozita e camerve te emigruar karakterizohet nga keto te dhena: as nje nga te ~~xxx~~emigruarit rishme nuk ka post partie ose qeverie. Ne duket, bile, se as nje nga emigrantet e 1946 nuk eshte bere anetar partie. Shteti u kufizua vetem per t'u gjetur nje strehim te ofaradoshem. Puna zyrash nuk kane. Kryesisht meren si puntore bujqesore dhe kryesisht si mavro-agorite te vegjel. Shteti shqiptar dhe popullsia shqiptare i konsideron si cifu te, te afte per allish-verishe te vogla, per punera jo shume te ndershme dhe te nene-dores; mjaft prej syresh jane matrapaze dhe te shumte jane ata qe jane denuar me denime te vogla per kundra-vajtje, per veprime te paligjeshme, etj. Adofta te gjitha keto jane te shkaketuara nga fakti se kjo mase nuk di si te fitoje buken, si te jetoje rerkrahja e shtetit thuaje eshte zero. Camet formojne edhe ne Shqiperi nje komunitet me vete, te izoluar nga popullsia tjeter (bile ata urrehen), ndihmohen me sa mundin njeri-tjetrin, kryesisht, e verserit, ne veprime te dyshimta, matrapazlleke, etj.

Te gjitha keto me japin te kuptoj se camet nuk duhet te jene te kenaqur nga gjendja e tyre e re ne Shqiperi. Se ata e mallkojne regjimin komunist. Por, c'te bejne? Ata kane katandisur ne nje fare komunitet kurbetesh.

Mbi planet dhe mendimet e pushtetit te sotme komunist persa i perket te arthmes se kesaj popullsie, une nuk di c'te thom me siguri. Por jam i bindur se Partia komuniste shqiptare do ish e lumtur t'i sikteriste prej ku erdhen dhe te shpetonte nga "matrapazlleket" dhe "punet e cndershme" te tyre. Sidoqofte, ne situaten qe ndodhen maredhenisht greqi-Shqiperi ajo ~~xxx~~ as qe mendon per nje

SECRET

SECRET

zgjidhje te mundeshme te ketij problemi. Dshte nje e keqe qe e ka zene wushtetin
komunist dhe qe s'ka c'ben.

Me duket, se ne lidhje me ate qe me kerkohet ne kete pyetje kam thene te
gjitha sa dinja. Frandaj, per te mos perseritur me fjale te tjera gjera qe i
kam thene nje here deri tani, e gjej te arsyeshme t'i jap fund ketu keti kapitull.
tulli.

SECRET

180
SECRETMerzitë dhe pyetje të vecante:

HISTORIKU I SIGURIMIT

(Si lindi dhe si u zhvillua)

Tri perioda në historinë e Sigurimit (Asfalia):

- a) Perioda fillestare.
- b) Perioda e "Mbrotjtjes së Popullit".
- b) Perioda: "Sigurim".

PERIODA FILLESTARE

Organ i pushtetit komunist, për ruajtjen e rendit dhe luftimin e kundërshtarëve politikë të regjimit, Sigurimi lindi në Shqipëri ^{formë embrionare} që

në kohën e luftës partizane, domethënë që në kohën e periodes revolucionare.

"Prindërit" e Sigurimit të shtetshqiptar, ^{origjina e tij, dhe për-ardhësia e tij} kanë qenë, në kohën e luftës revolucionare, ato që quheshin "Komanda vendi". Natyrisht roli i këtyre komandave të vendit, rëndësia e tyre, autoriteti i tyre, përberia e tyre, cilësia dhe fuqia, struktura organizative dhe sasia e personelit, influenca dhe aftësija, kanë qenë shumë më të kufizuara dhe shumë më të inferiore/se sa ato organeve të Sigurimit sot.

Komandat e vendit, që quheshin edhe forca partizane të prapa-vijes, lindën aty nga mezi i vitit 1943, domethënë në fazën e luftës. Dihet se Këshillat nacional-clirimitare, organe legjislativë dhe ekzekutive të pushtetit të partë komunist në Shqipëri, në zonat e cliruara, nuk mund të kryenin funksionet e tyre ~~administrative~~ administrative pa një forcë të amatosur. Repartet e Ushtrisë nacional-clirimitare (domethënë ushtrisë partizane) nuk merreshin me, si përpara, nga mezi i 1943, me ndjekjen e krimineleve ose hajduteve, me mbajtjen e rendit publik në zonat ku ish rrezuar dhe shkallëmuar pushteti i partë, etj. Roli i tyre ishte vetëm lufta kundër ushtrisë okupatore dhe repartëve armike të "Ballit" ose "Legalitetit" i kërkuar për këtë, u be e nevojshme krijimi i disa organeve të posacme, ushtarake, ^{më mjetë e forca} që të merreshin me veprimet kundër-vajtës dhe gjurmimin e personave të dyshimë. Të gjitha këto organe u quajtën "Komanda vendi".

Cdo katund nuk kish komandë vendi. Për një grup katundesh kish një Komandë vendi. Krijoheshin zakonisht në katunde që ishin një-komunikacione, ^B nëpër rrugët partizane. Kishin një komandant (zakonisht jo anëtar partie,

SECRET

SECRET

por person me influence ne ate reth katundesh), nje nen/komandant (zakonisht anetar partie) dhe qe ish ne fakt komandanti i vertete dhe nje sekretar (gjithashtu anetar partie) qe ish dera e djathte e nen/komandantit. Keta te tre persona perbenin kryesine e Komandes se vendit. Afer kryesis se Komandes se vendit qendronte nje intendenti, i cili ish njekokesisht edhe llogaritar e magazinier. Tri te pare, domethene komandanti, nen-komandanti dhe sekretari qene oficera inferiore (teger, nentoger, aspirant). I fundit, domethene intendenti, ish nen-oficere. Perverc ketyre, cdo komande vendi kish edhe nje grup partizanesh, numuri i te cileve ndryshonte sipas rastit: per gjithmone reth 20 vete.

Keto komanda te vendit (qe ~~perbenin~~ ^{ishte rreth 20 vete} nje grup fshatrash) vareshin nga komanda e vendit te qarkut. Komanda e vendit te qarkut ishte formalisht organi me i larte; dhe zyrtarisht konsiderohesh si organ autonom. Ne fakt, komanda e vendit ~~te qarkut~~ varesh (nepermjet sekretarit te saj, anetar partie) nga Komiteti qarkor i artise; (nepermjet nenkomandantit te saj, anetar partie) nga Shtabi i qarkut (qe kish te bente me forcat ~~partizane~~ ^{territoriale} partizane te atij qarku); dhe nepermjet komandantit te saj (qe ne qark ish anetar partie) nga Keshilli nacional ~~qendror~~ ^{qendror} clirimitar i qarkut).

Gilat qene, konkretisht, detyrat e komandave te vendit.

a) Te ruanin rendin, duke u ardhur ne ndihme me fuqin e tyre te armatosur, Keshillave nacional-clirimitare; konkretisht: te ndiqnin kriminelet, vjedhesit, kunder-vajtesit e ndryshem dhe t'i denonin keta. (Per raste te vegla merrnin vendime e denonim autonomisht. Per raste te rendesishme udhezeshin nga Komanda e vendit te qarkut). Keto detyra, qe kishin te benin me teper me detyrat e nje policie kriminale, ishin ne kompetencat e Komandantit.

b) Te gjurmonin, te arrestonin dhe te mbanin nen-verrejtje (deri sa te vendoste mbi fatin e tyre komanda e ~~qarkut~~ vendit te qarkut) persona te dyshimte per veprimtarin e tyre te spiunazhit ne favor te armikut, te sabotazhit, etj. Keto detyra, qe kishin te benin me teper me detyrat e nje policie politike, ishin ne kompetencat e nen-komandantit. Me qene se rastet e kesaj kategorie kishin kurdohere nje fare rendesie, komandes se vendit nuk i ish ~~ndone~~ ^{zane} ndonje autonomi e inisjative ekzekutive. Cdo veprim ne kete fushe duhet te kish aprovimin e Komandes se vendit te qarkut.

c) Te mobilizenin kafshe e mjete te ndryshme transporti per nevojat e

SECRET

SECRET

ushtrise partizane, te grumbullonin ushqime te castit per te furnizuar repartet partizane ne pozicion lufte, te sigurimin percjelljen (si udheheqes sepse i dinin rruget) te korriereve te reparteve partizane, etj. etj. Keto detyra ish-in me teper ne kompetencat e sekretarit te Komandes se vendit.

Disa verretje mbi komandat e vendit te asaj kohe. Ato nuk kishin as au-teritet, as rendesi. Partia caktonte ne keto komanda vendi kuadrot e saj me te dobeta: frikamanet, njerezit e semure, invalidet, te pazotet. Kuadrot me te zenjat, me te aftat, me besniket, i caktonte ne ushtrene partizane. Ne fakt, qe periode lufte. Armiku ishte i armatosur, qe ky italian ose gjerman-domethene i jashtem, qe ballist ose zogist, domethene i brendeshem. Te gjitha ceshtjet qe kishin te benin me kundershatare te armatosur (dhe te tille ish-in gati te gjitha kundershataret e komunizmit atehere ne Shqiperi) zgjidhe-shin nga repartet partizane, ose me mire nga komandat e ketyre reparteve. Ne kompetencat e komandave te vendit ish-in vetem ceshtjet qe kishin te benin me kundershataret e pa-armatosur, domethene me popullsi civile. Rushteti ke-munist nuk qe vendosur definitivisht, nuk kish nje qeveri komuniste, etj. Ne ate situat, eshte e natyreshme qe edhe roli e rendesia e organeve te siguri-mit te ishte gati zero. Aktiviteti subversiv, aktiviteti klandestin qe eshte ne kompetencat e organeve te sigurimit te cdo shteti, drejtohet kunder nje pushteti e qeveris qe ka ardhur ne fuqi. Atehere ne Shqiperi komunistet nuk kishin ardhur akoma ne fuqi. Roli i aktivitetit klandestin, pra, s'kish ndonje kuptim. Tere roli dhe rendesia i takonte luftes se hapet, aktivitetit te arma-tosur legale. "e kete aktivitet te armatosur legal, te hapet, kishin te benin repartet partizane. Dhe roli i komandave te vendit, ishte, per paseje e llo-gjikisht, vetem nje rol shum i kufizuar e modest ndihmes.

Funa eshte krejt e ndryshme se. Rushteti komunist eshte ne fuqi ne te gjith Shqiperine. Qeveria komuniste e Tiranes drejton tere vendin. Lufta e hapet legale e armatosur ka mare fund qe nga mbarimi i ~~1944~~ 1944-es. Kundershata-ret nuk jane me legale por ilegale, klandestine. E tille eshte edhe veprimta-ria e tyre. "e keto kondita eshte e natyreshme qe roli i Sigurimit, roli i organeve te tij te jete i deres se pare.

PERIODA E "MOROTJES SE POPULLIT"...

Ne tetorin e 1944-es, domethene ne pragun e "clirimit" te Shqiperise, Partia komuniste bori nje ricorganizim

SECRET

SECRET - 163-

krejt fushat e aktivitetit te saj. Para se gjithash u formua qeveria e pare komuniste. Marrja e pushtetit shtronte edhe detyra te reja ne fushen e organizimit. U krijua, pra, Drejtoria e Mbrojtjes se Popullit.

Drejtoria e Mbrojtjes se Popullit ishte nje drejtori autonome. Ajo nuk vareshe nga asnje dikaster. Titulli i saj i plote ish: Drejtoria e pergjitheshme e Mbrojtjes se Popullit.

Drejtor i kesaj drejtorie u emerua Koci i Xoxes, sekretari organizativ i Komitetit qendror te Partis komuniste shqiptare dhe personi Nr. 2 ne hierarkin komuniste. Si nen/drejtor u emerua Nesti Kerenxhiu. Si pergjegjes i ketij sektori, Koci i Xoxes emerei ne sektorin e "Mbrojtjes se Popullit" kuadre partie qe ishin te njohura per besnikerin e tyre te verber ndaj partise, per ashpersi in e tyre ne aktivitetin e ~~shqiptare~~ deri atehere, per idete e ngurta dhe bindjen e verber. Zakonisht qene kuadre qe me perpara kishin ushtruar funksione partie ne ushtri (zevendes-komisare) dhe qe njiheshin mire nga Koci i Xoxes, sepse pikerisht ky kish te bente atehere direkt me punet e Partise.

Krahas me Drejtorin e pergjitheshme te ~~figuronit~~ Mbrojtjes se Popullit, u organizuan atehere:

a) Brigadat e Mbrojtjes se Popullit, trupa partizane me efektiva te zgjedhur, si ne personelin graduat ashtu edhe ne ate jo graduat. Detyrat e ketyre brigadave ishin: ndjekja e reparteve balliste e armike ne pergjithesi, qe, sapo kishin filluar te fshiheshin sepse gati i krejt shqiperia kish rene ne dore te komunisteve; arrestimet dhe ekzekutimet e disa personave, per te cilat partia kishte bere lista te posacme, ne qytetet ku priteshin te hynin nga casti ne cast komunistet (percaktoj se ne keto lista kish personat qe duheshin arestuar; disa prej tyre do te mbaheshin nen verrejte deri sa te gjykoheshin; te tjeret qe figuronin ne keto lista do te pushkateheshin fshehtesisht sapo te arestoheshin); mbajtja e regullit neper qytetet.

Mbrojtjes se Popullit
b) Seksionet e ~~figuronit~~ (ne cdo qytet, ose me mire qender qarku). Keto seksione bashkepunonin ngushte me komandat e Brigadave te Mbrojtjes se popullit.

c) Oficeret e mbrojtjes se popullit prane komandave partizane (nga batalien e lart). Kuadre graduate te tilla ushtarake nuk kish patur deri atehere ne repartet partizane.

Shenim: Roli i komandave te vendit ish zero ne keto periede. Ate as qe

SECRET

SECRET

104 164

i pyeste e perfillte njeri. Kuaften vetem kompetencat qe kishin te benin me ceshtjet kriminale; duke mbetur ~~nga~~ si organe te policise Gradualisht, ate u cduken dhe ne vend te tyre u krijuan organet e policise.

PERIODA: "SIGURIM".

Fillon, ne mbaj mend mire, aty nga 1946 (fundi i vitit) Drejtoria e Mbrojtjes se Popullit riorganizohet krejt. Cduken komandat e vendit dhe krijohen organet e policise; e cila lidhet organikisht me Sigurimin, dhe ky, nga drejtori autonome behet aneks i Ministris se Brendeshme, me minister Keci Xoxen dhe drejtor te pergjithesem te Sigurimit Nesti Aerenxhine. Brigadat e "Mbrojtjes se Popullit" humbin nga kompetencat e tyre. Ate mbeten vetem reparte per ndjekjen e te arratisurve ne mal, dhe gradualisht ndrojne edhe emrin e tyre, duke u quajtur "brigada te ndjekjes".

Arrestimet, hetimet, etj. qe beheshin me perpara nga Komandat e Brigadave te Mbrojtjes se Popullit ne bashkepunim me seksionet e Mbrojtjes se popullit, mbeten ~~vetem~~ kompetenca te vetem seksioneve te Sigurimit dhe te organeve ndihmese te Sigurimit: polici, etj. Rolet kemebehen: armiku i armatosur, domethene te arratisurit ~~shpesh~~ ne mal, luftimi i ketyre, hyn ne kompetencat e Brigadave te Mbrojtjes se Popullit ese "brigadave te ndjekjes". Armiku i fshehte ne qytet hyn ne kompetencat e organeve te Sigurimit.

Mbi stukturën e "Mbrojtjes se Popullit" dhe ate te "Sigurimit" me von nuk kam shkruar gje sepse nuk di. Di kete se ne 1944 "Mbrojtja e Popullit" u organizua ne Shqiperi sipas shembullit dhe eksperiences se "OZNAS" jugosllave. Sigurimi i pare, ay i Keci Xoxes (sipas shembullit dhe eksperiences se UDB-se jugosllave. Sigurimi i Mehmet Shehut/sipas eksperiences dhe shembullit te NKV D.

SECRET

SECRET - 165 -

PRËRGJIGJE PYETJES

A është e mundur që Shqipëria, në situatën e sotme, të mbajë një pozite ndërmjetëse midis të dy bloqeve, me fjale të tjera të jete krajt e pavarur si shtet.

Pyetjen në fjale do ta gjeneralizoj me tepër, duke marrë vecmas disa eventualitete, për të dhënë pastaj opinionin tim personal.

Dihet se Shqipëria, që kurse u formua si shtet i pavarur me kufijtë e sotme të saj, nuk ka qenë kurrë shtet i pavarur nga fuqitë e huaja (në kuptimin e plote që i japim pavaresisë). Historia e saj e re ndahet në tri periudha:

a) Perioda e parë - ose perioda e Republikës. Ajo zgjati shumë pak kohë. Ishte me tepër një periode përgatitore që celi rrugën për ardhjen e regjimit monarkik, me mbret Ahmet Zogun. Gjatë kësaj periode, që më fund sikurse thashe me "triumfin e "egalitetit", Shqipëria ~~shfaq~~ sado që shtet i pavarur, varët kryekeput nga fuqitë e huaja: Italia, Anglia dhe Jugosllavia. Italia ka privilegjet më të mëdha, sepse si shtet fq i jep huara të ndryshme Shqipërisë. Anglia vjen e dyta, sepse i janë njohur disa koncesione; Jugosllavia vjen e treta, për arsye sepse Zogu nuk harron që u kthye në Shqipëri më 1924, dhe triumfoi mbi Fan Nolin, pikërisht me ndihmën jugosllave. Në perioden e parë, pra, në Shqipëri e bëjnë ligjvënës kryes shtet tri fuqi të huaja: Italia, Anglia, Jugosllavia.

b) Perioda e dytë - ose perioda e monarkisë, me mbret Zogun. Gradualisht, por sistematikisht, Italia, për arsye të njohura strategjike, eliminon Jugosllavinë dhe pastaj edhe Anglinë duke realizuar okupacionin ekonomik. Kjo periode, pra, është perioda e forcimit të pozitave të Italisë në Shqipëri në dem të fuqive të tjera të huaja që deri atëherë kishin njëfarë influence në Shqipëri. Shqipëria kthehet, praktikisht, në këtë kohë, në një koloni italiane, sado që formalisht është shtet i pavarur dhe i pavarur.

c) Perioda e tretë - ose perioda e okupacionit ushtarak italian. Dihet se okupacioni ekonomik italian në Shqipëri përgatiti dhe ~~ishte~~ i celi rrugën okupacionit ushtarak, i cili u bë një fakt i kryer më 1939. Kështu Shqipëria hyn në suazën e perandorisë Italiane, me mbret Viktor Emanuelin e III-të. Humbet ~~sovereaniteti~~ ^{sovereaniteti}.

d) Perioda e katërt fillon pas mbarimit të luftës së dytë, domethënë më 1945, dhe është perioda e parë e regjimit komunist në Shqipëri, ku predominencën absolute e ka një fuqi e huaj: Jugosllavia e Titos. Arsyet që shpune në ndryshimin e kësaj situatë, dihen shprehurja e Titos nga Kominformi dhe ~~shprehurja~~ lidhja e Shqipërisë me Kominformin.

SECRET

SECRET - 16 -

e) perioda e peste Fillon ne veren e 1948, dhe eshte perioda e dyte e regjimit komunist shqiptar, por jo me predominencen absolute te Jugosllavis, por te Rusise.

Dikurse shihet, pra, Shqiperia vazhdimisht ka qene ndene vartesine absolute (dhe jo "aleate" e kesaj ose asaj fuqie te huaj) te nje shteti tjetere ne fillim te Italis; pastaj - te Jugosllavis; se fundit - te Rusise.

Ky fakt historik nuk eshte nje ko incidence - por vete poziten e saj strategjike, per vete potencen e saj ekonomike, Shqiperia, si shtet i vogel, ne lufte e sotme, nuk mund te i toje si shtet plotesisht i pavarur. Interesat e te huajve mbi te jane te medha, keshtu qe do s'ido ajo do te bje ndene vartesine e nje shteti te huaj, sepse vete nuk ka as mundesine ekonomike, as mundesine ushtarake, as neshan e nvojtesha politike ne anen nderkombetare qe te jetoje plotesisht i pavarur. Paze e dobet ekonomiko-politike mbi te cilen mbeshtetet si shtet, e detyron pa tjetere te kerkoje perkrahejen e nje fuqie te huaj, perkraheje e cila kthehet automatikisht me von ne nje vartesi.

~~xxxxxxxxxxxxxxxx~~ Por a do te thote ~~ky~~ sa thashe deri tani se Shqiperia nuk mundet te kete edhe nje vartesi formale? Opinioni tim personal eshte ^{se} me kufite e sotme, ne mos ~~shqiperia~~ ^{si} ka mundesine te jete si shtet plotesisht independent dhe i pavarur, ^{shqiperia ndofes} ka mundesi qe te jetoje si shtet independent me nje vartesi te kufizuar. ~~Shqiperia nuk mundet te jete shtet i pavarur. Natyrisht nje~~ gje e tille nuk varret aqe shume nga ajo vete. Shpjegohem: Dot bota eshte e ndare ne dy blloqe. Deri tani, Rusia ka ushtruar nje presion te forte mbi satelitet e tij. Ky presion ka bere qe jo vetem Shqiperia e vogel, por edhe Cekoslovakia e madhe te jete ndene vartesine absolute te Moskes. I vetmi shtet qe beri perjashtim nga ky regull ne bllokun lindor, ishte Jugosllavia. Por Jugosllavia i rezistoi me sukses nje presioni dhe bllokade te tmerreshme ekonomiko-politike, se ciles Shqiperia nuk mundet t'i rezistonte dhe as qe t'i rezistojte. Mundesia qe Shqiperia, sa kohe qe ne ate vend sundojne komunistet, te ndjekin shembullin e Jugosllavis perjashtohet, per deri sa mbi te do te ushtrohet kontrolli sovjetik. Jo te leshohet ky kontroll, punet mund te jene ndryshe. Por me ~~nuk~~ duket se te pretendohet qe Rusia te heqe dore ne dobi te perendimit nga kontrolli absolut i saj mbi Shqiperine, eshte nje eventualitet qesharak. Shqiperia, pra, nuk mundet te kaloje ne blokun e perendimit, me maredhenie shume me te lira ^{branda vendit qe rezistojte pushtete komunist me pasqyre legjitime} me shtetet e tjere, sa kohe qe ~~me~~ ^{kontrollin sovjetik nga jashte}

SECRET

SECRET

- 167 -

Konkluzioni tim pra: ne situaten e sotme midis te dy bloqeve ne fushen nde-
 rkombetare, Shqiperia nuk mundet te ndjeki shembullin e Jugosllavise si shtet
 me vete. Ajo nuk ka mundesite te perballoje presionet e jashtme me sukses. Ajo
 eshte e destinuar t'i neneshtrohet Moskes, sepse ne saje te kotij neneshtrimi
 varet ekzistenca e pushtetit komunist, vete ekzistenca e qeveris komuniste, dhe
 ne fund te fundit ekzistenca e saj si shtet me kufijt e sotme. qeveritaret e
 sotme te Tiranes e dine se kane te gjitha ~~mundesite~~ perfitimet me Mosken. Ata
 druaje nga perendimi shume gjera: mungesen e perkrahjes ne ceshtjen e Vorio-
 spirit (perkrahje te cilen e ka patur deri me sot nga Rusia), mungesen e perk-
 rahjes politike (perendimi nuk mund te pajtohet me nje regjim komunist si ate
 te Tiranes, ku ligjin e ben vetem nje parti, e cila ka vendosur ne vend nje dik-
 tature te eger ushtarako-policore) - perkrahje te cilen e kane patur deri me
 sot me te dyart nga Rusia; etj.

pra, situata e brendeshme ^{tashme e} vendit, lidhur me ate te jashtmen, e destino-
 jne Shqiperine edhe sot, sikurse ne te kaluaren, qe te jete kurdohere ndene var-
 tesine absolute te nje fuqie te huaj.

Kjo eshte e vertete jo vetem me kufijt e sotme te Shqiperise, por edhe me
 nje Shqiperi te cinguar, domethene me nje Shqiperi ne Vorio-Jupirin* te lichte me
 kete pike, opinioni tim eshte:

qeveria e Tiranes nuk do te pranoje ne asnje menyre shkeputjen e Vorio Spi-
 rit nga Shqiperia. Ajo e di se vete hartimari e Shqiperise perbehet nga Korca e
 Gjirokastra. se te dyja mjaft te pasura ekonomikisht. e te dyja me nje popullsi
 qe e ka ndihmuar -artine ~~ekonomike~~ per te ardhur ne pushtet dhe per ta mbajtur
 pushtetin; qe te dyja me nje popullsi mjaft te dendur; qe te dyja me qytetet me
 kryesore te vendit; ~~si pikes~~ qe te dyja si krahinat me te perparuara te vendit;
 qe te dyja vatra te rendesishme per furnizimin ~~ekonomik~~ ^{me kuadro} aparatit shteteror; etj.
 etj..

Opinionimi tim eshte gjithashtu se edhe Rusia nuk do te perkrahte ~~qeverine~~ Greqi-
 ne ne rivendikimet e saj mbi Vorio-spirin. Shqiperia i siguron asaj nje base te
 rendesishme ne Adriatik. Shqiperia pa Korcen e Gjirokastren, nuk i vlen asnje
 dysh edhe Rusise. Tani qe Rusia po ben cmos per te siguruar nje dalje ne Mesdhe
 me duket se rendesia e bregdetit shqiotar ne Adriatik mer per te nje rendesi
 akoma me te madhe se ne te kaluaren. Rusia mund te ishte per nje Shqiperi ne
 kuadrin e Republikes Federative Jugosllave, po per nje Shqiperi me kufijt e so-
 tme, dhe jo per nje Shqiperi te cinguar. ^{Shqoqofte}, e perserit, ky eshte nje

SECRET

SECRET

- 16 -

eventualitet ~~XXXXX~~ i se arthmes se larget, dhe jo i se arthmes se aferme. Cungimi i Shqiperise (domethene shkeputja e Vorio-Spirit prej saj) me duket se eshte nje koncesion te cilin Rusia e konsideron si te papranueshem. Inkuadrimin e Shqiperise, me kufijt e sotme, ne suazen e Republikes federative jugosllavia, mendoj se Rusia e konsideron si nje koncesion te pranueshem, por ne te arthmen jo shume te afert.

Del pyetja ne kete mes: po qendrimi i Beogradit personalisht kam qendruar shume kohe ne Jugosllavi dhe kam patur rastin te bisedoj me persona te ndryshem dhe personalitete. Mirepo kjo ndodhte ketu e ~~XXXX~~ 8-9 vjet me pare. Sidoqofte, konkluzioni ne te cilin kisha arritur atehere eshte ky: Jugosllavia nuk pranon ne asnje menyre atehere shkeputjen e Vorio-Spirit nga Shqiperia. Tere politika jugosllave synonte ne shpiksimin e krajt Shqiperise nepermjet futjes se kesaj te fundit ne Republiken federative. Atehere Jugosllavia nuk pranonte as nje nderhyrje te Greqis ne Shqiperi. Por qe atehere kane kaular disa vjete dhe kane ndodhur shume evenimente te cilat i heqin nje fare force konkluzionit tim. Sidoqofte edhe sot une mendoj se oreksi jugosllav eshte i madh dhe sot une mendoj (opinion shume personal dhe i dhene me rezerva) se Jugosllavia nuk do te pranonte ndarjen e Shqiperise me dysh: Vorio-Spirit, Greqia, dhe ^{e Shqiperis} Variun/Beogradi.

Vikurse shihet, ora, qenia e Shqiperis si shtet ~~XXXXXX~~ independent eshte i mundur, per mendimin tim, me kufijt e sotme, por vetem me konditen qe shteti shqiptar te jete ndane vartesine qofte te Rusise, qofte te Jugosllavise. Qenia e Shqiperise, pa Vorio-Spirit, si shtet independent, eshte i pamundur. Shkeputja e Vorio-Spirit do te sillte automatikisht ne kete rast futjen e Shqiperise se Variut, si Republike e federuar (ndofta edhe me Kosoven) ne gjirin e Republikes federative jugosllave. Ne pak fjale: Shqiperi nuk do te ekzistonte.

Ne lidhje me sa me sipër, duad te shkaroj: Partia komuniste shqiptare nuk do te desh ne asnje menyre shkeputjen e Vorio-Spirit. Partia nuk do njehohesht as futjen e Shqiperise, me kufijt e sotme, ne suazen e Republikes federative jugosllave. Bile, Tirana, nuk do te deshte as nje shtet independent shqiptar ~~XXXX~~ ndane vartesine e Beogradit (si me 1944-1947). Si mire se opinioni i mases se vartis dhe i udhheguesve ne Shqiperi eshte: Shqiperia te jete shtet komunist, sa me i pavarur nga Rusia por "aleat" i ngushte dhe besnik i Moskes, jo i nenshtuar tek Beogradi por me maredhenie reciprokisht te barabarta me Jugosllavine. Sidoqofte, kjo eshte opinioni i ~~XXXX~~ - "Tiranes". Por qe nga deshirat tek mundesite ka nje difference te madhe. Randaj, me qene se nuk ka mundesite,

SECRET

SECRET - 169 -

Tirana, sado qe kunder vullnetit te saj, do t'i bindeshe urdherit te moskes po qe se Rusia do t'i kerkonte te rifillonte maredhëniet e "perzemerta" qe kish me Beogradin deri nga 1948, domethene do te pranonte neneshtimin e saj tek Jugosllavia e Titos. *see sepse nuk mund te veproje ndryshe. *a perkrahjen e Rusis, pa perkrahjen e Jugosllavis po t'i mungoje perkrahja ruse, Shqipëria si shtet independent, me kufijte e sotme, eshte e pamundur te ekzistojte. *e lene, pra, ne meshiren e Titos, Shqipëria/^{komuniste} do s'do do te pranonte neneshtimin e saj tek Jugosllavia, bile edhe inkuadrimin e saj si republike e federuar. *or opinioni tim eshte se Partia komuniste dhe qeveria e Tiranes nuk do te pranonin kurre shkeputjen e Vlorës. Mendoj se Shqipëria do mbeteshe pa qeveri komuniste ne rast se Moska ose Beogradi i imponojne Tiranes shkeputjen e Korces dhe Gjirokastrës. Do te krijoheshe nje situatë anarqike ku nuk do ta merrte vesh i pari te dytën ku lufta civile do te ndizeshe per t'u shpëtur nga fuqite e huaja ^{sidomos} ^{pa} ^q ^{do} ^{te} ^{admirim}

Me duket se ne vija te trasha shpjegova deri diku nje problem shume delikat, prandaj, te gjitha opinionet e mijs ne kete bergjigje i jap me rezerva te medha, si mendime shume personale.

SECRET

SECRET 190 -

PARAGJJE RILITJES
 ka rivendikime nga ana shqiptare persa i perket:
 a) tokes greke;
 b) tokes jugoallave.

Ne te shpjegohem me mire reth kesaj pyetjeje do te pergjigjem me periodes:
 - periodes e pare 1945 - 1955 (kundrejt Greqise). Shqiperia komuniste kur-
 rre nuk ka avancuar pretendime te cfare dshme tokesore persa i perket tokes
 greke. Rivendikime nga ana e Shqiperise persa i perket tokes greke jane bere
 vetem gjate okupacionit italian. Keto rivendikime (qe nuk i perkasin kesaj
 periodes, domethene periodes te pushtetit komunist) kishin te benin me Camuri-
 ne. or kurre, e perserit, Shqiperia nuk ka patur ide te sakta mbi tokat qe
 rivendikonte. Cameria ka qene kurdohere nje fjale abstrakte dhe jo dicka me
 kufi te caktuara. Here, per shembull, shtriheshe deri ne Janine, here shume
 me afer kufirit shqiptar, here tjeter perfshinte "revezen", here shkonte edhe
 me brenda Janines; etj. Sidoqofte, pushteti komunist nuk ka avancuar rivendi-
 kime mbi as mbi Camerine, as mbi "revezen", as mbi Janinen, as edhe mbi nje
 pellembe toke greke.

Krejt ndryshe paraqitet puna ne liche me Jugosllavine.

- periodes e pare (1945 - 1948). Severia e Tiranese dhe Partia komuniste shqi-
 ptare jo vetem qe nuk mund te rivendikonin toka shqiptare ne Jugosllavi ate-
 here (sepse te tilla ish-in maredheniet ~~xxxx~~ jugosllavo-shqiptare) por trupat
 partizane shqiptare i kane dhene nje ndihme te madhe Titos per te moshtur
 me anen e forces dhe te armeve levizjen kosovare anti-jugosllave dhe per bashkim
 me Shqiperine, qe ishte mjaft e organizuar dhe e efektshme nga fundi i 1944-es
 dhe fillimi i 1945. Vec kesaj, kane qene trupat e Divizionit te V-te shqiptar
 ato qe hyjten me pare ne qytetet shqiptare te Kosoves (pas largimit te gjermane-
 ve) dhe qe u a dorezuan me von trupave te Titos. Trupat e Titos priteshin
 atehere ne Kosove kudo me pushke. Ne treti kane qene trupat e Divizioni te
 V-te shqiptar ato qe carmatosen popullsine kosovare ne Jugosllavi, me flamurin
 shqiptar paipara.

- periodes e dyte (1948-1949). Maredheniet shqiptaro-jugosllave acarohen ne
 maksimum. Mirepo Tirana akoma nuk kish hedhur parullan per rivendikimin e Koso-
 ves. Ndofta sepse mendohesh akoma qe Titua do te rrezohesh.

- periodes e trete (1950-1952). Ne shembullin e Bullgarise, qe hodhi parullat
 dhe filloi rivendikimet per krahinen e Pirinit ne Makedonine e Titos, edhe

SECRET

SECRET - 171 -

Tirana fillon te rivendikojte krahinen e ~~Sovjetike~~ Kosoves ne shtyp e ~~stalinistike~~ fjalime te mbajtura nga personalitete te potohen bile dokumenta te shumta qe bejne fjale mbi "terrorin" dhe masakrat e vjetra te Titos e te reja mbi minoritetin shqiptar, dhe filtet jo si minoritet shqiptar ne Kosove, por si popullsi shqiptare e Kosoves (nuance e qarte qe tregun se Kosova nuk ka minoritet shqiptar, por edhe shqiptare).

Perioda e katert (1953-1955) Vdekja e Stalinit i dha fund kesaj propagande. Duket, pra, sipas orientimit te dhene nga Moskua Tirana i jep fund jo vetem fushates ne lidhje me rivendikimet e saj kunder kosoves shqiptare, por edhe fushates se saj drejtuar pergjithesisht ne shtyp e propagande kunder Jugosllavise. Te gjitha shenjat tregonin, pra, se ishte duke u bere nje ndryshim ne politiken e Moskes, ndryshim qe synonte te zbutet ~~ac~~ acarimin me Jugosllavine dhe ta afronte gradualisht kete ne blokun e shteteve socialiste. Shkurt, pra, qe nga 1953 shqiperia nuk ka bere asnje rivendikim kokesor edhe kunder Jugosllavise.

Me gjate mendoj se nuk ka c' te thom mbi kete pike. Mendoj se ndarja ne perioda ka qene e nevojeshme, sepse ndryshe me ishte e pamundur te shprehja idete qartesisht.

SECRET

SECRET

- 192 -

SHQIPERIA

A ekziston ne Shqiperi nje rryme ose tendence politike per bashkim te Shqiperise me Jugosllavine, si republike e federuar ne Federate n Jugosllave

~~XXXXXXXXXX~~

Ne Shqiperi nuk ka ekzistuar kurre nje rryme politike per futjen e Shqiperise, qofte edhe si republike autonome, (pa~~xi~~ e federuar) ne kuadrin e Federates jugosllave. Ne Shqiperi ka patur vetem disa antare te Komitetit qendror te Partise me pike, amje te tilla, dhe pikerisht keta nje e rez kane qene: Koci i Xoxes, Fandi i Kristos, Rellumb Dishnica, Kristo Themelkua dhe ndonje tjeter, (biografite e te cileve i kam dhene ne pyetjet e mepraeshme). As masa e Partise, as opinioni publik shqiptar nuk kane dashur futjen e Shqiperis ne Federaten jugosllave. Bile jap nje fakt karakteristik.

Nga fundi i 1946, komiteti qendror i Partis komuniste jugosllave i propozoj atehere Komitetit qendror te partis komuniste shqiptare qe te lejonte dhe aprovonte hyrjen e disa divizioneve jugosllave ne token shqiptare, sidomos ne krahinen e Korces dhe Gjirokastrës. Duke avancuar kete propozim te cuditeshem, Komiteti qendror i Partis komuniste jugosllave avanconte si pretekst dhe justifikim "rrezikun monarkofasisht grek", friken e "nje sulmi nga ana e Athines", - shkurt invazionin ushtarak te tokes shqiptare nga Greqia. Ne lidhje me kete propozim, Komiteti qendror i partis komuniste shqiptare eshte mbledhur dita here (sepse ngrihesha si problem i madh nga Koci i Xoxes) per te mare nje vendim, por kurdohere, rezultati ka qene: shumica ishte kunder ardhjes se divizioneve jugosllave ne Shqiperi, sepse e shikonte qarte qe hyrja e ketyre divizioneve do te thoshte automatikisht shndrimin e Shqiperis ne republike te federuar te Federates jugosllave.

Thashë se ne Shqiperi nuk ka patur nje rryme ose tendence per futjen e Shqiperise ne Federaten jugosllave. Mbet te shtoj se ne Jugosllavi ka ekzistuar, dhe me force, nje projekt i tille jo vetem ne masen e Partise, por edhe ne Komitetin qendror. Pa kohe qe kam qendruar ne Jugosllavi, kisha rastin te takohesha me tyrlin njerez. Jam takuar me antare te thjeshte partie dhe ne bisedimet me ta shikonja se ata e konsideronin perfshirjen e Shqiperis ne Federaten jugosllave si nje ~~XXXX~~ eveniment te pashmangeshem dhe shume te afert, si nje ngjarje qe kish mbetur e perealizuar vetem e vetem sepse e pengonin "raportet politike ne fushen nderkombetare" dhe jo raportet "midis te dy vendeve". Jam takuar edhe me personalitete te partis ose te Ministris

SECRET

SECRET- 12 -

se jashtme jugosllave ose te aparatit propagandistik te partise. Edhe keta, vecse ne nje menyre me te maskuar, te njejten tendence tregonin: perfshirjen e arthme te Shqiperis ne Federaten jugosllave. Bile cdo cangim i Shqiperise, sado i vogel ne ~~shkoll~~ dobi te Greqise, perjashtohesh. Ne bisedime, per shembull me ambasadorin e sotme te Jugosllavis ne Vashinkton, ose me Velebitin, ~~ky~~ ish nenminister i jashtem, Koshin (ish drejtor i departamentit te shtypit), drejtorin e gazetes Borba, presidentin e Minise jugosllave, Rato Jugonicin (~~ish~~ anetar i Komitetit qendror) etj. (bisedime shoqerore, jo zyrtare) kam pare qarte se opinioni i tyre ishte ky: Jugosllavia preferonte me mire nje Shqiperi shtet borgjez, se sa nje ~~Shqiperi~~ gjysme Shqiperi ne Kuadrin e Federates Jugosllave dhe gjysmen nene Greqine. Mendimi i tyre ishte se dalja e Greqise ne Adriatik, afer Vlores, prekte jasatezakonisht demeshem interesat e Jugosllavise ne Adriatik, sepse Jugosllavia, ne nje rast te tille duhesh te perballonte ne kete det jo vetem Italine, por edhe Greqine. For, e perserit: keto opinione jugosllave ishin nga 1947. ~~me ate here~~ kane ndodhur shume evenimente. A e kane ndruar opinionin jugosllav keto evenimente. Mendimi tim eshte i ~~qart~~ ^{qart}.

Ohtoj me kete rast se Komiteti qendror i Partis komuniste shqiptare, pas prishjes se marrëdhënieve me Titon, ka bere nje deklarate ^(ndofte demagogjike) sipas se ciles Moshajade ka biseduar ne Organizaten e Kombeve te Bashkuara (aty nga 1946-1947) me perfaqesuesin e qeveris greke ^{greqe} per copetimin e Shqiperise. Vorio spirin ta mare Greqia dhe Shqiperin e liriut ta mare Jugosllavia. Me sa e vertete eshte kjo chenie, une nuk e di. Por kete eveniment e ka shballur vete Partia komuniste shqiptare, per ta demaskuar Titon si armik te Shqiperise dhe per ta vene ate ne nje radhe me Greqine. Me ky fakt (po te jete i vertete) vjen ne kundërshtim me sa kam biseduar une ne Jugosllavi, duket: ~~por~~ une nuk di si te them, dhe aqe me pak mund te di prapaskenen e politikës jugosllave. Kete eshte ne gjendje ta njohe me mire Greqia. Une jap opinionin tim te nxjerre si konklusion nga sa kam pare e degjuar me veshet e mija. Por veshet e mija nuk arrinin deri ne prapaskenen e politikës jugosllave.

Nuk di c'ete thom me gjate mbi kete pyetje; prandaj edhe i jap fund kesaj pergjigjeje ketu.

SECRET

SECRET - 194 -

PYETJE

Ne cilat qytete te Shqiperise ekzistojne Radio-stacione. Kush punon ader 'to. Ne cilin post. Eksponente dhe pershkrimi i tyre.

Ne Shqiperi ka vetem nje radiostacion ne krotimin e plote te kesaj tjelle. Ky eshte radiostacioni i Tiranes. Te tjerit jane krejt te parendesishem dhe quhen radiostacione lokale.

Pampara se te hvi ne hollesirat e kesaj pergjigjeje e quaj te nevojeshme te theksoj se kesaj pyetjeje i jam pergjigjur shume hollesisht dhe gjere gjate, qe sa me eshte e pamundur sot, ketu e nje vit e gjysme me pare, qofte ne Kostur kur jam mare ne pyetje heren e pare nga autoritetet greke qofte (sidomos) ne Glifadhe, kur jam mare ne pyetje nga autoritetet amerikane te cilat me mbajtten edhe nje kohe teper te gjate ne izolim. Sidomos, per cdo eventualitet, shenoj.

I vetmi radiostacion i rendesishem ne Shqiperi eshte Radio-Tirana. Vetem ky ka emisione dhe programe ne shkalle nacionale. Vetem ky ka programe ne gjuhe te huaja. Vetem ky ben propogande per boten e jashtme. Vetem ky ka fuqi e mjete teknike te degjohet brenda Shqiperise ne te kater anet dhe jashte kufijve te shtetit shqiptar.

Pers neli i tij perbehet si rason:

Ne krye te krejt kesaj drejtorie (qe eshte aneks i Ministris se arsimit dhe kultures) mendron Drejtori i Radio-Stationit: Petro Kita. Lindur ne Gjiro-kaster, dhe tani me moshe rreth 78 vjet. Anetar partie qe ne kohet e okupacionit Per nje kohe te shkurter ka qene anetar i qarkorit te Elbasanit, kur partia ish ne ilegalitet. Drejtor i Radio-Stationit qe norsa u cilrua Shqiperia. Person me nje kulture shume te kufizuar. Nuk ka kryer as gjimnazin. Me aftesira teper te kufizuara. E vetmia merite e tij: puntor shume i madh. Punon te pakten 14 ore cdo dite. Por muna e tij eshte pa perspektive, Ay nuk drejton, por vetem kontrollon. Dhe kontrolli i tij nuk eshte kontroll prej drejtuesi por kontroll prej ^{shandori} ~~shandori~~. Meret me presjet (sado qe nuk di as vete se ku vihen) dhe sidomos kujdesohet qe ne emisionet te mos thuhet as gje e re. Po qe se ne nje artikull ose shkrim te cfaredoshem shikon nje ide te re, qofte edhe brenda vijes se partise, e prish, e cduk, duke thene: "Pse ta themi ne te parat le t'a thote Zeri i Popullit ose ndonje organ tjeter i aparatit te Partise." Eshte shume frikaman se mos shkele vijen e partise, se mos beje gabime. E perserit: ky drejtor eshte nje kale hallucinorabaje, qe punon sa pelcet, meret me gjera te vogla, prish cdo fraze qe nuk e ka degjuar vete, por as eshte i

SECRET

SECRET - 495 -

xoti te drejtoje dhe as qe drejton. Vete shkruan shume ralle dhe shkrimet e tij jane jashtezakonisht te keqija. Zaten shkrimet e tij nuk jane nga ay vete, por fraze te viedhura andej ketej nga gazetaret e tjere, te lidhura akoma me keq midis tyre, qe perseritin idete e te tjereve, fjalet e te tjereve dhe me nje stil te rende halldup e me te keq se te tjereve.

Pas drejtorit vjen nenedrejtori. Ky quhet Alqi Kristo. Lindur ne Pavmet. Tani duhet te jete rreth 77 vjet. Eshte me kulture (ka kryer gjimnazin) por si domos eshte autodidakt. Flet anglishten, frengjishten dhe italishten. Eshte organizator i mire por gazetar i keq. Njeri qe meret me shume vokalisme. Shkruan ralle dhe ~~me~~ ^{mesme}. Meret me tepar me problemet e kultures se sa probleme politike. Si nenedrejtor ka ndene vartesine e tij personelin, administraten dhe aner teknike te drejtoris se Radio-Tiranes. Eshte nga ata njerez qe duan t'i vene pleshtit fre. Anetar partie qe nga viti 1941. Qe nga cilrimi e gjer me 1954 eshte mare kurdhore me pune te agitacionit gofte ne drejtorin e shtypit te ministris se jashtme gofte ne aparatit e Komitetit qendror per propaganden. I martuar, sikurse edhe drejtori, dhe me femije. Ka konsideracione te mira nga partia sepse eshte puntor, me origjine jo te pasur dhe anetar i vijeter partie. Gjate luftes ka qene shikuarin e partise ka hapur qe kuptet e bashketeles partiake ne te shpallur ne puna te pamund te merit. Killoqofte, pas cilimit, i kambi mjaft pozitivat e tij.

Si nenedrejtor ka ndene vartesine e tij:

a) Zyren nderkombetare te Radio-Tiranes.

b) Zyren teknike.

c) Zyren administrative.

d) Zyra e shkrimeve (fotografie).

Zyra nderkombetare eshte nje seksion qe meret me korespondencen e Radio Tiranes me boten e jashtme (degjuar nga Italia ose Franca) dhe drejtorit e vendeve te tjera te Lindies te radio-stacioneve (Billigani, Hunzani, Risti, etj) Meret ne shkrimitin e materialave propagandistike, ne lundrimin e shkrimeve ne Shqipëria ne keto vende dhe ne marrjen e shkrimeve nga keto vende ne Shqipëri. Kjo zyre ka ne tepar kontaktin e nje sekretarise. Përgjegjese e kesaj zyre eshte nje grua, emri i se ciles nuk ne kujtohet tani, por e kam dhene ne ~~shkrimeve~~. E kujtohem qe ka i pari Prifti. Nuk eshte ndonje person i rëndesidhem. Eshte anetar partie, ~~por shkrimet~~. Eshte tepar ambicioze dhe svnon te ngjitet lart. Per kete eshte e gatshme te djege cilindo. Por i ka duart e shkurtra qe te beje te kendete madha. **SECRET**

SECRET

- 497 -

korrespondent i Zeri te Popullit ne qarkun e Korces, dhe Fadil Pacrami, si kryeredaktor i ketij organi nuk ~~em~~ kish me aqe sy te mire sepse ^{Dh. Nini} deshte ta kishte grure me udhhehesisht e qarkut te Korces, gje qe e demtonte gazeten, ^{si korrespondent} sepse (nuk bente as nje kritike, nuk shkruante as nje shkrim ku te kritikonte qofte edhe nje sektor pune ne Korce. Thashe: u ngjit lart sepse ka fituar besimin e Vandush Vincanit, i cili eshte nje fare diktatori ne tere aparatun e shtypit dhe propagandes ne Shqiperi (me perjashtim te Zeri te Popullit, iku diktator eshte Fadil Pacrami).

*Te vohet ne kete te sessionit te korrespondenteve speciale, me pane shkruar tri jete; (***)*

Hysen Pojani eshte ~~korrespondent special~~. ^{Korrespondent special}. Edhe ky eshte nje Dhori Nini i dyt ne miniature. Por shkruan me mire se sa Dhori, tike qene organizator me i keq. Sidoqofte shumica e shkrimeve te tij jane te vjedhura nga shtypi sovjetik, sepse mer fraza te tera ~~mbi~~ nga perkthimet e Pravdes mbi probleme te ndryshme dhe i jep keto si te tijat. Po mos vati pamara dhjete komente te shtypit sovjetik mbi bujtesine sovjetike, per shembull, nuk mund te shkruaje mbi bujtesine shqiptare. Nga shkrimet sovjetike vjedh ato fraza teorike e pazimore qe pajtohen me situaten ne Shqiperi dhe keshtu i ben artikujt. Te njejten gje ben edhe kur eshte puna per nje koment mbi probleme nderkombetare. Ne kete rast, bile, ay nuk ben gje tjeter vecse shkurton artikujt e shtypit sovjetik dhe i jep si te tijat.

~~Tjeter redaktor me influenca~~ ^{Kohin me Dh. Nini me} Kete seksion eshte M. Sar Dekteshi. Lindur ne Korce. Eshte me i keq se Dhori i Ninit si karakter, fanatik komunist, ambicioz dhe intrigant gjer me te e prapa-ktheu. Sidoqofte si gazetar eshte me i mire i kesaj redaksie.

SEKSIONI MUZIKAL.- Ka pergjegjes Sofokli Afezollin. Lindur ne Hociisht dhe ~~xxx~~ rritur ne Durres. Nje nga gazetaret me te mire ne Shqiperi. Ka stil te mprefte, eshte i squar, i zoti, me idera te tijat dhe jo "magiaire" si te tjerit. Shkrimet e tij jane nga me te miret. Mund te shkruaje shume mire edhe mbi probleme nderkombetare, edhe mbi probleme te kultures edhe reportazhe literare nga aspektet e ndryshme te jetes ne Shqiperi. Konsiderohet si gazetar i mire, organizator i keq dhe jo me pozita shume te forta ne parti, sado qe eshte anetar partie qe ne kohen e okupacionit. Ndofta sepse eshte nga origjine e pasur, ndofta sepse ka idera te tijat ne shkrime qe nwanjehere (pa formuar shkelte te rrites se partise) dalin nga kufijt e ngushte te propagandes se thate ~~te rrites se partise~~ ^{Ka kulture enciklopedike dhe sillet} mire me vartesit e tij. Eshte ambicioz por jo i rrezikeshem dhe intrigant i

SECRET

SECRET

- 998 -

llojit Dhori Nini.

Ky seksion ka dy neneseksione: seksionin e diskotekes, me pergjegjese Violeta Papulin dhe seksionin e incizimeve artistike me pergjegjes Vehip Demin;

Qe te dy keta neneseksione te seksionit te muzikes lidhen me nen/shefin e seksionit ose ndihmesin e pare te Sofokli Afezollit, qe quhet Abdullah Grimci.

Abdullah Grimci: Eshte anetar partie por nuk ka konsideracion. Eshte me teper nje teknik muzikal. Ka disa kenze e marshe te kompozuar nga av vete. Eshte profesor muzike. Eshte si te themi njeriu qe meret me teper me anen e paraqitjes se bukur te gjerave, me anen artistike dhe jo me anen politike.

Vehip Demi, qe eshte shef i incizime artistike (domethene shef neneseksioni) - Shenime biografike mbi ketete person kam dhene ne pergjigjen: ceshtja game.

Violeta Papuli: Grua e Sotir Papulit, qe eshte kryeredaktor i gazetes Bashkimi, organ qendror i frontit demokratik te Shqiperise. Puna e saj eshte te gjeje disqet qe duhen dhene gjate emisioneve muzikale, ne bashkepunim te ngushte me Abdullah Grimcin. Eshte anetare partie. ~~Ka~~ Punon ne Radio Tirana qe ne moshe shume te re ~~2000~~ gati 17 vjec, domethene qe nga viti 1945, qe kurse u krijua drejtorja e Radio-Tiranes nga regjimi komunist. Eshte e pazonja per pune tjeter, po per muziken, nga praktika e madhe qe ka, ka fituar nje fare eksperience qe e ndihmon ne punen e saj.

SEKSIONI I JASHEM:- Ka si pergjegjes Firdia Veizin. Anetar i vjeter partie. E ka mbaruar luften me graden kapiten i L-re. Qe nga 1945 e deri me 1953 ka qene nenedrejtor i Radio-Tiranes. (Me perpara Radio-Tirana kish dy nenedrejtores). Eshte nga rethet e Himares dhe ka studiuar ne Korfuz. Di mire greqisht. Shume i ngurte, shume i ngushte ne mendimet e tij. Karakter i mbyllur ne veten e tij dhe autoritar. Gazetar i keq por organizator i mire. Eshte shume i pakenaqr sepse ka kerkuar kurdohere te largohet nga sektori i propagandes (sepse e shih edhe vete qe nuk jep) per te bere karriere ne nje sektor tjeter (fjala vjen ekonomik, ushtarak, etj). I martuar dhe me femije. Njeri qe nuk shqerohet dhe s'ka shoke. Ben sikur punon por ne fakt nxjerr shume pak pune, sado qe ri ne zyre per ore e ore te tera. Ndofta sepse i mungojne kapacitetet qe duhen ne gazetari. Shkruan ralle dhe keq.

SECRET

POOR ORIGINAL**SECRET**

T 100 -

Kaloj ne radiostacionet lokale te Shoiperise.

Radiostacione te tilla ka: Korca, Gjirokastra, Vucova, Kombinati dhe Shkodra. E theksoj: keto radio-stacione japin vete lize te brendesme ne nivern lokale. Wiale vete e shohet me duhetatino, shohet me budgesine ne as- sasin e tyre. Dersohen vete ne nje shtepi te kufizuar. Korca, ne shem- ball nuk desiohet as ne Tiran, as ne Birmokastan. Gjirokastra nuk degjo- het as ne Korca as ne Vlone. Shkodra nuk desiohet as ne Durres as ne Tiran e. Me teper se sa ka lajme keto radiostacione japin muzike. Ato lidhen me Radio Tiranen dhe transmetojne nga kjo me shume se gjysmen e materialeve propagandistike qe jepen Radio Tirana.

Une nuk njoh as nje nga drejtuesit e katyre radiostacioneve, sepse Radio Tirane nuk ka te beje aspak me keto institucione. Ato nuk varen as nga Radio Tirana, as nga ministria e arsimit. Ato varen nga komitetet ekze- kutive te rethave ku ndodhen te pranishme. E theksoj: nuk jane radio- stacione me karakter nacional. Qellimi i tyre, potencia teknike e tyre, kuadri i tyre eshte jashtezakonisht i kufizuar dhe fare i varandeshket.

SECRET

~~SECRET~~

BYROJE

Antare e Komitetit qendror te Partise e Shoiperise. Sa antare ka Komiteti i saj Qendror. Sa antare Byroje politike.
~~Antare e Komitetit qendror te Partise e Shoiperise. Sa antare ka Komiteti i saj Qendror. Sa antare Byroje politike.~~

Sipas te dhenave te Enver Hoxhes ne Kongresin e III-te te PPSH (maj 1956) sot Partia e punes se Shoiperise ka 42.700 antare efektive partie dhe 7 mije e ca kandidate partie.

Pyetjas rrebi sasine e antareve te K.Q te PPSH dhe Byros politike te saj i kam pergjigjur ne vjezitan e 15-te, domethene fane 76 te raportit tim: Sidiqofte percaktoj:

Antare te Komitetit qendror: rreth 25 vete (shifer skzakte nuk me kujtohet). Por shifra prej ²⁵ vetesh eshte e vlefshme perpara majit 1956, domethene perpara Kongresit te III-te te PPSH. Tani, numuri i antareve mund te jete ~~shume~~ me i madh ne Komitetin qendror. Une nuk e di seose nuk dispononja radio qe te degjonja ne Athine punimet e Kongresit te III-te.

Antare te Byros politike te Komitetit qendror: Perpara Kongresit te III-te (domethene dari ne maj te ketij viti): gjithesej 7 vete dhe konkretisht: Enver Hoxha, Mehmet Shahu, ~~Tedo Jakova~~ Hysni Kapo, Gogo Mushi, Beqir Balluku, Liri Belishova, Seif Doka. (Shenim: me perpara ishin antare Byroje edhe Tuk Jakova e Bedri Spahiu, por ata u perfashtuan qe ne Kongresin e II-te, dhe nuk u zevendesuan).

Kandidate te Komitetit qendror dari ne Kongresin e III-te: afro 7 vete.

Kandidate te Byrose politike ~~xxx~~ dari ne " " " : 3 vete dhe konkretisht: Pilo Peristeri, Rita Marko, Manush Hyftiu.

Shenim i pergjitheshem: e perserit, keto te dhena jane te vjetra seose Kongresi i ~~xxx~~ III-te ka bere pa tjetere ndryshime, ne mos shume te madha, te vogla, qe perberjen dhe sasine e antareve te Komitetit qendror, ndofta edhe te Byrose ^{qe une nuk i diqora dhe nuk i di.}

Me gjate ^{si me} ~~me~~ c'te thom rreth kesaj vjetjese.

SECRET